



Empowered lives.
Resilient nations.

PLANI STRATEGJIK PËR QARKUN E VLORËS

“Territor me Zero Emetime”

Dokumenti përfundimtar -
Qershor 2011

UNDP ART GOLD 2 Albania
www.artgold.undp.org.al



AULEDA
www.auleda.org

www.vloraregionstrategicplanning.eu

Ky dokument u hartua në kuadrin e

Programit të PNUD-it ART GOLD 2 Shqipëri

www.artgold.undp.org.al

me mbështetjen financiare të:

PNUD-it në Shqipëri

Zyra e Kooperacionit Italian për Zhvillim – Ministria e Punëve të Jashtme

UNOPS – Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve

me kontributin e:

www.inextstudio.org



Z. Andrea Nobili - Ekspert i lartë në Planifikimin Strategjik

Znj. Federica Di Pietrantonio - Eksperte në Planifikimin Strategjik

Znj. Jonila Prifti dhe Znj. Maria Grazia Zagaria - stafi i iNExTstudio (Itali)

në bashkëpunim të ngushtë me:

Stafi i Këshillit të Qarkut Vlorë

AULEDA - Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal Vlorë

PNUD ART GOLD 2 – Z. Luigi Cafiero, Këshilltar i Parë Teknik; Z. Estevan Ikonimi, Drejtues Kombëtar i Programit; Znj. Matilda Duri, Specialiste Komunikimi; Z. Aurel Jupe, Koordinator Lokal për Qarkun e Vlorës.

në koordinim me:

ILS LEDA - Lidhje dhe Shërbime Ndërkombëtare për Agjencitë e Zhvillimit Ekonomik Lokal

IDEASS - Inovacioni për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug-Jug

Programi Universitas - Iniciativa KIP (Njohuri, Inovacione dhe Politika për Zhvillimin Njerëzor)

Falenderime

Do të ishte e pamundur të përmendeshin të gjithë personat që kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar për përgatitjen e këtij dokumenti. Falenderime të veçanta shkojnë për institucionet dhe aktorët në vijim, ndihmesa e çmuar e të cilëve mundësoi realizimin e këtij dokumenti strategjik.

Qeveria e Shqipërisë: Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë – Komiteti Shkencor Inter-Agjenci për Bashkëpunimin e Zhvillimit Njerëzor dhe Ambasadën Italiane në Shqipëri

Kooperacioni Italian - DGCS

PNUD Shqipëri

ART GOLD 2 stafi i projektit

UNOPS, UNEP, ILO

ILS LEDA

Programi Universitas

IDEASS

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Këshilli i Qarkut Vlorë

Prefektura e Vlorës

Agjencia e Mjedisit të Qarkut Vlorë

Bashkitë dhe Komunitat e Qarkut Vlorë

AULEDA

Falenderime i shkojnë gjithashtu aktorëve të shumtë territorialë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal që morën pjesë aktivisht në procesin e planifikimit strategjik, për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre.

PLANI STRATEGJIK
PËR QARKUN E VLORËS
“Territor me Zero Emetime - ZET”

Dokumenti përfundimtar
(Qershor 2011)

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
HYRJE E PLANIT STRATEGJIK TË QARKUT TË VLORËS	5
Për çfarë nevojitet një Plan Strategjik në Qarkun e Vlorës?	5
Historiku dhe objektivat e Planit Strategjik për Qarkun e Vlorës	6
Si ta lexojmë këtë dokument	8
Metodologjia e procesit të Planifikimit Strategjik	9
Hapat dhe periudha kohore e procesit të Planifikimit Strategjik	11
Pjesëmarrja - Baza e procesit të Planifikimit Strategjik	13
KAPITULLI 1. STRUKTURA E ANALIZËS	20
1.1. Hyrje e strukturës së analizës	20
1.2. Ndarja e analizës - Aktiviteti prezantues	22
1.3. Struktura territoriale	23
1.4. Ngjarjet kryesore historike	24
1.5. Infrastruktura për lëvizjen dhe struktura urbane	26
1.6. Konteksti social	31
1.7. Aspektet mjedisore	35
1.8. Peizazhi dhe trashëgimia kulturore	38
1.9. Zinxhirët e vlerave	50
1.10. Programimi territorial	56
1.11. Analiza S.W.O.T e territorit rajonal	64
1.12. Qëllimi i përgjithshëm i zhvillimit dhe fjalët kyçe të planit strategjik	66
1.13. Skenarët për zhvillimin rajonal	69
KAPITULLI 2. KUADRI STRATEGJIK	76
2.1. Hyrje metodologjike	76
2.2. Pjesëmarrja në përcaktimin e strategjisë - Ditët e hapura dhe debatet publike	77
2.3. Vizioni për zhvillimin rajonal	86
2.4. Udhëzuesit strategjikë dhe veprimet	88
2.5. Sinergjitë ndërmjet Udhëzuesve Strategjikë - Koherenca e brendshme e Planit Strategjik	98
2.6. Konsistenca e Strategjisë me politikat e zhvillimit rajonal	109
2.7. Konsistenca e Strategjisë me politikat e zhvillimit kombëtar	111
KAPITULLI 3. PLANI I VEPRIMIT	115
3.1. Hyrje metodologjike	115
3.2. Hartimi i projekteve pjesëmarrëse - Fokus Grupet	116
3.3. 10 paketat e projekteve për zhvillimin rajonal	119
3.4. Sinergjitë ndërmjet Paketave të projekteve	147
3.6. Një e ardhme për Planin Strategjik: Projektet e Koordinuara të Zhvillimit	149
SHTOJCA	
A. Lista e shkurtesave	
B. Bibliografi dhe referenca	
C. Materiale të përgatitura për të mbështetur pjesëmarrjen	
D. Diagrami i procesit të Planifikimit Strategjik	
E. Paketat e projekteve dhe projekt-propozimet	
F. Studimi i programeve në proces në Qarkun e Vlorës	
G. Harta e trashëgimisë kulturore dhe peizazhore në Qarkun e Vlorës	

Përmbledhje ekzekutive

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) është rrjeti i zhvillimit global i OKB-së, i advokimit për ndryshim dhe i lidhjes së vendeve me njohurinë, ekspertizën dhe burimet, për t'i ndihmuar njerëzit që të ndërtojnë një jetë më të mirë.

Aktualisht, PNUD-i vepron në 166 vende, duke i ndihmuar ato në formulimin e zgjidhjeve të tyre për sfidat globale dhe kombëtare të zhvillimit. Synimi kryesor i PNUD-it është që të ndihmojë vendet në zhvillim të ndërtojnë kapacitetin e vet kombëtar për të arritur një zhvillim njerëzor të qëndrueshëm, pra të përmirësojë jetët e njerëzve mbi një bazë të qëndrueshme.

Në mënyrë të veçantë, PNUD-i në Shqipëri mbështet aspiratat e vendit drejt integritimit në Bashkimin Europian dhe kontribuon në përpjekjet kombëtare për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM-të) në lidhje me reduktimin e varfërisë, barazinë gjinore, qëndrueshmërinë mjedisore dhe me qeverisjen e mirë.

Programi i PNUD-it ART GOLD 2 Shqipëri është pjesë e nismës Art (Artikulimi i Rrjeteve për Bashkëpunim Tematik dhe Territorial për Zhvillimin Njerëzor) të PNUD-it, e cila nxit bashkëpunimin kombëtar për projektet e qeverisjes dhe të zhvillimit lokal. Programi financohet nga qeveria italiane (Kooperacioni Italian) dhe mbështet qeverinë shqiptare për të arritur OZHM-të dhe për të përmbushur kërkesat e anëtarësimit në BE, përmes nxitjes së partneritetit me këshillat rajonalë, në përputhje me Strategjinë Kombëtare Shqiptare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore. Programi punon për të krijuar lidhje dhe për të zhvilluar partneritetin ndërmjet komuniteteve lokale dhe rajonale shqiptare dhe atyre europiane, institucioneve lokale, Agjencive të Zhvillimit Ekonomik Lokal (LEDA) dhe aktorëve të tjerë që operojnë në vend (mes të tjerëve, ILS LEDA, Programi Universitas dhe IDEASS).

Qarku i Vlorës është një nga zonat e synuara nga ART GOLD 2. Njësia e qeverisjes rajonale kishte nevojë për mbështetje për hartimin e një politike të përgjithshme zhvillimi, që të përfshinte të gjithë

territorin rajonal dhe të trajtonte çështje kritike territoriale në mënyrë të koordinuar, ndërkohë që do të vazhdonte me programet, projektet dhe politikat e sektorit në zhvillim e sipër në zonë. Për më tepër, programi i PNUD-it ART GOLD 2 Shqipëri synonte nxitjen dhe mbështetjen e pjesëmarrjes demokratike të aktorëve lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë në procesin e vendimmarrjes, në lidhje me politikat e zhvillimit të Qarkut të Vlorës dhe u përpoq t'i siguronte qeverisjes vendore kapacitetet e nevojshme për të tërhequr dhe për të menaxhuar në mënyrë autonome fondet ndërkombëtare për zhvillim.

Për të përmbushur këto nevoja, ART GOLD 2 nisi një Plan Strategjik (PS) si një program afatgjatë për qeverisjen territoriale dhe zhvillimin e qëndrueshëm duke përshtatur metodën e pjesëmarrjes.

Synimi i PS-së është të përfshijë komunitetin lokal për të krijuar vizionin e tij për të ardhmen dhe për të zbuluar mënyrën më të mirë për ta zbatuar atë, duke lidhur aspektet kulturore, mjedisore, sociale dhe ekonomike të territorit.

Misioni i PS-së është të nxisë një zhvillim të ekuilibruar dhe endogjen të zonës dhe të rrisë vlerën e qarkut, duke forcuar identitetin e tij unik kulturor, social, mjedisor, ekonomik dhe burimet e tij njerëzore. Duke vepruar kështu, qeverisja vendore dhe komuniteti mund të bëhen më të ndërgjegjshëm për rolet që mund të luajnë në procesin e zhvillimit dhe më të sigurt në aftësitë e tyre për të bashkëpunuar në proceset e zhvillimit.

Brenda kuadrit të ART GOLD 2, Planifikimi Strategjik përfaqëson një proces demokratik novator, të nevojshëm për ta çuar Shqipërinë drejt integritimit në BE dhe një instrument të dobishëm për të përfunduar decentralizimin administrativ në zhvillim e sipër në vend.

Në një vend të karakterizuar nga një traditë e varfër në praktikën pjesëmarrëse, Planifikimi Strategjik në Qarkun e Vlorës shërben si proces demokratik dhe nga poshtë-lart, i nevojshëm për të përforcuar bashkëpunimin dhe besimin e përbashkët ndërmjet institucioneve, aktorëve vendas dhe të huaj.

Për më tepër, Plani Strategjik i Qarkut të Vlorës përfaqëson një platformë koordinimi ndërmjet donatorëve, organizatave ndërkombëtare, orientimeve kombëtare dhe politikave rajonale dhe lokale. Për rrjedhojë, donatorët mund të mbledhin fonde për projektet që pasqyrojnë më mirë nevojat e komunitetit dhe të jenë pjesë e një zhvillimi të vërtetë e të qëndrueshëm.

Proçesi i Planifikimit Strategjik në Qarkun e Vlorës nisi me inventarin e politikave territoriale në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, me qëllim koordinimin e tyre, parandalimin e mbivendosjes, zhvillimin e strategjive dhe optimizmin e rezultateve. Në të njëjtën kohë, analiza territoriale siguroi një përmbledhje të përgjithshme të situatës aktuale rajonale territoriale për sa i përket infrastrukturës, mjedisit, trashëgimisë kulturore, ekonomisë, aspekteve sociale etj., nëpërmjet përdorimit të informacionit të publikuar më së fundmi mbi planifikimet e ndryshme dhe dokumentet e programimit, së bashku me rezultatet e studimeve territoriale dhe takimet pjesëmarrëse. Nuk ishte e nevojshme që të kryhej një kërkim i mëtejshëm, sepse proçesi i Planifikimit Strategjik nuk filloi që nga skicimi, por përkundrazi ruajti vazhdimësinë e politikave që tashmë operonin në territor. Analiza territoriale mundësoi identifikimin e pikave reale të forta dhe të dobëta të qarkut, të përmbledhura në një analizë SWOT. Rrjedhimisht, u identifikuan fjalët kyçe dhe skenarët e mundshëm të zhvillimit rajonal. Fjalët kyçe përmbledhën çështjet dhe nevojat e ngritura gjatë takimeve, të cilat aktorët e territorit i konsideronin vendimtare për zhvillimin rajonal. Skenarët përfaqësonin konfigurimet e së ardhmes së mundshme të qarkut dhe u bazuan në kushtet e tanishme, prirjet e përvijuara nga politikat aktuale operuese në të gjitha nivelet dhe në variabël e mundshme që PS-ja mund të prezantojë për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe endogjen. Analiza territoriale i dha rrugë përcaktimit të një Strategjie rajonale të përbashkët afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, që konsistonte në:

- Një Vizion – i cili sugjeron rolin e mundshëm që mund të luajë Qarku i Vlorës në perspektivën globale, në koherencë me rezultatet e analizës dhe rezultatet e proçesit pjesëmarrës.
- Nëntë Udhëzues Strategjik - Drejtimet e integruara dhe sinergjike që duhen ndjekur, për të përmbushur Vizionin, duke trajtuar aspektet kryesore kritike të qarkut.
- Tridhjetë e tre Veprime - "Mjetet" për të mbushur hendekun ndërmjet situatës aktuale dhe zhvillimit në të ardhmen. Ato janë fuqimisht të ndërlidhura dhe ndihmojnë për të

arritur disa synime njëkohësisht. Ato realizohen përmes zbatimit të projekteve.

Kjo Strategji, e diskutuar dhe e miratuar nga aktorët e territorit, përpiket të përcjellë dëshirat dhe nevojat e komunitetit rajonal, siç janë shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë gjatë takimeve dhe aktiviteteve pjesëmarrëse dhe së fundi t'i përshtatë ato brenda situatës aktuale të territorit, programeve në zhvillim e sipër dhe brenda politikave e synimeve kombëtare.

Hapi tjetër i proçesit të Planifikimit Strategjik ishte Plani i Veprimit, që është një sistem i integruar projektsh, të cilat duhet të zbatohen në mënyrë që të arrihen synimet e PS-së. Projektet u propozuan kryesisht nga aktorët lokalë dhe u krijuan në një kuadër racional dhe të orientuar nga vizioni. Aktorët e territorit të përfshirë në proçesin pjesëmarrës propozuan rreth 100 projekt-propozime dhe projektide, për sa i përket zbatimit të Strategjisë së përbashkët rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfaqësuar kështu përmbushjen e kërkesave të territorit. Gjithashtu, u sugjeruan edhe ide të tjera nga ekspertët e PS-së, bazuar në rezultatet e debateve publike dhe të takimeve të mbajtura me institucionet në nivel kombëtar. Një tjetër grup i projekt-ideve erdhi nga analizat e kryera nga një prej ekspertëve të ILS LEDA-s për zinxhirët e vlerave të rajonit. Në mënyrë që të jepej një perspektivë më e gjerë për këto propozime dhe ide, ekspertët e PS-së prezantuan "Paketat e projekteve" ose "mbajtëset", ku projektet që trajtonin të njëjtat tema dhe/ose të njëjtat pjesë të territoreve rajonale u grupuan rreth një teme të vetme dhe të integruar, duke zhvilluar kështu sinergji dhe ndërveprime. Kështu, projektet mund të kontribuojnë në mënyrë më të efektshme për arrijten e Vizionit dhe për ripërcaktimin e rolit të qarkut në të ardhmen në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Metodologjia e Planifikimit Strategjik e miratuar në Qarkun e Vlorës përdor metodën nga poshtë-lart. Kjo do të thotë se çdo hap i proçesit të Planifikimit Strategjik u karakterizua nga pjesëmarrja e të gjithë grupeve lokale të interesit në përcaktimin e PS-së. Hapat e pjesëmarrjes patën një nivel në rritje të ndërveprimit, ku kërkohet vazhdimisht përfshirja dhe bashkëpunimi i grupeve të interesit dhe i shoqërisë civile, duke zhvilluar takime personalisht me aktorët e rëndësishëm (më shumë se 100 takime u mbajtën në kuadrin e proçesit të Planifikimit Strategjik), si dhe duke organizuar aktivitete të konsultimit publik:

- Një aktivitet prezantues për të filluar publikisht nismën e Planifikimit Strategjik
- Seminare tematike për të identifikuar çështje kritike territoriale dhe për të filluar përcaktimin e Strategjisë së zhvillimit rajonal
- Një debat publik për të ndarë me të gjithë aktorët e territorit një draft të Vizionit dhe të Strategjisë për zhvillimin rajonal
- Dy takime të Fokus Grupeve për identifikimin e përbashkët të projekteve të integruara për të arritur objektivat e Planit Strategjik.

Pjesëmarrja në aktivitete ishte e kënaqshme dhe të gjithë aktorët provuan se ishin të interesuar dhe të gatshëm për t'u përkrahur aktivisht në përgatitjen e Planit Strategjik. Gjatë këtij procesi u përforcua gjithashtu bashkëpunimi ndërmjet aktorëve rajonalë dhe lokalë dhe ndërmjet ART GOLD 2 dhe partnerëve. Në Planin Strategjik u morën në konsideratë dhe u përfshinë të gjitha rezultatet e procesit pjesëmarrës (pas punës së nevojshme të aktiviteteve të përpunimit dhe të sistematizimit). Rrjedhimisht, e gjithë përmbajtja e Planit mund të konsiderohet se është ndarë me të gjithë komunitetin rajonal dhe për të cilën ai ka rënë dakord. Procesi pjesëmarrës në Qarkun e Vlorës u mbështet nga një sërë materialesh informacioni dhe komunikimi, që kishin si synim të informonin aktorët territorialë për çështjet e Planifikimit Strategjik, t'i përfshinin ata në proces dhe të nxisnin diskutimin gjatë aktiviteteve të konsultimit publik. Këto materiale u krijuan duke marrë në konsideratë zakonet e rrallë të popullsisë së rajonit për praktikën pjesëmarrëse. Një nga mjetet më të rëndësishme të krijuara për Planin Strategjik të Qarkut të Vlorës është faqja e internetit (www.vloraregionstrategicplanning.eu), ku mund të gjendet i gjithë informacioni për Planifikimin Strategjik në qarkun e Vlorës.

Procesi i përshkruar deri tani çoi në gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e mëposhtme:

- Duke pasur parasysh situatën aktuale dhe prirjet e përvijuara nga politikat aktuale kombëtare dhe rajonale, qarku i Vlorës ka përpara tij tre Skenarë të mundshëm zhvillimi:
 - **Skenari 1) Zhvillimi i turizmit** - Turizmi është sektori kryesues në ekonominë e Qarkut të Vlorës, si dhe katalizatori kryesor i rritjes ekonomike. Sidoqoftë, deri tani nuk është krijuar një strategji e qartë për zhvillimin e turizmit. "Turizmi bregdetar" ka luajtur rolin drejtues, me efekte negative për mjedisin. Megjithatë, qarku ka një sërë atraksionesh potenciale turistike (trashëgimia kulturore, zonat natyrore, tradita

dhe ushqimi) dhe prandaj ka mundësinë të shkojë drejt turizmit të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, duke gjeneruar të ardhura dhe vende pune ndërkohë që respekton mjedisin dhe kulturën e vendit.

- **Skenari 2) Zhvillimi rural dhe agrobiznesi** - Aktivitetet rurale janë një pjesë e rëndësishme e kulturës rajonale dhe e identitetit. Sidoqoftë, çështjet e mjedisit në lidhje me sektorin rural, siç janë mungesa e ujit, sistemet e administrimit të ujit të ndotur dhe të mbetjeve të ngurta duhet të trajtohen menjëherë, duke pasur parasysh se mjedisi natyror është një burim potencial i të ardhurave për zonat rurale, përmes aftësisë për të ndikuar te cilësia e produkteve ushqimore, si dhe përmes tërheqjes për turizmin. Kështu, sfida është që të arrihet një qëndrueshmëri e përgjithshme mjedisore në aktivitetet rajonale rurale, duke ekuilibruar novacionin dhe traditën dhe duke përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve tipike vendase.

- **Skenari 3) Shërbimet, rrjetet dhe industria e lehtë** - Në Qarkun e Vlorës mungojnë sistemet e shërbimeve bazë. Problemet me infrastrukturën kanë një ndikim negativ në aktivitetet ekonomike, të cilat nuk mund të kenë zhvillim pa furnizimin e duhur me energji dhe me sisteme të besueshme komunikimi. Politikat në zhvillim e sipër kanë pranuar, deri në njëfarë mase, domosdoshmërinë për përmirësimin e infrastrukturës dhe të rrjeteve të shërbimeve, ndërkohë që tregohet vëmendje edhe për qëndrueshmërinë mjedisore. Rreziku qëndron në faktin se mungesa e burimeve financiare mund të shkaktojë vonesa në zbatimin e strategjive, duke çuar kështu në zgjidhje afatshkurtra dhe në largimin e vëmendjes nga qëndrueshmëria e përgjithshme dhe nga koordinimi i ndërhyrjeve. Sfida është që të vazhdohet koordinimi i të gjitha elementeve të Skenarit, në mënyrë që të gjitha politikat e sektorit të konvergjojnë tek të njëjtat objektiva dhe të jenë koherente me njëra-tjetrën.

Për të arritur një zhvillim më të larmishëm dhe për të shmangur çekulibrimet që mund të shkaktojë zhvillimi i një sektori të vetëm, këta Skenarë duhet të zbatohen njëkohësisht, në mënyrë të integruar dhe plotësuese, duke e bërë qëndrueshmërinë elementin kryesor të zhvillimit rajonal. Kështu, Vizioni i zgjedhur për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal është "Qarku i Vlorës 2020: një Territor me Zero Emetime.

- Qarku i Vlorës duhet të bëhet një territor në të cilin qëndrueshmëria mbulon të gjithë sektorët e aktivitetit njerëzor (akomodimi i turistëve, transporti, administrimi i mbetjeve të ngurta, administrimi i ujit dhe i ujit të ndotur, aktivitetet prodhuese, aktivitetet ndërtimore etj.) dhe ku të gjitha politikat dhe nismat e zhvillimit janë të koordinuara dhe sinergjike. Në këtë kuadër, qarku duhet të vendosë të përmbushë kërkesën globale në rritje për turizmin kulturor, ekoturizmin dhe turizmin rural dhe ta konsiderojë mbrojtjen e mjedisit jo si limit, por si mundësi për të nxitur novacionin, zhvillimin social-ekonomik dhe rritjen profesionale.
- Për të përmbushur këtë Vizion u identifikuan 9 Udhëzues Strategjikë:
 1. Turizmi me bazë komunitetin
 2. Produktet tipike rurale dhe artizanati
 3. Peshkimi dhe akuakultura
 4. Arsimimi dhe trajnimi
 5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale
 6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit
 7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia
 8. Përfshirja sociale
 9. Plani Strategjik për fëmijët dhe adoleshentët
 - Këta Udhëzues Strategjikë do të arrihen përmes zbatimit të 112 projekteve të përbashkëta dhe projektideve, që përmbahen në 10 "Paketat tematike të projekteve":
 - ▶ Turizmi tematik në Qarkun e Vlorës
 - ▶ Markat për produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës
 - ▶ Mbrojtja e ujit dhe e tokës
 - ▶ Rrugët detare në Qarkun e Vlorës
 - ▶ Artizanati i Qarkut të Vlorës
 - ▶ Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës
 - ▶ Rrjeti i përkujdesjes sociale në Qarkun e Vlorës
 - ▶ Fëmijët e Qarkut të Vlorës
 - ▶ Shëndetësia në Qarkun e Vlorës
 - ▶ Punësimi i grave në Qarkun e Vlorës
 - Duke marrë parasysh natyrën tematike të Paketave të projekteve, projektet që ato përmbajnë përfshijnë të gjithë territorin rajonal. Rrjedhimisht, për ta bërë zbatimin e tyre sa më të efektshëm që të jetë e mundur, do të jetë e nevojshme të identifikohen zonat fizike të ndërhyrjes në nivel nënrajonal, gjithashtu të lehtësohet krijimi i partneriteteve të projektit dhe që veprimet e tyre të bëhen më të mprehta. Kështu, sfida për të ardhmen e procesit të

Planifikimit Strategjik është që të nisë dhe të zhvillojë një sërë projektesh të integruara, të fokusuara në zonat gjeografike të ndërhyrjeve, të cilat mund të konsiderohen si homogjene për shkak të veçorive të tyre morfologjike, social-ekonomike dhe/ose kulturore. Këto projekte të integruara do të rrjedhin drejtpërdrejt nga rezultatet e procesit të kryer të Planifikimit Strategjik dhe do të shërbejnë si "shprehja e prekshme" e Strategjisë së përbashkët të zhvillimit për territorin rajonal. Përmes tyre, Veprimet e PS-së rajonale do të zbatohen gradualisht, gjithnjë duke marrë parasysh "tablonë e madhe" të përfaqësuar nga Vizioni dhe Strategjia e përgjithshme. Projektet e integruara të rekomanduara ose Projektet e Koordinuara të Zhvillimit (PKZH) për t'u zhvilluar janë katër të mëposhtmet:

- ▶ **Qarku i turizmit kulturor** - Krijimi i qarqeve të turizmit tematik që përfshijnë vendet e trashëgimisë kulturore të përhapura në të gjithë qarkun, për t'u menaxhuar dhe promovuar në mënyrë të koordinuar dhe pjesëmarrjen aktive dhe bashkëpunimin e të gjitha niveleve të qeverisjes, shoqatave kulturore, bizneseve të lidhura me turizmin.
- ▶ **Rrethi rural i luginës së Shushicës** - Krijimi i partneritetit për menaxhimin dhe zhvillimin e koordinuar rural dhe të turizmit në zonën nënrajonale të luginës së lumit të Shushicës, e karakterizuar nga tradita e bujqësisë organike, potenciali i lartë i turizmit, peizazhi i pasur dhe nga trashëgimia kulturore. Partneriteti do të përfshijë qeverisjet vendore dhe një grup biznesesh (individuale dhe në partneritet), që punojnë në sektorin agrorshqimor dhe në atë të turizmit.
- ▶ **Qarku i turizmit peizazhor të bregdetit jugor të Shqipërisë** - Zbatimi dhe integrimi i Planit të Zhvillimit të Bregdetit Jugor të Shqipërisë, duke zgjeruar atë në të gjithë qarkun dhe zbatimin e projekteve të Planit Strategjik për bregdetin, për të ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonat bregdetare të qarkut.
- ▶ **Rrethi agrorshqimor i Delvinës** – Krijimi i një partneriteti për menaxhimin dhe zhvillimin rural në mënyrë të koordinuar të një zone nënrajonale, që karakterizohet nga tradita e fortë bujqësore dhe trashëgimia e pasur e produkteve tipike agrorshqimore me një treg të konsoliduar (Saranda). Partneriteti do të përfshijë qeverisjet vendore dhe një grup biznesesh (individuale dhe në partneritet), që punojnë në sektorin agrorshqimor.

HYRJE

E PLANIT STRATEGJIK PËR QARKUN E VLORËS



Ura për në
Manastirin e
Zvërnecit në
Komunën e
Novoselës

Për çfarë nevojitet një Plan Strategjik në Qarkun e Vlorës?

Në ditët e sotme, prioriteti absolut për shumicën e territoreve është zhvillimi i një baze ekonomike të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Në këtë drejtim, qeveria shqiptare ka përshtatur një politikë zhvillimi, të fokusuar në investimet në infrastrukturën kyçe dhe ka promovuar sektorët kryesues në ekonomi, të cilët demonstrojnë avantazh krahasues rajonal. Njësitë e qeverisjes në Qarkun e Vlorës kanë treguar një interes të vazhdueshëm për të qenë pjesë e zhvillimit të integruar, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Turizmit dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Qarku i Vlorës është destinacioni kryesor turistik në Shqipëri. Edhe pse në nivel lokal ekzistojnë disa plane strategjike zhvillimi që iu referohen territoreve të bashkive, deri tani nuk janë krijuar strategji dhe një vizion i përbashkët rajonal për të ardhmen për të udhëhequr zhvillimin e secilës bashki dhe komunë, veçanërisht të atyre që nuk kanë ndonjë plan zhvillimi

lokal. Prandaj, në mars të vitit 2010, qarku nisi një proces të planifikimit strategjik brenda kuadrit të programit ART GOLD 2 të PNUD-it.

Plani Strategjik është një platformë e rritjes dhe e përtëritjes territoriale, me synimin për të realizuar një model zhvillimi endogjen dhe të qëndrueshëm, nëpërmjet përfshirjes të të gjithë përbërësve kulturorë, mjedisorë, socialë dhe ekonomikë të një zone të caktuar. Plani Strategjik është një instrument novator dhe fleksibël i qeverisjes territoriale, i aplikuar tashmë në disa qytete dhe territore europiane, me synimin për të siguruar një drejtim të qartë të politikave të zhvillimit lokal.

Planifikimi strategjik është një mjet i domosdoshëm për komunitetet dhe institucionet, për të nxitur pjesëmarrjen demokratike si një pjesë integrale e planifikimit territorial, duke i mundësuar kështu aktorët lokalë që të deklarojnë opinionet e tyre dhe që këto të fundit të integrohen në politikat e zhvillimit.

Historiku dhe objektivat e Planit Strategjik për Qarkun e Vlorës

PS-ja e Qarkut të Vlorës është nismë e programit ART GOLD 2 Shqipëri, i cili është pjesë e nismës ART (Artikulli i rrjeteve për bashkëpunim tematik dhe territorial për zhvillimin njerëzor) të PNUD-it.

PNUD-i (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) është rrjeti i zhvillimit global i OKB-së, i advokimit për ndryshim dhe i lidhjes së vendeve me njohurinë, ekspertizën dhe burimet, për t'i ndihmuar njerëzit që të ndërtojnë një jetë më të mirë.

Aktualisht, PNUD-i vepron në 166 vende, duke i ndihmuar ato në formulimin e zgjidhjeve të tyre për sfidat globale dhe kombëtare të zhvillimit.

Qëllimi kryesor i PNUD-it është të ndihmojë vendet në zhvillim që të ndërtojnë kapacitetin e tyre kombëtar, për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm njerëzor; pra, të përmirësojë jetën e njerëzve mbi një bazë të qëndrueshme.

Në mënyrë të veçantë, PNUD-i në Shqipëri mbështet aspiratat e vendit drejt integritimit në Bashkimin Europian dhe kontribuon në përpjekjet kombëtare për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM-të) në lidhje me reduktimin e varfërisë, barazinë gjinore, qëndrueshmërinë mjedisore dhe me qeverisjen e mirë.

Nisma Art nxit bashkëpunimin kombëtar për projektet e qeverisjes dhe të zhvillimit lokal.

Programi financohet nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme nëpërmjet Kooperacionit Italian dhe mbështet qeverinë shqiptare për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM-të) dhe për të plotësuar kërkesat e anëtarësimit në BE, përmes nxitjes së partneritetit me këshillat rajonale, në përputhje me Strategjinë Kombëtare Shqiptare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore.

Programi synon të krijojë lidhje dhe të vendosë partneritete ndërmjet komuniteteve lokale dhe rajonale shqiptare dhe atyre europiane, institucioneve lokale, Agjencive të Zhvillimit Ekonomik Lokal (LEDA) dhe subjekteve të tjera që operojnë në vend (mes të tjerave, ILS LEDA, Programi Universitas dhe IDEASS).

ART GOLD 2 nxit një kuadër të bashkëpunimit kombëtar për qeverisjen dhe zhvillimin lokal nëpërmjet rolit aktiv të aktorëve publikë dhe privatë, si dhe të përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe qendrore.

Qarku i Vlorës është një nga zonat e synuara nga ART GOLD 2.

Njësia e qeverisjes rajonale kishte nevojë për mbështetje për hartimin e një politike të përgjithshme zhvillimi, që të përfshinte të gjithë territorin rajonal dhe të trajtonte çështje kritike territoriale në mënyrë të koordinuar, ndërkohë që do të vazhdonte me programet, projektet dhe politikat e sektorit në zhvillim e sipër në zonë.

Për më tepër, programi i PNUD-it ART GOLD 2 Shqipëri synonte nxitjen dhe mbështetjen e pjesëmarrjes demokratike të aktorëve lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë në procesin e vendimmarrjes, në lidhje me politikat e zhvillimit të Qarkut të Vlorës dhe u përpoq t'i siguronte qeverisjes vendore kapacitetet e nevojshme për të tërhequr dhe për të menaxhuar në mënyrë autonome fondet ndërkombëtare për zhvillim.

Për të përmbushur këto nevoja, ART GOLD 2 nisi një Plan Strategjik (PS) si një instrument të dobishëm për të mbështetur decentralizimin administrativ në Shqipëri.

Siç tregohet në metodologjinë e aplikuar nga ekspertët e planifikimit strategjik, PS-ja është një program afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për qeverisjen dhe zhvillimin territorial të qëndrueshëm, i hartuar nëpërmjet një procesi pjesëmarrës me qasje "poshtë-lart".

Kështu, PS-ja e Qarkut të Vlorës u udhëhoq nga parimet e pjesëmarrjes dhe të negociimit: aktorët kryesorë publikë dhe privatë, që operojnë në territor, u përfshinë në takimet dhe aktivitetet e hapura, gjatë të cilave ata identifikuan së bashku potencialet dhe pikat e dobëta rajonale dhe parashikuan Skenarë të mundshëm të zhvillimit rajonal.

Në vijim, të njëjtët aktorë bashkëpunuan për përcaktimin e një Vizioni të përbashkët zhvillimi dhe të qëllimeve strategjike për ta arritur atë.



Pjesëmarrja e gjerë në takimet dhe aktivitetet e shumta të organizuara gjatë procesit, demonstroi aftësinë e PS-së për të nxitur dhe për të përforcuar mekanizmat e bashkëpunimit brenda komuniteteve lokale.

Pra, PS-ja nuk është një produkt, por më tepër një proces në ndryshim të vazhdueshëm, i ndërtuar nëpërmjet negociimeve dhe përsiatjeve dhe përdorimit të teknikave pjesëmarrëse.

Synimi kryesor i procesit të planifikimit strategjik ishte identifikimi i një liste të projekteve gjithëpërfshirëse, konsistente dhe të përbashkëta, që rezultojnë nga metoda nga poshtë-lart. Identifikimi i projekteve u udhëhoq nga ideja se Shqipëria do të bëhet anëtare e Bashkimit Europian në të ardhmen e afërt. Për më tepër, PS-ja përfshiu projektet prioritare, të dorëzuara nga aktorët e territorit për financimin

e PNUD-it. Ekspertët e PS-së siguruan asistencën teknike për zhvillimin e këtyre projekteve, duke u fokusuar kryesisht në konsistencën e tyre me drejtimin e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal të ndjekur nëpërmjet Planifikimit Strategjik.

Brenda kuadrit të ART GOLD 2, Planifikimi Strategjik përfaqëson një proces novator dhe demokratik të domosdoshëm për ta orientuar Shqipërinë drejt integritimit në BE.

PS-ja e Qarkut të Vlorës përfaqëson një platformë koordinimi ndërmjet politikave kombëtare, rajonale dhe lokale dhe institucioneve që i promovojnë ato (ministritë, qeverisjet vendore, Fondin Shqiptar të Zhvillimit etj.) dhe është një mjet i dobishëm koordinimi për donatorët ndërkombëtarë.



Si ta lexojmë këtë dokument

Ky dokument paraqet një përmbledhje të procesit të planifikimit strategjik të kryer në Qarkun e Vlorës nga marsi 2010 deri në qershor 2011.

Gjithashtu, ai shpjegon se si është aplikuar metodologjia e planifikimit strategjik në zonën e synuar, mënyrën se si aktorët e territorit u përfshinë në proces dhe rezultatet e arritura. Përshkruan situatën aktuale të territorit rajonal dhe ilustron strategjinë e përbashkët të zhvillimit të qëndrueshëm, e cila u zgjodh nga komuniteti rajonal.

E gjithë përmbajtja e tij u nda me aktorët territorialë dhe/ose u hartua mbi bazën e sugjerimeve dhe studimeve të tyre. Rrjedhimisht, PS-ja nuk pretendon të jetë shteruese dhe mund t'i nënshtrohet unifikimeve dhe shtesave në çdo kohë.

Në tërësi, ky dokument përfaqëson një përmbledhje të asaj që rezultoi nga procesi i negociimeve demokratike, që ishte baza e programit të planifikimit strategjik. Rrjedhimisht, është i hapur, i përbashkët dhe i

ndryshueshëm. Nëse është e nevojshme mund të përditësohet, gjithnjë nëpërmjet përfshirjes të të gjithë komunitetit rajonal.


Qeveria rajonale duhet ta përdorë këtë dokument si memorandum dhe si një udhëzues për zbatimin gradual të projekteve të koordinuara të zhvillimit në qark.

Natyra pjesëmarrëse e PS-së garanton vazhdimësinë dhe legjitimitetin e strategjisë së zhvillimit. Fakti që kjo strategji u miratua nga shumica e aktorëve lokalë duhet të merret parasysh nga administratorët aktualë dhe të ardhshëm për të përmbushur pritshmëritë e komunitetit lokal.

Ky PS u hartua në përputhje me qëllimet e Strategjisë Rajonale për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM-të) të PNUD-it.

Gjithashtu, ai u referohet qëllimeve strategjike kombëtare, të pohuara në Strategjinë Kombëtare të Turizmit dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Proçesi i Planifikimit Strategjik për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit



Metodologjia e procesit të Planifikimit Strategjik

Planifikimi Strategjik është një proces ciklik i rishqyrtimit dhe i vlerësimit, i shoqëruar vazhdimisht nga procedurat e monitorimit, komunikimit dhe të pjesëmarrjes. Ai konsiston në katër hapa kryesorë:

1. Nisja
2. Struktura e Analizës
3. Kuadri Strategjik
4. Plani i Veprimit

1. Nisja

Procesi i Planifikimit Strategjik në Qarkun e Vlorës filloi me një sërë aktivitetesh përgatitëse, që kishin si synim prezantimin e nismës së planifikimit strategjik tek autoritetet shqiptare të të gjitha niveleve, krijimin e hartës së grupeve të interesit, theksimin e qëllimeve të përgjithshme dhe programimin e aktiviteteve të mëtejshme. Metodologjia e planifikimit strategjik dhe rezultatet e tij të mundshme u diskutuan me aktorët e ndryshëm territorialë, duke theksuar përfitimet në të ardhmen për sa i përket koordinimit të politikave të zhvillimit, optimizimit të burimeve, përfshirjes dhe ndërgjegjësimit të komunitetit lokal. Më pas, PS-ja iu prezantua publikut nëpërmjet një aktiviteti prezantues, të organizuar në Vlorë dhe të mbështetur nga një fushatë komunikimi.

2. Struktura e Analizës

Situata aktuale e Qarkut të Vlorës u analizua, duke filluar nga informacioni që përmbajnë planet dhe programet e fundit në lidhje me territorin rajonal. Kjo analizë përfshin:

- një analizë të aspekteve territoriale (sfondi historik, infrastruktura, mjedisi, trashëgimia kulturore, konteksti social dhe ekonomik), bazuar në informacionin e marrë nga instrumentet ekzistuese të planifikimit dhe të programimit, të vlerësuara nëpërmjet studimeve territoriale dhe të integruara me

rezultatet e procesit pjesëmarrës;

- një analizë krahasuese e planeve dhe programeve në lidhje me qarkun;
- një analizë S.W.O.T, për identifikimin e potencialeve dhe probleme kryesore të zonës;
- një sërë fjalësh kyçe, që sintetizojnë rezultatet e analizës dhe qëllimin e përgjithshëm të Planit Strategjik;
- Skenarët e zhvillimit, që shprehin konfigurimet e mundshme në të ardhmen për qarkun, bazuar në kushtet aktuale dhe në prirjet e përvijuara nga politikatat aktuale në të gjitha nivelet.

Në këtë fazë, takimet me grupet e interesit ishin të rëndësishme, për të nxjerrë në pah problemet aktuale dhe për të ndarë me ta objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm.

3. Kuadri Strategjik

Analiza territoriale ishte hapi i parë drejt përcaktimit të një strategjie të përbashkët afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit rajonal, që konsistonte në:


- *Vizioni* - Është imazhi i ardhshëm i një zone, që drejton të gjitha politikatat e zhvillimit. Ai sugjeron rolin e mundshëm që mund të luajë Qarku i Vlorës në perspektivën globale, në përputhje me analizën e kryer dhe rezultatet e procesit pjesëmarrës.
- *Udhëzuesit strategjikë* - Janë drejtimet që duhen ndjekur për të përmbushur Vizionin, duke krijuar një sistem të integruar dhe sinergjik, të fokusuar në çështjet vendimtare të zhvillimit rajonal.
- *Veprimet* - Janë "mjetet" për të mbushur hendekun ndërmjet situatës aktuale dhe zhvillimit në të ardhmen. Ato janë të ndërlidhura fort, ndihmojnë për të arritur disa qëllime njëkohësisht dhe kryhen nëpërmjet zbatimit të projekteve.

Përmbajtja e këtij hapi u diskutua dhe u nda me aktorët territorialë në një sërë seminaresh tematike në Vlorë dhe në Sarandë.

4. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përmban një sistem të integruar projektesh të koordinuara (të propozuara nga aktorët territorialë dhe të organizuara në një kuadër koherent dhe të orientuar nga vizioni)

Plani i Veprimit ndjek procedurë të mundshme për të zbatuar projektet dhe sugjeron rolin e institucioneve dhe të aktorëve privatë në procesin e zbatimit. Plani i Veprimit u diskutua dhe u ra dakord për të nga aktorët territorialë gjatë Fokus Grupeve.



Hapat dhe periudha kohore e procesit të Planifikimit Strategjik

Hapat e Planifikimit Strategjik (PS)	Aktivitetet e kryera	Lloji i aktivitetit		Koha
		Pjesëmarrja dhe aktivitetet të tjera në terren	Aktiviteti në zyrë	
Nisja dhe struktura e analizës	Takime përgatitore me përfaqësuesit e PNUD-it, AULEDA-s, dhe stafit të AGA2 për të ndarë metodologjinë e PS-së	✓		Shkurt-Mars 2010
	Takime me autoritetet vendore dhe grupe të tjera të rëndësishme interesi, për të prezantuar metodologjinë e PS-së së AGA2, për të mbledhur informacion për programet dhe projektet e zbatuara dhe në zbatim e sipër në zonat e synuara, për të vendosur bashkëpunimin dhe sinergjitë	✓		Shkurt-Tetor 2010
	Studime të territorit rajonal Përgatitja e një drafti të analizës SWOT	✓	✓	Mars 2010
	Analizë e planeve dhe e programeve në zhvillim e sipër Ekstrapolimi, përpunimi dhe organizimi i të dhënave dhe i informacionit, të vlefshme për të përvijuar Kuadrin e Analizës Drafti i Kuadrit të Analizës, përfshirë Skenarë të mundshëm të zhvillimit rajonal		✓	Mars-Shtator 2010
	Përcaktimi më në hollësi i roleve dhe i përgjegjësive të të gjithë personave të përfshirë në program, për të optimizuar procesin e PS-së	✓		Maj-Gusht 2010
	Përgatitja e një CD-Rom-i të "Paketës prezantuese të Planifikimit Strategjik", për të mbështetur aktivitetet e trajnimit drejtuar AULEDA-s		✓	Maj 2010
	Trajnim dhe asistencë teknike për stafin e AULEDA-s për të përgatitur aktivitetin prezantues të PS-së	✓		Maj 2010
	Aktivitete të koordinimit me programe të tjera të OKB-së, veçanërisht duke vlerësuar aktivitetet e tyre në zhvillim e sipër në zonat e ndërhyrjes së AGA2	✓		Korrik-Tetor 2010
	Takimi i parë i Këshillit të Partneritetit të Qarkut Mbështetje e identifikimit pjesëmarrës të projekteve prioritare që duhet të financohen nga AGA2 dhe e përcaktimit të kriterëve të përbashkëta të zgjedhjes	✓		Gusht 2010
	Asistencë teknike dhe trajnim për koordinatorin lokal të AULEDA-s dhe të AGA2 për organizimin e aktivitetit prezantues Asistencë teknike dhe trajnim për menaxheren e Zyrës së Komunikimit të AGA2 mbi aktivitetet e komunikimit në lidhje me procesin e PS-së, duke u fokusuar në përgatitjen e informacionit dhe materialeve të komunikimit për aktivitetin prezantues	✓	✓	Gusht-Shtator 2010
	Aktiviteti prezantues: prezantimi tek aktorët territorialë i metodologjisë së PS-së dhe i rezultateve të para të arritura; ndarja me ta e draftit të Kuadrit të Analizës	✓		Tetor 2010

Hapat e Planifikimit Strategjik (PS)	Aktivitetet e kryera	Lloji i aktivitetit		Koha
		Pjesëmarrja dhe aktivite të tjera në terren	Aktiviteti në zyrë	
Kuadri strategjik	Mbështetja e AULEDA-s dhe e stafit të AGA2 në organizimin e aktiviteteve të Ditëve të Hapura, të fokusuara në përcaktimin e strategjisë së zhvillimit rajonal	✓		Nëntor 2010
	Ditë të Hapura në Vlorë dhe në Sarandë: diskutim për Skenarë të mundshëm të zhvillimit rajonal dhe përvijimi i një drafti të strategjisë së zhvillimit duke përdorur metodën pjesëmarrëse	✓		Nëntor 2010
	Përpunimi dhe organizimi i rezultateve të Ditëve të Hapura Përgatitja e një drafti të Vizionit dhe Strategjisë për zhvillimin rajonal, bazuar në rezultatet e debateve		✓	Nëntor-Dhjetor 2010
	Përmirësimi i koordinimit ndërmjet procesit të planifikimit strategjik, programeve dhe aktiviteteve të tjera ART në zhvillim e sipër, të kryera nga aktorë të rëndësishëm shqiptarë dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar	✓		Dhjetor 2010
	Ofrimi i asistencës teknike për AULEDA-n dhe stafin e AGA2 për të kryer 2 debate publike për të diskutuar draftin e Vizionit dhe të Strategjisë	✓		Dhjetor 2010
	Zhvillim i një takimi me një panel ekspertësh të zgjedhur nga Këshilli Rajonal dhe një debat publik me aktorët e territorit: miratimi i draftit të Vizionit dhe të Strategjisë së zhvillimit rajonal	✓		Dhjetor 2010
	Përcaktimi i versionit përfundimtar të Vizionit dhe të Strategjisë së zhvillimit rajonal, bazuar në rezultatet e debateve publike		✓	Dhjetor 2010-Janar 2011
	Paraqitja e një drafti të Planit Strategjik gjatë konferencës ndërkombëtare "Integrimi evropian, njohuri, novacione dhe qeverisja demokratike për zhvillim" në Tiranë	✓		Janar 2011
Plani i veprimit	Monitorimi dhe mbështetja e procesit të hartimit të projekteve prioritare në bashkëpunim me AULEDA-n dhe Këshillin e Qarkut të Vlorës	✓		Shkurt 2011
	Raund takimesh me bashkitë dhe komunat për të rritur përfshirjen e autoriteve vendore në procesin e PS-së	✓		Mars 2011
	Fokus Grupe në Vlorë dhe në Sarandë: konceptimi dhe hartimi i projekt-propozimeve për të përfshirë edhe PS-në rajonale	✓		Prill 2011



Pjesëmarrja

Baza e procesit të Planifikimit Strategjik



Një moment i procesit të pjesëmarrjes: Aktiviteti Prezantues në Vlorë (Tetor 2010)

Secili hap i metodologjisë së planifikimit strategjik karakterizohet nga pjesëmarrja, duke nxitur kështu përfshirjen dhe angazhimin në rritje të aktorëve territorialë.

Gjatë fazës së parë, aktorët informohen për metodologjinë dhe objektivat e planifikimit strategjik. Në fazën e dytë, atyre iu kërkohet që të fokusohen në identifikimin e aspekteve potenciale dhe kritike të qarkut të tyre dhe që të përvijojnë Skenarë të mundshëm të zhvillimit. Faza e tretë është identifikimi i përbashkët i Vizionit dhe i Strategjisë së përbashkët për zhvillimin rajonal. Faza e fundit kërkon një përfshirje më të madhe të aktorëve territorialë, të cilëve iu kërkohet që të angazhohen për identifikimin dhe nisjen e projekteve të zhvillimit.

Në përputhje me këtë metodologji, përgjatë procesit të planifikimit strategjik u nxit pjesëmarrja aktive e të gjithë aktorëve territorialë dhe u realizua nëpërmjet caktimit të takimeve personalisht me aktorë të rëndësishëm, si dhe nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të konsultimit publik. Hapat e pjesëmarrjes u karakterizuan nga një nivel në rritje i ndërveprimit, duke filluar nga një prezantim i thjeshtë i nismës së planifikimit strategjik (aktiviteti prezantues), te seminarët tematike, një debat publik për Strategjinë dhe së fundi Fokus Grupet, në të cilat aktorët territorialë punuan së bashku për përcaktimin e projekteve.

Gjatë gjithë procesit u zhvilluan takime me grupe

të rëndësishme të interesit, së bashku me takimet e nevojshme të koordinimit me të gjithë aktorët e përfshirë në program.

Aktivitetet pjesëmarrëse, brenda kuadrit të ART GOLD 2, mbështetën krijimin e Këshillit të Partneritetit të Qarkut (KPQ) dhe të një Grupi Teknik Mbështetës (GTM). I pari është organi kryesor këshillues dhe koordinues për përgatitjen dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal dhe përbëhet nga subjekte institucionale dhe përfaqësues të shoqërisë civile, organizata të arsimit dhe të biznesit, ndërsa i dyti siguron asistencën e nevojshme teknike për KPQ-në për përcaktimin dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit.

Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal në Vlorë (AULEDA) u krijua nga ART GOLD në vitin 2003 dhe më vonë u shndërrua në instrument të politikave të fuqizimit të ndërmarrja si nga ART GOLD 2, ashtu edhe nga ILS LEDA. AULEDA luajti një rol vendimtar në menaxhimin e proceseve pjesëmarrëse dhe, e mbështetur nga ekspertët e PS-së, zhvilloi kapacitetet e saj për të sjellë së bashku aktorët territorialë, për të moderuar diskutime publike etj.

Rezultatet e procesit pjesëmarrës u morën në konsideratë të gjitha, u përpunuan, u organizuan dhe u përfshinë në PS. Rrjedhimisht, e gjithë përmbajtja e PS-së mund të konsiderohet se është ndarë me të gjithë komunitetin rajonal dhe për të cilën ai ka rënë dakord.

Takimet me pjesëmarrje

Fakte dhe shifra

Nga shkurti i vitit 2010 deri në prill të vitit 2011, në kuadrin e nismës së planifikimit strategjik rajonal u mbajtën më shumë se 110 takime.

Takimet e ndryshme të organizuara kishin si synim prezantimin e qëllimeve dhe objektivave të PS-së të përfaqësuesit të qeverisë shqiptare, autoritetet rajonale dhe vendore dhe të aktorëve të tjerë përkatës që operojnë në zonë, në mënyrë që të krijohej konsensusi dhe gatishmëria për të marrë pjesë aktivisht në procesin e planifikimit strategjik dhe për të zhvilluar një ndjenjë zotërimi të procesit. Si rezultat, metodologjia pjesëmarrëse e planifikimit strategjik u nda dhe u miratua gjerësisht dhe u themeluan marrëdhënie bashkëpunimi, veçanërisht ndërmjet AULEDA-s dhe aktorëve institucionalë, siç janë Ministria Italiane e Punëve të Jashtme, Ministrinë shqiptare, Kooperacioni Italian, Banka Botërore, Qarku i Vlorës, organet e bashkëpunimit ndërkombëtar etj. Për më tepër, takimet ishin gjithashtu të rëndësishme për kryerjen e një studimi të aktiviteteve dhe të projekteve të zbatuara nga aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në Qarkun e Vlorës, si dhe për të mbledhur informacione për statusin e zbatimit të ndërhyrjeve për zhvillim, përfshirë planifikimin urban dhe përvojat e zhvillimit lokal. Veç kësaj, ato nxorën në pah mundësi koordinimi ndërmjet ART GOLD 2 dhe organizatave të tjera që operojnë në Qark dhe ndihmuan për të nxitur

Shifrat e pjesëmarrjes


- **50** takime me grupet e interesit
- **70** takime koordinimi
- **6** aktivitete të konsultimit publik
- **40** orë debat publik
- Më shumë se **300** pjesëmarrës në aktivitetet e diskutimit publik

bashkëpunimin ndërmjet institucioneve.

Një grup tjetër takimesh iu përkushtua krijimit të një platforme koordinimi ndërmjet stafit të programit ART GOLD 2, AULEDA-s dhe aktorëve të tjerë të përfshirë drejtpërdrejt në program. Gjithashtu, këto takime kishin si qëllim ngritjen e kapaciteteve, veçanërisht për sa i përket AULEDA-s, e cila ishte e përfshirë vazhdimisht dhe e trajnuar për metodologjinë dhe aktivitetet e planifikimit strategjik.

Takimet janë listuar në faqen pasuese në rend kronologjik, të ndara në dy kategoritë e lartpërmendura: takime koordinimi dhe takime me aktorët e rëndësishëm.

Aktorët e rëndësishëm në procesin e Planifikimit Strategjik



70 Takime koordinimi

- 38 takime me stafin ART GOLD 2 të PNUD-it
- 17 takime me stafin e AULEDA-s dhe stafin rajonal
- 5 takime me koordinatorët e programit Universitas
- 4 takime me ekspertin e ILS LEDA-s
- 1 takim me menaxherin e grupit të PNUD-it
- 1 takim me drejtorin e zyrës së PNUD-it në Shqipëri
- 1 takim me PNUD-IsD
- 2 takime me përfaqësuesit e bordit të AULEDA-s

46 Takime me grupet e interesit

- Drejtoria e Programimit Strategjik, Ministria e Ekonomisë
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- Banka Credins
- Departamenti i Investimeve të Huaja të Direkte AlInvest
- Nënkryetari i Këshillit të Qarkut të Vlorës
- Nënkryetari i Bashkisë së Vlorës
- Drejtori i Kooperacionit Italian
- Agjencia e Mjedisit të Qarkut të Vlorës
- Shoqata e mjedisit "Adriatiku"
- Kryetari dhe nënkryetari i Bashkisë së Orikumit
- Nënkryetarët e Komunës së Shushicës
- Kryetari i Komunës Horë-Vranisht
- Kryetari dhe nënkryetari i Bashkisë së Himarës
- Zyra e Bashkëpunimit të Decentralizuar, Rajoni Emilia Romanjas
- Banka Botërore
- Departamenti Rajonal i Ministrisë shqiptare të Bujqësisë
- DGCS, Kooperacioni Italian për Zhvillim
- Drejtoria Qendrore, Ministria e Turizmit
- Konsulli i Përgjithshëm Italian në Vlorë
- Kryetari i Qarkut të Vlorës
- Projekti i Pikave të Nxehta Mjedisore, UNEP
- Drejtoria e Përgjithshme, Ministria e Turizmit
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit - FSHZH
- Organizata Holandeze për Zhvillim - SNV
- 19 Përfaqësues të autoriteteve vendore (Bashki dhe Komuna)

Aktivitetet e konsultimit publik

Fakte dhe shifra

Për të krijuar përfshirje dhe zotërim në PS-në rajonale dhe procesin e saj, u organizuan gjashtë aktivitete për diskutim publik, si më poshtë:

1 Aktivitet prezantues

5 Tetor 2010

Nisja publike e nismës së Planifikimit Strategjik dhe takimi prezantues.



2 Ditë të Hapura

17 and 19 Nëntor 2010

Për të përvijuar strategjinë e zhvillimit rajonal, në Vlorë dhe Sarandë u zhvilluan konsultime publike, të nënndara në 4 seminare tematike:

- Rrjetet mjedisore dhe infrastrukture për qëndrueshmëri
- Trashëgimia kulturore dhe turizmi
- Çështjet sociale
- Zhvillimi rural dhe zgjerimi i larmisë së aktiviteteve rurale



1 Debat publik

15 Dhjetor 2010

Për të ndarë, për të diskutuar dhe për të rishikuar draftin e Vizionit dhe të Strategjisë së zhvillimit rajonal u zhvillua një takim për konsultim publik. Aktiviteti u parapri nga një tryezë e rumbullakët me një panel ekspertësh dhe intelektualësh të zgjedhur nga Këshilli Rajonal.



2 Takime të Fokus Grupeve

18 dhe 19 Prill 2011

Në Vlorë dhe Sarandë u zhvilluan takime të konsultimit publik, për të përcaktuar projektet e përbashkëta dhe të integruara për zbatimin e PS-së.



Të gjitha aktivitetet ishin të suksesshme për sa i përket numrit të pjesëmarrjes, e cila ishte e kënaqshme (më shumë se 330 pjesëmarrës të regjistruar në total) dhe të gjithë aktorët treguan interes dhe gatishmëri për t'u përfshirë aktivisht në procesin e përgatitjes së PS-së. Gjatë këtyre aktiviteteve u përforcua gjithashtu bashkëpunimi ndërmjet aktorëve rajonalë dhe lokalë dhe ndërmjet ART GOLD 2 dhe partnerëve.

Ekonomi

UNDP mbështet qarkun e Vlorës, zhvillimi rajonal, me standarde të BE-së

Prezantohet plani strategjik, nishta e programit ART GOLD 2 të PNUD-it. Pirro: Hartimi i planit strategjik, impakt për zhvillim të qëndrueshëm të territorit

Teuta Shamku

Turizmi, trashëgimia kulturore, infrastruktura portuale, aeroportuale, agroindustria, bujqësia janë sektorët që të gëshehuan në një strategji të mirëfilltë zhvillimi, do të sillin zhvillimin që realisht pret qarku i Vlorës. Autoritetet vendore të qarkut Vlorë dhe aktorë të tjerë që kontribuojnë në zhvillimin e rajonit, prezantuan dje në qytetin e Vlorës nisjen e procesit të planifikimit strategjik për qarkun e Vlorës. Ky proces mbështetet nga programi PNUD-it, ART GOLD 2, dhe Agjencia Lokale e Zhvillimit Ekonomik, AULEDA. Kryetari i Këshillit të Qarkut, z. Ylli Piro, deklaroi dje se strategjia që qarku i Vlorës po përpiqet të realizojë, synon që ajo të jetë në koherencë me strategjitë e zhvillimit të qeverisë. A tha se Këshilli i Partimetet që është miratuar nga Këshilli i Qarkut, ka një rol konsultativ të përcaktuar dhe detyrën për të udhëhequr procesin e planifikimit strategjik dhe se me anë të takimit të zhvilluar dje dhe takime të tjera që do pasojnë, synohet të realizohet një strategji rajonale për qarkun e Vlorës në koherencë me të gjitha strategjitë që janë ndërtuar nga ministritë e linjave dhe me strategjitë që ka ndërtuar qarku në fusha të tjera. "Po hedhim një hap, i cili duhet të jetë një matës dhe një vlerësues i drejtëpërdrejtë në zhvillimin e qarkut të Vlorës. Qarku ynë, një qark me potencial turistike, me një pozitië geografike të favorshme, me një peizazh atraktiv, që ofron një gamë të gjerë aktivitetesh në det dhe në mal dhe me një numër ta madh monumentesh të trashëgimisë kulturore, por një mungesë në infrastrukturën turistike. Në një sërë sektorësh që kanë nevojë, si p.sh. mjedisi turistik, profesionalizimi në sektorin e turizmit, infrastruktura portuale dhe aeroportuale, pra sektorë që janë rëndësishëm dhe që duhet në të ardhmen me këtë strategji t'i ndërtojim për t'i dhënë



Autoritetet vendore të qarkut Vlorë dhe aktorë të tjerë që kontribuojnë në zhvillimin e rajonit, prezantuan dje në qytetin e Vlorës nisjen e procesit të planifikimit strategjik për qarkun e Vlorës



një suport të fuqishëm turizmit si sektori prioritar në qarkun tonë", - ka deklaruar Piro.

Projekti në fjalë, që është i mbështetur edhe nga operacioni italian me nismë të UNDP-së, është vlerësuar nga konsulli italian në Vlorë, Sergio Sroci, për veçantinë e tij dhe modalitetet që ka. "Pjesëmarrja e UNDP në zhvillimin e projektit është shenja më e mirë për gjetjen e zgjidhjes më të mirë për planin strategjik të rajonit të Vlorës. Bashkëpunimi që po bëjmë, është shumë sesa ajo që në kemi pritur për zhvillimin e këtij projekti dhe është gjithashtu një përpjekje për lehtësimin të çfarëdo lloj mënyre", - tha dje në takim konsulli italian në Vlorë, Sergio Sroci. Edmond Leka, nënkryetari i Bashkisë së Vlorës, tha se në këtë proces të planifikimit strategjik, Bashkia e Vlorës si bashkia më e madhe e qarkut të Vlorës, duhet të jetë përfutjesja më e madhe e këtij projekti.

Planifikimi strategjik është një proces me pjesëmarrje të gjerë, gjatë të cilit institucionet, subjektet private, shoqëria civile dhe qytetarët e Vlorës do të punojnë

së bashku për të përcaktuar rrugët për zhvillimin e rajonit. Gjithashtu, ai përfundon kuadrin referues për të gjitha projektet dhe nisimat, duke i orientuar drejt realizimit të qëllimeve të përbashkëta. "Hartimi i planit strategjik do të ketë një impakt të konsiderueshëm për arrijten e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit. Nga ana tjetër, ky është një proces demokratik dhe gjithëpërfshirës", - deklaroi kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, z. Ylli Piro.

Vladimir Malkaj, menaxher i programeve të UNDP në Shqipëri, tha se puna për këtë plan strategjik kishte nisur prej kohësh dhe dje po bëhej vetëm një prezantim publik. "UNDP është prej kohësh promovues e zhvillimit rajonal dhe lokal në gjithë Shqipërinë. Është punuar edhe në Vlorë me projekte për mjedisin apo mbledhjen e armëve, por edhe për strategji të zhvillimit rajonal. Sot UNDP-ja ka disa projekte dhe programe të rëndësishme në nivel qendror për programe për zhvillim rajonal, që përfajtojnë politikën e zhvillimit rajonal shqiptar me kërkesat dhe politikat e ardhshme shumë të afërta të Bashkimit

Evropian", - deklaroi Vladimir Malkaj, menaxher i programeve të UNDP, në Shqipëri.

Gjatë aktivitetit të prezantuar dje në Vlorë, metodologjia që do të përdoret dhe rezultatet e para të përfutur, iu bë në njohura të gjithë aktorëve të pranishëm, përfutjesve të UNDP-së, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Procesi i Planifikimit Strategjik i ka fillimet në shkurt 2010 në kuadër të programit ART GOLD 2 të PNUD-it dhe do të drejtohet në muajt e ardhshëm zbatimin e planit strategjik për të cilin është rënë dakord me të gjithë aktorët. Gjatë procesit do të identifikohen burimet dhe do të zbatohen nishta që përmirësojnë cilësinë e jetesës në rajonin e Vlorës. Programi ART GOLD 2 në Shqipëri si pjesë e rrjetit Global të Iniciativës ART ka për qëllim të promovojë mirëqeverisjen dhe zhvillimin vendor ndërmjet aktorëve dhe autoriteteve vendore. Programi ART GOLD 2 në Shqipëri financohet nga qeveria italiane.

Drafti

Qarku i Vlorës, me strategji zhvillimi

Këshilli i Qarkut të Vlorës, i mbështetur nga Programi i PNUD-it "ART GOLD 2" dhe Agjencia për Zhvillimin Lokal Ekonomik, "AULEDA", prezantuan dje tek aktorët vendorë draft- strategjinë e zhvillimit të qarkut në kuadër të procesit të planifikimit strategjik: "Drejt zhvillimit të qëndrueshëm". Ky dokument është prodhuar si rezultat i konsultimeve publike me të gjithë aktorët vendorë. Gjatë takimit që u zhvillua ditën e mërkurë në mjediset e Këshillit të Qarkut Vlorë, u prezantuan skenarët e mundshëm për zbatimin e kësaj strategjie. Kryetari i Këshillit të Qarkut, Ylli Piro ftoi të gjithë aktorët vendorë të kontribuojnë në hartimin e këtij plani strategjik. Drejtuesi i projektit "Art GOLD 2", Luigi Cafiero theksoi se ky është plani i Qarkut Vlorë, ndaj është domosdoshmëri pjesëmarrja dhe kontributi i aktorëve vendorë. Draft- strategjia përcakton udhëzime dhe veprime konkrete për t'u ndjekur e zbatuar dhe që fokusohen në mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe turizmit, çështjet sociale dhe prodhimin agro-ushqimor e zhvillimin rural. Programi i PNUD-it, "ART GOLD 2" financohet nga qeveria italiane dhe po ofron asistencë teknike në dy rajonet Vlorë e Shkodër.

Sarandë

Prezantohet projekti i Planifikimit Strategjik të Qarkut


Këshilli i Qarkut Vlorë, i mbështetur nga Programi i PNUD-it "ART GOLD 2" dhe Agjencia për Zhvillimin Lokal Ekonomik, AULEDA, nisën dje në Sarandë procesin e diskutimeve publike për procesin e Planifikimit Strategjik "Drejt zhvillimit të qëndrueshëm". Diskutimi u përqendrua në katër tryeza, me fokus kryesor mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e rrjetit të infrastrukturës, trashëgiminë kulturore dhe turizmin, zhvillimin rural dhe prodhimin agro-ushqimor. Luigi Cafiero, drejtuesi i programit "ART GOLD 2", që financohet nga qeveria italiane, garantoj një plan strategjik gjithëpërfshirës dhe gjithrajonal (Vlorë, Sarandë dhe Delvinë). Edmond Gjoka, kryetari i Bashkisë Sarandë, vlerësoi se planifikimi strategjik është proces multisektorial që në Bashkinë Sarandë do të fokusohet në të gjithë sektorët, por theksoi të vihet tek midhja, që është produkt tipik i zonës dhe mbrojtja e monumenteve të kulturës, që kanë densitetin më të madh në këtë bashki. Pas prezantimit të projektit, aktorët vendorë të ndarë nëpër tryeza, diskutuan rreth risive të këtij projekti dhe detyrave për realizimin e tij në fushat përkatëse, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përqendrimin në resurset e Sarandës, që janë zhvillimi i turizmit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi rural dhe prodhimin agrourbushqimor.

Botime shtypi të konsultimeve publike: Aktiviteti Prezantues (sipër dhe djathtas) në Vlorë dhe Sarandë dhe Debatet Publike (majtas)

Materialet

për të mbështetur pjesëmarrjen

Djathtas: Logo e vizatuar nga iNEXtstudio për procesin e planifikimit strategjik që paraqet kalimin nga input-et (analizat) tek output-et (projektet), duke përshkuar "filtrin" e pjesëmarrjes



Proçesi pjesëmarrës në Qarkun e Vlorës u mbështet nga një sërë materialesh informacioni dhe komunikimi, që kishin si synim të informonin aktorët territorialë për çështjet e Planifikimit Strategjik, t'i përshinin ata në proçes dhe të nxisnin diskutimin gjatë aktiviteteve të konsultimit publik.

Këto materiale u krijuan duke marrë në konsideratë traditën e varfër të komunitetit rajonal për të marrë pjesë në praktikën pjesëmarrëse. Që nga fillimi i proçesit, në mënyrë që proçedurat e pjesëmarrjes të bëheshin më të lehta, u vendos që t'u jepej aktorëve territorialë mbështetje e vazhdueshme me informacion. Në çdo aktivitet u paraqitën prezantime, të cilat përmbledhnin metodologjinë e planifikimit strategjik dhe statusin aktual të PS-së (aktivitetet e kryera, rezultatet e arritura, hapat në vazhdim etj.). Secili prezantim u plotësua nga një diagram i proçesit të planifikimit strategjik, i përditësuar për çdo aktivitet.

Për aktivitetet u përgatitën edhe materiale të tjera grafike dhe të komunikimit, të tilla si:

- logoja e proçesit të planifikimit strategjik
- drafti i axhendës së aktivitetit dhe ftesat
- faqosja e fletëve të pjesëmarrjes, për të marrë emrat dhe kontaktet e pjesëmarrësve
- faqosja grafike e posterave për të reklamuar aktivitetet
- faqosja grafike e kartave të aktivitetit që përmbanin kontaktet e ART GOLD 2 dhe të AULEDA-s, të cilat iu shpërndanë pjesëmarrësve
- faqosja grafike dhe përmbajtja e broshurave, të cilat siguronin informacion bazë për proçesin e planifikimit strategjik dhe statusin e tij aktual
- materiale informuese, të tilla si "rregullat e debatit", që u shpjegonin pjesëmarrësve

rregullat që duheshin ndjekur për një debat produktiv dhe inkurajonin diskutimin demokratik, "fjalorthi", që shpjegonte fjalët më të rëndësishme në lidhje me proçesin e planifikimit strategjik etj.

- faqosja grafike e dosjeve që do t'u shpërndaheshin pjesëmarrësve, të cilat përmbanin informacion të zgjedhur dhe materiale të komunikimit.
- faqosja grafike e stemave me logon e proçesit të planifikimit strategjik, të shpërndara gjatë të gjitha aktiviteteve pjesëmarrëse.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK QARKU VLORE
 "Drejt një Zhvillimi të Qëndrueshëm"
 STRATEGIC PLANNING VLORA REGION
 "Towards Sustainable Development"

DITE E HAPUR
 4 Seminare Tematike
 17 dhe 19 Nëntor 2010
 ora 10.00 - 17.30

OPEN DAYS
 4 Thematic Workshops
 17 and 19 November 2010
 10.00 AM - 5.30 PM

UNDP ART GOLD 2 www.artgold.undp.org.al **AGA2**
 AULEDA www.auleda.org

Sipër: Poster i përgatitur për të reklamuar Ditët e Hapura në Vlorë dhe Sarandë (Nëntor 2010)

Faqja e internetit e Planit Strategjik

www.vloraregionstrategicplanning.eu

Ekspertët e PS-së ofruan mbështetje për krijimin e faqes së internetit të PS-së, një mjet kryesor i komunikimit dhe i informimit për të përhapur informacionin për aktivitetet e procesit të planifikimit strategjik dhe rezultatet në Qarkun e Vlorës.

Brenda kuadrit të procesit të planifikimit strategjik, faqja e internetit mund të:

- nxisë pjesëmarrjen dhe të mbështesë vendimmarrjen demokratike, duke i dhënë komunitetit lokal informacion të përditësuar për procesin e planifikimit strategjik, metodologjinë, axhendën, aktivitetet, objektivat dhe rezultatet e arritura;
- përmirësojë transparencën në hartimin e politikave dhe të ndihmojë për të krijuar lidhje të besueshme ndërmjet komuniteteve lokale dhe autoriteteve, përfshirë OKB-në;
- sigurojë mbështetje për donatorët potencialë në zgjedhjen e projekteve që mund të financohen në zonë, duke përshkruar

strategjinë e zhvillimit të përshtatur për territorin dhe Planin e Veprimit për ta arritur atë. Synimi është që të sigurohet që projektet e financuara të përmbushin nevojat territoriale.

Për sa i përket kësaj, faqja e internetit u konceptua si produkt i plotë i programit.

Bashkë me trajnimin në terren dhe aktivitetet e promovimit të kryera gjatë misionëve, ekspertët e PS-së hartuan dhe ndanë me AULEDA-n dhe stafin rajonal udhëzuesit për krijimin e faqes së internetit dhe përcaktuan detyrat dhe përgjegjësitë për menaxhimin e faqes së internetit. U siguroi asistencë teknike për kompaninë e dizajnit të faqes së internetit, të kontraktuar për të realizuar dizajnimin e faqes dhe zbatimin.

Faqja e internetit e PS-së www.vloraregionstrategicplanning.eu është funksionale dhe përditësohet nga stafi rajonal, në bashkëpunim me AULEDA-n.

Një imazh nga faqja e internetit të Planit Strategjik për Qarkun e Vlorës, aktualisht në vazhdim

KAPITULLI 1

STRUKTURA E ANALIZËS



Laguna e Butrintit

1.1. Hyrje e Strukturës së Analizës

Një synim i rëndësishëm i PS-së së Qarkut të Vlorës është që të funksionojë si lidhje ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes, qytetarëve e organeve qeverisëse dhe llojeve të ndryshme të programeve. Qëllimi është që të arrihet koordinimi, integrimi dhe sinergjia optimale dhe të përmirësohen e të maksimizohen efektet e nismave të zhvillimit në territorin lokal dhe rajonal.

Rrjedhimisht, objektivi kryesor i Strukturës së Analizës është vlerësimi i situatës aktuale të territorit, duke filluar nga studimi i territorit prej ekspertëve, studimet e drejtpërdrejta në aktivitetet pjesëmarrëse dhe analiza e dokumenteve të planifikimit dhe të programimit të publikuara së fundmi. Në rastin specifik të Qarkut të Vlorës, pjesa më e madhe e mjeteve të planifikimit dhe të programimit u zbatuan pas vitit 2005 dhe informacioni që ato përmbajnë mund të konsiderohet i përditësuar. Për këtë arsye, ato u shfrytëzuan si bazë për përgatitjen e kësaj Struktura të Analizës. Vëzhgimet e drejtpërdrejta nga

qytetarët dhe institucionet lokale ishin të dobishme për të plotësuar pjesën munguese të analizës, domethënë perceptimin që ka komuniteti lokal për zhvillimin e Qarkut në të ardhmen.

Për sa i përket metodologjisë nuk qe e nevojshme të kryheshin kërkime të reja, sepse procesi i planifikimit strategjik nuk filloi nga zeroja, por përkundrazi ruajti vazhdimësinë me programet, projektet, proceset dhe politikat që operonin tashmë në territor, duke i koordinuar dhe duke i përmirësuar ato dhe duke ofruar një perspektivë më të gjerë. Rezultati është ndërtimi i një sistemi konsistent referues për identifikimin e një strategjie të përbashkët zhvillimi, e cila synon të përmirësojë dhe të organizojë burimet lokale.

Kështu, analiza territoriale është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e një imazhi të përbashkët të së ardhmes së Qarkut të Vlorës, i cili duhet të arrihet nëpërmjet identifikimit të qëllimeve dhe strategjive të përbashkëta.

Burimet për analizën territoriale

Siç u përmend më sipër, Struktura e Analizës së PS-së mbledh informacion për territorin kryesisht nga burime dytësore dhe e integron informacionin përkatës me rezultatet e vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe të procesit pjesëmarrës.

Burimet kryesore të informacionit për analizën territoriale të Qarkut të Vlorës ishin si më poshtë:

Në nivel kombëtar:

- Strategjia Sektoriale e Transportit
- Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, 2007-2013

Në nivel rajonal dhe nënrajon:

- Plani për Zhvillimin e Bregdetit Jugor të Shqipërisë
- Korridori VIII - Studimi i Parafizibilitetit për Zhvillimin e Aksit Hekurudhor
- Strategjia për Qarkun e Vlorës për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit

Në nivel lokal:

- Plani Strukturalor i Qytetit të Vlorës
- Plani i Zhvillimit Strategjik të Orikutit

Për analizën mjedisore dhe studimin e zinxhirëve të vlerave referenca kryesore ishte dokumenti "Vlerësimi i potencialeve endogjene territoriale - Studim i burimeve të Vlorës", i përgatitur nga njëri prej ekspertëve të ILS LEDA-s.

Burimi i pjesës më të madhe të të dhënave demografike ishte INSTAT-I (Instituti Kombëtar Shqiptar i Statistikës), ndërsa faja zyrtare e UNESCO-s ishte burimi kryesor për informacion shtesë në lidhje me historinë rajonale dhe trashëgiminë kulturore (www.unesco.org). Referenca të tjera relevante ishin faja e internetit e Agjencisë Kombëtare Shqiptare të Turizmit (www.albaniantourism.com), si dhe faqet zyrtare të internetit të bashkive të Vlorës dhe të Sarandës dhe libri "Delvina - Shqipëri" nga Ylber Hysi.

Ju lutemi, vini re që studimet e përfshira në këtë dokument nuk kanë si synim të jenë gjithëpërfshirëse dhe mund të bëhen ndryshime dhe shtesa në çdo kohë, në koherencë me natyrën e procesit të PS-së rajonale.

The screenshot shows the UNESCO World Heritage Convention website. The main heading is "World Heritage Convention" with the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization logo. Below the heading is a navigation menu with options like "News & Events", "The List", "About World Heritage", "Activities", "Publications", "Participate", and "Resources". A search bar is present with the text "Search the List". The main content area displays the entry for "Butrint" in Albania, including a brief description, location (District of Sarandë, County of Vlorë), date of inscription (1992), and a photograph of the stone tower. A sidebar on the right contains links to "Global Strategy", "Criteria", "Tentative Lists", "World Heritage List Nominations", "World Heritage List", "New Inscriptions", "Interactive Map", "World Heritage in Danger", and "Success Stories".

Imazh nga faja e internetit të UNESCO-s në lidhje me Butrintin - sit i Trashëgimisë Botërore

1.2. Ndarja e analizës me të tjerët

Aktiviteti prezantues

Aktiviteti prezantues i procesit të planifikimit strategjik në Qarkun e Vlorës u zhvillua më 5 tetor 2010.

Takimi u moderua nga drejtori i AULEDA-s, pati një pjesëmarrje të konsiderueshme (rreth 70% të aktorëve të ftuar morën pjesë, në një total prej afërsisht 80 pjesëmarrësish) dhe pati mbulim të mirë nga media.

Gjatë takimit, u prezantuan dhe u shpjeguan metodologjia dhe objektivat e planifikimit strategjik, duke theksuar qasjen novatore të nismës.

U nxor në pah roli i PS-së si platformë koordinimi ndërmjet politikave kombëtare dhe lokale, së bashku me dobinë e saj për ngritjen e fondeve.

Gjithashtu, takimi ishte i dobishëm për të:

- theksuar pronësinë rajonale të procesit të planifikimit strategjik
- theksuar rolin e rëndësishëm të AULEDA-s në zhvillimin e Qarkut të Vlorës dhe të angazhimit të saj për të mbështetur programin.

Aktiviteti ia doli mbanë që t'u shpjegonte institucioneve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile metodologjinë dhe "filozofinë" e planifikimit strategjik, duke theksuar natyrën pjesëmarrëse dhe vepruese të nismës, në kuadrin e programeve të OKB-së, të fokusuar në zhvillimin njerëzor në Shqipëri.



1.3. Struktura Territoriale

Qarku i Vlorës është një nga 12 qarqet e Shqipërisë, i themeluar si njësi e qeverisjes vendore në 30 nëntor 2000.

Qarku përfshin rrethet e Vlorës, Sarandës dhe Delvinës. Çdo rreth përfshin një ose më shumë bashki dhe një sërë komunash, me një total prej 7 bashkish dhe 19 komunash (shihni tabelën 1).

Kryeqyteti rajonal është Vlora, një qendër e madhe e industrisë, e tregtisë dhe e komunikimit.

Popullsia e qarkut është rreth 211.734 banorë (INSTAT, 2009), në një sipërfaqe 2.706 km².

Qarku i Vlorës ndodhet në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë, i shtrirë më së shumti në vijën bregdetare joniane.

Vlora është qarku me vijën bregdetare më të gjatë në vend. Karakteristikat e tij gjeografike përbëjnë potencialet kryesore për turizmin dhe zhvillimin lokal.

Qarku ka një vijë bregdetare prej 144 km, e cila është shtëpia e plazheve të bukura ranore. Bregu fillon në pjesën jugore të qytetit të Vlorës dhe gjarpëron deri në pikën më jugore të kufirit me Greqinë, duke përfshirë gadishullin e Karaburunit dhe Rivierën shqiptare.


Qarku është kryesisht malor dhe kodrinor. Livadhet dhe luginat e tij krijojnë mundësinë që popullsia lokale të fitojë jetesën nëpërmjet prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Zona përbën një mozaik të traditave historike dhe kulturore, duke ofruar një larmi habitatesh dhe vlerash të rëndësishme mjedisore.

Qarku karakterizohet nga kushte të ndryshme ekonomike, të cilat lidhen drejtpërdrejt me nivelet e ndryshme të zhvillimit. Ndryshimi në cilësinë e jetës ndërmjet zonave bregdetare urbane dhe zonave rurale (kryesisht të vendosura në male ose në luginat e lumenjve) është i dallueshëm dhe është shkak i disa çështjeve sociale dhe ekonomike. Kjo situatë lidhet ngushtë me rolin që ka luajtur deri tani turizmi i "plazhit dhe i rërës" në zhvillimin lokal.

Tabela 1.
Bashkitë dhe Komunat në Qarkun e Vlorës

Bashkitë	Komunat
Delvinë	Finiq
Sarandë	Mesopotam
Konispol	Vergo
Vlorë	Aliko
Himarë	Dhivër
Orikum	Ksamil
Selenicë	Livadhja
	Lukovë
	Markat
	Xarrë
	Armen
	Brataj
	Horë-Vranisht
	Kotë
	Novoselë
	Qendër
	Sevaster
	Shushicë
	Vllahinë



1.4. Ngjarjet kryesore historike

Në antikitet, pjesa veriore e Qarkut të tanishëm të Vlorës ishte e populluar nga fisi i Ilirëve, ndërsa pjesa jugore banohej nga fisi epirot i Kaonëve.

Në atë kohë, qyteti i Vlorës quhej Aulona. Ai njihej nga shumë udhëtarë si një nga qytetet-porte kryesore të rajonit jugor ilirian, i dyti vetëm pas Apollonisë dhe Orikumit. Emri, Vlora, është një nga disa emrat e paktë gjeografikë të bregut lindor të Adriatikut që ka mbetur i pandryshuar që nga antikiteti.

Një pjesë e rëndësishme e popullsisë së këtyre zonave mundi t'i rezistonte procesit të romanizimit dhe të skllavërimit, gjë që karakterizoi një pjesë të madhe të Gadishullit Ballkanik. Sipas rrënojave arkeologjike të gjetura në zonë, Qarku i Vlorës dallohej nga vendbanime të rëndësishme prehistorike, vendbanime kulturore dhe ekonomike, qytete dhe qendra urbane.

Qarku i Vlorës ka një sërë zonash që provojnë pavarësinë dhe vazhdimësinë e kulturës ilire gjatë epokave të Bronzit dhe të Hekurit. Vendbanime të tjera të njohura antike janë qytetet: Amantia, Olimpia, Kanina, Himara, Cerja, Armeni, Saranda, Butrinti, Finiqi, Triporti dhe Aulona. Simboli antik arkeologjik i Vlorës është "Vajza aulonase", një skulpturë e një nimfe 87 cm e lartë dhe e gdhendur nga mjeshtri vendas me gurin gëlqeror të Kaninës. Ajo simbolizon veshjen e grave ilire.

Qyteti i Orikumit u themelua në jug të Vlorës. Orikumi është porti më i lashtë në bregun jugor dhe në shekullin e 5-të p.e.r. ishte një zonë e

rëndësishme vendbanimi. Më pas, Orikumi u një port i fortifikuar dhe një bazë ushtarake e rëndësishme në Adriatik.

Amantia u themelua në shekullin e 5-të p.e.r. dhe është një nga qytetet më të vogla jugore ilire. Rrënojat e saj përfshijnë shumë ndërtesa dhe stadiume të ndërtuara me gurë të mëdhenj.

Qyteti antik i Foenikes (Finiqi) u ndërtua në shekujt 5-4 p.e.r. në pjesën jugore të qarkut, afër qytetit të sotëm të Sarandës. Foenike ishte qyteti kryesor i kaonëve dhe më vonë, në shekullin e 2-të p.e.r., u bë kryeqyteti i shtetit të Epirit. Qyteti i Sarandës ishte fillimisht porti i Foinikes dhe gjurmët e para të vendbanimit datojnë në shekullin e 2-të p.e.r. me emrin Angjizmos. Edhe pse ndodhej në një pozicion gjeografik të favorshëm, nuk u bë asnjëherë një qendër e rëndësishme si Butrinti.

Ky i fundit ishte një qytet antik brenda rajonit të Epirit. Të dhënat e para arkeologjike të pushtimit të vendosur datojnë ndërmjet shekujve 10-8 p.e.r., megjithëse ka të dhëna më të hershme të vendbanimit në shekullin 12-të p.e.r. Butrinti ishte zona e një kolonie greke, një qyteti romak dhe e një dioqeze. Pas një periudhe lulëzimi nën administrimin e Bizantit, Butrini u pushtua nga Venedikasit në fundin e shekullit të 14-të. Në fund të Mesjetës, qyteti, nën administrimin otoman, u braktis, për shkak të formimit të kënetave në zonë. Aktualisht, zona është një grumbullim rrënojash, që përfaqësojnë çdo periudhë të zhvillimit të qytetit. Në vitin 1992 ai u përfshi në listën e UNESCO-s të Vendeve të Trashëgimisë Botërore.



Majtas: teatri antik në Parkun Arkeologjik të Orikumit;
Sipër: pamje nga Parku Arkeologjik i Butrintit

Në shekullin e 6-të e.r. dhe duke vazhduar në Mesjetë, Aulona përmendet në një listë të qyteteve bregdetare porte të rëndësishme, me pajisje detare të zhvilluara, që eksportonin vaj ulliri, kripë, lëndë druri dhe ullinj në të gjithë pjesën tjetër të Europës.

Në mesin e shekullit të 14-të, familja aristokratike Delvina sundoi qytetin e Delvinës dhe në vitin 1354 Mehmet Ali Pasha Delvina ishte pronari i kalasë dhe i qytetit. Në shekujt 15-të dhe 16-të regjimi otoman e ktheu Vlorën në një port të rëndësishëm të Adriatikut. Vlora ishte baza për sulmet otomane kundër qyteteve italiane jugore në vitin 1480, kundër kryengritësve të Himarës në vitin 1492 dhe shërbeu si bazë për Sulltan Sulejmanin kundër Korfuzit në vitin 1537.

Në shekujt 17 dhe 18, Vlora ishte një nga limanet më të rëndësishme të Shqipërisë Jugore, për shkak të formës së gjirit të saj që i mbronte anijet nga stuhitë. Në portin e Vlorës ishte ndërtuar një depo e madhe për grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe të mallrave për eksport. Qyteti zhvillonte tregti me Triesten, Venedikun, Vjenën, Korfuzin, Stambollin, Izmirin, Breshian, Barin, Manastirin, Janinën dhe Maltën. Vlora eksportonte vaj ulliri, ullinj, kripë, lesh dhe lëkurë, si dhe shumë prodhime të tjera bujqësore nga zonat e rajonit.

Ndër shekuj, Vlora është njohur si një nga vatrat më patriotike të Shqipërisë. Luftërat për liri, pavarësi dhe prosperitet kanë qenë në shpirtin e të gjithë njerëzve të territorit. Qarku i

Vlorës ishte vendi i shumë luftërave kundër pushtimeve të huaja dhe e përpjekjeve për përhapjen e arsimit shqip dhe ishte vendi i shumë shoqërive patriotike.

Ngjarja më e rëndësishme në qytetin e Vlorës ndodhi më 28 Nëntor 1912, kur Ismail Qemali, së bashku me delegatë të tjerë shqiptarë të ardhur nga viset e vendit, shpalli pavarësinë e Shqipërisë nga pushtimi turk dhe ngriti flamurin kombëtar në Vlorë. Vlora u bë kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur.



Në dhjetor të vitit 1914 Vlora u pushtua nga italianët. Pas zgjerimit të pushtimit italian nisi të rritej rezistenca kundër sundimit të tyre. Në vitin 1920, pas Kongresit të Lushnjës, u krijua "Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare". Komiteti organizoi forcat luftarake në Luftën e Vlorës.



Në këtë faqe: monumente historike në Vlorë dhe në Luginën e Shushicës

1.5. Infrastruktura për lëvizjen dhe struktura urbane

Sistemet e transportit janë një faktor kyç për zhvillimin e suksesshëm të turizmit. Deri tani, Qarku i Vlorës ka qenë relativisht i izoluar, për shkak të rrjetit të pazhvilluar të rrugëve dhe kushteve të këqija të udhëtimit. Analizat e kryera tregojnë mungesën e politikave të zhvillimit të transportit të integruar në nivel rajonal dhe lokal.

Megjithatë, masat e parashikuara nga qeveria shqiptare për zhvillimin e infrastrukturës së rrugëve pritet të transformojnë situatën e tanishme. Zhvillimi i rrjetit të infrastrukturës rajonale të transportit do të lehtësojë lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave dhe do t'i afrojë tregjet me njëra-tjetrën. Si rezultat, do të ketë nxitje të biznesit dhe do të rritet mundësia për të përfituar shërbime, si për shembull shëndetësore dhe arsimore, duke pasur kështu një ndikim të drejtpërdrejtë në kushtet e jetesës së qytetarëve.

Në Shqipëri, autobusët janë të vetmet mjete që përdoren për transport publik, ndryshe nga qytetet europiane ku në sistemet e transportit përdoren lloje të tjera të mjeteve të transportit, siç janë tramvajet, hekurudhat nëntokësore, hekurudhat rajonale etj. Aktualisht, nuk ka projekte të tilla për mjete alternative të transportit publik.

Rrjeti rrugor

Rrjeti rrugor i Qarkut bazohet në aksin veri-jug që lidh Tiranën dhe Durrësin me qytetin e Vlorës, Orikum, Himarën dhe Sarandën, i cili përfaqëson aksin kryesor në nivel rajonal dhe ndërregional.

Zhvillimi i pabarabartë i rrjetit rrugor është një nga arsyt kryesore për zhvillimin e çekuilibruar të pjesëve të ndryshme të rajonit. Në fakt, ka një lidhje proporcionale ndërmjet nivelit të varfërisë dhe nivelit të cilësisë së infrastrukturës së

rrugës. Në fshatra të ndryshme, rrugët e pashtuara shkaktojnë probleme të transportit publik dhe pengojnë zhvillimin e ekonomisë rurale. Mungesa e një sistemi të efektshëm të mirëmbajtjes së rrugëve nga komunat dhe bashkitë e përkeqëson më shumë situatën aktuale.

Volumi në rritje i trafikut në rrugë është burimi kryesor i ndotjes së ajrit dhe i trafikut të rënduar, duke shkaktuar probleme mjedisore dhe ekonomike. Volumi i trafikut në stinën e verës e përkeqëson më tej situatën aktuale, për shkak të vërshimit të turistëve. Përveç kësaj, veçanërisht në qytetet bregdetare, rrugët nuk janë ndërtuar për t'u përshtatur me rritjen e madhe të trafikut të automjeteve, shkak i të cilit është rritja e shpejtë e ekonomisë së tregut dhe zhvillimi i pakontrolluar urban që erdhi si pasojë e saj. Rrjedhimisht janë krijuar probleme të mëdha të trafikut, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet me përqindjen më të madhe të aksidenteve rrugore, të plagosjeve dhe vrasjeve të njerëzve, mes vendeve europiane. Shumë nga këto aksidente janë shkaktuar nga kushtet e këqija teknike të rrugëve dhe nga përdorimi i automjeteve të vjetra.

Për shkak të mungesës së një autostrade në Qarkun e Vlorës, si trafiku i transportit, ashtu edhe trafiku lokal përdorin të njëjtat rrugë, duke kaluar përmes disa qyteteve dhe/ose fshatrave dhe duke shkaktuar ngarkim të trafikut.



Tabela 2.


Nr. i automjeteve për pasagjerë në qarkun e Vlorës dhe Shqipëri (INSTAT 2007)

	Makina	Autobus/Minibus	Motoçikleta	Totali
Qarku i Vlorës	18.599	594	762	19.995
Shqipëri	225.114	35.973	11.639	272.726

Diagram 1.

Buxheti i mirëmbajtjes së rrugëve për rrugët kombëtare sipas prefekturave 2005-2009

(Rishikimi i parë pesëvjeçar i Planit Kombëtar Shqiptar të Transportit, 2010)



Projektet më të rëndësishme rrugore që po ndërtohen ose janë në progres në qark, janë si më poshtë:

- Lushnjë – Fier – Vlorë: duke u përmirësuar në një autostradë 2x2 (në ndërtim)
- Vlorë – Qafa e Llogorasë – Dhërmi: rehabilitimi i rrugës kombëtare (e përfunduar)
- Dhërmi – Himarë – Sarandë: rehabilitimi i rrugës kombëtare (në ndërtim)
- Levan – Tepelenë: rehabilitimi i rrugës

kombëtare dhe pjesërisht ndërtim i ri (në fazën e tenderimit)

- Ura e Kardhiqit (afër Gjirokastrës) – Delvinë: rehabilitimi i rrugës kombëtare (projekti ka hyrë në proçes)
- Sarandë – Kranë – Konispol (kufiri me Greqinë): rehabilitimi i rrugës kombëtare (projekti ka hyrë në proçes)
- Cukë – Dritas – Pllakë – Mursi: rehabilitimi i rrugës rajonale (projekti ka hyrë në proçes).



Fig. 2 (në të djathtë)

Rrugë ekzistuese, në ndërtim dhe të reja (Plani i Zhvillimit të Bregdetit Jugor të Shqipërisë)



Infrastruktura hekurudhore

Pas vitit 1990, volumi i trafikut hekurudhor pati një rënie të ndjeshme ashtu si në të gjitha vendet e Europës Lindore. Transporti i pasagjerëve pati ulje, për shkak të importit masiv të automjeteve, përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës rrugore dhe konkurrencës me kompanitë private të autobusëve.

Ndërkohë, për arsye sigurie, shpejtësia maksimale e trenave është reduktuar në 30-40 km/h, madje në disa zona të caktuara në 25 km/h. Një nga arsyet e kësaj uljeje është se 20 vitet e fundit nuk ka pasur fonde për të mirëmbajtur dhe për të riparuar hekurudhën.

Gjithashtu, gjatë periudhës 1991-1997, sistemet e sinjalizimit dhe të komunikimit u shkatërruan. Për rrjedhojë, trenat lëvizin me shpejtësi të reduktuar dhe kanë një nivel të ulët sigurie.

Infrastruktura e sistemit hekurudhor është e varfër dhe si pasojë e shpërndarjes së pamjaftueshme të burimeve dhe mungesës së një mekanizmi për të siguruar mirëmbajtje të vazhdueshme, standardet teknike të hekurudhës janë të ulëta dhe nuk garantojnë siguri. Sistemi i sinjalizimit në linja dhe në sistemin e ndërlihdjes në disa stacione të kalimit të trenave nuk është funksional. Ka disa kryqëzime pa mbikalim, të cilat shpesh shkaktojnë aksidente ndërmjet trenave dhe automjeteve të tjera.

Në këto kushte, transporti hekurudhor në krahasim me atë rrugor, nuk është konkurrues.

Hekurudha aktuale lidh qytetin e Vlorës me rajonet veriore, ku stacioni i Vlorës është ndalesa e fundit. Nuk përdoret për transport publik, por vetëm për transportin e mallrave.

Korridor VIII

Korridor VIII është një nga dhjetë 'Korridoret trans-europiane', që kanë si qëllim të lehtësojnë shkëmbimin e mallrave, njerëzve, naftës dhe furnizimeve të tjera me energji ndërmjet BE-së, Ballkanit dhe Azisë Qendore. Për këtë arsye, Korridor VIII, pasi të përfundohet, do të përputhet, në kuadrin e përgjithshëm të Aksit Transkombëtar të Europës Juglindore, me zhvillimin e rrjetit të transportit në rajonin e Ballkanit. Ky rrjet do të shërbejë si urë ndërmjet Europës dhe Lindjes së Largët, si dhe një faktor paqeje dhe zhvillimi për ekonomitë ndërrajonale.



Linja kryesore e Korridorit VIII kalon nga portet jugore italiane të Barit dhe Brindizit, portet shqiptare të Durrësit dhe Vlorës, qytetet e Tiranës, Shkupit, Sofjes, Plovdivit në portet bullgare të Burgas dhe Varnës në Detin e Zi, duke lidhur kështu Korridorin e Transportit të Adriatikut të Italisë, degën e Adriatikut të Autostradës Detare dhe Zonën Mesdhetare të Transportit me Zonën e Detit të Zi të Transportit Paneuropian. Përgjatë rrugës së tij, Korridor VIII është i ndërlidhur me korridoret paneuropiane IV, IX dhe X.

(Burimi: Studimi i Parafizibilitetit për Zhvillimin e Aksit Hekurudhor - Raporti përfundimtar, 2007)

Infrastruktura detare

Shqipëria ka miratuar së fundmi një ligj për administrimin detar dhe për themelimin e drejtorisë së transportit detar. Aktualisht është i ndaluar lundrimi privat i anijeve shqiptare përgjatë një gjatësie të caktuar dhe për shkak të problemeve të kontrabandimit, ky ndalim nuk do të hiqet përpara mesit të vitit 2012.

Shqipëria shtrihet ndërmjet 2 aglomerateve shumë të mëdha të turizmit detar, një në jug, me bazë në Greqi dhe një në veri, me qendër në Kroaci. Aktualisht, anijet nga të dyja vendet lundrojnë përmes bregdetit shqiptar, pa ndaluar, për shkak të mungesës së strukturave pritëse dhe sigurisë së ofruar nga strukturat e organizuara. Anijet, porti i regjistrimit i të cilave është në Itali, vështirë të marrin përsipër të kalojnë në ujërat shqiptare. Sidoqoftë, interesi për Shqipërinë po rritet. Portet e Vlorës dhe të Sarandës janë identifikuar si pikat hyrëse të qarkut për anijet e huaja dhe meritojnë struktura të plota të porteve brenda mjedisit ekzistues urban.

Porti detar i Vlorës është porti i dytë i rëndësishëm në Shqipëri, i cili është përcaktuar si porta e dytë hyrëse e Korridorit VIII pas portit të Durrësit. Nëpërmjet këtij porti transportohen pasagjerë dhe mallra, duke mbuluar rreth 10% të mallrave të eksport-importit. Aktualisht, infrastruktura dhe superstruktura e tij po zhvillohen. Qeveria italiane do të financojë fazën e parë, të dytë dhe të tretë të projektit të fuqizimit të portit me anë të 15,3 milionë euro, i cili do të përfshijë gjithashtu ndërtimin e dokeve të ngarkimit të mallrave dhe dokun e trageteve.

Porti i Himarës shërben si port dytësor, i përdorur kryesisht për turizmin në Himarë dhe në zonat përreth dhe nuk luan asnjë rol për transportimin e mallrave.

Porti detar i Sarandës është një port dytësor, i cili shërben për transportimin e pasagjerëve



dhe të mallrave. Gjithashtu, ai po zhvillohet mbi bazën e Masterplanit, si port me funksion turistik për transportimin e pasagjerëve, ndërsa transportimi i mallrave do të bëhet në **portin e Limanit** (rreth 3 km larg portit të qytetit). Fondi do të sigurohet nga buxheti kombëtar dhe Banka Botërore.

Kompania italiane "Petrolifera Italo-Shqiptare", bazuar në një marrëveshje koncesionare me qeverinë shqiptare, po ndërton **Portin e Gjirit të Vlorës**. Ky port do të përdoret për shkarkimin dhe magazinimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Ai do të lehtësojë përpunimin duke rritur nivelet e sigurimit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mes porteve të tjera që duhet të përmenden janë **porti i peshkatarëve të Triportit**, në Vlorë, dhe **porti i Oriksit** i ndërtuar së fundmi (*shihni foton më poshtë*) në pjesën jugore të Gjirit të Vlorës, i cili ofron shërbime bazë për jahtet, hapësira shumëfunksionale dhe apartamente.



Qarqet	Numri i pasagjerëve në total	Mallra në total (000 ton)
Totali	978.115	4.271
Durrës	701.081	3.423
Lezhë	36.543	283
Vlorë	240.491	565
<i>nga të cilat:</i>		
Porti i Vlorës	136.831	457
Porti i Sarandës	10.366	108

Tabela 3.

Transporti detar i pasagjerëve dhe i mallrave (INSTAT 2007)

Transporti publik

Brenda territorit rajonal, makinat private janë mjeti kryesor i transportit. Ekzistojnë disa linja private të autobusëve, të cilat i lidhin qytetet kryesore me njëri-tjetrin. Forma më e zakonshme e transportit kolektiv me automjete private është furgoni. Përkundrazi, me përjashtim të qytetit të Vlorës, të ecurit është mënyra kryesore e lëvizjes brenda qyteteve dhe komunave, sepse qarku karakterizohet nga një numër i madh qytetesh të vogla dhe fshatrash, ku të gjitha mjediset ndodhen në një largësi ku mund të shkohet më këmbë.

Transporti publik nuk luan një rol të rëndësishëm në lëvizjen e popullsisë në qytetin e Vlorës, ku shkalla e motorizimit po rritet. Nga ana tjetër, korporatat e transportit publik po përballen me presionin në rritje për zhvillim të mëtejshëm, me subvencionet e reduktuara dhe detyrimet e reja për rindërtimin dhe ripërtëritjen e linjave të tyre. Aktualisht, qyteti i Vlorës ka vetëm 3 linja publike të autobusëve: Vlorë – Uji i Ftohtë, Plazhi i Vjetër - Unazë dhe Çole – Spital. Shërbimi i transportit publik të qytetit ka një kapacitet total shërbimi prej 2,074,064 pasagjerësh në vit dhe 50 pasagjerësh për udhëtim, rrjedhimisht 114 udhëtime në ditë. Si rezultat, automjetet private po përdoren gjithnjë e më shumë për udhëtimet urbane.

Ecja me biçikletë është shumë pak e zakonshme në qytetet e Shqipërisë (përveç Shkodrës), kryesisht sepse rrugët nuk janë ndërtuar për përdorimin e biçikletave dhe janë gjithashtu të ngarkuara me makina të parkuara, materiale mbeturina etj. Për këtë arsye, kjo mënyrë lëvizjeje ka nevojë për vëmendje të veçantë përmes masave rregulluese, si dhe ndërtimit të korsive të veçanta për biçikletat. Krijimi i sipërfaqeve për këmbësorët nuk duhet të kufizohet vetëm te hapësirat e rrugëve, por duhet të zgjerohet edhe te vendet kulturore dhe historike, në vendet e aktiviteteve zbavitëse dhe përgjatë bregdetit.

Struktura urbane

Që nga rënia e komunizmit, Shqipëria ka përjetuar tranzicion në ekonominë e tregut. Efektet e këtij transformimi janë të dukshme, veçanërisht në modelin fizik dhe atë të hapësirës. Urbanizimi ka kaluar nëpër tri faza:

- faza e parë ishte e dominuar nga zhvillimi i

sektor joformal;

- e dyta ishte e karakterizuar nga konsolidimi i sektorit joformal dhe shfaqja e atij formal;
- e treta ose faza aktuale është rritja e urbanizimit të qëndrueshëm, me zhvillimin e mëtejshëm të sektorit formal dhe normalizimi i shpejtë i vendbanimeve joformale, së bashku me vendbanimet e reja formale.

Në Qarkun e Vlorës, ashtu si në qarqe të tjera të Shqipërisë, mund të identifikohen katër lloje të ndërtesave të banimit, si më poshtë:

- Blloqe ndërtesash me apartamente (3, 4 ose 5-katëshe) të ndërtuara gjatë periudhës së socializmit (rreth vitit 1970) dhe që akomodonin pjesën më të madhe të popullsisë qytetare përpara vitit 1990. Këto ndërtesa kanë cilësi mesatare dhe të ulët, megjithatë në shumicën e rasteve me kalimin e kohës banorët e kanë rinovuar pjesën e brendshme të tyre. Të gjitha këto ndërtesa banimi janë të lidhura me shërbimet publike.
- Shtëpi tradicionale private dhe shtëpi apartament që datojnë në vitet '20.
- Shtëpi private të porsandërtuara (1 deri në 3-katëshe, me hapësirë 100 deri 150 m² për çdo kat). Këto shtëpi nuk kanë lidhje zyrtare me shërbimet publike, përveçse lidhjen me energjinë.
- Ndërtesa të reja të porsandërtuara shumëkatëshe (5 deri në 13-katëshe) të cilësisë së lartë në qytetet kryesore.

Qendrat e qyteteve përbëheshin kryesisht nga blloqe apartamentesh të llojit të vjetër socialist dhe ndërtesa të tjera, që akomodonin një dendësi të lartë popullsie, që variojnë nga 300 deri në 500 banorë për hektar.

Ky urbanizim i shpejtë nuk është ndjekur nga zhvillimi i infrastrukturave të nevojshme mbështetëse. Ka pasur mungesë të burimeve financiare të bashkisë dhe të kapacitetit të menaxhimit urban për të ruajtur dhe për të garantuar cilësinë e jetesës në qytete. Ndërtimet e pakontrolluara dhe pa leje po shkatërrojnë pasuritë kulturore dhe mjedisore, veçanërisht cilësinë e lartë të peizazheve natyrore të këtyre qyteteve, duke krijuar kështu pengesa serioze për një planifikim më të mirë. Infrastruktura rrugore e rinovuar tashmë nuk përmbush kërkesën e dendësisë së rritur të popullsisë. Për sa i përket zhvillimit të turizmit, kjo gjë përfaqëson një kërcënim, veçanërisht në zonën bregdetare, jo vetëm sepse dëmton peizazhin, por gjithashtu sepse përfshin shkatërrimin e burimeve mjedisore dhe territoriale.

1.6. Konteksti social

Profili social-demografik

Në janar 2009 (sipas faqes zyrtare të internetit të INSTAT-it) popullsia e Qarkut është rreth 211.734 banorë, e cila përfaqëson 6,6% të gjithë banorëve të Shqipërisë (shihni fig. 3).

Qarku ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 2.706 Km², 9,5% e sipërfaqes së vendit. Dendësia e popullsisë është e ulët, rreth 78 banorë/Km².

Pjesa më e madhe e popullsisë së Qarkut jeton në Vlorë (shihni tabelën 3). Ndarja e popullsisë qytetare në Qark është 54%, kurse për rrethin e Vlorës kjo ndarje është 58% (shihni fig. 4).

Modeli më i zakonshëm i familjes në Vlorë është familja me katër anëtarë.

Jetëgjatësia mesatare është 71,4 vjet, 68,5 për burrat dhe 74,3 për gratë. Sipas të dhënave nga regjistrimet lokale, moshë mesatare në qark është 28,6. Në disa komuna, si Mesopotam, Dhivër dhe Himarë, përqindja e popullsisë mbi 65 (rreth 30%) është shumë më e lartë se mesatarja e qarkut. Një arsye e kësaj ndarjeje të pazakontë është shkalla e lartë e emigrimit në këto zona. Meqenëse të rinjtë kanë prirjen të jenë të etur për të emigruar, pjesa e grupmoshës së mesme është tkurrur, duke çuar në një proporcion më të lartë të personave mbi 65 në pjesën e mbetur të popullsisë.

Një fenomen tjetër i rëndësishëm është se komunat e rrethit të Vlorës kanë një përqindje më të lartë të grupmoshës 0-14, veçanërisht në komunat malore. Një shpjegim bindës për këtë prirje mund të ishte se këto komuna kanë përqindje më të ulëta të emigracionit. Duke i lidhur këto prirje me çështjen e varfërisë, ia vlen të theksohet se komunat malore të rrethit të Vlorës, aktualisht më të varfërat në qark, kanë potencial të mjaftueshëm njerëzor për të mbështetur zhvillimin.

Figura 3.

Popullsia e Qarkut të Vlorës krahasuar me popullsinë e Shqipërisë (INSTAT 2009)




Figura 4.

Popullsia urbane dhe rurale në Qark (INSTAT 2009)



Rrethi	Popullsia	% e qarkut në total
Delvinë	11.983	5,6
Sarandë	48.465	22,9
Vlorë	151.286	71,5
Totali	211.734	100

Tabela 4.

Popullsia rajonale sipas rrethit (INSTAT 2009)

Sipas të dhënave nga autoritetet rajonale, 27% e familjeve kanë të paktën një anëtar emigrant. Është e dukshme që emigracioni është një çështje e rëndësishme për Qarkun e Vlorës. Saranda ka shkallën më të lartë të emigracionit. Komuna Mesopotam ka raportin më të madh të emigrantëve në qark, me 39% të popullsisë në total, e ndjekur nga Himara me një raport prej 38%.

Qarku i Vlorës është më pak i varfri në Shqipëri, me vetëm 18% të popullsisë që jeton poshtë kufirit të varfërisë. Saranda dhe Delvina janë qytetet më pak të varfra të vendit, me 14% të popullsisë së varfër (sipas *Hartës së varfërisë dhe të pabarazisë në Shqipëri*, INSTAT, 2004).

Në të njëjtën kohë, Vlora është qarku me dallimet më të mëdha, sipas shpërndarjes së shpenzimeve.

Qarku paraqet kontraste të dukshme dhe varfëria është më e theksuar në zonat rurale, veçanërisht në zonat malore të rrethit të Vlorës, si në Horë-Vranisht, Brataj, Sevasterë, Kotë, Armen dhe Shushicë.

Bashkitë bregdetare kanë standarde më të larta jetese, për shkak të të ardhurave që rrjedhin nga turizmi, shpesh të kombinuara me një nivel të lartë remitancash. Këto të ardhura janë burimi kryesor i investimeve në turizëm, veçanërisht të turizmit me bazë familjare ose komunitare.

Bashkia e Selenicës është më e varfra e Qarkut. Qyteti i Selenicës u ndërtua afër një miniere dhe aktualisht gjendet në një pike kthese. Miniera punëson individë nga 150 familje, ndërsa shumë nga banorët e qytetit janë të papunësuar.

Norma e papunësisë në bashki është 38%. Shumë individë dhe familje u detyruan të emigronin, për shkak të mungesës së vendeve të punës. 30% e këtyre familjeve kanë anëtarë emigrantë dhe paratë e dërguara prej tyre përbëjnë bazën e ekonomisë së familjes, ndërkohë që 14% e familjeve jetojnë me asistencë sociale.

Asistenca sociale

Asistenca sociale është mbështetje ekonomike për segmentin më të varfër të popullsisë. Ajo ka qenë funksionale në Shqipëri që nga viti 1993. Sipas ligjit, familjeve në situatën e mungesës totale të të ardhurave ose me të ardhura të pamjaftueshme, iu njihet e drejta e asistencës

sociale.

Sipas të dhënave të vitit 2002 nga Shërbimet Sociale të shtetit, Qarku i Vlorës ka përqindjen më të ulët të familjeve që marrin asistencë sociale, rreth 4%. Shpërndarja e asistencës sociale ndryshon brenda qarkut, nga njëri rreth në tjetrin dhe brenda vetë rrethit. Delvina ka përqindjen më të ulët brenda qarkut, sepse nuk ka familje që marrin asistencë në komunat Mesopotam dhe Finiq.


Tabela 5.


Shpërndarja e popullsisë sipas grupmohave
(Rregjistrimi i popullsisë dhe i banesave 2001, INSTAT)

Komuna (Bashkia)	0-14 %	15 - 64 %	65+ %
Delvinë	26	63	11
FinIQ	14	61	25
Mesopotan	10	57	33
Vergo	23	64	14
Dhivër	10	54	36
Konispol	27	64	9
Livadhja	28	64	9
Lukovë	20	61	18
Sarandë	27	65	9
Xara	28	60	13
Aliko	28	64	8
Markat	27	61	11
Ksamil	28	65	7
Brataj	30	60	9
Himarë	18	53	29
Kotë	31	61	8
Novoselë	29	63	8
Orikum	31	59	10
Qendër	28	63	10
Selenicë	26	59	10
Sevastër	30	63	8
Shushicë	30	64	8
Vllahinë	31	62	7
Vlora	27	65	8
Horë Vranisht	26	61	13
Armen	31	62	7
Total	27	63	10

Figura 5.

Familjet me asistencë sociale sipas llojit të asistencës sociale
(INSTAT 2007)





Punësimi

Grupmosha ndërmjet 15-64 vjeç përfaqëson popullsinë që përbën forcën punëtore dhe përfshin gjithashtu individët që nuk po kërkojnë punësim, të cilët kanë njëfarë varësie ekonomike nga të afërmit e tyre migrues.

Dallimet gjinore janë të dukshme kur bëhet analiza e tregut të punës nga perspektiva e përfshirjes së burrave dhe grave në aktivitetet ekonomike. Pjesëmarrja e grave në tregun e punës përjetoi një rënie në vitet pas rënies së komunizmit. Ndërkohë që në vitin 1989 pjesëmarrja e grave në tregun e punës ishte 77,5%, në vitin 1998 ajo ra në 43,8% dhe në vitin 2003 ra edhe më tej në 39,1%, krahasuar me nivelin e punësimit të burrave, i cili në vitin 2003 arriti 62,6%. Aksesit i kufizuar i grave në mundësitë e punësimit është më i dukshëm në sektorin privat dhe pak më i vogël në atë publik. Sipas të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2001, përqindja e papunësisë në Qarkun e Vlorës është 25,5%. Rrethi i Vlorës ka përqindjen më të lartë të papunësisë prej 27%. Përqindja e papunësisë për Delvinën është 21%, ndërsa për Sarandën është 19,5%.

Të rinjtë janë përgjithësisht të papunësuar, gjë që përbën problemin kryesor të qarkut.

Pamundësia për të gjetur punësim të paguar në mënyrë të arsyeshme, që do t'u siguronte jetesën është një nga arsyet kryesore që ata i drejtohen emigracionit ose ekonomisë joformale.



Tabela 6.

Papunësia e shpërndarë sipas rrethit/gjinisë në Qarkun e Vlorës (Popullsia e Shqipërisë, Vlorë 2001, INSTAT)

	Meshkuj (%)	Femra (%)
Rrethi i Vlorës	21	38
Rrethi i Sarandës	16	26
Rrethi i Delvinës	15	30
Qarku	20	35

Tabela 7.

Papunësia sipas grupmoshave (Popullsia e Shqipërisë, Vlorë 2001, INSTAT)

	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64
Meshkuj	44,5%	36,2%	8,6%	2%	2%
Femra	36,8%	46,5%	40,8%	20%	19%*
Totali	41,5%	41,2%	20,3%	10%	4%

* Llogaritja e femrave në këtë rast është bërë për grupmoshën 55-59 vjeç për shkak të moshës së daljes në pension 60 vjeç


Për sa i përket sektorëve të punësimit, bujqësia është sektori më i rëndësishëm në Rrethin e Vlorës, i cili punëson rreth 34% të të gjithë numrit të personave që punojnë në qark. Punësimi në tregti, hotele, restorante pason me 25%.

Turizmi konsiderohet si një nga shtytësit kryesorë ekonomikë dhe të punësimit në qark, sepse krijon mundësitë për gjenerimin e të ardhurave për një numër të konsiderueshëm familjesh. Është një industri e bazuar në kapitalin njerëzor dhe ofron një mori vendesh pune për kategori të ndryshme profesionale.

Diagrami në figurën 6 tregon se sektori privat zë 75% të forcës punëtore, ndërkohë që vetëm 25% e saj është e punësuar në sektorin publik. Pjesa më e madhe e forcës punëtore, rreth 45%, është e punësuar në sektorin e bujqësisë. Ky është një tregues i mbizotërimit të sektorit të bujqësisë në qark.

Figura 6.

Punësimi sipas aktiviteteve ekonomike (INSTAT 2007)



Arsimimi

Sistemi arsimor parauniversitar shqiptar konsiston në arsimin 9-vjeçar, arsimin e mesëm (gjimnazi dhe shkollat e mesme profesionale) dhe arsimin e lartë (universitetet e më lart). Ai vepron nën përgjegjësinë e përbashkët të qeverisjes vendore dhe qendrore.

Përqindja e regjistrimit në arsimin 9-vjeçar për gjithë qarkun ka qenë 99,86%, ndërsa për arsimin e mesëm është 74% për qarkun, 87% për Rrethin e Sarandës dhe shumë më e ulët për Rrethin e Delvinës (ndërmjet 66-68%)

Në Qarkun e Vlorës, shpërndarja gjeografike e shkollave në nivelin e 9-vjeçar dhe të mesëm të arsimit është i ekuilibruar, duke iu ofruar kështu studentëve mundësi shumë të mira për përfshirjen në sistemin arsimor.

Për nivelin 9-vjeçar, treguesit janë më të mirë, për shkak të shpërndarjes më të barabartë të shkollave 9-vjeçare dhe të ndikimit pozitiv të klasave të kombinuara, veçanërisht në zonat rurale. Në arsimin e mesëm situata është më problematike, sepse shkollat e mesme janë përqëndruar kryesisht në qytetet e Vlorës dhe të Sarandës dhe në shumë raste studentët duhet të frekuentojnë klasat në shkolla që ndodhen shumë larg shtëpive të tyre. Situata është akoma më e keqe në disa zona rurale dhe malore, ku infrastruktura është një pengesë serioze, veçanërisht gjatë stinës së dimrit.

Në të gjitha nivelet arsimore, Qarku i Vlorës ka tregues të mirë të frekuentimit të shkollës dhe përfundimit të arsimimit.

Shkalla e analfabetizmit në qark është më e ulët se mesatarja e vendit (1,5%). Përqindjet e analfabetizmit janë më të larta për gratë (63,1% të numrit total të personave analfabetë) dhe zonat rurale e të largëta, veçanërisht për ato malore. Statistikat tregojnë se shkalla më e lartë e analfabetizmit është në grupmoshat 6-19 (35,4% e totalit) dhe 60-75 (40,4%).

Rreth 14,7% e popullsisë nuk e ka përfunduar arsimin fillor, edhe pse mund të lexojnë dhe të shkruajnë, rrjedhimisht janë analfabetë.

Gjatë 10 viteve të fundit, autoritetet rajonale i kanë kushtuar vëmendje gjendjes fizike të shkollave, duke përmirësuar kushtet e tyre. Pothuajse të gjitha shkollat 9-vjeçare janë rindërtuar plotësisht ose pjesërisht dhe gjithashtu të gjitha shkollat e mesme në qytetin e Vlorës.

1.7. Aspektet mjedisore

Konteksti fizik

Qarku i Vlorës është kryesisht kodrinor dhe malor, ndërsa pjesa më e largët veriperëndimore dhe zona e luginës së Shushicës janë kryesisht fushore.

Një zonë e gjerë malore shtrihet në jug të qytetit të Vlorës në Qeparo dhe Borsh. Pika më e lartë e kësaj zone është Mali i Çikës (2.045 m), i cili ndodhet afërsisht në të njëjtën gjerësi gjeografike me atë të Komunës së Vranishtit. Fusha e Novoselës, Rrethi i Delvinës dhe zonat e tjera kodrinore e luginat e lumenjve karakterizohen përgjithësisht nga toka pjellore dhe toka të mira bujqësore.

Qarku është shumë i pasur me rezerva të ujërave nëntokësore. Një nga burimet më të mrekullueshme është burimi i Syrit të Kaltër, me një kapacitet prej 14 m³/sek, i cili ndodhet në Rrethin e Delvinës.

Bregdeti i qarkut është pjesë e rretheve të Vlorës dhe të Sarandës, ndërsa Rrethi i Delvinës nuk ka dalje në det.

Nga lumi i Vjosës deri në qytetin e Vlorës, bregu përbëhet nga një zonë sedimentare, me ekosisteme shumë interesante, siç janë dunat përreth grykëderdhjes së Vjosës dhe ligatinat e lagunës së Nartës.

Që nga jugu i qendrës së Vlorës deri në kufirin me Greqinë, bregu përbëhet kryesisht nga një linjë erozioni të ashpër, me gjire, limane, plazhe të bukura dhe peizazh shkëmbor nënujor. Përballë zonave të mëdha dhe të vogla me ndërtesa, cilësia e ujit të detit shpesh është e dobët, për shkak të ndotjes, kryesisht për arsye të mungesës së trajtimit të ujit të ndotur urban.

Qarku është i pasur me laguna: Laguna e Nartës në veri dhe Laguna e Butrintit në jug janë që të dyja zona të mbrojtura, ndërsa Laguna e Orikumit, pranë qytetit me të njëjtin emër, është e vetmja zonë ligatinore që nuk është përfshirë në rrjetin e zonave shqiptare të mbrojtura. Shkaku i mbrojtjes është hyrja e saj në bazën e Marinës Shqiptare të Pashalimanit

dhe, meqenëse është planifikuar gjithashtu për të qenë park arkeologjik, ajo menaxhohet gjithashtu nga Ministria shqiptare e Kulturës. Sidoqoftë, hyrja në këtë zonë të vyer natyrore dhe kulturore është e vështirë dhe gjendja e ruajtjes së saj nuk është e mirë, për shkak të pranisë së ndërtesave të braktisura ushtarake. Për më tepër, rritja e numrit të gaforreve mesdhetare dhe ndryshimi i komuniteteve të algave mund të interpretohen si efekte të eutrofikimit të të gjithë sistemit të lagunës.

Shumë lumenj të qarkut kanë një regjim stinor dhe, në të kaluarën, në kohën e përmblyjes së tyre, ata përmblytën zonat përreth shtrateve. Në ditët e sotme, përmes ndërtimit të pritave të përshtatshme, rrjedhat e tyre janë më të kontrolluara.

Sidoqoftë, lumenjtë tani kërcënohen nga mungesa e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve. Intervale të mëdha të brigjeve të lumenjve janë të ndotura nga plehurat e pakontrolluara dhe të djegura.

Ekzistenca e *vendeve të hedhjes* që digjen, veçanërisht gjatë natës, si në periferitë urbane, ashtu edhe në zonat e egra, e bën shumë të mundshëm praninë e ndotjes së ajrit me dioksinë.



Ekosistemet

PS-ja përfshiu rezultatet e studimeve të kryera nga një prej ekspertëve të ILS LEDA-s, në lidhje me burimet produktive të territorit rajonal. Ky studim identifikoi 13 ekosisteme në Qark dhe i klasifikoi ato sipas njërës prej karakteristikave më të rëndësishme të një ekosistemi: produktivitetin e tij.

Kjo tregon në shkallë të gjerë gjendjen e një ekosistemi të caktuar dhe sistemet e ndryshme mund të krahasohen drejtpërdrejt mbi bazën e produktivitetit të tyre. Proçesi i ndërtimit të një lënde organike në një ekosistem varet ngushtësisht nga disponueshmëria dhe lëvizja e energjisë përmes sistemit dhe lëvizja drejtohet përfundimisht nga energjia diellore.

Rrjedhimisht, ekosistemet janë konsideruar si komunitete biologjike dhe janë klasifikuar mbi bazën e Produktivitetit të tyre Kryesor Bruto (PKB). PKB-ja e një komuniteti biologjik është sasia e energjisë së prodhuar nga fotosinteza, për njësi sipërfaqeje dhe kohe, nga bimët, meqenëse ato janë prodhueset kryesore.

Tabela e mëposhtme i ndan ekosistemet sipas kategorisë së PKB-së: produktivitet negativ, i ulët, mesatar, i lartë dhe shumë i lartë.

Tabela tregon se ekosistemet me PKB negative përfaqësojnë zonat urbane dhe ato me PKB pozitive janë zonat natyrore. Ekosistemet me PKB të ulët, mesatare, të lartë dhe shumë të lartë duhet të mbrohen, të ruhen dhe të zgjerohen, me qëllimin për të ruajtur dhe/ose rritur kapacitetet e produktivitetit.

Tabela 8.

Ekosistemet e identifikuar të Zonës AGA2 të Vlorës

(G. Di Stefano, "Studim i burimeve të Vlorës" - Programi ART GOLD 2 në Shqipëri)

PKB (x 10 ³) (kcal/m ²)	Tipologjia	Vende
Negative (PKB<0)	Zona urbane	<ul style="list-style-type: none"> Qendra e Vlorës Qendra e Sarandës
E ulët (0<PKB<0.5)	Zona të larta malore	<ul style="list-style-type: none"> Mali i Çikës (Parku Kombëtar i Llogorasë, më i lartë se 1500 m mbi nivelin e detit)
E lartë (0.5<PKB< 3.0)	Pyje malore	<ul style="list-style-type: none"> Parku Kombëtar i Llogorasë (nga 500 m deri në 1500 m mbi nivelin e detit) Kepi i Karaburunit (më shumë se 500 m mbi nivelin e detit) Në jug të luginës së Shushicës (më shumë se 500 m mbi nivelin e detit) Në veri të Rrethit të Delvinës (më shumë se 500 m mbi nivelin e detit) Në veri të Rrethit të Sarandës (më shumë se 500 m mbi nivelin e detit)
	Makje mesdhetare	<ul style="list-style-type: none"> Të përhapura gjerësisht
	Duna	<ul style="list-style-type: none"> Zona e grykëderdhjes së lumit të Vjosës
	Ujëra të bregut të detit	<ul style="list-style-type: none"> Bregu i Vlorës Bregu i Sarandës
E lartë (3.0<PKB< 10.0)	Pyje	<ul style="list-style-type: none"> Të përhapura gjerësisht në anën lindore të Rrethit të Vlorës (deri në 500 m mbi nivelin e detit) Kepi i Karaburunit (deri në 500 m mbi nivelin e detit) Në jug të luginës së Shushicës (deri në 500 m mbi nivelin e detit) Në veri të Rrethit të Delvinës (deri në 500 m mbi nivelin e detit) Në veri të Rrethit të Sarandës (deri në 500 m mbi nivelin e detit)
	Toka bujqësore (prodhim i vogël)	<ul style="list-style-type: none"> Fusha e Novoselës Në jug të Rrethit të Delvinës Zona të tjera kodrinore Fusha dhe lugina të tjera lumore
	Liqene jo shumë të thella	<ul style="list-style-type: none"> Baseni artificial i Bisticës Liqene të tjera artificiale
	Lumenj	<ul style="list-style-type: none"> Lumi i Vjosës Lumi i Shushicës Lumi i Bisticës
	Laguna	<ul style="list-style-type: none"> Laguna e Nartës Laguna e Orikumit Laguna e Butrintit
Shumë e lartë (10.0<PKB< 25.0)	Toka bujqësore (prodhim industrial)	<ul style="list-style-type: none"> Delvina jugore
	Grykëderdhje të lumenjve	<ul style="list-style-type: none"> Grykëderdhja e lumit të Vjosës Grykëderdhja e lumit të Bisticës

Vlerësimi i konkurrencës

Sipas metodologjisë së ILS LEDA-s, konkurrenca territoriale është synuar si "kapaciteti i qëndrueshëm që zotëron një sistem territorial për të mbështetur, nxitur dhe për të propozuar ndryshimin dhe risitë përmes përdorimit të përshtatshëm të burimeve të tij.

Prandaj, konkurrenca territoriale mat "kapacitetin e evolucionit" të një territori, që

është kapaciteti i tij për të qenë i dukshëm në mënyrë të qëndrueshme në kontekstin global, nëpërmjet dhënies së përgjigjeve të përshtatshme ndaj ndryshimeve të shpeshta dhe të shpejta të këtij të fundit dhe pa komprometuar veçoritë e tij, të cilat duhet të konsiderohen arsyt e tij kryesore të fuqisë".

Tabela e mëposhtme, e marrë nga studimi i ILS LEDA-s, sintetizon arsyet aktuale dhe potenciale të konkurrencës dhe elementet penguese që karakterizojnë territorin rajonal.

Tabela 9.

Vlerësimi i konkurrencës i Sistemit Mjedisor të Qarkut të Vlorës

(G. Di Stefano, "Studim i burimeve të Vlorës" - Programi ART GOLD 2 në Shqipëri)

	<i>Aktuale</i>	<i>Potenciale</i>
Arsyet e konkurrencës	<ul style="list-style-type: none"> Diversiteti i mirë morfologjik (male të larta, lugina, fusha, det, laguna, lumenj, burime, vende urbane dhe të antropizuara), e karakterizuar nga një nivel i lartë diversiteti (dhe biodiversiteti) Peizazhe të cilësisë së mirë Toka pjellore në fusha, lugina lumore dhe në lartësitë mesatare Fusha deltine të cilësisë së mirë Klimë e butë Diversiteti i mirë klimatik 	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e mundshme e zonave bujqësore kushtuar prodhimit në nivel industrial (kryesisht në Rrethin e Delvinës)
Elementet penguese	<ul style="list-style-type: none"> Invazioni i aktiviteteve ndërtimore, të cilat deri tani përcaktuan shkatërrimin e qendrës së Sarandës, dhe tani po kërcënojnë të gjithë rrethin Modifikimi në progres i ekosistemeve të lagunave Mungesa e sistemeve të organizuara të administrimit të mbetjeve dhe të ujërave, të cilat shkaktojnë ndotjen e tokës, ujit dhe të ajrit 	<ul style="list-style-type: none"> Humbja e pakthyeshme e konkurrencës territoriale, për shkak të shkatërrimit të peizazhit si pasojë e aktiviteteve ndërtimore Ajri me dioksinë dhe ndotja e terrenit Ndotja e detit, e lumenjve dhe e lagunave Rrezikimi serioz i biodiversitetit të ekosistemeve të ligatinave



1.8. Peizazhi dhe trashëgimia kulturore

Peizazhet dhe zonat e mbrojtura

Qarku i Vlorës është i pasur me burime natyrore: territori i tij karakterizohet nga një shumëllojshmëri interesante ekosistemesh dhe peizazhesh, duke variuar nga zonat malore te luginat, ligatinat, plazhet ranore dhe brigjet shkëmbore.

Disa prej këtyre zonave të vlefshme nga ana mjedisore mbrohen nga ligji shqiptar si Parqe Kombëtare, Monumente Natyrore dhe Rezervate Natyrore. Në tabelën 8 është paraqitur një listë e zonave të mbrojtura.

Tabela 8.

Lista e zonave të mbrojtura në Qarkun e Vlorës

Paqet kombëtare


Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966
Butrint	VKM nr. 693, datë 10.11.2005
Karaburun-Sazan	VKM nr. 289, datë 28.04.2010

Monumentet natyrore

Syri i kaltër	VKM nr. 102, datë 15.01.1996
---------------	------------------------------

Rezervatet natyrore

Karaburun	Urdhër MB, 22.02.1968, 1977
Rrëzomë	VKM nr. 102, datë 15.01.1996
Vjosë-Nartë	VKM nr. 680, datë 22.10.2004



Sipër: Plazh në Karaburun

Djathtas. nga lart - poshtë:


pamje nga Parku Kombëtar i Llogarasë, laguna e Butrintit, Syri i Kaltër dhe laguna e Nartës

Figura 7.

Rrjeti i Zonave të Mbrojtura (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave)



Figura 8.
Zonat e Mbrojtura të propozuara në Shqipëri (Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin)



Parqet natyrore

Parku kombëtar i Llogorasë

Ky park ndodhet rreth 40 kilometra në jug të qytetit të Vlorës, ndërmjet detit Adriatik dhe Jon. Pemët në këtë zonë kanë kurora të veçanta, që kanë marrë formë nga erërat. Një pemë e veçantë është "Pisha Flamur", e cila është një monument i rrallë natyror me vlerë shkencore të rëndësishme, e vizituar nga shumë turistë. Nga Qafa e Llogorasë, rreth 3 kilometra në perëndim, mund të shikohet shumë qartë deti Jon. Ky park ka vlera të padiskutueshme dhe klima e tij është një kombinim i mirë i ajrit të freskët malor me atë detar. Parku Kombëtar i Llogorasë është gjithashtu një vend i përshtatshëm për sportet ajrore.



Sazani

Sazani është ishulli më i madh në Shqipëri, i gjendur në anën veriperëndimore të gadishullit të Karaburunit, rreth 12 milje nga porti i Vlorës. Ka një sipërfaqe prej 5,7 km, me gjatësi 4,5 km dhe me gjerësi maksimale 2 km. Në antikitet ai quhej Sason. Ishulli ka formën e një blloku shkëmbor, me brigje të thepisura, veçanërisht në pjesën perëndimore të tij. Në pjesën juglindore ndodhet plazhi ranor Admiral, i cili njihet për ujin e tij shumë të pastër. Si Sazani, ashtu edhe Karaburuni njihen veçanërisht për zhytjet.

Karaburuni

Gadishulli i Karaburunit ndodhet në anën perëndimore të gjirit të Vlorës. Ai është gadishulli më i madh në Shqipëri, rreth 16 km i gjatë dhe 4,5 km i gjerë. Në veri të Karaburunit gjendet shpella e Haxhi Aliut, shpella më e madhe e vendit. Ajo është 30 metra e thellë, 18 metra e lartë dhe 12 metra e gjerë. Këto përmasa lejojnë hyrjen e varkave. Shpella mori emrin e një detari nga Ulqini, i cili lundroi në këto ujëra gjatë shekullit XVII. Gadishulli strehon shumë plazhe të vogla, siç janë gjiri i Arushës, plazhet e

Gramës dhe të Dafinës, të cilat janë të shquara për ujërat e thella dhe të pastra. Pranë plazhit të Gramës ndodhet Shpella e Skllëvërve. Në muret e plazhit të Gramës ka mbishkrime antike. Pjesa perëndimore e Karaburunit është një nga pikat më tërheqëse të bregut shqiptar për amatorët e zhytjes.

Parku kombëtar i Butrintit

Ky park ndodhet rreth 25 kilometra në jug të qytetit të Sarandës. Ai ka vlera të larta shkencore, turistike, arkeologjike, sociale dhe zbavitëse, të kombinuara gjithashtu me biodiversitetin e rëndësishëm. Sipërfaqja e parkut është 2500 hektarë. Është një zonë me rëndësi të veçantë për turizmin shqiptar: ai njihet kryesisht për turizmin kulturor në qytetin antik të Butrintit, i mbrojtur nga UNESCO, por gjithashtu për turizmin bregdetar në rajonin e Ksamilit dhe për ekoturizmin në liqenin e Butrintit.



Monumentet natyrore

Syri i Kaltër

Syri i Kaltër është një burim uji, që ndodhet 25 km larg Sarandës, rrugës për në Gjirokastrë, mes një pylli me gështenja, arra, qershi, pisha dhe bredha. Ai është një fenomen gjeologjik dhe një atraksion popullor turistik: uji i kaltër i pastër buron nga një zgavër karstike më shumë se pesëdhjetë metra e thellë. Burimi siguron ujë për lumin e Bisticës dhe, duke kaluar përmes një kanali artificial të ndërtuar në vitin 1958, ujërat e tij derdhen në detin Jon.



Rezervatet natyrore

Laguna e Nartës


Në pjesën jugore të Qarkut të Vlorës shtrihet laguna e Nartës, e cila ka një sipërfaqe prej 4.189 ha dhe është laguna e dytë më e madhe në Shqipëri.

Laguna e Nartës është një tjetër ekosistem natyror me mundësi për zhvillimin e ekoturizmit, vrotimit e zogjve, peshkimit etj. Vlera mjedisore e zonës është e lartë, meqenëse ajo përfshin disa habitate të ndryshme: duna ranore, pyje të pishave mesdhetare, shtrate të vjetra lumore, ligatina të vogla bregdetare, basene të njelmëta, kripore dhe toka të kripura të pakultivuara, toka të kultivuara.

Laguna është përfshirë në IBA (Zona me rëndësi për shpendët) dhe përfaqëson zonën e dytë në Shqipëri për shpendët detarë. Në Nartë ka 195 lloje shpendësh. Gjatë dimrit, rreth 23% e shpendëve që vijnë në Shqipëri ngrenë fole aty. Në ujërat e Lagunës së Nartës jetojnë disa lloje peshqish, por më karakteristike janë ngjala dhe levreku i Nartës.

Laguna e Butrintit

Laguna e Butrintit është një liqen me origjinë tektonike, me një ekosistem natyror me vlera të mëdha mjedisore dhe turistike. Ajo ka një sipërfaqe prej 16 km katrorë dhe lidhet me kanalin e Vivarit, i cili është 3,6 kilometra i



gjatë. Liqeni ka një thellësi prej 20 metrash. Është një vend shumë i përshtatshëm për praktikimin e sportit të lundrimit, për shkak të drejtimit të favorshëm të erës.

E gjithë sipërfaqja e Lagunës mbrohet falë dekretit që e përcakton si Park Kombëtar. Sipërfaqja e mbrojtur u rrit në 86 km² në vitin 2005. Që nga viti 2002, ky territor ka statusin e Ligatinës së Mbrojtur, në përputhje me Konventën e Ramsarit.

Për sa i përket faunës, aty jetojnë rosakët, rosat qafëzeza, shqiponjat, skifteri, lakuriqët e natës etj. Këtu ne mund të gjejmë një sërë reptilësh dhe amfibësh që u shtuan shumë shpejt në numër në zonën e kallamishtes, në bregun verilindor të liqenit. Ia vlen të përmendet bretkosa epirote, lloji i vetëm në Shqipëri.

Ekosistemi është gjithashtu shumë i përshtatshëm për vrotimin e shpendëve: në pyllin e zonës arkeologjike të Butrintit, pranë anës së liqenit, jetojnë 90 lloje të ndryshme shpendësh.



Trashëgimia kulturore

Rajoni i Vlorës është një grumbullim i traditave interesante kulturore, të cilat janë shprehje e një zone të shquar etno-kulturore, të quajtur "Labëri". Këto tradita mund të gjenden në shumë fusha: arkitekturë, folklor, muzikë, artizanat, gastronomi etj.

Qarku ruan traditën e Iso-Polifonisë, e klasifikuar nga UNESCO-ja në vitin 2005 si një kryevepër e trashëgimisë gojore jomateriale të njerëzimit. Iso-polifonia është një formë e sofistikuar e të kënduarit në grup, e cila buron nga muzika e kishës bizantine dhe interpretohet kryesisht nga burrat. Në ditët e sotme, kjo traditë është prekur negativisht nga varfëria, mungesa e mbrojtjes ligjore, mungesa e mbështetjes financiare për praktikuesit dhe emigrimi i të rinjve nga zonat rurale.

Qarku është i njohur gjithashtu për punët artizanale, përfshirë kostumet tradicionale të komunave të ndryshme, qilimat dhe tapiceritë e

punuara me dorë, mbulesat e leshta, thurjet me shtiza, qëndisjet, përpunimi i shajakut, veglat e punës dhe instrumentet muzikore.

Tradicionalisht, nusët përgatitnin pajën e tyre të punuar me dorë dhe në disa fshatra kjo traditë praktikohet ende. Për këtë arsye, në shumicën e shtëpive të fshatit mund të gjenden kostume tradicionale origjinale dhe të punuara me dorë, qilima dhe qëndisje. Aktualisht, ka shumë pak vende ku turistët mund të shikojnë dhe të blejnë punime të tilla artizanale. Ka një potencial të madh për rigjallërimin e disa muzeve etnografike dhe zhvillimin e aktiviteteve tregtare, ku turistët mund të vëzhgojnë procesin e prodhimit të punimeve artizanale, si dhe të blejnë produktet.

Në qytetin e Vlorës, ka tre muze funksionalë, Muzeu i Pavarësisë Kombëtare, Muzeu i Relikeve Historike (ose Muzeu Historik) dhe Muzeu Etnografik. Secili nga këta të fundit paraqet aspekte të ndryshme të historisë rajonale. Muzeu i katërt i qarkut është Muzeu Arkeologjik i Butrintit, i cili përmban materialin arkeologjik të zbuluar në zonë.



Trashëgimia arkeologjike

Amantia

Amantia ishte kryeqyteti historik i fisit ilir të Amantëve dhe u themelua rreth shekullit të 5-të p.e.r. Ai ndodhet në qytetin bashkëkohor të Ploçës në luginën e lumit të Vlorës. Në vitet e kulmit të zhvillimit të saj, Amantia kishte një akropol dhe një tempull të stilit dorik, kushtuar Afërditës. Më i shquari mes ndërtesave të ruajtura është stadiumi, i cili është 60 metra i gjatë dhe 12,5 metra i gjerë. Një skulpturë e rëndësishme, gdhendja në relief e Perëndisë së Pjellorisë, mund të shikohet në Muzeun Historik Kombëtar. Gjetje të tjera nga Amantia janë ekspozuar në Muzeun Arkeologjik në Tiranë.

Shpallur Park Arkeologjik, nga Këshilli i Ministrave, më 31.03.2005.

Aulona

Prapa Sheshit të Monumentit të Pavarësisë në Vlorë, janë gërmuar rrënojat e një kështjelle drejtkëndore. Kalaja përbënte një pjesë të qytetit antik të Aulonës dhe është ndërtuar në shekullin e 4-t e.r. për të përballuar dyndjet gotike. Gjetje të tjera në zonë tregojnë datën më të hershme të banimit rreth shekullit të 4-t p.e.r. Gjetja më e famshme e kësaj periudhe është një skulpturë e njohur si "Vajza e Vlorës", e cila tregon një vajzë të veshur me fustan ilir. Burimet historike e përmendin Aulonën në shekullin e 2-të e.r., të lidhur me përpjekjet romake për të përmirësuar rrugët në këtë pjesë të Ballkanit perëndimor. Në fundin e shekullit të 6-të e.r., sllavët pushtuan qytetin, duke shkaktuar dëmtime të mëdha dhe largimin e shumë qytetarëve në ishullin e Sazanit, ku janë zbuluar gjurmët e këtij vendbanimi. Qyteti mund të mos e ketë rifituar më asnjëherë statusin e tij dhe duket se është zvogëluar ndjeshëm në përmasa dhe për nga rëndësia në kohën kur emri i tij rishfaqet në dokumentet bizantine, rreth vitit 1100 e.r.

Butrinti

Butrinti ndodhet në bregdetin jugperëndimor të Shqipërisë, në jug të qytetit bashkëkohor të Sarandës. Zona është banuar të paktën që nga shekulli i 8-të p.e.r. Në shekullin e 4-t p.e.r u themelua një vendbanim i fortifikuar dhe qyteti filloi të rritej nëpërmjet tregtisë. Augusti themeloi një koloni në Butrint dhe qyteti mbeti një port romak relativisht i vogël deri në

shekullin 6-të e.r. Pas rënies së Perandorisë Romake, popullsia dhe rëndësia e qytetit u tkurrën. Më pas, Butrinti hyri në një periudhë të trazuar të luftës për kontroll nga shtetet e Bizantit, Normandisë dhe të Venedikut. Venedikasit, turqit otomanë dhe për një kohë të shkurtër francezët luftuan për zotërimin e mëvonshëm. Në kohën kur u bë pjesë e Shqipërisë në vitin 1912, ai ishte praktikisht i braktisur. Përpjekje të ndryshme arkeologjike filluan në vitet '20 dhe vazhdojnë ende sot.

Butrinti u përcaktua nga UNESCO si Zonë e Trashëgimisë Botërore në vitin 1992 dhe u shpall Park Kombëtar Arkeologjik, nga Këshilli i Ministrave, më 02.03.2000.



Nga lart - poshtë: Rrënojat e Amantias; statujë në Muzeun Arkeologjik të Butrintit

Finiqi/Foenike

Foenike ndodhet pranë qytetit bashkëkohor të Sarandës. Në antikitet, territori përreth zonës i përkiste Kaonisë, pjesë e mbretërisë së Epirit. Është i pasur me objekte nga periudha klasike dhe ajo bizantine. Burime antike përmendin pasurinë e qytetit, veçanërisht gjatë periudhës helenike, ndërmjet shekullit të 3-të dhe të 2-të p.e.r., kur Foenike ishte një qytet me rëndësi në Lidhjen Epirote. Në qytetin Foenike u nënshkrua marrëveshja e rëndësishme nga ana historike për fundin e Luftës së parë Maqedonase. Dokumenti mori emrin "Paqja e Foenikes". Zhvillimi i qytetit vazhdoi edhe gjatë periudhës së Perandorisë Romake dhe asaj të Bizantit. Pushtimi osman me sa duket shkaktoi kurrjen e popullsisë dhe të tregtisë së Foenikes. Shpallur Park Arkeologjik, nga Këshilli i Ministrave, më 31.03.2005.

Onchesmos (Sarandë)

Emri i qytetit antik rrjedh nga trojani Ankiz, bashkimi mitologjik i të cilit me perëndeshën Afërditë solli në jetë një djalë me emrin Enea. Në periudhën e vonë republikane dhe perandorake të hershme, qyteti përmendet në lidhje me lundrimin dhe portin. Rreth shekullit të 6-të e.r., emri i qytetit ndryshon në Shën Saranda ose "Dyzet Shenjtorët". Rrethanat e ndryshimit të emrit janë të paqarta, por mund të lidhen me ndërtimin e një bazilike të madhe mbi qytetin modern të Sarandës. Janë gërmuar monumente të ndryshme dhe gjetjet arkeologjike nga qyteti. Mes atyre më mbresëlënëse janë sinagogat/bazilikat, një pjesë e një harku perandorak romak dhe një model i një shtëpie të antikitetit të vonë. Gjetje të tjera të rëndësishme janë: një ndërtesë apsidale, një Odeon, një varrezë dhe një mozaik i përpunuar mirë, i njohur gjerësisht si "Dyshemeja e Delfinit".

Orikumi

Orikumi ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë, në jug të Vlorës, pranë qytetit të sotëm të Orikumit. Sipas Plinit, qytetin e Orikumit e themeluan kolonët nga Kolkia. Pozicioni i tij gjeografik e bëri atë një port dhe qendër tregtare të rëndësishme në bregdetin e Adriatikut. Orikumi ishte i rëndësishëm edhe për strategjit ushtarake. Ai përdorej nga romakët si bazë mbrojtjeje në luftërat kundër ilirëve, si dhe në shekullin e 3-të p.e.r. kundër

maqedonasve, të cilët e pushtuan atë më vonë në vitin 214 p.e.r. Jul Cezari e përdori zonën si vendfushim për trupat për disa muaj, derisa u mor nga Pompeu i Madh.

Shpallur Park Arkeologjik, nga Këshilli i Ministrave, më 31.03.2005.



Nga lart - poshtë: Rrënojat e Finiqit; pamje nga Parku Arkeologjik i Butrintit; shkallët për në akropolin e Orikumit

Kalatë dhe manastiret

Qarku i Vlorës është i pasur me ndërtesa historike, siç janë kalatë, fortesat dhe manastiret, shpesh të lëna pas dore dhe të nënvlerësuara. Ato më kryesoret janë përshkruar më poshtë.

Kalatë

- **Kalaja e Porto Palermos** ndodhet në një gadishull në gjirin e Porto Palermos, rreth 60 km në jug të Vlorës, pranë Himarës. Kalaja u ndërtua në fillim të shekullit të 19-të, nga një sundues osman, Ali Pasha i Tepelenës, për nder të së shoqes, Vasiliqisë, në themelet e një forte me të vjetër. Kalaja ka formë trekëndore me përmasa 150x400 metra me mure që arrijnë në 20 metra lartësi. Ajo ndodhet mes shkurreve mesdhetare gjithmonë të gjelbëruara dhe nga muret e saj mund t'i gëzohesh pamjes së gjirit. Në vendin ku gadishulli lidhet me tokën ndodhet kisha e Shën Nikollës.
- **Kalaja e Kaninës** u ndërtua në fshatin me të njëjtin emër, rreth 6 km në juglindje të Vlorës. Kalaja ngrihet në anë të Malit Shushica, rreth 380 metra mbi nivelin e detit. Ajo u ndërtua në zonën e një vendbanimi të lashtë, e banuar që nga shekulli i 7-të ose i 6-të p.r.s. dhe e fortifikuar që në gjysmën e 2-të të shekullit të 4-t p.e.r. U rindërtua nga perandori Justinian në shekullin e 5-të p.e.r. Gjithashtu, kalaja



Nga lart - poshtë, nga e majta në të djathtë: Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Borshit, rrënoja në Tragjas dhe Kalaja e Himarës

ishte shumë e rëndësishme në antikitetin e vonë dhe në Mesjetë. Rrethi mbrojtës është rreth 1000 m i gjatë dhe përfshin një sipërfaqe prej 3,5 hektarë.

- **Kalaja e Lëkurësit (Sarandë)** ndodhet në majën e një kodre strategjike, që ngrihet sipër qytetit të Sarandës dhe mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1537, në rrënojat e fshatit Lëkurës, nga Sulltan Sulejmani, i cili sulmoi Korfuzin dhe e përdori kalanë për të kontrolluar gjirin e Sarandës dhe rrugën që e lidhte atë me Butrintin. Kalaja ka formë katërkëndore, me dy kulla të rrumbullakëta në këndin veriperëndimor dhe atë juglindor. Tani është strehë e një restoranti panoramik.
- **Kalaja e Borshit**, e njohur gjithashtu si Kalaja e Sopotit nga emri i kodrës në të cilën ngrihet, ka një sipërfaqe prej 5 hektarësh dhe një bazament prej blloqesh guri. Ajo u ndërtua në shekullin e 4-të p.e.r., nga fiset epirote-ilire. Kalaja u dëmtua rëndë gjatë pushtimeve barbare të shekujve të 5-të dhe të 6-të e.r., dhe u rindërtua në Mesjetë. Më pas u pushtua nga osmanët gjatë vitit 1417 dhe nga Princi i Arbrit në vitin 1441. Osmanët e rimorën përsëri kalanë në vitin 1848.
- **Kalaja e Gjon Boçarit**, në fshatin Tragjas, daton në shekujt 16-17-të.
- **Kalaja e Himarës** u fortifikua nga fisi i kaonëve dhe përmendet në dokumentet bizantine. U riparua në shekullin e 6-të. Perandori Justinian ishte ai që urdhëroi rindërtimin për t'i bërë ballë sulmit të gotëve dhe të husëve.



Manastiret dhe vendet e adhurimit

- **Manastiri i Zvërnecit** (në të djathtë)- Nndodhet në ishullin me të njëjtin emër në lagunën e Nartës. U ndërtua në shekullin e 13-të sipas stilit bizantin dhe iu kushtua Shën Mërisë. Çdo 15 gusht, është një festë ortodoksë për të kujtuar lindjen e Shën Mërisë.
- **Kisha e Shën Stefanit, Manastiri dhe Kisha e Panajasë (Dhërmi)** – Fshati Dhërmi (poshtë) daton të paktën në shekullin e 1-rë p.e.r. Dikur kishte 31 kisha dhe disa prej tyre ia vlen të vizitohen ende. Më e rëndësishmja është Kisha e Shën Stefanit nga periudha bizantine, një vend pelegrinazhi çdo mes gushti, kur kryhen ritet fetare në ditën e Shën Mërisë. Mund të vizitoni edhe Manastirin e Panajasë me kishën e saj të shekullit të 14-të.
- **Xhamia e Muradijes**, e ndërtuar në stilin osman në gjysmën e dytë të shekullit të 16-të dhe e projektuar nga arkitekti shqiptar Sinani, një nga projektuesit më të rëndësishëm të xhamive në periudhën e Perandorisë Osmane, i cili projektoi Xhaminë e Madhe "Sulejmani" (Xhamia Blu) në Stamboll.

Gjithashtu, me vlerë për t'u përmendur janë: rrënojat e **Manastirit bizantin të 40**

shenjtoreve në Sarandë (nga i cili qyteti ka marrë emrin); fshati tradicional Qeparo, me **Kalanë e Kukumit** (e ndërtuar në shekullin e 2-të p.e.r.) dhe **Manastiri i Shën Dhimitrit**; një sërë kishash, manastiresh dhe xhamish antike në Rrethin e Delvinës, siç është **Manastiri i Shën Nikollës në Mesopotam** (i ndërtuar ndoshta në shekullin e 11-të e.r.), **Kisha e Shën Thanasit në Pecë** (një kishë e vogël, që daton në vitin 1525, pjesa e brendshme e së cilës është e zbukuruar me afreske), **Manastiri i Shën Triadhës në Kardhikaq** (shekulli i 17-të), **Manastiri i Shën Mërisë në Kamen** (shekulli i 16-të) dhe **Xhamia e Gjin Aleksit** (shekulli i 17-të) në fshatin Rusanj.



Figura 9.
Harta e trashëgimisë kulturore në qark


ZONA TË MBROJTURA

- A** PARKU KOMBËTAR I LLOGARASË
- B** LAGUNA E NARTËS
- C** PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT
- D** SYRI I KALTËR

ELEMENTË HISTORIKË

- 1 SHPELLA E SHËN MARENËS
- 2 KALAJA E VAGALATIT
- 3 KALAJA E LËKURBIT
- 4 QYTETI ANTIK I BUTRINTIT
- 5 QYTETI ANTIK I FONIKË
- 6 MURET ANTIKE NË DUKË
- 7 MANASTIRI I SHËN GUERGJIT
- 8 QYTETI ANTIK PALEOMANASTËR
- 9 KALAJA E DUKËS SË AUTOJIT NË CIFLIK
- 10 KALAJA E DUKËS SKILLAPUAS NË VERDQ
- 11 KALAJA E BORSHIT
- 12 KALAJA E KALIVOSË
- 13 KALAJA E KARLIBEJIT
- 14 KALAJA E ALI PASHËS NË MEHALLE
- 15 KALAJA E MALLATHRESË NË MURSI
- 16 KALAJA E ALI PASHËS NË VRINË
- 17 KALAJA E DELVINËS
- 18 MURET ANTIKE NË HUNDEQOVË
- 19 KISHA E SHËN TODHRIT
- 20 MANASTIRI I SHËN MARIËS SË KORBZIT
- 21 KISHA E SHËN VASILIT
- 22 GËRMADHAT E LUJËSELËSIT NË XARRË
- 23 TEMPULL ANTIK
- 24 MANASTIRI I SHËN MËRISË
- 25 MUSEU HISTORIK
- 26 SHPELLA E SHËN GUERGJIT NË DHIVËR
- 27 MANASTIRI I SHËN MËRISË SË KAKOMËS
- 28 MANASTIRI I SHËN MËRISË SË KRIMAROVËS
- 29 MANASTIRI I SHËN THANASIT
- 30 KISHA E SHËN MËRISË NË LESHNICË E POSHTME
- 31 KISHA E SHËN GUERGJIT
- 32 KISHA E SHËN MËRISË
- 33 MANASTIRI I BUON THEOLOGJIT NË CERKOVICË

- QYTET ANTIK**
- KALA**
- MONUMENT FETAR**
- URË ANTIKE**
- PARK KOMBËTAR**
- REZERVAT NATYROR**
- MONUMENT NATYROR**
- SHPELLË**
- MUR I LASHTË**
- GËRMADHA**
- TEMPULL I LASHTË**
- SHTËPI TIPIKE**
- MONUMENT HISTORIK**



Potencialet dhe problemet kryesore

Studimet e vendeve kryesore të trashëgimisë natyrore dhe kulturore nxjerrin në pah disa probleme të mëdha, të cilat ndikojnë negativisht në shfrytëzimin e tyre turistik.

Me përjashtim të Butrintit, në vendet e tjera arkeologjike dhe turistike është e vështirë të shkohet, për shkak të mungesës së sinjalistikës dhe rrjetit të pazhvilluar rrugor. Madje, edhe komunitetet lokale janë ndonjëherë të pandërgjegjshme për vlerën e këtyre vendeve dhe vendndodhjen e tyre.

Në rastin e Orikumit, aksesimi është më i vështirë, për shkak të pranisë së një baze ushtarake: për të hyrë në vend, kërkohet një autorizim i veçantë. Në zonë nevojiten gërmime të mëtejshme, për të nxjerrë në dritë strukturën urbane të qytetit antik, aktualisht i fshehur. Për më tepër, prania e ndërtesave dhe e pajisjeve të braktisura ushtarake dëmton vlerën peizazhore të vendit dhe përfaqëson një kërcënim potencial për shëndetin dhe sigurinë.

Një situatë e ngjashme karakterizon gjirin e Porto Palermos, ku ndërtesat e braktisura rrethojnë Kalanë e Ali Pashait, të ruajtur në mënyrë të mrekullueshme. Kalaja vetë nuk shfrytëzohet për turizëm dhe, duke mos qenë e

ruajtur vazhdimisht, është e ekspozuar ndaj akteve të vandalizmit dhe të shkatërrimit.

Vendet e trashëgimisë kulturore në zonat e thella janë ato më të neglizhuarat, për shkak të përqendrimit të aktivitetit të turizmit në bregdet.

Nëse do të jetë i vazhdueshëm, ky neglizhim mund të çojë në shkatërrimin e plotë të monumenteve dhe në humbjen e pakthyeshme të atraksioneve të turizmit kulturor në zonat e brendshme.

Zonat natyrore, nga ana tjetër, janë të kërcënuara vazhdimisht nga hedhjet e paligjshme dhe aktivitetet e ndërtimit pa leje. Një kontroll i efektshëm në këto vende, me synimin për të ruajtur vlerat e tyre mjedisore dhe pamjen tërheqëse turistike, është një çështje prioritare.

Në përgjithësi, e gjithë trashëgimia mjedisore dhe kulturore e Qarkut të Vlorës nuk ka politika të koordinuara të marketingut të turizmit, të integruara me veprime të efektshme të ruajtjes dhe të menaxhimit të qëndrueshëm.

Shërbimet turistike dhe infrastruktura, të tilla si guidat turistike, sinjalizimi, transportet etj., ose nuk ekzistojnë, ose janë të papërshtatshme. Informacioni i disponueshëm, veçanërisht në internet, është shpesh i fragmentuar dhe jokonsistent.



Majtas, nga lart - poshtë: Ndërtesë e braktisur ushtarake; brenda Parkut Arkeologjik të Orikumit;

Djathas, nga lart - poshtë: Baza ushtarake e Pashalimanit në Orikum, ndërtesa të braktisura afër Kalasë së Ali Pashës në Porto Palermo.

1.9. Zinxhirët e Vlerave

Potencialet e Qarkut të Vlorës

Në kuadrin e programit ART GOLD 2 të PNUD-it, nga specialisti i ILS LEDA-s janë identifikuar potenciale të rëndësishme ("Studim i burimeve të Vlorës", i përditësuar në nëntor 2010) të tilla si:

- Zonat natyrore me biodiversitet të lartë, që iu përkasin ekosistemeve të ndryshme, përfaqësojnë një burim për turizmin e qëndrueshëm dhe zhvillimin rural.
- Disa zinxhirë të vlerave bujqësore dhe agroushqimore që përfaqësojnë "burime të përsosmërisë" (sipas metodologjisë së ILS LEDA-s: burime endogjene konkurruese, të cilat mund të konsiderohen të rralla, unike ose që zotërojnë cilësi primare dhe, rrjedhimisht, janë të krahasueshme ose madje të parapëlqyera në raport me burimet e shprehura nga territore të tjera), siç janë:
 - produktet e zinxhirit të vlerave të Bletës, si për shembull mjalti nga një lloj i vetëm luleje, qumështi i bletës, propolisi
 - shumë lloje peshqish
 - të gjitha llojet e bimëve
- varieteti i ullirit *kalinjot* dhe vaji ekstra i virgjër.
- Burimet bazë (burimet endogjene të natyrës "së zakonshme", të cilat mund të përdoren për të pakësuar nevojat primare të territorit: këto burime duhet të konsiderohen konkurruese, sepse ato janë të domosdoshme për qëndrueshmërinë ekonomike të territorit), të tilla si:
 - djathi *feta* ose "djathi i bardhë i fortë", djathi *kaçkavall*, kosi
 - verërat *Kallmet*, *Shesh* dhe *Vlosh*
 - mishi
 - pijet alkoolike (*raki* rrushi dhe thane).
- Lloje të tjera të burimeve të përsosmërisë, të tilla si:
 - burimet kulturore, për shembull, trashëgimia muzikore, e bazuar në muzikën tradicionale iso-polifonike dhe tendencat e reja ose vitaliteti artistik që mund të identifikohet në ditët e sotme
 - produktet e aktivitetëve artizanale, siç janë filigrani prej argjendi, mobiljet prej druri dhe xunkthi, zbukurimet dhe xhinglat dhe qilimat prej leshi.



Produktet ushqimore

Produktet ushqimore përfshijnë zinxhirët e mëposhtëm të vlerave:

Bleta

Zinxhiri i vlerave të Bletës fillon nga biodiversiteti i ekosistemeve të ndryshme deri te marketingu i produkteve (të freskëta, të papërpunuara dhe të përpunuara) të bletëve, të cilat përfshijnë këtu: mjalti nga lloje të shumta lulësh, qumështi i bletëve, poleni, propolisi, dylli i bletëve. Prodhimi është shumë i paktë, kryesisht për shkak të instrumenteve të vjetruara, të përdorura për mbledhjen e qumështit të bletëve dhe të polenit. Propolisi është i vetmi produkt që duhet të përpunohet, në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe tradicionale, për të prodhuar tretësirën e propolisit. Avantazhi konkurrues i mjaltit nga shumë lloje lulësh është i lartë, i karakterizuar nga veçori të mira organoleptike dhe nivele të mira të përfaqësimit dhe të dallimit të territorit, duke qenë përfaqësues tipik i rajonit mesdhetar, për shkak të prejardhjes së tij nga poleni i rignonit, trumzës dhe sherbelës.

Për sa i përket tregtimit, të gjitha produktet e zinxhirit të vlerave të Bletës janë të njohura dhe konsumohen në tregun vendas, kështu që i gjithë prodhimi rajonal shitet dhe ka edhe më shumë hapësirë në treg për më shumë prodhues; mjalti, qumështi i bletëve dhe propolisi shiten, më së shumti, drejtpërdrejt në kioska në rrugë, ndërsa produktet e tjera, duke pasur një vlerë të lartë të shtuar, si propolisi dhe dylli i bletëve, vështirë se shiten në tregun vendas, për shkak të mungesës së laboratorëve të përshtatshëm të përpunimit.

Pjesëmarrja e Shoqatës së Bletarëve të Vlorës "Nektari" në Forumin Mesdhetar të Bletarisë bëri që produktet shqiptare të zinxhirit të vlerave të Bletës të njiheshin dhe të vlerësoheshin jashtë, por, deri tani, nuk janë identifikuar eksportues ndërkombëtarë të këtyre produkteve.

Peshku

Aktivitetet e peshkimit kryhen kryesisht nga flotat e rëndësishme të peshkimit të Vlorës dhe të

Sarandës, megjithatë në fshatrat bregdetare mund të gjenden flota më të vogla të peshkimit. Përdoren gjithashtu anijet e peshkimit dhe rrjetat e peshkimit. Aktivitetet e mbarështimit të peshkut të detit kryhen kryesisht në zonën e Qeparoit dhe të Porto Palermos, ndërsa në lagunën e Butrintit zhvillohet mbarështimi i midhjes.

Peshku i detit në këtë zonë mund të konsiderohet me cilësi të shkëlqyer dhe, për shkak të pozicionit gjeografik të qarkut dhe rrymave të detit Jon, peshkimi mund të bëhet në sasi të mëdha. Varieteti i llojeve të peshkuara është gjithashtu i rëndësishëm. Sardelet, ançovi dhe skumbri mund të përpunohen me lehtësi dhe të ruhen në mënyrë natyrore ose në vaj vegjetal. Nëpërmjet proceseve artizanale, mund të përftoheshin konservime ushqimore shumë të vlefshme.

Aktualisht, peshku i detit përpunohet rrallë në vend. Deri tani, janë identifikuar vetëm disa fabrika të vogla për prodhimin e peshkut të konservuar në vaj dhe nuk janë identifikuar produkte të paketuara dhe/ose të një marke të caktuar. Tregu i peshkut të freskët të detit të prodhuar në Qarkun e Vlorës është, deri tani, ekskluzivisht ai vendas, por është zgjeruar në të gjithë jugun e Shqipërisë.

Studimet e ILS LEDA-s nxorën në pah një kapital relacional mjaft të ndërgjegjshëm në lidhje me zinxhirin e vlerave të Peshkut; në veçanti, Shoqata e Peshkatarëve të Vlorës, me bazë në Triport, konsiderohet një subjekt shumë i rëndësishëm, përfaqësues dhe gjithëpërfshirës.

Prodhimet pyjore

Pyjet e Qarkut të Vlorës mund të konsiderohen një kontekst i mirë, për të përfutur produkte të vlefshme organike në mënyrë të qëndrueshme nga ana mjedisore.

Sistemi i prodhimit pyjor të qarkut në rastin ideal fillon nga biodiversiteti i ekosistemeve të ndryshme deri te tregtimi i produkteve të freskëta, të papërpunuara dhe të përpunuara, të lidhura me pemlat, kërpudhat, gështenjat.

Mishi

Zinxhiri i vlerave të Mishit në rastin ideal do të fillonte nga aktivitetet e mbarështimit të gjedhëve, deleve, derrave dhe të kafshëve të buta deri te tregtimi i produkteve (mish i freskët dhe i përpunuar), kryesisht i lidhur me mishin e viçit dhe delet. Një avantazh i mirë konkurrues i zinxhirit të vlerave të Mishit të Qarkut të Vlorës buron nga njohuritë tradicionale për prodhimin e mishit të konservuar të viçit dhe nga mënyrat tradicionale të mbarështimit të deleve.

Mungesa aktuale e thertoreve të organizuara dhe të sigurta do të zgjidhet gradualisht, falë zbatimit të projekteve nga shoqatat që merren me hartimin e tyre (p.sh., projekti i PNUD-it "Përmirësimi i performancës së sektorit të blegtorisë në Shqipëri").

Qumështi

Zinxhiri i vlerave të Qumështit në rastin ideal fillon me biodiversitetin e ekosistemeve të ndryshme deri te tregtimi i produkteve, të cilat, këtu, janë të lidhura me çështjet e mëposhtme: qumështi, djathi dhe kosi. Aktivitetet mbarështuese janë shumë të fragmentuara, prodhimi i qumështit nuk sigurohet rregullisht dhe cilësia e qumështit nuk mund të kontrollohet (shpesh prodhuesit i shtojnë qumështit ujë dhe niseshte, për të rritur pandershmërisht prodhimet e qumështit dhe fitimet). Rrjedhimisht, cilësia e pjesës më të madhe të qumështit të prodhuar për qëllime "industriale" është shumë e ulët. Për më tepër,

shumica e baxhove të bulmetit përdorin farë djathi mikrobiologjike industriale, të lirë dhe me cilësi të dobët për prodhimin e djathit.

Prodhimi i djathit shqiptar *feta* dhe i djathit *kaçkavall*, i realizuar sipas recetave tradicionale dhe nëpërmjet përdorimit të farës natyrore të djathit, mund të konsiderohet konkurrues. Nga ana tjetër, djathërat "e ngjashme me të huajat" karakterizohen nga një nivel i ulët cilësie dhe prodhimi i tyre mund të rrezikojë të ardhmen e sektorit rajonal të bulmetit.

Ulliri

Në Qarkun e Vlorës mund të gjenden varietetet e mëposhtme të kultivuara të ullinjve:

- varieteti *i zakonshëm* i paidentifikuar mirë, që prodhon ullinjë të tryezës
- varieteti *kalinjot* (endogjen shqiptar)
- varieteti *frantoio* (i importuar nga Italia)
- varieteti *leccino* (i importuar nga Italia)

Ullinjë e tavolinës bëhen në shtëpi, duke i përpunuar dhe duke i ruajtur të freskët në shëllirë.

Ullinjë *kalinjot* mund të konsiderohen si një varietet shumë i çmuar: vaji ekstra i virgjër i nxjerrë prej tyre, nëse prodhohet mirë është vërtet i shkëlqyer. Prodhimi i vajit të ullirit kryhet kryesisht për përdorim familjar. Në disa raste, vaji ekstra i virgjër i ullirit (*kalinjot*, *frantoio*, *leccino*) shitet me shishe dhe me një markë të caktuar. Punishtet e vogla, por të mira të bluarjes së ullinjve bashkekzistojnë në qark, së bashku me punishtet e nivelit të ulët-mesatar.





Vera dhe pijet alkoolike

Në Qarkun e Vlorës, prodhohen varietetet e mëposhtme të verës:

- *Kallmet* (verë e kuqe dhe e bardhë)
- *Shesh* (*Shesh i bardhë* dhe *Shesh i zi*, përkatësisht verë e bardhë dhe e kuqe)
- *Vlosh* (verë e kuqe).

Kallmeti, *Sheshi* dhe *Vloshi* mund të konsiderohen varietete rrushi të mira endogjene shqiptare, me veçori të rëndësishme dallimi.

Mungesa e shoqatave të prodhuesve tregon një cilësi të ulët të kapitalit relacional në lidhje me zinxhirin e vlerave të Verës së Qarkut të Vlorës.

Produktet e zinxhirit të vlerave të Pijeve Alkoolike mund të përfaqësojnë një shprehje të vërtetë të territorit. Në fakt, ato varen nga lënda e parë që karakterizon zonën në të cilën ato prodhohen.

Studimet e ILS LEDA-së identifikuan distilatet e mëposhtme: *raki* rrushi dhe kumbulle (produkti alkoolik tradicional shqiptar, i përfutur nëpërmjet distilimit të frutit të fermentuar, të lidhur ngushtësisht me identitetin ballkanas) dhe ekstraktet alkoolike (limon dhe mente).

Distilatet e cilësisë së mirë dhe ekstraktet alkoolike prodhohen kryesisht në shtëpi dhe prodhimi i tyre është i pakët, nëse krahasohet me potencialet rajonale për prodhim të qëndrueshëm.

Të gjitha produktet e zinxhirit të vlerave të Pijeve Alkoolike njihen dhe konsumohen në tregun vendas dhe i gjithë prodhimi rajonal shitet, kështu që në treg ka hapësirë edhe për më shumë prodhues rajonalë.

Nuk janë identifikuar ende eksportuesit ndërkombëtarë të produktit artizanal.

Duke marrë parasysh cilësinë e mirë të lëndëve të para, të gjitha produktet e zinxhirit të vlerave mund të marrin çertifikata të cilësisë, të sigurisë dhe të origjinës organike.

Bimët industriale dhe mjekësore

Informacioni i mbledhur nga eksperti i ILS LEDA-s sugjeron ekzistencën e prodhimit të pambukut, të foragjereve (misër, jonxhë) dhe të sojës. Në qark, aktivitetet e lidhura me bimët industriale duhet të gjenden ndoshta në fusha, sepse ato janë zonat e karakterizuara nga një PKB artificiale e lartë. Për sa u përket bimëve, në qark janë identifikuar, deri tani, varietetet e mëposhtme:

- mendra (*Mentha aquatica*), mblidhet dhe kultivohet
- livanda e malit (*Satureja Montana*), mblidhet
- "çaji i malit" ose "çaji i bariut" (*Syderitis syriaca*), mblidhet
- rigoni (*Origanum vulgare*), mblidhet
- sherbela (*Salvia Officinalis*), mblidhet dhe kultivohet
- trumza (*Timus Serpillum*), mblidhet.

Të gjitha produktet e këtij zinxhiri vlerash njihen dhe vlerësohen më së shumti nga konsumatorët kombëtarë dhe blihet për përdorim bazë (kryesisht për gatim). I gjithë prodhimi rajonal shitet, kështu që në treg ka hapësirë edhe për më shumë prodhues rajonalë. Të gjitha llojet e bimëve shiten pa një markë të caktuar dhe të papaketuara dhe produktet më të freskëta dhe të thata u shiten drejtpërdrejt pronarëve të dyqaneve dhe konsumatorëve. Deri tani, nuk janë identifikuar procese organike të kultivimit dhe aktivitete përpunuese (përveç produkteve të thata tradicionale). Duke pasur parasysh gjendjen e mirë dhe të pastër të tokës dhe të mjedisit, si bimët e mbledhura, ashtu edhe ato të kultivuara mund të marrin çertifikime të cilësisë dhe të organicitetit (nuk është arritur ende). Sidoqoftë, grupet e bimëve të egra (së bashku me prodhimin e disa llojeve të mjaltit) në ditët e sotme rrezikohen seriozisht nga përdorimi i teknikave të ndaluara të mbledhjes nga mbledhësit e bimëve, të gatshëm për të kursyer kohë dhe për të përfutur sasi më të mëdha të produktit për t'u shitur, pa asnjë lloj kujdesi për nevojën e ruajtjes së cikleve natyrore dhe mundësive të riprodhimit të burimeve gjenetike të egra.



Produktet kulturore, artizanale dhe të turizmit

Këto produkte përfshijnë zinxhirët e mëposhtëm të vlerave:

Sistemi i prodhimit kulturor

Studimet e ILS LEDA-s identifikuan një trashëgimi të pasur kulturore në qark, si materiale, ashtu edhe jomateriale. Në Vlorë, prodhimi i njohurive (në fushën tekniko-shkencore, si dhe në atë të shkencave humane) dhe i krijimtarisë njerëzore (veçanërisht në fushat e arteve figurative dhe të muzikës) mund të konsiderohen të mira.

Gjithashtu, duhet të theksohet ekzistenca e ndërveprimeve të mira parësore (në të njëjtën fushë) dhe "të kryqëzuara" (ndërmjet fushave të ndryshme) mes subjekteve kulturore dhe të orientuara nga kultura. Këto ndërveprime çuan në krijimin, për shembull, të Festivalit të përvitshëm Folklorik.

Elementet kryesore penguese të këtij sistemi janë mungesa e informacionit dhe e subjekteve të komunikimit, e informacionit të përbashkët njëkuptimor për trashëgiminë kulturore të qarkut, si dhe e promovimit të tyre në rrjetet globale. Emigrimi i të rinjve dhe mungesa e politikave të ruajtjes dhe të përmirësimit për trashëgiminë materiale gjithashtu kërcënojnë mbijetesën e kulturës rajonale.

Sistemi i prodhimit artizanal

Prodhimet e të hekurit të farkëtuar në Vlorë, të modeluara duke u frymëzuar nga modelet dhe pikurat shumë origjinale, nuk kanë produkte të ngjashme të huaja konkurruese, duke pasur parasysh gjithashtu kontekstin lindor-perëndimor shumë "të ndotur" në të cilin janë modeluar.

Duhet të theksohet se prodhimi i dyerve me hekur të farkëtuar ka vlerë të veçantë artistike, por përbën gjithashtu edhe një furnizim për aktivitetet e ndërtimit.

Objektet me hekur të farkëtuar konsiderohen si aksesore prestigjioze për shtëpitë dhe kanë një treg të mirë në rang kombëtar, ndërkohë që nuk janë të pranishme në tregjet e huaja.

Zinxhiri i vlerave të Tekstileve Artizanale lidhet me produktet e mëposhtme: leshi (qilima dhe çanta) dhe pambuku (pallto artizanale dhe qëndisma).

Artizanët e tekstileve janë zakonisht gra të shkathëta në përdorimin e vegjëve. Në disa raste, ky aktivitet është shansi i tyre për të integruar të ardhurat nga aktivitete të tjera rurale. Leshi vendas nuk konsiderohet i mirë për prodhimin e tekstileve artizanale dhe mungon prodhimi vendas i pambukut, kështu që lëndët bazë të tekstileve importohen që të gjitha, kryesisht nga jashtë.

Nuk u identifikua prodhimi i bojërave natyrore. Produktet e tekstileve artizanale mund të gjenden në tregjet rajonale dhe të vendit, në dyqanet që shesin produkte tradicionale dhe artizanale, por nuk janë identifikuar ende në tregjet e huaja.

Sistemi i prodhimit turistik

Qarku i Vlorës është shumë i pasur me atraksione potenciale turistike, meqenëse në qark mund të gjenden shumë ekosisteme dhe atraksione kulturore.

Cilësia e mjedisit e zonave të urbanizuara është shumë e ulët dhe prania e plehrave të pambledhura në qendrat urbane dhe në fshat (veçanërisht përgjatë brigjeve të lumenjve dhe rrugëve rurale) është e dukshme.

Zonat rurale të qarkut karakterizohen nga prania e paktë e aktiviteteve të agroturizmit, e hoteleve që ofrojnë fjetje dhe mëngjes dhe e zonave të organizuara të kampingut. Cilësia e akomodimit përgjithësisht është e ulët.

Duhet të theksohet vlerësimi i pamjaftueshëm i trashëgimisë gastronomike lokale.



Potencialet dhe problemet kryesore

Studimi i ILS LEDA-s nxori në pah probleme të ndryshme në lidhje me sistemin rajonal të prodhimit. Ato mund të përmbliidhen në mënyrë të përgjithshme si më poshtë:

- **Efektshmëria e produktivitetit:** edhe pse shumica e produkteve kanë njëfarë potenciali për rritjen e prodhimit të qëndrueshëm, ka një mungesë të efektshmërisë së prodhimit, për shkak të përdorimit të paktë të teknologjive, veçanërisht në prodhimin bujqësor dhe blegtoral. Mungesa e ndërgjegjshmërisë për vlerën e kapitalit relational rrit copëzimin e prodhimeve dhe vështirëson hyrjen në tregje të reja. Për më tepër, mungesa e aktiviteteve të përpunimit dhe e prodhimit vendas të produkteve me vlerë të lartë të shtuar në shumicën e sektorëve (kryesisht në zinxhirët e vlerave të Peshkut, Bletës dhe të Bimëve) pengon potencialet e produkteve lokale.
- **Siguria dhe cilësia:** në ditët e sotme, më shumë se kurrë, cilësia dhe siguria e ushqimeve përbëjnë një shqetësim të vazhdueshëm për konsumatorët dhe autoritetet publike. Edhe pse shumica e produkteve vendase në Qarkun e Vlorës zakonisht kanë cilësi dhe veçori të mira organoleptike, ato nuk kanë certifikim të sigurisë dhe të cilësisë, kështu që nuk kanë mundësi të tërheqin konsumatorët e huaj. Certifikimet e sigurisë, cilësisë dhe organicitetit të ushqimeve përfaqësojnë një arsye potenciale për rritjen e konkurrencës.
- **Vitaliteti i sistemeve kulturore dhe turistike:** pasuritë kulturore dhe turistike nuk janë përmirësuar në mënyrë të përshtatshme, nëpërmjet aktiviteteve dhe eventeve


promovuese për të rritur banueshmërinë dhe vitalitetin e zonave për interesin turistik.

- **Tregtimi:** shumica e produkteve vendase kanë potencialin për të siguruar hapësirë më të madhe dhe më të qëndrueshme në tregjet vendase (gjithashtu në lidhje me aktivitetet turistike, siç janë hotelet dhe restorantet) dhe për të arritur hapësira të reja në tregjet e huaja. Megjithatë, mungesa e aktiviteteve të strukturuar të tregtimit (përfshirë vendosjen e markave dhe paketimin) për shumicën e zinxhirëve të vlerave, sasitë e vogla dhe të pabarabarta të prodhuara, dhe, mbi të gjitha, mungesa e certifikimeve të sigurisë dhe të cilësisë shkaktojnë mungesën e aktiviteteve të eksportit drejt tregjeve të huaja.

Për më tepër, biodiversiteti i ekosistemeve dhe kushtet e mira mjedisore, të cilat sigurojnë cilësinë e mirë të produkteve agroushqimore janë të rrezikuara rëndë nga mungesa e sistemeve të organizuara të menaxhimit të mbetjeve dhe të ujit, duke shkaktuar ndotjen e tokës, të ujit dhe të ajrit dhe duke kërcënuar shëndetin e kafshëve. Mungesa e trajnimit përfaqëson gjithashtu një element pengues për zinxhirët e identifikuar të vlerave: nuk nevojitet vetëm ngritja e specializuar e kapaciteteve për fermerët, mbarështuesit dhe mbledhësit, por nevojiten gjithashtu edhe aktivitete trajnimi me synimin për të rritur dhe për të ruajtur ndërgjegjësimin për rëndësinë (gjithashtu për zhvillimin e turizmit) e produkteve cilësore tipike dhe të dallueshme, në mënyrë që të shmanget përkeqësimi i pakthyeshem ose zhdukja e tyre në favor të produkteve "të ngjashme me të huajat".



1.10. Programimi territorial



Pamje nga
Riviera
Shqipëtare

Analiza e instrumenteve të planifikimit dhe të programimit Metodologjia e miratuar

Analiza e instrumenteve të planifikimit dhe të programimit në nivel bashkiak, ndërbashkiak, rajonal dhe ndërrajonal kontribuon për të ndërtuar një kuadër referimi për strategjitë e zhvillimit territorial të Qarkut të Vlorës, duke u fokusuar në projektet në zhvillim e sipër në këtë zonë.

Analiza u krye duke marrë parasysh llojet e ndryshme të instrumenteve: planet dhe programet e përgjithshme dhe sektoriale, planet/programet e zhvillimit, planet/programet mjedisore, urbanistika dhe studimet e fizibilitetit. U krijuan disa baza të dhënash, në të cilat u analizua çdo dokument më vete, duke listuar gjithashtu synimet e tij kryesore.

Prandaj, në këtë kapitull, ne përqipemi të ofrojmë një pamje të përgjithshme të programimit në zhvillim e sipër, duke theksuar elementët e nevojshëm për ndërtimin e skenarëve të mundshëm të zhvillimit rajonal dhe strategjinë e kërkuar për realizimin e tyre. Proçesi sintezë ka ndjekur një rrugë të ndarë në 3 faza:

- **Përmbledhja e qëllimeve kryesore të dala**

nga analiza e instrumenteve: duke filluar nga informacioni i mbledhur në bazat e të dhënave, u sintetizua një listë e objektivave kryesore për çdo dokument, duke marrë parasysh gjithashtu llojin e instrumentit dhe fushën e tij të interesit (shihni tabelën 1).

- **Identifikimi i qëllimeve të përbashkëta në instrumente të ndryshme,** për të nxjerrë në pah objektivat e përbashkëta të instrumenteve të analizuar (shihni tabelën 2) dhe për të identifikuar drejtimet kryesore që ato ndjekin për zhvillimin territorial. Synimet janë grupuar në katër kategori tematike: "Mbrotjtja e mjedisit dhe rrjeti i infrastrukturës", "Trashëgimia kulturore", "Prodhimi agrorshqimor dhe turizmi rural" dhe "Çështjet sociale".
- **Analiza e përputhshmërisë ndërmjet qëllimeve të instrumenteve të ndryshme,** për të ofruar një pamje të përgjithshme të konsistencës së programimit aktual dhe për të verifikuar mundësinë për koordinim dhe sinergji ndërmjet programeve në zhvillim e sipër (shihni tabelën 3).

Studimi, analiza dhe krahasimi i planeve dhe i programeve ekzistuese

U mbledhën dhe u analizuan **14 instrumente të planifikimit dhe të programimit**:

Zona bashkiake

Instrumentet e planifikimit

Urbanistika

- Plani strukturor i Vlorës (2009)

Instrumentet e programimit

Planet e zhvillimit

- Plani i zhvillimit - Xarrë (2005)
- Plani strategjik për zhvillimin e turizmit - Komuna Qendër (2009)
- Plani i zhvillimit - Orikum (2009)
- Studim për lumin e Vlorës (2008)
- Projekt për Lumin e Vlorës - "Një partneritet territorial në progres" (2009)

Zona rajonale

Instrumentet e programimit

Programet e zhvillimit

- Strategjia rajonale e Vlorës për arritjen e OZHM-ve (2005)
- Plani i menaxhimit të mbetjeve (2005)
- Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë (2007-2010)
- RDS/NPA - Monitorimi dhe zbatim i DevInfo në Qarkun e Vlorës (2006)

Programet sektoriale

- Ngritja e një seksioni të posaçëm pedagogjik në Universitetin e Vlorës (2007)

Zona ndërbashkiake

Instrumentet e programimit

Planet e menaxhimit

- Plani i menaxhimit: Zona e mbrojtur peizazhore Vjosë-Nartë, (2005)
- Plani i menaxhimit: Kompleksi Llogora, Rrëza e Kanalit, Dukat, Orikum, Tragjas, Radhimë, Karaburun (2005)

Zona ndërrajonale

Instrumentet e programimit

Planet sektoriale

- Korridor VIII: Studimi i parafizibilitetit për zhvillimin e aksit hekurudhor (2007)



Më pas, planet dhe programet u vendosën në një hartë (figura 10).

NIVELI LOCAL

STUDIUMI I PARAFIZIBILITETIT PËR ZHVILLIMIN E AKSIT HEKURUDHOR
Zbatuar nga RAILWAY WORKING GROUP
Klient SEKRETARIATI I KORRIDORT VIII 2007

PLANI I MENAXHIMIT ZONA PEIZAZHORE E MBROJTUR VJOSË-NARTË
Zbatuar nga QARKU I VLORËS
Klient QARKU I VLORËS 2005

PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT - KOMUNA QENDËR
Zbatuar nga INSTITUTI I KËRKOMJE URBANE
Klient KOMUNA QENDËR 2009

PLANI STRUKTUROR - VLORË
Zbatuar nga HIDEA
Klient MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKIMIT 2009

STUDIUMI PËR LUMIN E VLORËS
Zbatuar nga AULEDA
Klient ART GOLD SHOPIERI 2007

PLANI I ZHVILLIMIT - ORIKUM
Zbatuar nga BASHKIA ORIKUM
Klient BASHKIA ORIKUM 2009

PLANI I MENAXHIMIT PËR KOMPLEKSIN LLOGORA, RRËZË KANALIT, DUKAT, ORIKUMI, TRAGJAS, RRADHIMË, KARABURUN
Zbatuar nga QARKU I VLORËS
Klient MEDWETCOAST/GEF 2009

PLANI I ZHVILLIMIT - XARRË
Zbatuar nga INSTITUTI I KËRKOMJE URBANE
Klient KOMUNA XARRË 2009

NIVELI RAJONAL

NGRITJA E NJË SEKSIONI TË POSAÇËM PEDAGOGJIK NË UNIVERSITETIN E VLORËS
Zbatuar nga ZYRA E BASHKËPUNIMIT ZVËCERAN NË SHOPIERI
Klient ZYRA E BASHKËPUNIMIT ZVËCERAN NË SHOPIERI 2007

MONITORIMI RDS/NPA DHE ZBATIMI I DEVINFO NË QARKUN E VLORËS - DOKUMENT PROGRAMIMI I PËRBASHKËT
Zbatuar nga KOMBET E BASHKUARA SHOPIERI
Klient KOMBET E BASHKUARA SHOPIERI 2006

PLANI PËR ZHVILLIMIN E BREGDETIT JUGOR TË SHQIPËRISE
Zbatuar nga TBU-HBA-P&P
Klient MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE 2007

PLANI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE NË QARKUN E VLORËS
Zbatuar nga ISAREMA CONI
Klient REGIONE MARCHË 2001

STRATEGJIA RAJONALE E VLORËS PËR ARRITJEN E OZHM-VE
Zbatuar nga MNVTR GJIKIA
Klient QARKU I VLORËS 2005




Figura. 10.
 Studim i planeve dhe programeve në vazhdim në Qarkun e Vlorës

Tabela 1. Përmbledhja e qëllimeve kryesore të dala nga analiza e instrumenteve (*)

Dokumenti i referimit	Instrumenti	Qëllimet kryesore
PLANI STRUKTUROR - VLORË Zbatuar nga: HYDEA Financuar nga: Projekti WB-LAMP	Urbanistika	<ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i strategjive për transportin dhe projektet urbane Ristrukturimi i stacionit të mënyrave të ndryshme të transportit të pasagjerëve Krijimi i një qendre të re urbane në zonën e aeroportit të vjetër Krijimi i një Qendre të re Agroushqimore Krijimi i Unazës së qytetit të Vlorës Rinatyalizimi i një pjese të kepit (Qafa e Topit) për të shmangur erozionin e mëtejshëm
PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT - KOMUNA QENDËR Zbatuar nga: Instituti i Kërkimeve Urbane Financuar nga: Fondi Shqiptar i Zhvillimit - FSHZH	Plani i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi/konsolidimi i planifikimit pjesëmarrës Përmirësimi i politikave të taksave dhe i aftësive të menaxhimit Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve bashkiake Ngritja e një zyre të re për Zhvillimin e Turizmit brenda strukturës organike të administrimit bashkiak Krijimi i një Agjencie për Informacion Turistik Përgatitja e një pakete të projektpropozimeve për zhvillimin e turizmit në bashki Përgatitja e një studimi për përdorimin e efektshëm të burimeve për zhvillimin e turizmit
PLANI I ZHVILLIMIT - ORIKUM Zbatuar nga: Bashkia e Orikumit Financuar nga: Fondi Shqiptar i Zhvillimit - FSHZH	Plani i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> Ngritja e një zyre të re për Zhvillimin e Turizmit Zhvillimi i specifikimeve të produktit Vendosja e etiketave kombëtare të mjedisit Inkurajimi i fermerëve që të krijojnë/bashkohen me shoqatat. Organizimi i panairove për produktet bujqësore dhe blegtorale Rritja e kapaciteteve të menaxhimit dhe të komunikimit të fermerëve Përmirësimi i metodave për të marrë opinionet e banorëve dhe të turistëve me qëllim përmirësimin e shërbimeve dhe investimeve bashkiake
PLANI I ZHVILLIMIT - XARRË Zbatuar nga: Instituti i Kërkimeve Urbane Financuar nga: Fondi Shqiptar i Zhvillimit - FSHZH	Plani i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi maksimal i tokës bujqësore, nëpërmjet përmirësimit të sistemit të ujitjes dhe të kullimit Kreditimi dhe mbështetja e mekanikëve të bujqësisë për zbatimin e shërbimeve në bujqësi Krijimi i një fshati turistik në Psimeno Krijimi i mjediseve të doganave dhe të taksave Parafizibiliteti i tregut bashkiak në Sarandë Ndërtimi i pikave mbledhëse për grumbullimin e mbetjeve Krijimi i një qendre kulturore në fshatin Mursi
STUDIM PËR LUMIN E VLORËS Zbatuar nga: AULEDA Financuar nga: ART GOLD SHQIPËRI-PNUD	Plani i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> Konsiderimi i luginës si një zonë e mbrojtjes së lartë të mjedisit Mbrojtja e të gjitha burimeve natyrore Eksperimentimi me forma novatore të qeverisjes territoriale dhe strategjia e tregtimit territorial për të tërhequr investimet Çertifikimi i produkteve vendase dhe krijimi dhe fuqizimi i sipërmarrjeve të agroprodhimit Mbrojtja e zejtarisë tradicionale, e punimeve artizanale dhe e traditave vendase
PROJEKTI PËR LUMIN E VLORËS "NJË PARTNERITET TERRITORIAL NË PROGRES" Zbatuar nga: Maurizio Del Bufalo, PNUD Financuar nga: ART GOLD SHQIPËRI	Plani i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi i mbështetjes për konsolidimin e agjencisë dhe konsulencës për zhvillimin ekonomik lokal Propozimi i përmirësimit të burimeve lokale për të promovuar kohezionin social të komuniteteve të luginës
STRATEGJIA RAJONALE E VLORËS PËR ARRITJEN E OZHM-ve Zbatuar nga: Mynyr Gjika et al. për Qarkun e Vlorës Financuar nga: OKB, Oxfam	Programi i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i nivelit të arsimit mbështetja e arsimit profesional, duke u fokusuar në kërkesat e tregut Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, pakësimi i numrit të vdekjeve të fëmijëve dhe të nënave, përmirësimi i shëndetit të nënave, rritja e praktikës së ushqyerjes me gji Sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore, përmirësimi i cilësisë së jetës në qark

(*) Ngjyrat në tabelë i referohen ngjyrave të caktuara për secilën kategori plani/programi në hartën e faqes së mësipërme

Dokumenti i referimit	Instrumenti	Qëllimet kryesore
<p>PLANI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE NË QARKUN E VLORËS</p> <p>Zbatuar nga: Insarema Cioni, Vladimir Haxhi</p> <p>Financuar nga: UNOPS, Regione Marche</p>	Programi i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> - Ruajtja, përmirësimi dhe ripërtëritja e ekosistemeve kryesore, e specieve dhe e peizazheve, nëpërmjet krijimit dhe menaxhimit efektiv të Rrjetit Ekologjik Paneuropian - Menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi i diversitetit pozitiv potencial biologjik dhe peizazhor - Integrimi i ruajtjes së diversitetit biologjik dhe peizazhor dhe i objektivave të përdorimit të qëndrueshëm në të gjithë sektorët - Përmirësimi i informacionit për çështjet e diversitetit biologjik dhe të mjedisit dhe i ndërgjegjësimit për to dhe rritja e pjesëmarrjes publike në veprime për të ruajtur dhe për të përmirësuar këtë diversitet - Përmirësimi i të kuptuarit të gjendjes së diversitetit biologjik dhe peizazhor paneuropian dhe të proceseve për ta bërë atë të qëndrueshëm - Sigurimi i mjeteve të përshtatshme financiare
<p>PLANI PËR ZHVILLIMIN E BREGDETIT JUGOR TË SHQIPËRISË</p> <p>Zbatuar nga: Sipërmarrja e përbashkët TBU-HBA-P&P</p> <p>Financuar nga: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Banka Botërore</p>	Programi i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> - Vendosja e parimeve dhe e procedurave të kontrollit të zhvillimit për Zonën Bregdetare Jugore të Shqipërisë - Nxitja e rritjes ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës brenda kontekstit të zhvillimit të qëndrueshëm - Infrastruktura e përshtatshme për të plotësuar kërkesën ekzistuese dhe për të parashikuar kërkesën për banim dhe turizëm - Rivitalizimi i industrive primare industriale, siç janë bujqësia dhe peshkimi, dhe mbështetja e artit dhe e zejeve vendase dhe e industrive me ndikim të ulët
<p>NGRITJA E NJË SEKSIONI TË POSAÇËM PEDAGOGJIK NË UNIVERSITETIN E VLORËS</p> <p>Zbatuar nga: Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri</p> <p>Financuar nga: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)</p>	Programi sektorial	<ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e njësisë SPP në Universitetin e Vlorës dhe prezantimi i një kursi akademik kombëtar 3+2 vjet sipas standardeve të Bolonjës për pedagogët, në bashkëpunim me Universitetin e Lozanës - Përgatitja e pesë profesorëve me kohë të plotë për kursin, për trajnimin e pedagogëve të specializuar
<p>MONITORIMI RDS/NPA DHE ZBATIMI I DEVINFO NË QARKUN E VLORËS</p> <p>Zbatuar nga: UN ALBANIA</p> <p>Financuar nga: Kombet e Bashkuara</p>	Programi i zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi i një grupi të përzier me përfaqësues nga UNICEF-i, UNFPA-ja dhe PNUD-i/EVKB-ja - Sigurimi i drejtimit të përgjithshëm dhe i ekspertizës teknike për aktivitetet e projektit
<p>STUDIMI I PARAFIZIBILITETIT PËR ZHVILLIMIN E AKSIT HEKURUDHOR</p> <p>Zbatuar nga: Railway Working Group për Sekretariatit e Korridorit VIII</p> <p>Financuar nga: Ministria Italiane për Tregtinë Ndërkombëtare</p>	Programi sektorial	<ul style="list-style-type: none"> - Sjellja e një ndryshimi të vërtetë në Politikën e Përbashkët të Transportit - Rivendosja e ekuilibrit ndërmjet mënyrave të transportit dhe zhvillimi i transporteve në mënyra të ndryshme - Promovimi i korridoreve hekurudhore të transportit të mallrave - Heqja e barrierave teknike ndaj ndërfunksionimit në transportin hekurudhor - Monitorimi i tregut hekurudhor
<p>PLANI I MENAXHIMIT: PZONA PEIZAZHORE E MBROJTUR VJOSË-NARTË</p> <p>Zbatuar nga: Qarku i Vlorës</p> <p>Financuar nga: MedWetCoast, GEF</p>	Plani i menaxhimit	<ul style="list-style-type: none"> - Ruajtja, menaxhimi dhe përtëritja e habitateve dhe e specieve - Ruajtja e tokës dhe masat kundër erozionit - Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve ujore - Krijimi i organeve të administrimit dhe i rregulloreve për të përmirësuar menaxhimin e vizitorëve, infrastrukturën dhe punimet inxhinierike - Përmirësimi i organizimit të komuniteteve lokale
<p>PLANI I MENAXHIMIT PËR KOMPLEKSIN LLOGORA, RRËZË KANALIT, DUKAT, ORIKUM, TRAGJAS, RRADHIMË, KARABURUN</p> <p>Zbatuar nga: Qarku i Vlorës</p> <p>Financuar nga: MEDWETCOAST/GEF/PNUD</p>	Plani i menaxhimit	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i pasojave të zgjerimit të Parkut Kombëtar të Llogorasë, në dritën e legjislacionit të ri në lidhje me zonat e mbrojtura në Shqipëri - Zhvillimi i një vizioni të qartë për vendin për t'ua kaluar brezave të ardhshëm dhe sigurimi i një kuadri të politikave dhe të veprimeve për të mbështetur vizionin - Përmirësimi i bashkëpunimit me një mori të gjerë agjencish dhe organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat merren me zonat e mbrojtura - Ruajtja e biodiversitetit si i tërë

Tabela 2. Identifikimi i qëllimeve të përbashkëta në programe të ndryshme

SEKTORI 1: MBROJTJA E MJEDISIT DHE RRJETET INFRASTRUKTURE	
Qëllimet kryesore	Dokumentet e referimit
Administrimi i mbetjeve: përcaktimi i landfillëve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane, blerja e makinerive për administrimin e mbetjeve, nxitja e edukimit lidhur me mbetjet urbane, rehabilitimi i vendeve aktuale të paligjshme të grumbullimit, organizimi i grumbullimeve në mënyrë të mëvetësishme.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani për administrimin e mbetjeve në Qarkun e Vlorës - Plani strategjik për zhvillimin e turizmit - Komuna Qendër - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum - Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë
Furnizimi me ujë dhe sistemi i ujërave të zeza: rehabilitimi teknik i furnizimit me ujë, rehabilitimi teknik dhe zgjerimi i sistemit të ujërave të zeza, sistemet e reja për ujërat e zeza dhe për furnizimin me ujë, lidhja e çdo shtëpie me sistemin e ujërave të zeza.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani strukturor - Vlorë - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum
Mbrojtja e mjedisit dhe e burimeve natyrore: rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë mbi mjedisin, ruajtja dhe menaxhimi i burimeve natyrore, mbrojtja e tokës dhe masat kundër erozionit, ngritja e kapaciteteve lokale për planifikim, administrimi dhe monitorimi i burimeve natyrore dhe biologjike, ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e mjedisit, përgatitja e materialeve promovuese.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur peizazhore Vjosë-Nartë - Plani i administrimit për Kompleksin e Llogorasë - Studim për lumin e Vlorës - Strategjia për Qarkun e Vlorës për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit
Infrastruktura: përkufizimi i strategjive të transportit, përmirësimi i aksesit në fshatra të ndryshme, rregullimi i të gjitha rrjeteve rrugore.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani strukturor - Vlorë - Studimi i parafizibilitetit për zhvillimin e aksit hekurudhor - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum - Plani strategjik për zhvillimin e turizmit - Komuna Qendër - Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë
SEKTORI 2: TRASHËGIMIA KULTURORE	
Qëllimet kryesore	Dokumentet e referimit
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore: restaurimi dhe ruajtja e ndërtesave historike, kulturore dhe e shtëpive karakteristike.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani strukturor - Vlorë
SEKTORI 3: PRODHIMI AGROUSHQIMOR DHE TURIZMI RURAL	
Qëllimet kryesore	Dokumentet e referimit
Zhvillimi i bujqësisë: përdorimi i efektshëm i tokës bujqësore, nëpërmjet përmirësimit të sistemit të ujitjes dhe të kullimit, kreditimi dhe mbështetja e specialistëve të bujqësisë për zbatimin e shërbimeve në bujqësi, studimi i parafizibilitetit për një treg në Sarandë, krijimi dhe përforcimi i sipërmarrjeve të prodhimeve bujqësore, nxitja e fermerëve për të krijuar dhe për t'u bashkuar me shoqata ose grupime, mbrojtja e artizanatit tradicional, e zejeve dhe e traditave vendase.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum - Studim për Lumin e Vlorës
Prodhimi bujqësor: çertifikimi i produkteve, promovimi i produkteve vendase, organizimi i panaireve me prodhime bujqësore dhe blegtorale, krijimi i një marke për prodhimet.	
Turizmi rural: ndërtimi i fshatrave të reja turistike (Psimeno).	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i zhvillimit - Xarrë
SEKTORI 4: ÇËSHTJET SOCIALE	
Qëllimet kryesore	Dokumentet e referimit
Përfshirja sociale e grupeve të pafavorizuara, shërbimet e arsimit dhe të kujdesit shëndetësor: përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmirësimi i nivelit të arsimit, përmirësimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor.	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia për Qarkun e Vlorës për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit - Ngritja e një seksioni të posaçëm pedagogjik në Universitetin e Vlorës

Tabela 3. Koherenca ndërmjet instrumenteve

SEKTORI 1: MBROJTJA E MJEDISIT DHE RRJETET INFRASTRUKTURE		
<i>Qëllimet kryesore të planeve dhe programeve në zhvillim e sipër</i>	<i>Dokumentet e referimit</i>	<i>Koherenca ndërmjet instrumenteve</i>
<p>Mjedisi natyror: Administrimi i burimeve natyrore nëpërmjet përdorimit të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së tokës dhe masave kundër erozionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur peizazhore Vjosë-Nartë - Plani i administrimit për Kompleksin e Llogorasë - Studim për Lumin e Vlorës - Strategjia e Qarkut të Vlorës për arritjen e objektivave të OZHM-së 	<p>Ka një koherencë të mirë për çështjet e mjedisit. Instrumente të ndryshme kanë qëllime të përbashkëta, edhe pse sigurojnë lloje të ndryshme të veprimeve/ndërhyrjeve.</p>
<p>Infrastruktura: Përmirësimi i rrjetit rrugor dhe hekurudhor nëpërmjet: ndërhyrjeve në rrugët ekzistuese urbane dhe rurale, lidhjeve të reja ndërmjet fshatrave, rehabilitimit dhe përmirësimit të aksit ekzistues hekurudhor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Plani strukturor - Vlorë - Studimi i parafizibilitetit për zhvillimin e aksit hekurudhor - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum - Plani strategjik për zhvillimin e turizmit - Komuna Qendër - Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë 	<p>Të gjitha planet dhe programet janë koherente me njëra-tjetrën për veprimet/ndërhyrjet e ndryshme në rrjetin rrugor dhe hekurudhor.</p>
SEKTORI 2: TRASHËGIMIA KULTURORE		
<i>Qëllimet kryesore të planeve dhe programeve në zhvillim e sipër</i>	<i>Dokumentet e referimit</i>	<i>Koherenca ndërmjet instrumenteve</i>
<p>Mbrojtja e trashëgimisë kulturore: Restaurimi dhe ruajtja e ndërtesave historike dhe e shtëpive karakteristike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Plani strukturor - Vlorë 	
SEKTORI 3: PRODHIMI AGROUSHQIMOR DHE TURIZMI RURAL		
<i>Qëllimet kryesore të planeve dhe programeve në zhvillim e sipër</i>	<i>Dokumentet e referimit</i>	<i>Koherenca ndërmjet instrumenteve</i>
<p>Bujqësia dhe prodhimi agroushqimor: Përmirësimi i aksesit në kredimarrje për fermerët, nxitja e produkteve cilësore, e kreditimit dhe e mbështetjes për teknikat bujqësore për zbatimin e shërbimeve në bujqësi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum - Studim për Lumin e Vlorës 	<p>Të gjitha planet dhe programet aktuale kanë të përbashkëta të njëjtat objektiva lidhur me promovimin e produkteve bujqësore, mbështetjen dhe trajnimin e fermerëve, përdorimin e bujqësisë biologjike dhe përmirësimin e aksesit në kredimarrje dhe të rrjetit infrastrukturor.</p>
<p>Turizmi rural: Zhvillimi i ekoturizmit në Lumin Vlorë, promovimi i produkteve lokale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Studimi për Lumin e Vlorës 	
SEKTORI 4: ÇËSHTJET SOCIALE		
<i>Qëllimet kryesore të planeve dhe programeve në zhvillim e sipër</i>	<i>Dokumentet e referimit</i>	<i>Koherenca ndërmjet instrumenteve</i>
<p>Përfshirja sociale e grupeve të pafavorizuara, shërbimet e arsimit dhe të kujdesit shëndetësor: Rritja e aksesit në shërbimet shëndetësore, përmirësimi i nivelit të arsimimit gjithashtu për personat me aftësi të kufizuara</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia e Qarkut të Vlorës për arritjen e objektivave të OZHM-së - Ngritja e një seksioni të posaçëm pedagogjik në Universitetin e Vlorës 	<p>Ka vetëm 2 programe lidhur me çështjet sociale në nivel rajonal dhe lokal. Ato janë koherente me njëra-tjetrën për sa i përket përmirësimit të cilësisë dhe nivelit të arsimimit por i referohen kategorive të ndryshme të njerëzve.</p>

Përfundimet nga analiza e programeve Fragmentizimi dhe koherenca

Ashtu siç tregohet qartë në tabelat e faqeve të mësipërme, planet dhe programet që përfshijnë Qarkun e Vlorës janë relativisht të pakta.

Në nivel qarku, i vetmi program ekzistues dhe gjithëpërfshirës është Plani për Zhvillimin e Bregdetit Jugor të Shqipërisë, duke treguar se menaxhimi i zonave bregdetare përfaqëson shqetësimin kryesor për autoritetet e qeverisjes territoriale.

Mbizotërimi është i arsyeshëm, pasi pasqyron gatishmërinë e autoriteteve për të kontrolluar, në të njëjtën mënyrë, efektet negative të zhvillimit të turizmit bregdetar: ndërtimet e paligjshme dhe të pakontrolluara, shkatërrimi i peizazheve dhe i burimeve natyrore, etj. E njëjta nevojë për ruajtjen e pasurive natyrore me shumë gjasa ka udhëhequr hartimin e planeve të menaxhimit për dy zonat e mbrojtura, atë të Llogorasë dhe të Nartës. Vlen të theksohet se deri tani nuk është krijuar një plan i ngjashëm për zonat e tjera ekzistuese të mbrojtura dhe duket se nuk ka projekte për përmirësimin e vendeve të trashëgimisë kulturore, megjithëse ato janë të shumta në qark.

Zonat e brendshme nuk kanë zhvilluar ndonjë plan ose program zhvillimi; të vetmin përjashtim përbën lugina e Shushicës, ku PNUD-i ka filluar të analizojë potencialet e zhvillimit për krijimin e zonës rurale të mbrojtur.

Instrumente të planifikimit urban mund të gjenden vetëm në qytetet kryesore të qarkut. Bashkitë dhe komunat e tjera trajtojnë, në instrumentet e programimit, çështjet e rëndësishme si turizmi dhe zhvillimi rural në përputhje me aktivitetet kryesore ekonomike në qark. Mungesa e instrumenteve të programimit, në pjesën më të madhe të bashkive dhe komunave të qarkut përbën një shenjë të mungesës së kapaciteteve nga ana e autoriteteve vendore për të menaxhuar qeverisjen territoriale dhe për të hartuar dhe zbatuar projektet e zhvillimit për të arritur qëllimet e interesit të përbashkët. Megjithatë, kjo mungesë e "parashikimit" dhe planifikimit të përgjithshëm, çon në fragmentizimin e ndërhyrjeve dhe në humbjen e burimeve financiare.

Një aspekt pozitiv është koherenca e përgjithshme ndërmjet të gjitha instrumenteve të programimit në sektorët kryesorë: Vlen të theksohet se programet nuk pengojnë njëra-tjetrën dhe nuk parashikojnë ndërhyrje kontradiktore.

Në këtë kuadër, PS-ja mund të përfaqësojë mjetin për të koordinuar projektet e programuara dhe në zhvillim e sipër (në përputhje me instrumentet ekzistuese) dhe për të optimizuar investimet.



1.11. ANALIZA S.W.O.T. e territorit rajonal

Analiza SWOT (Pikat e forta, Pikat e dobëta, Mundësitë dhe Kërcënimet) mund të kryhet për të vlerësuar potencialet e zhvillimit dhe aspektet vendimtare të territorit rajonal. Gjetjet kryesore janë të sintetizuara në këto faqe.

Pikat e forta

- Peizazhet e padëmtuara, vendet natyrore dhe zonat bregdetare (lugina e Shushicës, Parku Kombëtar i Llogorasë, gadishulli i Karaburunit, lagunat e Orikumit dhe të Butrintit, Riviera shqiptare, etj.)
- Vendet potencialisht tërheqëse të trashëgimisë kulturore (Manastiri i Zvërnecit, Kalaja e Ali Pashës në Porto Palermo, parqet arkologjike të Butrintit dhe të Orikumit, Amantia, kriporet e Nartës, etj.)
- Trashëgimia kulturore e dallueshme jomateriale (p.sh. muzika iso-polifonike, e njohur nga UNESCO)
- Kultura rajonale dhe trashëgimia kulturore e përfshirë në projektin "I&A" të INTERREG III.A
- Prezenca e ndërtesave të braktisura dhe të shkatërruar në fshat (shtëpitë tradicionale, fermat, fabrikat shtetërore, ndërtesat ushtarake, urat për këmbësorët, etj.), të cilat mund të përbëjnë një burim për turizmin
- Pasuria e produkteve tipike agroushqimore dhe artizanale – 11 zinxhirë vlerash (4 prej të cilave përfaqësojnë burimet e përsosmërisë të: vajit të ullirit Kalinjot, bimëve, produkteve të bletëve dhe 3 sisteme prodhimi (kultura, artizanati, turizmi) të identifikuara
- Eksperiencat e bujqësisë organike në luginën e lumit të Shushicës
- Ndjenja e fortë e përkatësisë dhe identiteti
- Projektet ekzistuese, duke treguar gatishmërinë për të ekuilibruar mbrojtjen mjedisore dhe nevojat e zhvillimit ekonomik; vëmendja gjithnjë e më e madhe për mbrojtjen e mjedisit, ruajtja e arkitekturës tradicionale dhe kontrolli mbi ndërtimet
- Nismat për zhvillimin e turizmit
- Prezenca e sinjalistikës së informacionit për turistët në zonat arkologjike të orikumit dhe Butrintit
- Projektet e reja të zbatuara në sektorin e shëndetësisë
- Prezenca e rëndësishme e shoqatave që punojnë në sektorët kulturorë dhe socialë
- Ekzistenca e universiteteve publike dhe private

Pikat e dobëta

- Aktivitetet e pakontrolluara të ndërtimeve, sidomos në bregdet (Vlorë, Sarandë, Ksamil)
- Trashëgimia kulturore dhe arkologjike e neglizhuar ose e pazbuluar, informacioni i varfër për turistët që disponohet, mungesa e promovimit të koordinuar
- Mungesa dhe cilësia e dobët e shërbimeve turistike, mungesa e trajnimeve profesionale në sektorin e turizmit, raporti i pabarabartë cilësi/çmim në strukturat turistike të akomodimit
- Niveli i ulët i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe të arkitekturës tradicionale për zhvillimin
- Mungesa e përgjithshme e cilësisë urbane, si në fshatra ashtu dhe në qytete të mëdha
- Prezenca e ndërtesave të braktisura dhe të shkatërruara në fshat
- Mungesa e sistemeve të administrimit të mbetjeve të ngurta, duke shkaktuar dëmtime të mjedisit dhe të peizazhit, duke kërcënuar burimet natyrore dhe shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve dhe duke penguar kështu zhvillimin e turizmit
- Mungesa e sistemeve për administrimin e ujit dhe të ujit të ndotur, mungesa e sistemeve të menaxhimit për lumenjtë
- Gjendja e keqe e rrjetit rrugor ekzistues, aksesit i dobët rrugor në disa zona (pra, për të shkuar në luginën e lumit të Shushicës)
- Prezenca e aktiviteteve që kanë një ndikim të fortë në mjedis, siç janë zallishtet përgjatë lumit të Shushicës
- Zinxhirët e paplotë të vlerave, mungesa e aktiviteteve të përpunimit
- Mungesa e të dhënave dhe e studimeve për tendencat social-ekonomike në qarktrands
- Mungesa e strukturave kolektive për fermerët (thertoret, baxhot e bulmetit, magazinat)
- Fragmentizimi i tokës dhe dimensionit i vogël i bizneseve bujqësore, duke rezultuar në nivele të ulëta prodhimi, akses të vështirë në novacionet teknologjike, në kredimarrje, shërbime dhe tregje
- Të drejtat e pasigurta të pronësisë së tokës
- Mungesa e cilësisë në prodhimin e vajit të ullirit dhe qumështit, siguria ushqimore që duhet rritur
- Refuzimi i prodhuesve për të krijuar partneritet
- Vështirësia në përputhjen e zhvillimit industrial me mbrojtjen e mjedisit
- Frytëzimi i vështirë turistik i disa vendeve arkologjike për shkak të prezencës së pikave ushtarake, që nuk janë në përdorim

Mundësitë

- Transformimi i AULEDA-s nga LEDA në një agjenci rajonale zhvillimi nëpërmjet programit ART GOLD 2
- Projektet e zhvillimit tashmë të zbatuara nga AULEDA në luginën e Shushicës, në zonën e Nartës dhe në Bashkinë Orikum
- Ekzistenca e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, programimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës në qark
- Programet dhe projektet e OKB-së dhe të Kooperacionit Italian në qark, të zbatuara dhe në zbatim e sipër
- Mundësitë e ofruara nga bashkëpunimi i decentralizuar dhe nga fondet e BE-së që i drejtohen zhvillimit lokal, përmirësimin të trashëgimisë kulturore, mbrojtjes së mjedisit, etj.
- Shqipëria si vend kandidat i mundshëm për të hyrë në Bashkimin European – programet IPA
- Fondet e BE-së për programet ndërkufitare dhe projektet ndërmjet Qarkut të Vlorës dhe rajoneve greke
- Interesi në rritje për Shqipërinë si destinacion turistik
- Interesi global në rritje për produktet agrourbore cilësore – zhvillimi dhe përmirësimi i bujqësisë organike, çertifikimet për cilësinë dhe sigurinë ushqimore
- Fuqizimi i grave

Kërcënimet

- Niveli i dobët i kapaciteteve për të hartuar projekte që janë në përputhje me standardet e BE-së mund të pengojë aksesin në fondet ndërkombëtare
- Kapaciteti i dobët për të menaxhuar fondet ndërkombëtare
- Ndërtesat e braktisura në fshat, në mungesë të një programi restaurimi dhe ripërdorimi, do të ulte pamjen tërheqëse të zonës për turistët
- Tendencat për ndërtime të pakontrolluara, nëse janë të vazhdueshme, do të shkatërrojnë në mënyrë të pakthyeshme peizazhet natyrore dhe do të shkatërrojë ndërtesat tradicionale dhe identitetin lokal
- Mungesa e mundësive për punësim mund të shkaktojë rrallimin e popullsisë në fshatra, shkatërrimin e mjedisit dhe të paizazhit, humbjen e trashëgimisë kulturore dhe të identitetit
- Mungesa e vazhdueshme e sistemit për administrimin e mbetjeve mund të dëmtojë në mënyrë të pakthyeshme burimet natyrore dhe shëndetin e njerëzve, duke ndikuar negativisht në aktivitetet bujqësore dhe duke penguar zhvillimin e turizmit
- Prania e bazës ushtarake në breg, duke kufizuar aksesin në disa vende me pasuri kulturore dhe mjedisore, mund të pengojë zhvillimin e turizmit
- Konkurrenca e destinacioneve turistike që mund të ekuilibrojnë më mirë zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit



1.12. Qëllimi i përgjithshëm i zhvillimit dhe fjalët kyçe të Planit Strategjik

Qëllimi i përgjithshëm i zhvillimit

Qëllimi i përgjithshëm i PS-së është përcaktuar bazuar në rezultatet e studimeve në territorin rajonal, në analizat e programeve që operojnë në qark, në takimet e realizuara me qeverinë rajonale dhe me përfaqësues të tjerë të grupeve të interesit si dhe në inventarin e trashëgimisë kulturore dhe peizazhore si dhe duke u bazuar në zinxhirët e vlerave.

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Strategjik është:

“Përmirësimi i qëndrueshmërisë për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen sociale”.

Ky qëllim rrjedh nga përhapja e ndërgjegjësimit lidhur me dëmet që u janë shkaktuar deri tani burimeve natyrore të çmueshme në qark.

Ai shpreh gjithashtu nevojën për rikuperim (aty ku është e mundur) dhe ruajtjen e rrënojave me qëllim mirëmbajtjen dhe rritjen e pamjes turistike tërheqëse dhe për të garantuar një mjedis të sigurt dhe kushte më të mira jetese për popullsinë rajonale.

Qëndrueshmëria mjedisore mund të jetë çelësi për të nxitur rritjen ekonomike (sidomos në sektorin e turizmit) pa rrezikuar pasuritë natyrore, por përkundrazi duke e përdorur mjedisin si një mundësi për të ndjekur një model të ri zhvillimi.

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Strategjik si rezultat i studimeve të burimeve territoriale rajonale



Prandaj dhe proçesi i Planifikimit Strategjik të qarkut përcakton një model të qëndrueshëm zhvillimi në 3 aspekte themelore dhe të ndërlidhura: mjedisi, ekonomia dhe shoqëria (Rio-de-Zhanejro, 1992).


Ku model është i arritshëm përmes veprimeve të orientuara drejt menaxhimit ekologjik territorial, aktiviteteve antropogjenike dhe promovimit të uljes së ndryshimeve klimatike (Protokolli i Kiotos).

Plani Strategjik është një instrument për të:

- përcaktuar qëllimet e qëndrueshmërisë mjedisore
- shqyrtuar aspektet kryesore mjedisore dhe për të sintetizuar faktorët vendimtarë
- analizuar aspektet e mundshme mjedisore duke vlerësuar objektivat dhe veprimet e PS-së nëpërmjet kritereve të qëndrueshmërisë
- përcaktuar veprimet e mundshme që lidhen me treguesit mjedisorë.


Fjalët kyçe

Hapi tjetër kishte të bënte me identifikimin e 13 fjalëve kyçe: ato sintetizojnë çështjet dhe nevojat (që janë ngritur gjatë takimeve), të cilat aktorët territorialë i konsiderojnë vendimtare për zhvillimin e Qarkut të Vlorës. Fjalët kyçe përfaqësojnë themelet për të ndërtuar Vizionin dhe Strategjinë për vitet e ardhshme.



Fjalët kyçe u shpërndanë më pas me aktorët territorialë dhe u grupuan në 7 kategori (shikoni diagramin e mëposhtëm) për t'u fokusuar më mirë në temat kryesore për zhvillimin rajonal.

Kategoritë e fjalëve kyçe dhe të temave për zhvillimin rajonal




1.13. Skenarët për Zhvillimin Rajonal

Skenarët përfaqësojnë konfigurimet e mundshme të ardhshme të një territori, bazuar në kushtet aktuale, në tendencat e përshkruara nga programet dhe politikat aktuale të operimit (në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal) dhe në variablet e mundshme që PS-ja mund të paraqesë për të nxitur zhvillimin e brendshëm dhe endogjen.

Në rastin e Qarkut të Vlorës, analiza e informacionit të mbledhur që është kryer dhe aktivitetet pjesëmarrëse që u organizuan çuan në përcaktimin e 3 skenarëve të mundshme:

1. Zhvillimi i turizmit
2. Zhvillimi rural dhe agrobiznesi
3. Shërbimet, rrjetet dhe industria e lehtë

3 skenarë zhvillimi të mundshëm për Qarkun e Vlorës



Këta skenarë nuk qëndrojnë të mëvetësishëm por janë të lidhur ngushtë ashtu siç janë tiparet e një territori dhe sektorët e tij ekonomikë. Prandaj dhe skenarët mund të zhvillohen njëkohësisht, në një mënyrë të integruar dhe përplotësuese, për të arritur një zhvillim më të larmishëm.

Me qëllim rishikimin dhe ndarjen e Skenarëve me aktorët lokalë, gjatë takimeve të konsultimeve publike u mbajtën disa prezantime (Ditët e Hapura në nëntor 2010), të cilat theksuan drejtimit e mundshme që mund të marrë territori bazuar në secilin skenar të

mundshëm zhvillimi.

Duke parë veçoritë territoriale, secili Skenar mund të marrë të paktën dy drejtime ose modele të ndryshme zhvillimi: një të qëndrueshëm dhe një të paqëndrueshëm.

Tre skenarët e përcaktuar dhe përfshirjet e tyre përshkruhen në projektfishat e mëposhtme, së bashku me:

- planet dhe programet në zhvillim e sipër që mbështesin Skenarin
- rezultate e analizës dhe aspektet specifike territoriale që çojnë në përcaktimin e Skenarit.

Skenari 1

Zhvillimi i turizmit

Situata aktuale: potencialet, problemet dhe mundësitë për zhvillimin e turizmit

Qarku i Vlorës ka zgjedhur turizmin si një sektor kryesues të ekonomisë dhe si katalizatorin kryesor të rritjes ekonomike.

Kjo zgjedhje është mbështetur nga një numër i lartë investimesh private në aktivitetet turistike, kryesisht në strukturat e akomodimit (të nxitura gjithashtu nga Ligji për turizmin 1993), nga rritja e qarkullimit të turistëve dhe nga politikat e programet e vjetra rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare që i kushtohen turizmit:

- Me kalimin e viteve, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka përgatitur një numër strategjish turistike, pra Strategjinë dhe Planin e veprimit për zhvillimin e sektorit turistik shqiptar bazuar në turizmin kulturor dhe mjedisor (2005) dhe Strategjinë për turizmin (2007).
- Rreth 30% e planeve dhe e programeve në zhvillim e sipër në qark, e radhisin zhvillimin turistik ndërmjet prioriteteve për rritjen territoriale, pra Strategjia rajonale për arritjen e OZHM-ve, Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë, Plani strukturor i Vlorës, projekti i lumit të Vlorës, Planet e zhvillimit të komunës Qendër dhe Orikum.
- Disa programe dhe projekte në zhvillim e sipër promovojnë partneritete ndërkombëtare ndërmjet vendeve në detin Adriatik, për të nxitur zhvillimin e turizmit të integruar (Regione Turistica Adriatico-Jonica, Rrugët turistike Adriatik-Jon, etj.).

Territori rajonal ka një sërë atraksionesh turistike potenciale:

- Trashëgimia e pasur kulturore, materiale (vendet arkeologjike të ilirëve, periudha greko-romake; dhe vendet e shenjta muslimane; kalatë; fshatrat tradicionale) dhe jomateriale (muzika dhe vallet tradicionale, zejtaria, etj.)
- Vlerat peizazhore natyrore të pasura, të larmishme dhe të afërta, përfshirë malet (si,

Parku Kombëtar i Llogorasë), luginat (si, lugina e Shushicës), deti dhe ligatinat (si, Butrinti, Orikumi, Narta)

- Produktet natyrore agroushqimore (vaji i ullirit, djathi, etj.) dhe kuzhina tradicionale
- Njerëzit mikpritës dhe ambienti i sigurt.

Pavarësisht potencialeve të mëdha, deri tani, qarku ka përdorur kryesisht bregun e tij të mrekullueshëm, të padëmtuar për zhvillimin e turizmit. Qarkullimi i vizitorëve shqiptarë është rritur në mënyrë të qëndrueshme, sidomos gjatë sezonit të verës. Ata janë kryesisht Shqiptarë nga Kosova dhe emigrantë shqiptarë që vizitojnë vendin e tyre gjatë pushimeve. Megjithatë, ky lloj turizmi ka pasur një ndikim negativ te territori, duke shkaktuar një shpërndarje masive dhe të çrregullt të shumë qyteteve dhe fshatrave bregdetare (si në Vlorë, Sarandë, Ksamil), rritje të nivelit të ndotjes nga njerëzit në zonat bregdetare, dëmtim të peizazheve natyrore dhe konsumim të burimeve natyrore (uji, toka) dhe çrregullime të forta social-ekonomike ndërmjet brigjeve dhe zonave të thella.

Analizat dhe studimet e kryera në qark gjatë procesit të planifikimit strategjik theksuan disa probleme kryesore, pjesa më e madhe e të cilave janë të lidhura ngushtë me shfrytëzimin turistik të territorit:

- mungesa e sistemeve për administrimin e ujit të ndotur, të ujit dhe të mbetjeve të ngurta
- rrjeti i papërshtatshëm i transportit (sidomos rrugët dhe sistemi hekurudhor)
- aktivitetet e pakontrolluara të ndërtimeve, sidomos në bregdet; ndërtesa të shumta joformale, pjesa më e madhe të papërfunduara ose pjesërisht të shkatërruara
- përdorimi i pakontrolluar i burimeve natyrore
- mungesa e vëmendjes për hapësirat publike dhe cilësia e ulët urbane në qytete dhe fshatra
- komunitetet e varfra rurale
- varfëria e përhapur, sidomos në zonat e thella
- shërbimet dhe akomodimi i papërshtatshëm për turistët, jo në përputhje me standardet europiane.

Zhvillime të mundshme të situatës aktuale

Nëse problemet e sipërpërmendura mbeten të pazgjidhura, pasojat e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit (duke përfshirë nivelin e lartë të rreziqeve për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve dhe ndikimi të aktiviteteve të mbarështimit), paqëndrueshmëria hidrogeologjike dhe cilësia e ulët e jetës mund të kthehen në diçka serioze. Nëse vazhdon përqëndrimi i investimeve në bregdet, kjo gjë ka shumë të ngjarë të rrisë marzhinalizimin e komuniteteve rurale në zonat e thella, të cilat janë të prekura tashmë nga sistemet e papërshtatshme të infrastrukturës dhe të transportit. Niveli më i lartë i marzhinalizimit shkakton mungesën e mundësive të punësimit, emigracionin, rrallimin e popullsisë në fshatrat rurale, humbje të trashëgimisë kulturore dhe të identitetit dhe shkatërrim të peizazheve rurale. Këto probleme kanë të ngjarë të kenë një ndikim negativ me kalimin e kohës, jo vetëm të komunitetëve lokale por edhe të burimeve turistike, duke shkakuar shkatërrim në mënyrë të pakthyeshme të atraksioneve natyrore dhe një humbje të pamjes tërheqëse turistike: mbetjet do të vazhdojnë të dëmtojnë peizazhin dhe të ndotin ujin dhe tokën; brigjet, të mbuluara plotësisht nga ndërtesat, do të humbin plotësisht pamjen e tyre dhe do të jenë objekt i rrëshqitjeve të tokës, i shembjeve dhe i përmytjeve.

Nëse kjo situatë vazhdon, territori do të hyjë shumë shpejt në një proces regresioni dhe do të humbasë konkurrencën, duke u kthyer kështu në një vend të degraduar për të jetuar dhe punuar. Turistët, si vendas dhe ata të huaj, do të zgjedhin me siguri destinacione të tjera, ku peizazhet janë

2 "anët" e mundshme të Skenarit 1

I PAQËNDRUESHËM

- Aktivitetet e pakontrolluara të ndërtimeve
- Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës nga mbetjet, duke vënë në rrezik shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve
- Paqëndrueshmëria hidrogeologjike dhe rreziqet lidhur me sigurinë
- Nivelet e ulëta të cilësisë së jetës
- Standardet e ulëta të akomodimit
- Zhvillimi "monokulturor" i turizmit Diell, det dhe rërë, duke rritur marzhinalizimin e zonave të thella
- Shkatërrimi i peizazhit si një atraksion turistik
- Humbja e pamjes tërheqëse turistike

I QËNDRUESHËM

- Aktivitete të ndërtimeve nën kontroll, administrimi efikas i tokës dhe planifikimi territorial
- Administrimi efikas i mbetjeve
- Rrjeti cilësor i burimeve turistike
- Integrimi ndërmjet bregut dhe zonave të thella
- Integrimi ndërmjet turizmit dhe sektorëve të tjerë
- Mbrojtja e pasurive mjedisore
- Produkti turistik konkurrues "Qarku i Vlorës"
- Rritja e pamjes tërheqëse turistike

ende të paprekura dhe ku shërbimet dhe akomodimi turistik janë të një cilësie të lartë.

Si një alternativë tjetër, qarku ka mundësinë e zgjedhjes së një modeli të ndryshëm zhvillimi, duke u orientuar drejt turizmit të qëndrueshëm i cili është ekologjik dhe i ndjeshëm nga ana kulturore, duke pasur një ndikim të ulët të mjedisi dhe të kultura vendase dhe duke ndihmuar ndërkohë gjenerimin e të ardhurave, punësimin dhe ruajtjen e ekosistemeve lokale. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit, turizmi i qëndrueshëm është ai i cili çon në menaxhimin e të gjitha burimeve në atë mënyrë që të mund të përmbushen nevojat ekonomike, sociale dhe estetike duke ruajtur integritetin kulturor, proceset thelbësore ekologjike, larminë biologjike dhe sistemet mbështetëse të jetës.

Strategjia Kombëtare për Turizmin 2007 thekson se *"Kultura, aventura dhe "ekoturizmi" konsiderohen si tregjet turistike me rritjen më të shpejtë në të gjithë botën (...). Turizmi i fokusuar te turistët e pavarur që vizitojnë komunitetet lokale dhe që marrin pjesë aktivisht në aktivitetet kulturore dhe natyrore ka treguar se prodhon 5 deri në 10 herë më shumë përfitime zhvillimi për çdo dollar të shpenzuar nga turistët se sa turizmi "diell dhe rërë" me një shtrirje të gjerë.*

"Pavarësisht potencialit të madh të tij, zhvillimi i sektorit të turizmit është i kushtëzuar nga infrastruktura e dobët në disa zona, nga mungesa e sistemeve efikase të trajtimit të mbetjeve, nga mungesa e kontrolleve të rrepta mbi ndërtimet joformale, nga niveli i ulët i financimeve për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e zonave me interes mjedisor dhe kulturor, nga burimet njerëzore të patrajnuara siç duhet [...], nga mungesa e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë dhe nga mungesa e një organizate të vetme gjithëpërfshirëse në sektorin privat."

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Skenari 2

Zhvillimi rural dhe agrobiznesi

Situata aktuale: potencialet, problemet dhe mundësitë për zhvillimin rural

Shqipëria ka një traditë të vjetër dhe të çmueshme në bujqësi, e cila përbën ende të ardhurat kryesore dhe sektorin e punësimit për pjesën më të madhe të popullsisë. Në këtë pikëpamje, Qarku i Vlorës pasqyron të njëjtën tendencë. Aktivitetet rurale përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të kulturës dhe identitetit rajonal. Ato janë gjithashtu mjete të qëndrueshme për të ruajtur peizazhet tradicionale. Zonat rurale janë gjithashtu një rezervuar i pasurive natyrore, traditave, zejeve dhe shijeve që mund të jenë atraksione të fuqishme për turistët. Pikat e forta kryesore të territorit rajonal në këtë zonë janë:

- Produktet natyrore agrourbane, kuzhina tradicionale
- Zinxhirët potencialë të vlerave të përcaktuara dhe të planifikuara tashmë: vaji i ullirit, peshkimi në det dhe akuakultura, bimët, mjalti, frutat dhe perimet, qumështi, vera dhe distilatet
- Peizazhet natyrore dhe rurale të padëmtuara
- Ndjenja e fortë e identitetit dhe e përkatësisë

Përveç këtyre aspekteve pozitive, sektori rural rajonal shfaq disa probleme kryesore siç janë:

- Mungesa e infrastrukturës bazë (sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, sistemet e administrimit të mbetjeve të ngurta)
- Përdorimi i pakontrolluar i burimeve natyrore
- Kushtet e papërshtatshme dhe/ose të dobëta të rrjetit rrugor, duke rritur marzhinalizimin e komuniteteve rurale
- Varfëria e përhapur, sidomos në zonat e thella, është shpesh arsyeja për të emigruar
- Fermat familjare të vogla dhe të ndara, duke penguar kështu zhvillimin e tregut të kreditimit për fermerët, të tregut bujqësor dhe të përpunimit të produkteve bujqësore si dhe të investimit të huaj të drejtpërdrejtë në bujqësi
- Të drejta të paqarta të pronësisë
- Mungesa e standardeve cilësore të ushqimit (sidomos në prodhimet e vajit të ullirit dhe të qumështit) dhe të sigurisë ushqimore
- Mungesa e strukturave kolektive për fermerët

- Zinxhirët e paplotë të vlerave dhe mungesa e përpunimit të ushqimit
- Refuzimi i prodhuesve për të krijuar dhe/ose për t'u bashkuar me shoqatat.

Për të trajtuar këto probleme strukturore, qeveria shqiptare përfshiu zhvillimin rural si një fushë kyçe të ndërhyrjes në Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2007-2013 dhe përgatiti dy strategji specifike: Strategjia e Bujqësisë dhe e Ushqimit (SBU) dhe Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural të Shqipërisë (ISRDSA). Prioritetet dhe objektivat e këtyre tre strategjive tematike mund të përmbledhen si më poshtë:

- Rritja e mbështetjes financiare për fermerët, bujqësinë dhe për përpunimin e produkteve bujqësore
- Përmirësimi i tregtimit të produkteve bujqësore dhe të përpunuara
- Rritja e konkurrencës së bujqësisë, agrobiznesit dhe e pylltarisë nëpërmjet: modernizimit të bujqësisë, për të rritur produktivitetin; rritjes së vlerës së shtuar dhe të cilësisë në prodhim dhe përpunim, për të garantuar standardet më të larta të sigurisë ushqimore dhe cilësinë e produkteve; menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas të pyjeve; rritjes së nivelit të konkurrencës
- Ruajtjes së peizazhit kulturor dhe mbrojtjes së mjedisit, gjithashtu nëpërmjet praktikave bujqësore pro-mjedisit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të tokës
- Përmirësimi të cilësisë së jetës në zonat rurale dhe nxitjes së larmisë së aktiviteteve ekonomike për të rritur punësimin, të ardhurat dhe standardet e jetesës, nëpërmjet: krijimit të mundësive për punësim në aktivitetet plotësuese të bujqësisë siç është turizmi, përpunimi dhe zejet; përmirësimi të cilësisë së jetës (rinovimi i fshatrave, shërbimet bazë, etj.)
- Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve lokale për të menaxhuar programet për zhvillimin rural nëpërmjet zhvillimit rural pjesëmarrës.

Sektori do të përfitojë nga programi qeveritar për rrugët rurale, nga investimet e planifikuara në sistemin e ujitjes dhe kullimit dhe nga mbështetja e zhvillimit që do të ofrohet nga procesi i integritit evropian.

Ekonomia me një sektor të vetëm e bazuar në turizëm është një strategji e dobët për zhvillimin ekonomik; si e tillë nuk është parashikuar. Në këtë pike, është parashikuar rigjallërimi i industrive tradicionale kryesore siç është bujqësia (...) dhe peshkimi (...), së bashku me programet për mbështetjen e arteve dhe zejeve lokale si dhe industritë me ndikim të ulët.

Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë

Zhvillime të mundshme të situatës aktuale

Çështjet mjedisore që lidhen me sektorin rural siç është mungesa e sistemeve për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, të ujit të ndotur dhe të ujit dhe përdorimi i pakontrolluar i burimeve natyrore duhet të trajtohen menjëherë ose përndryshe vazhdimi në këtë mënyrë mund të shkaktojë ndotje të ujit dhe të tokës dhe rreziqe të konsiderueshme për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, duke ndikuar gjithashtu tek aktivitetet e mbarështimit dhe të bujqësisë. Përveç këtyre, mund të shkaktohen dëme të pandreqshme për mjedisin, i cili është një burim potencial të ardhurash për zonat rurale, nëpërmjet ndikimit që ka si në cilësinë e produkteve ushqimore dhe në pamjen tërheqëse turistike.

Një tjetër rrezik në zhvillimin e Skenarit është "modernizimi i pakontrolluar" i cili mund të çojë në një përdorim masiv të pesticideve dhe të produkteve të tjera kimike për të rritur produktivitetin bujqësor (duke shkaktuar kështu probleme me ndotjen) ose në futjen e llojeve

vendase të produkteve bujqësore, të cilat mund të shkaktojnë humbje të traditës së produkteve vendase dhe uljen e pamjes tërheqëse territoriale. Kështu, sfida është që të vazhdojë qëndrueshmëria e përgjithshme mjedisore në aktivitetet rajonale rurale, duke ekuilibruar novacionin dhe traditën dhe duke përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve tipike vendase. Kjo gjë do të mundësonte rikuperimin/përmirësimin e një marrëdhënieje harmonike ndërmjet aktiviteteve rurale dhe mjedisit, të cilat mund të përfaqësojnë markën rajonale dhe gjithashtu burimin e fuqishëm për zhvillimin e turizmit.

Zhvillimi i qëndrueshëm rural, i integruar siç duhet me sektorë të tjerë produktivë siç është turizmi dhe artizanati dhe i mbështetur nga përmirësimet në infrastrukturë dhe nga politikat specifike për të zgjeruar shoqatën e prodhuesve mund t'i bëjë produktet rajonale të përshtatshme për tregjet rajonale, kombëtare dhe madje ndërkombëtare. "Ana e qëndrueshme" e Skenarit mund të gjejë terren pjellor në qark: kjo tregohet nga realitete të tilla si lugina Shushicës, ku bujqësia biologjike është e përhapur tashmë dhe ku autenticiteti i produkteve vendase është një burim i krenarisë së popullsisë.

Tregjet dhe standardet e cilësisë ushqimore nuk janë ende të zhvilluara në Shqipëri dhe rritja e prodhimit ka nevojë për mbështetje nga tregtia e përmirësuar, me qëllim që të jenë të qëndrueshme. Prandaj dhe, mbështetja për modernizimin e fermave dhe për zhvillimin e tregut do të jetë e një rëndësie të madhe."

ISRDSA 2007-2013

2 "anët" e mundshme të Skenarit 2

I PAQËNDRUESHËM

- Investimi në turizmin rural pa trajtuar problemet me administrimin e ujit dhe të mbetjeve: ndotja e ajrit, ujit dhe tokës nga mbetjet e pagrumbulluara, rreziqet shëndetësore për njerëzit dhe kafshët, paqëndrueshmëria hidro-gjeologjike (rrëshqitjet e tokës dhe përmbytjet)
- Përdorimi i pesticideve dhe i produkteve të tjera kimike
- Rrallimi i popullsisë në komunitetet rurale, emigrimi
- Shkatërrimi pakthyeshëm i peizazheve rurale që shërbejnë si atraksione turistike dhe i simboleve të identitetit
- Teknologjia dhe novacionet për një numër të vogël sipërmarrësish
- Prodhimet që nuk kanë lidhje me kontekstin lokal

I QËNDRUESHËM

- Kualifikimi i prodhimeve tipike vendase (markat)
- Bashkimi i prodhuesve për të përmirësuar konkurrencën
- Mbrojtja e tokës nga ndotja dhe erozioni
- Bujqësia organike
- Mbrojtja e mjedisit për të parandaluar rreziqet shëndetësore
- Diferencimi i aktiviteteve rurale – mikëpritja e turistëve, prodhimi i energjisë së rinovueshme, përpunimi i ushqimit
- Lidhja me tregjet – rrjeti rrugor i asyreshëm dhe i përmirësuar, TIK
- Ruajtja e peizazhit rural dhe e identitetit
- Ekuilibrimi i novacionit me traditën
- Integrimi me sektorin e turizmit dhe të artizanatit

Skenari 3 Shërbimet, rrjetet dhe industria e lehtë

Situata aktuale: potencialet, problemet dhe mundësitë për zhvillimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve

Situata ka të bëjë me një sërë çështjesh: rrjetet materiale dhe jomateriale (shërbimet bazë, furnizimi me energji, transportet, TIK-u), shërbimet e përkujdesjes sociale dhe shëndetësore dhe industria e lehtë (që lidhet kryesisht me sipërmarrjet e vogla dhe të mesme në sektorin e prodhimit). Këto aspekte janë të ndërlidhura fort, pasi rrjetet dhe shërbimet publike përfaqësojnë furnizimin bazë që një territor të jetë një tokë e begatë për zhvillimin sipërmarrës. Rrjetet e transportit dhe të TIK-ut sigurojnë mënyrën e lëvizjes së njerëzve, mallrave dhe informacionit, ndërkohë që rrjetet e energjisë dhe të shërbimeve bazë i lejojnë sipërmarrjet që t'i përdorin burimet natyrore në mënyrë efikase. Përveç kësaj, shërbimet efikase të përkujdesjes sociale dhe politikat efektive të përfshirjes sociale janë thelbësore për të garantuar mundësi të barabarta për t'u futur në tregun e punës. Qarku i Vlorës po përjeton një mungesë të rrjeteve të shërbimeve bazë: furnizimi me ujë dhe sistemet e administrimit të ujërave të zeza, sistemet e administrimit të mbetjeve, rrjetet e furnizimit me energji, rrjetet TIK, rrugët dhe hekurudhat, ose nuk ekzistojnë, ose janë në kushte të mjerueshme, duke ndikuar kështu negativisht në kushtet e jetesës dhe të punës. Problemet me infrastrukturën kanë një ndikim shumë negativ në aktivitetet ekonomike, të cilat nuk mund të kenë zhvillim pa furnizimin e duhur me energji dhe me rrjete të besueshme komunikimi. Për më tepër, shërbimet e tjera publike siç janë përkujdesja sociale dhe shëndetësore janë ende larg nga standardet evropiane. Pavarësisht kësaj situatë, Shqipëria synon integrimin në BE. Në këtë këndvështrim, Qarku i Vlorës do të luajë një rol të rëndësishëm në projektin Korridor VIII – një aks multimodal që lidh Italinë e Jugut me Detin e Zi, përfshirë portin e Vlorës (aktualisht objekt i një projekti zgjerimi të financuar nga Kooperacioni Italian).

Prandaj, si vendi ashtu dhe qarku duhet të angazhohen në përpjekjen për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet dhe për të garantuar aksesin e barabartë në to, sidomos në zonat rurale dhe të thella.

Prioritetet kryesore në lidhje me këtë janë të përfshira tashmë në Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2007-2013 dhe në strategjitë kombëtare tematike, siç është Strategjia sektoriale e transportit 2008-2013, për shembull:

- **Transportet** – Përfundimi i investimeve kryesore në rrjetin kombëtar të rrugëve, duke përfshirë korridorin Veri-Jug, korridorin Lindje-Perëndim (Korridori VIII), rrugët turistike (p.sh. rruga Dhërmi-Sarandë, rruga hyrëse në Butrint) dhe rrugët e pikave të kalimit të kufijve (p.sh., Sarandë-Konispol); përmirësimi i rrjetit të rrugëve lokale dhe rurale në bashkëpunim me qeveritë vendore; ngritja e stacioneve ndërurbane dhe ndërkombëtare për autobusët në qytetet më kryesore të Shqipërisë; zhvillimi i porteve mbi bazën e masterplaneve për specializimin funksional të tyre dhe për zhvillimin e harmonizuar; zhvillimi i transportit të brendshëm ajror.
- **TIK** – Zhvillimi i teknologjisë së informacionit në qendrat urbane dhe më pas në zonat rurale dhe përhapja e shërbimeve të telekomunikacionit dhe të internetit në të gjitha qarqet.
- **Energjia** – Nxitja e përdorimit të energjisë në mënyrë efikase duke nxitur gjithashtu përdorimin e teknologjive moderne në industri, shërbime dhe bujqësi për furnizimin efikas me energji; rritja e furnizimit me energji bazuar në konceptet e planifikimit për kosto sa më të ulët dhe për ndikim sa më të vogël në mjedis; zgjerimi i larmisë së burimeve të energjisë dhe rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme.
- **Uji** – Rritja e mbulimit të furnizimit me ujë, e shërbimeve për trajtimin e ujërave të zeza dhe të ujit të ndotur.
- **Mjedisi** – Përmirësimi i administrimit të mbetjeve të ngurta (pra, duke krijuar landfille që janë në përputhje me standardet e BE-së dhe rehabilitimi i tokës së kontaminuar); nxitja e përmirësimit teknologjik të industrive.

- **Shërbimet e përkujdesjes shëndetësore dhe sociale** – Decentralizimi i shërbimeve të kujdesit social; institucionalizimi i marrëdhënieve me OJQ-të; transformimi i shërbimeve të banimit në shërbime të ndryshueshme dhe të bazuara në komunitet; rritja e përfshirjes sociale të grupeve të pafavorizuara.
- **Aktivitetet ekonomike** – Përcaktimi i një politike industriale që synon rritjen e konkurrencës, modernizimit, zgjerimit të larmisë dhe të specializimit; nxitja e investimeve të huaja dhe e eksporteve; përforsimi i SME-ve: zhvillimi i kulturës sipërmarrëse; përmirësimi i trajnimeve; mbështetja e zhvillimit të biznesit nëpërmjet shërbimeve one-stop shop; përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për biznesin; lehtësimi i transferimit të teknologjisë; përmirësimi i mbështetjes financiare; mbështetja e ndërkombëtarizimit.

veçanërisht nga një këndvështrim i mjedisit, vonesat dhe mungesa e koordinimit si dhe e një vizioni afatgjatë mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme. Ndikimi i rritjes së pakontrolluar të ekonomisë mund të rrisë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, gjë që mund të rezultojë nga mbetjet e pagrumbulluara, nga mostrajtimi i ujit të ndotur, nga aktivitetet industriale dhe nga prodhimi i energjisë në mënyrë tradicionale, duke shkatërruar kështu, në mënyrë të pakthyeshme, atraksionet natyrore. Gjithashtu, përmirësimi i rrjetit të rrugëve mund të përkeqësojë paqëndrueshmërinë hidrogjeologjike dhe mund të krijojë çekuilibër social-ekonomik në rast se nuk shoqërohet nga krijimi i mundësive për vende pune në zonat e thella. Mënyra më e mirë për ta mbajtur këtë Skenar zhvillimi nën kontroll është mbajtja e komponentëve të tij vazhdimisht të koordinuar, kështu që të gjitha politikat e sektorit të takohen në të njëjtat objektiva dhe të jenë të përputhshme.

Zhvillime të mundshme të situatës aktuale

Politikat aktuale pranojnë nevojën për të përmirësuar rrjetet e infrastrukturës dhe të shërbimeve në territorin kombëtar duke u fokusuar vazhdimisht në qëndrueshmërinë e mjedisit. Rreziku qëndron në faktin se mungesa e burimeve financiare shkakton vonesa në zbatimin e strategjive dhe në përqendrimin te perspektivat afatshkurtra, duke e larguar vëmendjen nga qëndrueshmëria e përgjithshme dhe nga koordinimi i ndërhyrjeve. Duke u nisur

"Infrastruktura duhet të projektohet për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe duhet të vendosë prioritetet dhe të ndahet në faza për të lehtësuar objektivat e zhvillimit, në përputhje me burimet e disponueshme."

Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë

"Rritja e mundësive të ekonomisë shqiptare, në mënyrë që të përshtatet me logjikën e ndërkombëtarizimit dhe të integrimin në tregjet botërore, kërkon zgjerimin e larmisë së produkteve dhe shërbimeve ekzistuese dhe prodhimin e produktit me vlerë të shtuar të lartë."

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

2 "anët" e mundshme të Skenarit 3

I PAQËNDRUESHËM

- Ndotja nga mbetjet e pagrumbulluara, nga aktivitetet industriale dhe nga prodhimi i energjisë në mënyrë tradicionale
- Rritja e konkurrencës në sektorët tradicionalë të prodhimit nga vendet në zhvillim
- Zhvillimi industrial, që shkakton rritjen e problemeve nga furnizimi me energji
- Migrimi brenda vendit dhe rrallimi i popullsisë në zonat e thella
- Rreziqet nga rrëshqitjet e tokës nëse rrjeti rrugor është projektuar dhe ndërtuar me cilësi të dobët
- Aktivitetet ndërtimore jashtë kontrollit, pa u kushtuar vëmendje cilësisë urbane, duke shkaktuar ulje të cilësisë së jetesës në qytete dhe fshatra
- Shkatërrimi i mjedisit që shërben si atraksion turistik

I QËNDRUESHËM

- Kontrolli i ndotjes dhe prodhimi i energjisë së rinovueshme
- Prodhimet me cilësi me vlerë të shtuar më të lartë
- Novacionet në biznes dhe ndërkombëtarizimi
- Integrimi ndërmjet të gjithë sektorëve prodhues
- "Ekonomia e gjelbër"
- Lëvizja e qëndrueshme dhe zhvillimi i TIK-ut
- Akses i barabartë në burimet për zhvillim
- Kontrolli i territorit dhe përmirësimi i cilësisë urbane në qytete dhe fshatra
- Mjedisi si një burim zhvillimi

KAPITULLI 2

KUADRI STRATEGJIK



Pamje nga
bregdeti i Ksamilit

2.1. Hyrje metodologjike

Vizioni për zhvillimin e Qarkut të Vlorës në të ardhmen dhe Strategjia e propozuar për arritjen e tij u hartua duke filluar nga dhe sipas:

- vëzhgimit të planeve dhe programeve që operojnë aktualisht në territorin e qarkut, duke u fokusuar veçanërisht në *Planin për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë*
- vëzhgimit të kërkimeve shkencore dhe analizave të sektorit që janë kryer deri tani
- informacionit të mbledhur gjatë vëzhgimeve të territorit
- rezultateve të takimeve (me autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, me Këshillin e Partneritetit të Qarkut, me organet e bashkëpunimit ndërkombëtar) dhe aktiviteteve pjesëmarrëse (Faza e prezantimit të nismës për planifikim strategjik, Ditët e Hapura në Vlorë dhe Sarandë, debatet publike) të organizuara në kuadrin e procesit të planifikimit strategjik.


Prandaj dhe Vizioni përçon dëshirat dhe nevojat e aktorëve lokalë, të shprehura drejtpërdrejt ose jo

gjatë takimeve dhe aktiviteteve pjesëmarrëse dhe i harmonizon ato me situatën aktuale të territorit, me programet në zhvillim e sipër dhe me politikat dhe qëllimet kombëtare. Rezultati i këtij aktiviteti në përpunim është imazhi i një të ardhmeje të mundshme dhe të dëshirueshme për Qarkun e Vlorës – një imazh që mund të udhëheqë të gjitha nismat e ardhshme për zhvillim.

Si Vizioni, ashtu dhe Strategjia u diskutuan me aktorët rajonalë dhe lokalë gjatë dy takimeve të mbajtura në dhjetor 2010: një takim i kufizuar me një panel ekspertësh që janë zgjedhur nga stafi i Këshillit Rajonal dhe nga një konsultim publik, ku u paraqitën versionet e draftit të Vizionit dhe Strategjisë, që janë debatuar dhe rishikuar me grupet lokale të interesit.

Rrjedhimisht, Vizioni dhe Strategjia e mëposhtme duhet të konsiderohen se janë ndarë me të gjithë komunitetin rajonal dhe për të cilat ai ka rënë dakord.

Vizioni dhe Strategjia për zhvillimin rajonal



2.2. Pjesëmarrja në përcaktimin e strategjisë Ditët e Hapura dhe debatet publike

Me qëllim që të përcaktohej një strategji rajonale zhvillimi, e përbashkët për pjesën më të madhe të aktorëve territorialë, kjo fazë e procesit të pjesëmarrjes përfshinte dy hapa:

- Ditët e Hapura, që synonin të identifikonin çështjet territoriale vendimtare dhe të fillonin përcaktimin e përbashkët të strategjisë së zhvillimit të Qarkut të Vlorës
- Debatet publike, ku drafti i Vizionit dhe i Strategjisë për zhvillimin rajonal (i përgatitur nga ekspertët e Planifikimit Strategjik të bazuar në rezultatet e Ditëve të Hapura) u nda me të gjithë aktorët territorialë.

Ditët e Hapura

17-19 Nëntor 2010

Pas aktiviteteve prezantuese, Ditët e Hapura paraqitën hapin e dytë për të nxitur diskutimin demokratik mbi çështjet e zhvillimit dhe për të përcaktuar strategjitë e përbashkëta për zhvillim të qëndrueshëm në Qarkun e Vlorës. Me qëllim përmirësimit e përfshirjes së të gjithë aktorëve rajonalë në proces, në nëntor u mbajtën dy Ditë të Hapura, një në Vlorë dhe një në Sarandë.

Objektivat specifike të këtyre aktiviteteve publike të diskutimit ishin:

- Tërheqja dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve territorialë
- Stimulimi i diskutimeve demokratike lidhur me temat që konsiderohen vendimtare për zhvillimin rajonal
- Identifikimi i prioritetëve dhe i propozimeve për temat e rekomanduara për diskutim
- Diskutimi i skenarëve të mundshëm të zhvillimit për qarkun
- Përcaktimi i një drafti të strategjisë së zhvillimit duke përdorur një qasje pjesëmarrëse.

Secila Ditë e Hapur u nda në tre seminare tematike, të bazuara në çështjet vendimtare për zhvillim rajonal të qëndrueshëm.

- Rrjetet mjedisore dhe infrastrukturore për qëndrueshmëri
- Trashëgimia kulturore dhe turizmi
- Çështjet sociale

- Zhvillimi rural dhe zgjerimi i larmisë së aktiviteteve rurale

Secili seminar filloi me një shpjegim të shpejtë të objektivave të debatit dhe me një prezantim të një analize fotografike SWOT dhe me skenarët e mundshëm të zhvillimit, që synonin të prezantonin pikën e diskutimit dhe të mbështesnin e të nxisnin diskutimet. Seminari vijoi më pas me debatet publike, të cilat u udhëhoqën duke përdorur një variacion të metodologjisë pjesëmarrëse EASW (Seminari Evropian për Skenarin e Ndërgjegjësimin). Në fund të takimeve, u nxorën përfundimet, duke identifikuar fjalët kyçe të debatit dhe rezultate kryesore të arritura.

Debatet përfshinin më shumë se 100 pjesëmarrës.

Ditët e Hapura ishin gjithashtu të rëndësishme për të rizbuluar dhe për të konfirmuar rëndësinë e kulturës tradicionale në qark. Takimet u gjallëruan nga koncertet e shkurtra iso-polifonike të grupeve të muzikantëve dhe këngëtarëve vendas, të cilët u vlerësuan shumë nga pjesëmarrësit. Përveç kësaj, u shfaqën dhe kostume popullore. Për secilin seminar u përgatitën borde që shpjegonin temat kryesore të diskutimit (në anglisht dhe shqip) dhe për pjesëmarrësit u shpërnda një fletë me rregullat që duheshin zbatuar gjatë debateve me qëllim që të vihej rregull gjatë diskutimeve, si dhe një fjalorth ku shpjegoheshin temat kryesore teknike të përdorura në procesin e planifikimit strategjik.



Seminaret tematike të Ditëve të Hapura

Temat kryesore për diskutim

SEMINARI TEMATIK 1

Rrjetet mjedisore dhe infrastrukturore për qëndrueshmëri

- Mbrojtja e mjedisit dhe e peizazhit
- Administrimi i mbetjeve
- Administrimi i ujit dhe i ujit të përdorur
- Trajnimet e reja profesionale dhe mundësitë për punësim në sektorët e energjisë së "pastër" dhe të shërbimeve për mjedisin
- Ndërgjegjësimi mbi mjedisin
- Prodhimi i energjisë dhe aktivitetet industriale
- Lëvizja e qëndrueshme: rrjeti i rrugëve dhe transporti publik
- Cilësia urbane: hapësirat publike, zonat me gjelbërim, ambientet sportive, dekori urban

SEMINARI TEMATIK 4

Prodhimet agroushqimore dhe zgjerimi i larmisë së aktiviteteve rurale

- Prodhimet agroushqimore të cilësisë së lartë çertifikimi dhe markat
- Zinxhirët e shkurtër të prodhimit dhe të shpërndarjes
- Shoqatat e prodhuesve
- Turizmi i qëndrueshëm rural
- Trajnimet e reja profesionale dhe mundësitë për punësim në sektorët e bujqësisë, mbarështimit, përpunimit të ushqimit, tregtimit dhe turizmit rural
- Ndërgjegjësimi i prodhuesve mbi mjedisin
- Infrastruktura për prodhimin

SEMINARI TEMATIK 2

Trashëgimia kulturore dhe turizmi

- Identiteti dhe trashëgimia kulturore: ruajtja dhe përmirësimi
- Turizmi i qëndrueshëm bazuar në pasuritë kulturore
- Trajnimet e reja profesionale dhe mundësitë për punësim në sektorët e menaxhimit të pasurive kulturore, të shërbimeve të mikpritjes të një cilësie të lartë dhe të shërbimeve turistike
- Menaxhimi i destinacionit



SEMINARI TEMATIK 3

Çështjet sociale

- Shërbimet shëndetësore
- Shërbimet e përkujdesjes sociale
- Përfshirja sociale
- Trajnimet e reja profesionale dhe mundësi punësimi në sektorin social



Ditët e Hapura

Përfundimet dhe rezultatet e arritura

Vlorë

17 Nëntor 2010

Gjatë takimit që drejtohej nga ekspertët PS-së dhe nga AULEDA, u prezantua statusi aktual i procesit të planifikimit strategjik, temat kryesore për diskutim dhe skenarët e mundshëm për zhvillimin rajonal. Pjesëmarrja në seminare ishte e kënaqshme (rreth 50 pjesëmarrës të regjistruar) ndërkohë që të gjithë aktorët provuan se ishin të interesuar dhe të gatshëm për të theksuar aspektet vendimtare të territorit rajonal që duhet të trajtohen nga Plani Strategjik. Çështjet dhe objektivat kryesore që u diskutuan, që do të përfaqësojnë "skeletonin" e strategjisë së zhvillimit rajonal, ishin si më poshtë.

Seminari 1

Mbrojtja e mjedisit dhe rrjetet e infrastrukturës për qëndrueshmëri

- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta – Zhvillimi i grumbullimit të mbetjeve të ngurta në mënyrë të mëvetësishme dhe krijimi i shpejtë i sistemit të administrimit të mbetjeve (pra, duke krijuar landfille në terriore të përshtatshme).
- Ruajtja e zonave natyrore, të cilat përbëjnë një burim për zhvillimin e turizmit.
- Planifikimi dhe kontrolli i efektshëm urban, sidomos në zonat bregdetare.
- Nxitja e zhvillimit industrial pro-mjedisor.
- Burimet me ujë të pijshëm, administrimi i ujit dhe i ujit të përdorur, sistemi i ujërave të zeza. Burimet e shumta me ujë të pijshëm në qark janë objekt i rreziqeve të mëdha për ndotje dhe nevojiten në mënyrë urgjente impiante pastrimi për të ruajtur ujin e detit dhe për të nxitur turizmin.
- Lidhjet ndërmjet portit të Vlorës dhe pasurisë urbane të qytetit: projekti për rinovimin e portit (financuar nga Kooperacioni Italian dhe i programuar për të filluar brenda vitit që vjen) parashikon 2 zona të dallueshme, një zonë tregtare dhe një zonë detare, me 2 hyrje të mëvetësishme, të cilat duhet të lidhen siç duhet me rrugë urbane dhe me rrjetet e shërbimeve.

- Roli potencial i planit strategjik si një platformë me nivele të shumta ku mund të takohen dhe të koordinohen politikat e zhvillimit vendor dhe kombëtar.
- Ruajtja/krijimi i zonave me gjelbërim në qytet.
- Riorganizimi i rrjetit të rrugëve në Vlorë për një kontroll më të efektshëm të trafikut.

Seminari 2

Trashëgimia kulturore dhe turizmi

- Aksesimi në trashëgiminë kulturore: Trajnimi i guidave turistike, organizimi i tureve, riorganizimi i menaxhimit të muzeve dhe të vendeve të trashëgimisë kulturore, përmirësimi i rrjeteve (rrugët, ndriçimi etj.).
- Mirëmbajtja, restaurimi dhe menaxhimi i monumenteve dhe i vendeve.
- Zhvillimi i artizanatit: shumë zeje po zhduken gradualisht për shkak të konkurrencës me vende të tjera në zhvillim, emigracionit, sistemit të taksimit që nuk i mbështet artizanët. Disa propozime: përcaktimi i politikave kombëtare për lehtësimin e taksave; nxitja e shoqatave të artizanëve; përforcimi i cilësisë së artizanatit dhe promovimi i një regjistri për artizanët; identifikimi i hapësirave për të shitur produktet artizanale, sidomos në zonat turistike; nxitja e zhvillimit të galerive të artit, gjithashtu për të mbështetur artistët lokalë.
- Integrimi i turizmit kulturor, ekoturizmit, turizmit sportiv, me qëllim diferencimin e produkteve turistike dhe për ta bërë turizmin më pak sezonal; integrimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm ekonomikë;
- Përmirësimi i cilësisë (i mjedisit, i ambienteve të akomodimit, i shërbimeve) për të kënaqur turistët e huaj dhe për të hyrë në tregun ndërkombëtar të turizmit.
- Trajnimet profesionale dhe arsimimi në universitete lidhur me sektorët e kulturës dhe turizmit; integrimi ndërmjet botës së arsimit dhe biznesit.
- Vlerësimi i iso-polifonisë si një burim për ta ruajtur dhe për ta transmetuar te brezat e rinj. Ai është një simbol i identitetit vendas dhe mund të jetë një atraksion për turizmin kulturor.

Seminari 3

Çështjet sociale

- Ngritja e strukturave për të ofruar shërbimet e kujdesit social, sidomos për fëmijët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për të moshuarit; zbatimi i Planit Social të financuar nga rajoni i Emilia-Romagna-s.
- "Plani strategjik në favor të fëmijëve".
- Nxitja e donacioneve dhe e investimeve në projektet sociale nga sektori privat.
- Integrimi social i grupeve të pafavorizuara nëpërmjet strehimit social, trajnimeve profesionale dhe programeve të përshtatshme për punësim.
- Ndiqja për të diplomuarit që kërkojnë të punësohen.
- Bashkëpunimi ndërmjet shoqatave, zyrave të bashkisë dhe zyrës rajonale të punës.
- Integrimi ndërmjet arsimit dhe politikave të trajnimit dhe sferës së biznesit.


Seminari 4

Prodhimet agrourbore dhe zgjerimi i larmisë së aktiviteteve rurale

- Përmirësimi i administrimit të ujit dhe i sistemeve të kanalizimit për ujitjen e fushave.
- Nxitja e shoqatave të prodhuesve për të kapërcyer problemet e ndarjes së pronësisë së tokës dhe nivelin e ulët të prodhimit.
- Përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore për eksport nëpërmjet krijimit të markave, marketingut dhe çertifikimit; rritja i ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe i sigurisë ushqimore.
- Përmirësimi i përpunimit të ushqimit për frutat, mjaltin etj.
- Zhvillimi i agro-turizmit.
- Përputhja e prodhimit me kërkesën e tregut, duke u dhënë mundësi prodhuesve që të kenë akses në analizimin e tregut.
- Mbështetja ekonomike dhe financiare për fermerët.
- Koordinimi me politikat kombëtare në sektorin e zhvillimit rural.

Në fund të takimeve, u nxorën përfundimet duke identifikuar fjalët kyçe të debatit: ndarja (e prodhimit, tokës, politikave etj.); trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve; koordinimi dhe krijimi i partneritetit (ndërmjet prodhuesve, institucioneve, niveleve qeveritare, etj.). Të drejtat e paqarta lidhur me pronësinë e tokës rezultuan si një çështje kryesore e cila mund të dëmtojë zhvillimin në të gjithë sektorët.

HISTORICAL BUILDINGS



All Pasha Caste in Porto Palermo management

CULTURAL HERITAGE Narta




Zverec monastery salt-works LANDSCAPE

CULTURAL HERITAGE folklore




POLYPHONY Shushica Valley TRADITIONS

HANDICRAFT Culture & identity Textile



ceramics tradition KNOW-HOW

ARCHAEOLOGICAL SITES



history tourism IDENTITY BUTRINT

ARCHAEOLOGY accessibility excavations



ORIKUM Tourist information AMANTIA

Sipër: Pjesë e posterit që shfaq një analizë SWOT fotografike e përgatitur për Seminarin 1

Sarandë

19 Nëntor 2010

Me qëllim fuqizimin e aktorëve lokalë, gjatë Ditës së Hapur në Sarandë, ekspertët e PS-së mbështetën stafin e AULEDA-s dhe anëtarët e bordit për drejtimin e aktiviteteve, duke i trajnuar ata në këtë mënyrë në punë lidhur me menaxhimin e proceseve të pjesëmarrjes. Kështu, seminarët 1 dhe 2 u drejtuan nga drejtori i AULEDA-s, ndërsa seminarët 3 dhe 4 u drejtuan nga presidenti i bordit të AULEDA-s.

Pjesëmarrja ishte e kënaqshme (më shumë se 60 persona në total) dhe pjesëmarrësit ishin të gatshëm të theksonin aspektet vendimtare të territorit rajonal dhe të propozonin nisma konkrete për t'i trajtuar ato. Debatimi mbi Çështjet Sociale ishte veçanërisht i nxehtë dhe produktiv. Çështjet kryesore që u diskutuan ishin si më poshtë.

Seminari 1

Mbrojtja e mjedisit dhe rrjetet e infrastrukturës për qëndrueshmëri

- Sistemi i lumit si një burim për ekonominë lokale – nevoja për monitorim për të shmangur përmytjet.
- Lufta kundër paqëndrueshmërisë hidrogjeologjike – nevoja për monitorim dhe për ndërhyrje specifike për të parandaluar rrëshqitjet e tokës dhe për të luftuar erozionin.
- Zhvillimi i rrjeteve të shërbimeve për të ruajtur burimet natyrore: sistemi i administrimit të mbetjeve, sistemi i ujërave të zeza, impiantet për trajtimin e ujit.
- Planifikimi i zhvillimit urban në Sarandë.
- Mbrojtja e pyjeve (sidomos në zonën e Butrintit).
- Vlerësimi i ujërave kurative në zonën e liqenit të Butrintit.
- Rritja e numrit të limaneve për varkat e peshkimit.
- Përmirësimi i lidhjeve me Greqinë dhe me rajone të tjera, si një mundësi për zhvillim.
- Koordinimi me politikën kombëtare.

Seminari 2

Trashëgimia kulturore dhe turizmi

- Trajnimi i shoqëruesve turistikë të specializuar në trashëgiminë kulturore dhe në turizmin kulturor.
- Përmirësimi i rrjeteve të transportit dhe i

shërbimeve.

- Administrimi i mbetjeve në mënyrë efikase si një çështje thelbësore për zhvillimin e turizmit
- Nxitja e investimeve në turizmin kulturor dhe kualifikimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve për përmirësimin e turizmit "diell, det dhe rërë".
- Vlerësimi i manastireve dhe i vendeve arkeologjike (ende për t'u gërmuar plotësisht).
- Qëndrueshmëria e turizmit, gjithashtu në lidhje me cilësinë e jetës së banorëve.

Seminari 3

Çështjet sociale

- Fuqizimi i grave – projekt-propozimet për të rritur punësimin e grave: ngritja e një sipërmarrjeje artizanale në Sarandë për të prodhuar suvenire artistike për turistët; rikthimi i eksperiencave të kaluara në bizneset e përpunimit të ushqimit (frutat, furrat e bukës etj.) që gjenden në zonat rurale; përcaktimi i programeve të punësimit në sektorin e mirëmbajtjes së hapësirave publike; nxitja e projekteve të turizmit familjar; ngritja e një qendre ndihme për gratë (viktima të dhunës, persona të pafavorizuar, të kthyerat nga emigracioni etj.).
- Kujdesi për shëndetin mendor – projekt-propozimi: ngritja e një qendre rehabilitimi.
- Shërbimet për të moshuarit – projekt-propozimet: përmirësimi i përkujdesjes në shtëpi; përmirësimi i trajnimeve profesionale; ngritja e "shkollave tradicionale" ose e "shkollave artizanale" për t'i dhënë vlera njohurive dhe aftësive të të moshuarve, me qëllim trashëgiminë e tyre të brezave të rinj dhe për të nxitur ngritjen e sipërmarrjeve artizanale, që të mbështeten nga AULEDA.
- Mbrojtja e fëmijëve – projekt-propozimet: transformimi i qendrës rezidenciale për fëmijët në Sarandë në një shtëpi strehimi të përkohshme për t'u kujdesur për fëmijët, nënat e të cilëve janë të punësuar në sektorët e turizmit ose të agrobiznesit; ngritja e këndeve të lojërave; "Plani strategjik në favor të fëmijëve".
- Integrimi social i minoritetit Rom – projekt-propozimi: integrimi në shkollë i fëmijëve romë dhe ndërgjegjësimi i familjeve të tyre.
- Shërbimet shëndetësore – projekt-propozimet: përmirësimi i spitalit të Sarandës dhe blerja e pajisjeve të reja; ngritja e një materniteti; trajnimi i specialistëve të rinj; adaptimi me standardet e BE-së për shërbimet shëndetësore; ngritja e qendrave shëndetësore komunitare në komunat e vogla.




Seminari 4

Prodhimet agroushqimore dhe zgjerimi i larmisë së aktiviteteve rurale

- Monitorimi dhe administrimi i ujit për të parandaluar përmytjet.
- Zgjerimi i personelit të specializuar dhe i infrastrukturës në sektorin e veterinarisë.
- Prodhimet e drejtpërdrejta drejt standardeve të cilësisë për t'i bërë ato të përshtatshme për eksport.
- Kualifikimi i sektorit për kultivimin e midhjeve dhe ndërtimi i impianteve që lidhen me përpunimin e ushqimit.



- Zhvillimi i sektorit të peshkimit.
- Përmirësimi i diferencimit, paketimit dhe tregtimit të produkteve vendase.

Në fund të ditës u mbajt një diskutim plenar, për të nxjerrë përfundimet e takimeve: fjalët kyçe që u identifikuan në dy seminarët e para ishin "ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet", "koordinimi", "rrjeti rrugor", "lumenjtë", "territori" dhe "menaxhimi i mbetjeve", ndërsa tek dy të tjerat fokusi ishte te integrimi social i personave të pafavorizuar dhe orientimi i prodhimeve vendase drejt standardeve të cilësisë, me qëllim nxitjen e eksportit ndërkombëtar.

**STRATEGIC PLANNING
OF VLORA REGION**

"TOWARDS SUSTAINABLE DEVELOPMENT"

DITE E HAPUR | OPEN DAYS

Nentor 2010 | November 2010

SEMINARE TEMATIKE

Prodhimet bujqesore dhe diversifikimi i aktiviteteve rurale

THEMATIC WORKSHOP

Agro-food production and diversification of rural activities

Prodhime agro-ushqimore të cilësisë së lartë: certifikimi, markat

Mungesë prodhimi dhe rrjete shpërndarjesh





Shoqatat e prodhuesve

Turizmi rural i qëndrueshëm


Kurse kualifikimi dhe mundësi punësimi në sektorët e bujqësisë, marketimit, përpunimit ushqimor, marketingut dhe turizmit rural

Infrastruktura prodhuese

- High-quality agro-food products: certification and brands
- Short production & distribution chains
- Producers' associations
- Sustainable rural tourism
- Innovative vocational training and job opportunities in the sectors of agriculture, breeding, food processing, marketing, rural tourism
- Infrastructure for production

Një nga broshurat e përgatitura për Ditët e Hapura që rendit temat e diskutimit të Seminarit 4

UNDP ARTGOLD 2 Albania www.artgold.undp.org.al **AGA2** |  **AULEDA** www.auleda.org



Sipër: Karta e aktivitetit e përgatitur për Ditët e Hapura
Poshtë: Dy momente nga tryeza e rumbullakët me ekspertët dhe nga Debatet Publike në Vlorë

Debatet publike

14-15 Dhjetor 2010

Rezultatet e Ditëve të Hapura udhëhoqën përgatitjet e një drafti të Vizionit dhe Strategjisë për zhvillimin rajonal.

Debatet publike i organizuar në dhjetor dhe tavolina e rumbullakët e mëparshme me një panel ekspertësh dhe intelektualësh të zgjedhur nga Këshilli Rajonal, ishin rastet për të paraqitur draftin dhe për të diskutuar si dhe për ta rishikuar atë me aktorët territorialë, duke mbledhur njëkohësisht opinione dhe propozime të dobishme për ndjekjen e procesit.

Të dy takimet përfshinë prezantimin e statusit aktual të procesit të planifikimit strategjik dhe paraqitjen e draftit të Vizionit, Udhëzuesit Strategjikë dhe Veprimet për zhvillimin rajonal.

Objektivi ishte nxitja e pjesëmarrësve të jepnin komente dhe vërejtje për Vizionin, Udhëzuesit Strategjikë dhe për Veprimet.



what happens now: DUKE VENDOSUR STRATEGJINE

Diskutimet kanë si qëllim ndajen dhe rishikimin e nje hipoteze strategjike per zhvillimin rajonal

1 Vizioni: Qarku i Vlores si nje "Zero Emission Territory"

9 Udhëzime Strategjike:

- Komuniteti bazuar tek turizmi
- Produktet tipike rurale dhe handicraft
- Peshkim dhe akuakulturë
- Arsimi dhe trajnimi
- Rritja e trashëgimisë kulturore rajonale
- Mjedisi dhe ruajtja e rehabilitimi i paisazhit
- Rrjetet materiale e jomateriale dhe energjia
- Përfshirja sociale dhe adolleshentëve

what happened so far: SKENARIOS

Analizet e kryera takimet e mbajtura ne kuader te procesit te planifikimit strategjik kane mundesuar identifikimin e 3 skenareve te mundshem per zhvillimin rajonal.

**SKENARI 1.
ZHVILLIMI I TURIZMIT**

**SKENARI 2.
ZHVILLIMI RURAL DHE AGRO-BIZNESI**

**SKENARI 3.
SHEBIME, RRJETE DHE INDUSTRI E LEHTE**

**SCENARIO 1.
TOURISM DEVELOPMENT**

**SCENARIO 2.
RURAL DEVELOPMENT AND AGRO-BUSINESS**

**SCENARIO 3.
SERVICES, NETWORKS AND LIGHT INDUSTRY**

PLANIFIKIMI STRATEGJIK QARKU VLORE
"Drejti nje Zhvillimi te Qendrueshem"
STRATEGJIC PLANNING VLORE REGION
"Towards Sustainable Development"
PUBLIC DEBATE
to discuss the regional development strategy
December 2010
DEBAT PUBLIK
per diskutimin e strategjise se zhvillimit rajonal
Dhjetor 2010

KONTAKTE

UNDP ARTGOLD 2 Albania
tel./fax +355 4 2373913
website: www.artgold.undp.org.al

AULEDA
tel./fax +355 33 222664
e-mail: auledavlore@yahoo.com
website: www.auleda.org

CONTACTS

UNDP ARTGOLD 2 Albania
tel./fax +355 4 2373913
website: www.artgold.undp.org.al

AULEDA
tel./fax +355 33 222664
e-mail: auledavlore@yahoo.com
website: www.auleda.org

VIZIONI: QARKU I VLORËS SI NJE "ZERO EMISSION TERRITOR" - ZET

UDHËZIME STRATEGJIKE DHE VEPRIME

1. Komuniteti bazuar tek turizmi

- 1.1. Komunikimi turistik dhe luajtimi i marketingut
- 1.2. Kualifikimi dhe diversifikimi i strukturave të akomodimit
- 1.3. Verësimi dhe integrimi i identiteteve kulturore dhe i burimeve paisazhike dhe mjedisore për zhvillimin e turizmit dhe diferencimin e tij
- 1.4. Përmirësimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve për turizmin

2. Produktet tipike rurale dhe artizanati

- 2.1. Promovimi i produkteve tipike dhe luajtimi i konkurrencës të bazuar në cilësi për eksport
- 2.2. Inkuajtimi grupimit të prodhuesve
- 2.3. Stimulimi dhe mbështetje në aksesin e kredive të ndërmarrjeve për fermerët, dëgjuesit, artizanët

3. Peshkim & akuakulturë

- 3.1. Finalizimi dhe verësimi i zvizhrit të vlerës së prodhuesve të peshkut
- 3.2. Ruajtja e ekosistemeve të lagunave
- 3.3. Fuqizimi i poveve teknike dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara të ankimit
- 3.4. Racionalizimi dhe luajtimi i prodhimit dhe integrimi i infrastrukturës në një vizion të integruar

4. Arsimi & trajnimi

- 4.1. Verësimi të asimit ekzistues dhe aktivitetet trajnuese duke forcuar lidhjet e tyre me sferat e tregut dhe ndërkombëtare
- 4.2. Fuqizimi i qasjes në arsim dhe trajnim përmasë financiare dhe bursave
- 4.3. Fuqizimi i promovimit dhe integrimi i ndërkombëtar të trajnimit dhe shkëmbimit
- 4.4. Edukimi dhe trajnimi personal ekspert në planifikim dhe krijim e shogjate
- 4.5. Fuqizimi i Arsimi dhe trajnimit në sektorët krye të zhvillimit rajonal

5. Rritja e trashëgimisë kulturore rajonale

- 5.1. Njohje, ruajtje, restaurimi dhe kualifikimi e aseteve historike, nëpërmjet menaxhimit inovativ dhe krijimit e rrjetëve të integruara
- 5.2. Fuqizimi i zotërimit të vlerës letrare dhe produktit kulturor dhe të trashëgimisë, duke përfshirë zejtaritë artike, muzikë tradicionale dhe artin bashkëkohor

6. Mjedisi dhe ruajtja e rehabilitimi i paisazhit

- 6.1. Mbrojtja dhe zhvillimi i qendrueshëm i zonave natyrore dhe paisazheve si dhe ruajtjen e biodiversitetit
- 6.2. Ruajtja e burimeve të ujit dhe menaxhimi i caktit të ujit
- 6.3. Menaxhimi i rreko-jeoqendueshmëri i mbeturinave të ngurta
- 6.4. Mbrojtja e territorit nga rreziku hidrogeologjik

7. Rrjetet materiale e jomateriale dhe energjia

- 7.1. Rritja e rrjetëve të transportit për të përmirësuar aksesin territorial dhe konkurrencën, në kuadër të projektit të Korridorit VIII
- 7.2. Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)
- 7.3. Promovimi i energjisë së rinovueshme dhe i kursimit të energjisë

8. Përfshirja sociale

- 8.1. Forcimi i integritetit social dhe lufta ndaj varfërisë përmes programeve të ndihes së punësimit
- 8.2. Përmirësimi dhe shërbime të reja për kujdesin social
- 8.3. Përmirësimi i shërbimeve publike shëndetësore
- 8.4. Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit lokal në politikë e zhvillimit rajonal

9. Plani strategjik i fëmijëve dhe adolleshentëve

- 9.1. Promovimi i autonomisë së fëmijëve
- 9.2. Promovimi i pjesëmarrjes aktive të fëmijëve dhe adolleshentëve në planifikimin urban dhe menaxhimin
- 9.3. Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe adolleshentëve në aktivitetet sociale dhe kulturore dhe në zhvillimin e trashëgimisë kulturore
- 9.4. Përmirësimi i qendrueshmërisë së mjedisit dhe i cilësisë urbane në qytete dhe fshata

Dy anët e broshurës së përgatitur për të mbështetur diskutimin në Debatin Publik në Dhjetor

Debatet publike

Përfundimet dhe rezultatet e arritura

Tavolina e rrumbullakët me intelektualë dhe ekspertë dhe takimi i mëpasshëm për konsultim publik përfshinë afërsisht 100 persona (36 për tavolinën e rrumbullakët me ekspertë, 61 për konsultim publik).

Gjatë takimeve, Vizioni dhe Strategjia të propozuara për zhvillimin rajonal u ndanë mes tyre dhe u aprovuan gjerësisht. Proçesi i planifikimit strategjik mori një feedback shumë pozitiv: të gjithë aktorët territorialë e vlerësuan faktin se drafti i strategjisë për zhvillim mori në konsideratë dhe përfshiu të gjitha sugjerimet dhe propozimet që vinin nga komuniteti lokal dhe që u diskutuan gjatë takimeve të mëparshme.

Stafi rajonal tregoi një zotërim në rritje të PS-së dhe u theksua përputhshmëria ndërmjet Strategjisë së propozuar dhe objektivave të qeverisë kombëtare.

Nevoja për njohjen e draftit të strategjisë nga të gjitha bashkitë rajonale ishte një nga çështjet që lindi nga diskutimi: çdo bashki duhet të ketë një grup të krijuar për të kontribuar te drafti i Strategjisë me anë të studimeve dhe projekteve. Aprovimi i ligjeve rajonale në përputhje me PS-në do të ishte një rrjedhje logjike e një proçesi të tillë.

Takimet në Vlorë theksuan gjithashtu disa nga çështjet për t'u përfshirë dhe/ose që ishin për t'u marrë më shumë në konsideratë në rishikimin e Strategjisë për zhvillimin rajonal:

- këshillohet fokusimi në portin e Vlorës dhe në porte të tjera rajonale
- kërkohet një përfshirje e fortë e Universitetit



publik të Vlorës (pra, nëpërmjet krijimit të një qendre universitare për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të detit dhe ligatinave, ose nëpërmjet fuqizimit të arsimit në universitet lidhur me sektorin e trashëgimisë kulturore)

- çështjet sociale kërkojnë më shumë vëmendje dhe një fokusim tek të moshuarit, fëmijët si dhe kërkohet një rritje e numrit të qendrave të kujdesit të përditshëm dhe e qendrave kulturore
- duhet të përcaktohen më shumë mundësi për zhvillimin industrial
- duhet të nxitet kontrolli urbanistik në zonat rurale
- duhet të rritet numri i zonave natyrore të mbrojtura, për të qenë më pranë modeleve të BE-së
- duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë mbrojtjes dhe përmirësimit të vendeve të trashëgimisë kulturore në zonat e thella, të cilat janë më të neglizhuarat
- në PS duhet të përfshihet krijimi i një rrjeti qendrash të kujdesit shëndetësor.



2.3. Vizioni për zhvillimin rajonal

Vizioni për zhvillimin rajonal është:

**Qarku i Vlorës 2020:
"Territor me Zero Emetime - ZET"**

Në vitin 2020, Qarku i Vlorës duhet të kthehet në një territor ku qëndrueshmëria të jetë në fokus në çdo sektor të aktiviteteve njerëzore dhe ku të gjitha politikat dhe nismat për zhvillim të jenë të koordinuara dhe sinergjike, duke ndikuar kështu në mënyrë pozitive në të gjithë komunitetin rajonal.

Në këtë Vizion, potencialet e fuqishme të qarkut si një destinacion turistik (trashëgimia kulturore, vendet natyrore, njerëzit mikpritës, kuzhina tradicionale, produktet tipike agroushqimore...) kanë marrë përparësi të plotë dhe janë të përmirësuara si një rrjet.

Vizioni përfaqëson një kthesë të plotë të tendencave aktuale, pasi është i bazuar në idenë se, me qëllim që të jetë vërtet tërheqës (për turistët por edhe për vendasit dhe për sipërmarrësit) një territor duhet të ofrojë pasuri kulturore dhe natyrore të mbrojtura mirë, një identitet të fortë dhe të veçantë, burime njerëzore të kualifikuara, shërbime efikase dhe kohezion social.

Modeli i zhvillimit që është ndjekur deri tani

duhet të transformohet plotësisht: Qarku duhet të refuzojë "turizmin në masë" dhe të zgjedhë për të përmbushur kërkesën globale në rritje për turizëm kulturor, eko-turizëm dhe turizëm rural. Për më tepër, me qëllim nxitjen e më shumë llojeve të qëndrueshme të turizmit, kriteret për qëndrueshmëri dhe cilësi të mjedisit duhet të zbatohen për të gjitha aspektet e territorit: akomodimi turistik, transportet, menaxhimi i mbetjeve të ngurta, menaxhimi i ujit dhe i ujit të përdorur, aktivitetet prodhuese, aktivitetet ndërtimore etj. Në këtë mënyrë, qarku mund të kthehet në një "Territor me Zero Emetime" (ZET) ku mbrojtja e mjedisit nuk është një kufizim por një mundësi për të nxitur novacionet, zhvillimin social-ekonomik dhe rritjen profesionale.

Me kalimin e kohës, kjo çon në një rritje të punësimit të kualifikuar dhe në ruajtjen e atraksioneve kryesore të qarkut, duke ruajtur dhe duke rritur fluksin e turistëve.

Duke nxitur në mënyrën e duhur të gjitha potencialet e tij, qarku mund të kthehet në një pjesë integrale të produktit turistik "Shqipëria për t'u zbuluar" e përshkruar nga Strategjia kombëtare për turizmin; ai mund të përmirësojë dhe të koordinojë ofrimin e produkteve natyrore, tradicionale dhe bio, të aktiviteteve kulturore dhe sportive, me qëllim joshjen e turistëve për të kaluar më shumë kohë në këtë qark dhe për të përjetuar plotësisht stilin vendas të jetesës.



Nga Skenarët te Vizioni Drejt ZET

Për sa i përket kalimit nga Skenarët te Vizioni, "Territori me Zero Emetime" paraqet evolucionin e skenarëve të mundshëm për zhvillim për të cilët aspirojnë aktorët rajonalë.


Proçesi për planifikim strategjik reflektoi mbi llojin e modelit të zhvillimit që qarku ka parashikuar për të ardhmen e tij dhe debatet publike theksuan gatishmërinë e aktorëve

rajonale për të zgjedhur "anën e qëndrueshme" të secilit skenar.

Në këtë kuptim, vizioni paraqet një përgjigje për pyetjen, duke shprehur zgjedhjen e qarkut për një zhvillim të qëndrueshëm.

Diagrami i mëposhtëm sintetizon rrugën që mbulohet nga skenarët për vizionin.

Kalimi nga Skenarët te Vizioni



2.4. Udhëzuesit Strategjikë dhe Veprimet

Strategjia për zhvillim rajonal konsiston në:

- **9 Udhëzues Strategjikë (US)**, që trajtojnë aspektet kryesore vendimtare të qarkut. Secili udhëzues është i nëndarë në veprime, duke llogaritur një total prej
- **33 Veprimesh**, ku secili prej tyre përfshin një numër kategorish të ndërhyrjeve, të cilat specifikojnë dhe shpjegojnë qëllimin e Veprimit.

Udhëzuesit dhe Veprimet janë përgatitur gjithashtu duke përdorur programet për akordimin e fondeve strukturore të BE-së në rajonet italiane si një model referimi. Kjo gjë u bë për të garantuar që programi për zhvillim i

qarkut të Vlorës të përputhet me standardet e Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë, PS-ja do të funksionojë si një bazë e përbashkët dhe një model për të përgatitur programet për fondet strukturore kur Shqipëria të jetë anëtare e BE-së.

9 Udhëzuesit Strategjikë janë të radhitur më poshtë.

Çështjet siç janë barazia gjinore, ligjshmëria, qëndrueshmëria sociale dhe mjedisore, etj. duhet të konsiderohen si çështje ndërsektoriale dhe qëllime të përgjithshme për të gjithë Udhëzuesit Strategjikë.

9 Udhëzuesit Strategjikë:

- ➔ **US1. Turizmi me bazë komunitetin**
- ➔ **US2. Produktet tipike rurale dhe artizanati**
- ➔ **US3. Peshkimi dhe akuakultura**
- ➔ **US4. Arsimimi dhe trajnimi**
- ➔ **US5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale**
- ➔ **US6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit**
- ➔ **US7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia**
- ➔ **US8. Përfshirja sociale**
- ➔ **US9. Plani strategjik për fëmijët dhe adoleshentët**



Udhëzuesi Strategjik 1

Turizmi me bazë komunitetin

Hyrje:

Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nëpërmjet analizave dhe vëzhgimeve ka theksuar potencialin e lartë turistik të Qarkut të Vlorës dhe vullnetin politik, në të gjitha nivelet, për të përfituar prej tij. Zhvillimi i turizmit është theksuar si një nga skenarët më të mundshëm për zhvillimin rajonal. Megjithatë, për të mbrojtur trashëgiminë mjedisore dhe kulturore (të cilat janë atraksionet turistike kryesore në qark) dhe tërheqin turistë ndërkombëtarë (të cilët presin standarde të cilësisë së lartë nga një vend që aspiron integrimin në BE) është e nevojshme të ndryshohet modeli për zhvillimin e turizmit që është ndjekur deri tani, për ta orientuar atë drejt qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale. Kjo nënkupton krijimin e një oferte turistike më të larmishme, duke futur bregun dhe zonat e thella në itineraret tematike, duke përfshirë atraksionet e ruajtura mirë si dhe akomodimin dhe shërbimet e cilësisë së lartë. Përveç kësaj, një aktivitet i efektshëm komunikimi dhe marketingu do të ishte vendimtar për suksesin e produktit turistik "Qarku i Vlorës".

Objektivi:

Zhvillimi i një produkti turistik rajonal të larmishëm që përmbush standardet evropiane të cilësisë.

Veprimet:

1.1. Shërbimet e informacionit për turistët, komunikim dhe marketing i efektshëm territorial

- Plan marketingu për territorin rajonal
- Fushata komunikimi për turistët

1.2. Kualifikimi dhe rritja e larmisë së strukturave të akomodimit

- Kualifikimi i strukturave të akomodimit nëpërmjet çertifikimit me yje
- Paketat e ndihmës për strukturën e akomodimit që synojnë çertifikimin e cilësisë
- Stimuli për organizimin e pushimeve në fshat dhe të akomodimit ku përfshihet mëngjesi në një perspektivë të qëndrueshme territoriale
- Rritja e numrit të ofertave të mikpritjes në fshat në realitete të ndryshme si një turizëm i përgjegjshëm nga ana sociale

1.3. Vlerësimi dhe integrimi i identiteteve kulturore, e peizazhit dhe e burimeve mjedisore për zhvillimin dhe diferencimin turistik

- Ndërtimi i rrugëve sportive dhe i ambienteve për zhvillimin e ofertave të ndryshme turistike
- Vlerësimi dhe promovimi i artizanatit tipik vendas
- Krijimi i rrugicave dhe i ambienteve natyrore
- Krijimi i itinerareve "verë dhe ushqim"
- Krijimi i paketave të integruara turistike: strukturat e akomodimit dhe produktet tipike për të nxitur cilësinë e jetës rurale nëpërmjet marketingut territorial dhe kulturor
- Vlerësimi i funksionit social dhe terapeutik të mjedisit dhe të ritmit të jetesës në fshat për problemet sociale

1.4. Përmirësimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve për turizmin

- Përmirësimi i aksesit në resortet turistike nëpërmjet krijimit të shoqatës së transportit turistik
- Krijimi i pikave kufitare tokësore dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara pranë moleve në fshatrat bregdetare
- Rindërtimi dhe restaurimi i ish-ndërtesave shtetërore për t'i kthyer në struktura turistike

Udhëzuesi Strategjik 2

Produktet tipike rurale dhe artizanati

Hyrje:

Analizat dhe vëzhgimet e kryera kanë theksuar lidhjen e sektorit agroushqimor në qark, si dhe ekzistencën e produkteve vendase dhe të zinxhirëve të vlerave me potencial konkurrues (vaj ulliri, bimët, punime artizanale prej tekstilësh, etj.). Përmirësimi i këtyre burimeve është vendimtar për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, pjesa më e madhe e të cilave janë të varfra, të izoluara dhe të prekura nga emigracioni dhe nga rrallimi i popullsisë. Udhëzuesi Strategjik 2 ndërhyr në aspektet kryesore vendimtare të sektorit kryesor rajonal, që është theksuar gjithashtu gjatë konsultimeve publike: zinxhirët e paplotë të vlerave, mungesa e politikave për çertifikimin e cilësisë dhe sipërmarrjet me përmasa të vogla, duke shkaktuar akses të vështirë në kredimarrje, tregje dhe teknologji.

Objektivi:

Përforcimi i sektorit agroushqimor duke diferencuar burimet e të ardhurave, duke nxitur krijimin e shoqatave të prodhuesve, duke zhvilluar zinxhirët e vlerave dhe duke rritur cilësinë e produkteve.

Veprimet:

2.1. Promovimi i produkteve tipike dhe rritja e produkteve cilësore për qëllime eksporti

- Integrimi i produkteve tipike në paketat turistike për një vlerësim territorial
- Promovimi i politikave të markave dhe nxitja e pjesëmarrjes së fermerëve në sistemet e cilësisë së ushqimit për arritjen e çertifikimit të cilësisë
- Mbështetja e modernizimit të fermave, teknikave dhe sistemeve të prodhimit
- Finalizimi dhe vlerësimi i zinxhirëve të vlerave
- Përmirësimi dhe vlerësimi i produkteve tipike
- Rikuperimi i teknikave tradicionale të prodhimit
- Nxitja dhe mbështetja e shoqatave të artizanëve dhe zhvillimi i tregjeve artizanale ku artizanët riprodhojnë teknikat tradicionale të prodhimit artizanal
- Lehtësimet për shoqatat e sipërmarrjeve që të mund të marrin pjesë në ekspozitat dhe galeritë kombëtare dhe ndërkombëtare
- Përfshirja e kontrollit të cilësisë, e sigurisë dhe e sistemit të çertifikimit të sigurisë ushqimore (HACCP)
- Rikuperimi i peizazhit tradicional bujqësor dhe i elementeve kulturore
- Komunikimi dhe promovimi i produkteve tipike bujqësore
- Krijimi i një shporte tipike me produkte që përfaqëson traditën lokale

2.2. Nxitja e grupimit të prodhuesve

- Realizimi dhe përmirësimi i infrastrukturave të nevojshme për prodhime tipike bujqësore të ndërmarra nga shoqatat e sipërmarrjeve
- Nxitja e shoqatës së sipërmarrjeve nëpërmjet informacionit, ndihmës dhe paketave të trajnimit

2.3. Nxitja dhe mbështetja e aksesit të sipërmarrjeve në kredimarrje për fermerët, mbarështuesit dhe artizanët

Udhëzuesi Strategjik 3

Peshkimi dhe akuakultura

Hyrje:

Zgjerimi i zonës bregdetare dhe ekzistenca e tre lagunave (Narta, Orikumi, Butrinti) së bashku me habitatet e tyre natyrore dhe me aktivitetet ekonomike (më së shumti peshkimi në det dhe kultivimi i butakëve) janë burime të rëndësishme të cilat ende nuk janë përdorur plotësisht për zhvillimin e Qarkut të Vlorës. Strategjia përfshin në këtë mënyrë jo vetëm mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre mjedisve natyrore apo përmirësimin e vijës bregdetare dhe të turizmit natyror, por gjithashtu zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve bregdetare dhe të ligatinave për të zbatuar sistemet e akuakulturës ose për të zhvilluar shërbimet e integruara të ankorimit, për të mbështetur turizmin.

Objektivi:

Përforcimi i sektorit të peshkimit dhe të akuakulturës, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës dhe të kualifikimit të produkteve në një perspektivë mjedisore të qëndrueshme.

Veprimet:

3.1. Finalizimi dhe vlerësimi i zinxhirëve të vlerave për produktet e peshkut

- Nxitja e shoqatës së sipërmarrjeve për ruajtjen e peshkut, nëpërmjet informacionit, ndihmës dhe paketave të trajnimit
- Mbështetja e arritjes së sigurisë dhe e çertifikimit të sigurisë ushqimore
- Krijimi, vlerësimi dhe promovimi i atyre markave me vlerë të shtuar të lartë, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe me ruajtjen e energjisë
- Zhvillimi i kultivimit lokal të butakëve dhe përmirësimi i sigurisë së produkteve dhe promovimi i tipikes që synon eksportimin

3.2. Ruajtja e ekosistemeve të lagunës

- Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i ligatinave
- Përmirësimi i ndërgjegjësimit mbi mjedisin te njerëzit që jetojnë dhe punojnë në ligatina

3.3. Rinovimi i pikave kufitare tokësore dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara të ankorimit

- Zhvillimi i infrastrukturës për të lehtësuar aktivitetet e peshkimit
- Zhvillimi i mjeteve dhe i shërbimeve për të përmirësuar turizmin e peshkimit dhe ekoturizmin detar

3.4. Racionalizimi dhe përforcimi i sistemit të infrastrukturës për të mbështetur prodhimin me një vizion të integruar

- Realizimi i infrastrukturës për të mbështetur peshkimin dhe kultivimin e butakëve, i ndërmarrë nga peshkatarët dhe nga shoqatat e prodhuesve
- Zhvillimi i mjeteve të shitjes dhe të marketingut

Udhëzuesi Strategjik 4

Arsimimi dhe trajnimi

Hyrje:

Proçesi i pjesëmarrjes theksoi kërkesën e fortë për një sistem arsimimi dhe trajnimi profesional më të përmirësuar dhe më të ri, si dhe për një lidhje më të ngushtë ndërmjet eksperiencave të trajnimit dhe nevojave të tregut të punës. Arsimitimi dhe trajnimi janë baza për çdo fushë zhvillimi. Është e nevojshme të jesh konkurrues nga ana profesionale nëpërmjet përvetësimit të aftësive të reja dhe të kualifikimeve profesionale për të rritur përmbushjen e kënaqësisë së klientit dhe për t'u përballur me konkurrencën ndërkombëtare. Për më tepër, në kontekstin global, është e rëndësishme që të nxitet lëvizja e studentëve dhe shkëmbimet ndërkombëtare të trajnimeve, të cilat janë thelbësore për modelin aktual të rritjes ekonomike nëpërmjet përforsimit të financimeve, nëpërmjet bursave dhe aksesit në to.

Objektivi:

Përmirësimi i arsimimit dhe i trajnimit në të gjithë sektorët për të krijuar mundësi më të shumta dhe më të mira punësimi dhe për të përmirësuar në mënyrë të efektshme burimet territoriale.

Veprimet:

- 4.1. Vlerësimi i arsimit ekzistues dhe i aktiviteteve të trajnimit duke përforsuar lidhjet e tyre me sipërmarrjet kombëtare dhe ndërkombëtare**
- 4.2. Rritja e aksesit në arsim dhe në trajnime duke financuar studentët me të ardhura të ulëta me bursa dhe me grante**
- 4.3. Pasurimi dhe promovimi i programeve të trajnimit përmes shkëmbimit ndërkombëtar**
- 4.4. Arsimitimi dhe trajnimi synojnë krijimin e një personeli ekspert për planifikimin dhe krijimin e shoqatave**
- 4.5. Arsimitimi dhe trajnimi lidhur me sektorët kyç për zhvillimin rajonal**
 - Arsimitimi dhe trajnimi synojnë krijimin e një personeli ekspertësh në sektorin social dhe ndërkulturor dhe zhvillimin e politikave të bashkëpunimit ndërmjet punonjësve socialë
 - Arsimitimi dhe trajnimi synojnë krijimin e një personeli ekspertësh në fushën e teknologjive të reja të komunikimit dhe të informacionit
 - Arsimitimi dhe trajnimi synojnë krijimin e një personeli ekspertësh në teknologjitë bujqësore për përmirësimin e kualifikimit profesional të fermerëve
 - Promovimi dhe zhvillimi i arsimimit dhe i trajnimeve për personelin turistik

Udhëzuesi Strategjik 5

Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale

Hyrje:

Bazuar në analizat, vëzhgimet dhe përfundimet nga pjesëmarrja, Qarku i Vlorës është i pasur në trashëgimi kulturore materiale dhe jomateriale, e cila përfaqëson një atraksion të fuqishëm turistik si dhe një shprehje të identitetit dhe historisë rajonale, për ta ruajtur dhe për t'ua trashëguar brezave të ardhshëm. Megjithatë, kjo trashëgimi shpesh vuan nga neglizhenca dhe harresa: mirëmbajtja në mënyrë të koordinuar e monumenteve, restaurimi, menaxhimi dhe politikat e promovimit mungojnë (shpesh për shkak të fondeve të pamjaftueshme), sidomos në zonat e largëta dhe të thella dhe teknikat tradicionale të ndërtimit si dhe zejet po zhduken dalëngadalë. Udhëzuesi Strategjik 5 ndërhyr për të rikuperuar dhe për të rindërtuar një identitet të përbashkët rajonal, të bazuar në histori dhe traditë, për të përforcuar ndjenjën e komunitetit dhe për të tërhequr turizmin kulturor.

Objektivi:

Përmirësimi i trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale për të rritur pamjen tërheqëse territoriale, për të përforcuar kohezionin social dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së komuniteteve vendase.

Veprimet:

5.1. Njohja, ruajtja, restaurimi dhe kualifikimi i pasurive historike, nëpërmjet menaxhimit të ri dhe krijimit të rrjeteve të integruara

- Vëzhgimi, mirëmbajtja, restaurimi dhe promovimi i vendeve të trashëgimisë historike (zonat arkeologjike, kështjellat, manastiret dhe vendet e shenjta, shtëpitë historike) në rajon, duke i kushtuar vëmendje të veçantë aksesit të tyre, frytëzimit dhe menaxhimit të ri
- Ruajtja dhe restaurimi i arkitekturës tradicionale dhe i teknikave tradicionale të ndërtimit në zonat urbane dhe rurale
- Mbështetja e rritjes së vendeve dhe institucioneve që i dedikohen ruajtjes dhe transmetimit të trashëgimisë kulturore (libraritë publike, muzetë, arkivat, teatrot etj.), gjithashtu nëpërmjet zhvillimit të partneriteteve publike-private
- Mbështetja e kërkimeve dhe e novacioneve në restaurimin e monumenteve dhe në sektorin e studimeve, përhapjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore
- Përmirësimi i arsimimit në universitet, në sektorin e trashëgimisë kulturore

5.2. Përmirësimi i zinxhirëve të vlerave që lidhen me prodhimin kulturor dhe me trashëgiminë kulturore, duke përfshirë artizanatin artistik, muzikën tradicionale dhe artin bashkëkohor

- Mbështetja e sipërmarrjeve dhe e shoqatave që punojnë në sektorin kulturor, gjithashtu nëpërmjet promovimit të rrjeteve të koordinimit
- Mbështetja e krijimit të rrjeteve të biznesit që lidhen me ruajtjen, restaurimin, promovimin dhe përmirësimin e trashëgimisë kulturore (përfshirë artizanatin për restaurim, artizanatin cilësor artistik, prodhimin e instrumenteve të muzikës tradicionale, shërbimet kulturore etj.)
- Nxitja e rikuperimit dhe e transmetimit të njohurive tradicionale dhe të folklorit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfshirjes së brezave të rinj
- Mbështetja e zhvillimit dhe e përhapjes së teknologjive të reja, në fushat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore, si dhe e promovimit dhe përhapjes së njohurive
- Promovimi dhe krijimi i një rrjeti të qendrave krijuese dhe laboratorësh për të rritur prodhimin e punëve artizanale dhe artistike cilësore dhe për të rritur promovimin dhe tregtimin e tyre
- Mbështetja e aktiviteteve kulturore për të promovuar manifestimet artistike, si ato tradicionale, ashtu dhe ato bashkëkohore (iso-polifonia, muzika bashkëkohore, teatri, etj.)

Udhëzuesi Strategjik 6

Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit

Hyrje:

Qarku i Vlorës është shtëpia e peizazheve të padëmtuara dhe të larmishme (deti, ligatinat, malet, kanionet, etj), i cili përfshin atraksionet e fuqishme turistike. Nga ana tjetër, ndërtesat e pakontrolluara dhe të paligjshme, mbeturinat e pagrumbulluara, uji i ndotur i patrajtuar dhe aktivitetet e tjera njerëzore të pakufizuara kanë dëmtuar disa zona dhe tani po kërcënojnë ato të pakontaminuara. Udhëzuesi Strategjik ndërhyt në aspektet mjedisore vendimtare të territorit rajonal: zonat natyrore dhe burimet që duhen ruajtur, administrimi i mbetjeve të ngurta dhe i ujit të ndotur, paqëndrueshmëria gjeologjike, zonat e ndotura dhe të degraduara.

Objektivi:

Mbrojtja, përmirësimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Veprimet:

6.1. Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonave natyrore, i peizazheve dhe ruajtja e biodiversitetit

- Rehabilitimi i zonave me vlera të larta natyrore dhe peizazhore
- Krijimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e parqeve natyrore në nivel rajonal
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi mjedisin në komunitetet vendase
- Mbështetja e sipërmarrjeve dhe e shoqatave që punojnë në fushat për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit dhe për të rritur gjithashtu ndërgjegjësimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin
- Konsultimet, ndihma teknike dhe shërbimet për shoqatat e biznesit që synojnë të rrisin qëndrueshmërinë e tyre mjedisore (çertifikimet ISO 14000, etj.)
- Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm
- Përmirësimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonave të ndotura dhe të degraduara
- Rehabilitimi mjedisor i zonave dhe i ndërtesave joformale

6.2. Ruajtja e burimeve të ujit dhe administrimi i ciklit të qarkullimit të ujit

- Zhvillimi i sistemeve të furnizimit me ujë për të siguruar disponueshmërinë e ujit të pijshëm në të gjitha qytetet dhe fshatrat e qarkut
- Zhvillimi i sistemeve për derdhjen e ujërave të zeza dhe impiantet për trajtimin e ujit, gjithashtu nëpërmjet promovimit të teknologjive të reja pro mjedisit

6.3. Administrimi i mbetjeve të ngurta ekologjike të qëndrueshme

- Zhvillimi i infrastrukturës dhe i impianteve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve, duke i dhënë prioritet sistemeve të reja që janë pro mjedisit
- Nxitja dhe mbështetja e grumbullimit të mbetjeve në mënyrë të mëvetësishme
- Përmirësimi dhe pastrimi mjedisor i zonave të kontaminuara nga mbetjet
- Mbështetja e zhvillimit të zinxhirëve të vlerave në sektorin e riciklimit të mbetjeve, gjithashtu duke stimuluar krijimin e sipërmarrjeve që përpunojnë materiale nga grumbullimet e mëvetësishme

6.4. Mbrojtja e territorit nga rreziku hidrogjeologjik

- Rritja e sigurisë në zonat që janë nën ndikimin e paqëndrueshmërisë gjeologjike
- Krijimi i sistemit të kërkimit dhe të monitorimit, që synon ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e territorit

Udhëzuesi Strategjik 7

Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia

Hyrje:

Përmirësimi i rrjeteve të transportit është njohur nga pjesa më e madhe e aktorëve territorialë si një veprim paraprak për çdo lloj zhvillimi rajonal. Përmirësimi i aksesit territorial përbën kushtin e nevojshëm për përmirësimin e lëvizjes së mallrave dhe të njerëzve, ndërkohë që zhvillimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (veçanërisht një lidhje interneti e shpejtë) paraqet një instrument të pashmangshëm për të zhvilluar dhe ndërkombëtarizuar biznesin. Udhëzuesi Strategjik 7 gjithashtu trajton zhvillimin e nevojshëm të rrjeteve të furnizimit me energji elektrike, duke i kushtuar vëmendje të veçantë energjive të rinovueshme, të cilat përfaqësojnë një risi thelbësore dhe një tendencë bashkëkohore për të ruajtur burimet mjedisore.

Objektivi:

Fuqizimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve për njerëzit, mallrat, fuqizimi i informacionit dhe i transportimit të energjisë.

Veprimet:

7.1. Fuqizimi i rrjeteve të transportit për të përmirësuar aksesin territorial dhe konkurrencën, në kuadrin e projektit Korridori VIII

- Përfundimi dhe përmirësimi i rrjetit të rrugëve, përfshirë rrugët rurale
- Përmirësimi i lidhjeve ndërmjet rrjeteve të rrugëve dhe të hekurudhave, porteve dhe aeroporteve
- Përmirësimi i aksesit të huajve në qark, gjithashtu nëpërmjet fuqizimit të pikave lidhëse infrastrukturore (portet, aeroportet, etj.)
- Përmirësimi i shërbimeve të transportit publik, gjithashtu për të nxitur zhvillimin e turizmit
- Promovimi i planit të lëvizjes
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve për një transport të qëndrueshëm (korsitë për biçikletat, etj.)

7.2. Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK)

- Zhvillimi i rrjeteve të brezit të gjerë me valë për të zbutur izolimin e zonave rurale dhe atyre të thella
- Përmirësimi i efikasitetit të rrjeteve ekzistuese të TIK-ut
- Përmirësimi i njohurive dixhitale, i aftësive dhe i përfshirjes në komunitetet vendase, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fshatrave dhe zonave të thella
- Nxitja e përhapjes së TIK-ut në sipërmarrjet lokale për të përmirësuar konkurrencën e tyre dhe ndërkombëtarizimin

7.3. Promovimi i energjisë së rinovueshme dhe i kursimit të energjisë

- Përmirësimi dhe monitorimi i hidrocentraleve dhe i rrjeteve të furnizimit me energji
- Nxitja e prodhimit të energjisë së rinovueshme, gjithashtu nëpërmjet zhvillimit të zinxhirëve të vlerave në sektorin e burimeve të energjisë së rinovueshme
- Promovimi dhe mbështetja e rritjes së efikasitetit të energjisë dhe reduktimi i emetimeve klimatike, sidomos në industri, transport dhe në sektorët e ndërtimit
- Promovimi i ndërtesave ekologjike dhe stimujve për përshtatjen e ndërtesave ekzistuese me kriteret e ndërtesave pro mjedisit

Udhëzuesi Strategjik 8

Përfshirja sociale

Hyrje:

Analizat e kryera në territor theksuan prezencën e një segmenti të madh të popullsisë që është viktimë e përjashtimit social dhe dëshmuar për një mungesë të shërbimeve ndihmëse dhe të një barazie gjinore të pamjaftueshme. Me qëllim mbështetjen e zhvillimit ekonomik të qarkut, është e rëndësishme nxitja e luftës kundër papunësisë, nëpërmjet trajnimeve profesionale, rikualifikimeve dhe zëvendësimeve dhe rritja e integritit të rinjve dhe grave në tregun e punës. Informacioni i mbledhur nëpërmjet takimeve publike gjithashtu theksoi nevojën për përmirësimin e shërbimeve për të moshuarit. Për më tepër, Udhëzuesi Strategjik 8 trajton mungesën e shërbimeve të shëndetit publik dhe aksesin e vështirë për të marrë ndihmën e parë shëndetësore, gjithashtu për shkak të mungesës së aksesit në disa pjesë të territorit.

Objektivi:

Përmirësimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve për të përforcuar kohezionin social dhe për të rritur përfshirjen e popullsisë së pafavorizuar.

Veprimet:

8.1. Përforsimi i integritit social dhe lufta kundër varfërisë nëpërmjet programeve të punësimit

- Promovimi i programeve të punësimit
- Promovimi i politikave për barazi gjinore dhe fuqizimi i grave për t'i integruar ato më mirë në tregun e punës
- Eksperimentimi i programeve të integruara për orientimin, mbështetjen dhe punësimin e grupeve të pafavorizuara (gratë viktime të dhunës, personat me aftësi të kufizuara, etj.)

8.2. Përmirësimi dhe rinovimi i shërbimeve të kujdesit social

- Zhvillimi i partneriteteve dhe i marrëveshjeve në shumë nivele ndërmjet aktorëve socialë për të përmirësuar mundësitë për punësim dhe shërbimet e përkujdesjes sociale, pra nëpërmjet krijimit të organeve të përhershme të koordinimit
- Promovimi i shoqatave jofitimprurëse dhe përforsimi i punësimit në sektorin social-ekonomik
- Krijimi i strukturave për të siguruar shërbimet e përkujdesjes sociale për grupet e pafavorizuara (personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, fëmijët, gratë etj.)
- Sigurimi i shërbimeve për të mbështetur gratë e punësuar (zgjerimi i qendrave të kujdesit të përditshëm etj.)
- Promovimi i programeve sociale të strehimit për personat e pafavorizuar, në bashkëpunim me programet e punësimit
- Përmirësimi i qendrave për të moshuarit dhe ngritja e "shkollave të Traditës dhe Zejeve" për të vlerësuar njohuritë e të moshuarve dhe për të nxitur marrëdhëniet ndërmjet brezave

8.3. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore publike

- Përmirësimi i qendrave mjekësore rajonale, gjithashtu nëpërmjet kualifikimit të shërbimeve dhe furnizimit me pajisje
- Rritja e numrit të qendrave shëndetësore komunitare, për të siguruar aksesin e ndihmës së parë shëndetësore për të gjithë popullsinë rajonale
- Krijimi i një rrjeti të qendrave të kujdesit shëndetësor

8.4. Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve vendase në politikat e zhvillimit rajonal

- Përfshirja e praktikave pjesëmarrëse në krijimin e programeve dhe projekteve për zhvillim
- Zbatimi dhe optimizimi i planeve, i programeve dhe i projekteve të përgatitura nëpërmjet pjesëmarrjes dhe shpërndarja e rezultateve të arritura

Udhëzuesi Strategjik 9

Plani Strategjik për fëmijët dhe adoleshentët

Hyrje:

Gjatë debateve publike, aktorët territorialë theksuan mungesën e hapësirave publike ku fëmijët dhe adoleshentët mund të krijojnë marrëdhënie shoqërore, siç janë këndet e lojërave, zonat me gjelbërim ose ambientet sportive publike. Ky Udhëzues strategjik bazohet në konceptin se fëmijët dhe adoleshentët përfaqësojnë të ardhmen e komunitetit rajonal, prandaj dhe është e rëndësishme që të kujdesemi për mirëqenien e tyre, për sigurinë dhe arsimimin dhe t'i inkurajojmë ata që të marrin pjesë në jetën e komunitetit për t'i përgatitur për përgjegjësitë që do të kenë në të ardhmen. Prandaj dhe Udhëzuesi Strategjik 9 fokusohet në përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve, duke i kushtuar vëmendje në mënyrë të veçantë arsimimit të tyre, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi mjedisin dhe i nxit ata të zbulojnë trashëgiminë kulturore të vendit të tyre.

Objektivi:

Përmirësimi i rolit të fëmijëve dhe të adoleshentëve në qeverisjen rajonale dhe në jetën sociale, si parametra dhe garantues të të gjitha nevojave të qytetarëve.

Veprimet:

9.1. Promovimi i autonomisë së fëmijëve

- Optimizimi i ndërtesave dhe zonave arsimore, për të rritur aksesin në to gjithashtu jashtë orarit mësimor
- Ngritja dhe mirëmbajtja e këndeve të lojërave të sigurta
- Përgatitja e planeve për trafikun dhe lëvizjen, duke përfshirë krijimin e rrjeteve të zonave dhe rrugicave të mbrojtura për këmbësorët dhe përdorimi i sinjaleve rrugore për fëmijët
- Përmirësimi i transportit publik për shkollat
- Heqja e barrierave arkitekturore të ndërtesave për përdorim publik, në trotuare, në zonat për këmbësorët dhe në mjetet e transportit publik

9.2. Nxitja e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve dhe adoleshentëve në planifikimin dhe administrimin urban

- Nxitja e formave të pjesëmarrjes, konsultimeve dhe diskutimeve siç janë ato të Këshillit të fëmijëve ose të Planifikimit të përfshirjes së drejtpërdrejtë (gjithashtu për të vlerësuar nevojat dhe kërkesat) dhe shpërndarja e rezultateve të arritura
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve në popullsinë rajonale

9.3. Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në aktivitetet sociale dhe kulturore dhe në zbulimin e trashëgimisë kulturore

- Nxitja e përdorimit të hapësirave publike për të krijuar marrëdhënie shoqërore, gjithashtu nëpërmjet ngritjes së ndërtesave shumëpërdorimëshe, në zonat urbane dhe në fshatra
- Nxitja e ndërhyrjeve që synojnë adaptimin e shërbimeve dhe strukturave publike për t'iu përshtatur nevojave të fëmijëve
- Promovimi i stimujve socialë dhe kulturorë që i adresohen fëmijëve dhe/ose adoleshentëve
- Ngritja dhe/ose fuqizimi i bibliotekave publike

9.4. Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe i cilësisë urbane në qytete dhe fshatra

- Promovimi i aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin mbi mjedisin, për të përhapur njohuritë rreth zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të nxitur sjelljet pro mjedisit
- Rehabilitimi i shkollave sipas kritereve të qëndrueshmërisë mjedisore
- Rritja e sigurimit dhe e cilësisë së ambienteve publike sportive, i zonave me gjelbërim dhe i hapësirave publike

2.5. Sinergjitë ndërmjet Udhëzuesve Strategjikë


Koherenca e brendshme e Planit Strategjik

Udhëzuesit Strategjikë të identifikuar janë shumë sinergjikë ndërmjet tyre.

Matrica në faqen tjetër përmban një vlerësim cilësor të nivelit të tyre të sinergjisë, ndërkohë që tabelat e mëposhtme sigurojnë, për secilin Udhëzues Strategjik, një shpjegim të gjerë të arsyeve që kanë çuar në këtë vlerësim.

Për sa i përket nivelit të sinergjisë (i lartë, mesatar, i ulët) i cili mund të zhvillohet ndërmjet Udhëzuesve Strategjikë, vlerësimi i tij është bërë duke marrë në konsideratë tre lloje ndërlidhjesh në rritje:

- **sinergji e ulët:** Udhëzuesit Strategjikë ndajnë vetëm të njëjtin qëllim të përgjithshëm (për shembull, rritjen e atraksionit turistik të Qarkut);
- **sinergji mesatare:** Udhëzuesit Strategjikë ndajnë të njëjtat qëllime të përgjithshme dhe të paktën një veprim/kategori e ndërhyrjes së Udhëzuesit strategjik mund të zbatohet në koordinim me Udhëzuesin tjetër strategjik;
- **sinergji e lartë:** Udhëzuesit Strategjikë janë shumë të ndërvarur dhe materialisht të lidhur, pasi ata ndajnë të njëjtën zonë të ndërhyrjes, aktivitetin e përfshirë ose grupin përfitues.



Matrica e sinergjisë së Udhëzuesve Strategjike për zhvillimin e Qarkut të Vlorës	Turizmi me bazë komunitetin	Produktet tipike rurale dhe artizanati	Peshkimi dhe akuakultura	Arsimimi & trajnimet	Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	Përfshirja sociale	PS-ja për fëmijët dhe adoleshentët
	US1	US2	US3	US4	US5	US6	US7	US8	US9
US1	Turizmi me bazë komunitetin	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●	●●
US2	Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●	●
US3	Peshkimi dhe akuakultura	●●●	●●●	●●●	●	●●●	●●●	●●	●
US4	Arsimimi dhe trajnimi	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●	●●●	●●●
US5	Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●●	●●●	●	●●●	●●●	●●	●●●	●●
US6	Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
US7	Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●●	●●●	●●●	●●	●●●	●●●	●●	●●●
US8	Përfshirja sociale	●●	●●	●●	●●●	●●●	●●	●●	●●●
US9	PS-ja për fëmijët dhe adoleshentët	●●	●	●	●●	●●●	●●●	●●●	●●

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 1

Turizmi me bazë komunitetin

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●●	Një nga objektivat e US1 është zgjerimi i larmisë së mundësisë që ofron turizmi, gjithashtu nëpërmjet promovimit të turizmit rural, krijimit të strukturave të akomodimit në zonat rurale (Veprimi 1.2) dhe e rrugëve turistike, duke u bazuar në produktet agrourbanore (Veprimi 1.3). Përmirësimi i produkteve tipike agrourbanore dhe artizanale është një pjesë thelbësore e vlerësimit të identitetit dhe kulturës lokale, të cilat janë atraksione të fuqishme për turistët, sidomos për ata që janë të gatshëm të zbulojnë të gjitha aspektet e një territori, duke mësuar për kuzhinën lokale, duke blerë produkte tipike, etj. Zhvillimi i sinergjive ndërmjet turizmit, bujqësisë dhe artizanatit mund të ndihmojë në krijimin e një "sistemi mikpritjeje", sipas parimeve europiane dhe metodologjisë ILS LEDA. Mbi të gjitha, aktivitetet artizanale dhe ato që lidhen me turizmin (përfshirë menaxhimin e strukturave të akomodimit, sigurimin e shërbimeve etj.) ofrojnë një mundësi të rëndësishme për të zgjeruar larminë e aktiviteteve rurale dhe për të garantuar burime të tjera të ardhurash për fermerët, duke ulur në këtë mënyrë varfërinë dhe marzhinalizimin.
3. Peshkimi dhe akuakultura	●●●	Turizmi i bazuar në komunitet mund të përfaqësojë një mundësi për të zgjeruar larminë e aktiviteteve prodhuese që lidhen me detin dhe ligatinat; këto ekosisteme, nëse ruhen mirë dhe vlerësohen në mënyrën e duhur, mund të kthehen në atraksione për ekoturizmin dhe komunitetet vendase mund të ofrojnë ekspertizën (njohuri mbi territorin, aftësi për të peshkuar...), shërbime (shëtitje me varkë...) dhe produkte tipike (peshk të freskët dhe midhje) për turistët për të rritur të ardhurat.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●●	Zhvillimi i një turizmi të bazuar në komunitet duhet të shoqërohet nga një trajnim i duhur i burimeve njerëzore, me qëllim që të ofrojnë shërbime sipas standardeve të BE-së si shoqëruar turistikë, si operatorë turistikë, si personel në strukturat e akomodimit, në bare dhe restorante, në ambientet zbavitëse etj. Gjithashtu, ngrija e kapaciteteve në sektorin e biznesit është i rëndësishëm në zhvillimin e sipërmarrjeve në sektorin turistik. Sistemi i arsimimit do të ketë një rol kryesor në këtë, gjithashtu duke zhvilluar lidhjet me sipërmarrjet me qëllim përmbushjen e kërkesave të tyre për trajnim, sa më shumë që të jetë e mundur.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●●	Trashëgimia kulturore është një nga atraksionet turistike kryesore në Qarkun e Vlorës, kështu që përmirësimi i saj është vendimtar në zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm bazuar në vlerat lokale. Vlerësimi dhe menaxhimi i ri i monumenteve rajonale mund të rrisë zhvillimin e turizmit kulturor, duke ndihmuar kështu zgjerimin e larmisë së mundësisë që ofron turizmi. Për më tepër, ndërtesat historike të braktisura dhe të shkatërruara mund të restaurohen për të përfshirë në to strukturat e akomodimit, shërbimet turistike, etj.
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	Mjedisi dhe peizazhi përfaqësojnë një nga atraksionet kryesore turistike në Qarkun e Vlorës. Prandaj dhe, ruajtja e tyre është thelbësore për të mbajtur dhe për të rritur fluksin e turistëve dhe për të garantuar sigurinë nga ndotja, rrëshqitjet e tokës dhe përmblytjet. Është gjithashtu e rëndësishme të rehabilitohen zonat e ndotura dhe/ose të degraduara, në mënyrë që të mos vazhdojnë të kërcënojnë shëndetin dhe të ndotin peizazhet natyrore, duke u kthyer kështu në një pengesë për zhvillimin e turizmit.
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●●	US1 dhe US7 mund të zhvillojnë sinergji shumë të forta ndërmjet tyre, pasi rrjetet janë thelbësore në zhvillimin e turizmit: një territor tërheqës për turistët duhet të jetë i pastër dhe i ruajtur mirë dhe të ofrojë komoditetet kryesore – pra, sistemet efikase të furnizimit me ujë dhe energji, trajtim të ujit të ndotur dhe administrim të mbetjeve të ngurta janë thelbësore në përmbushjen e nevojave bazë për turistët pa ndotur mjedisin dhe pa ndotur atraksionet turistike; turistët duhet të kenë mundësinë për të lëvizur të sigurt – kjo është arsyeja pse infrastruktura e transportit është gjithashtu e rëndësishme; së fundmi, zhvillimi i rrjeteve të TIK-ut është shumë i rëndësishëm, si për turistët (të cilët mund të mbledhin informacione rreth destinacionit të tyre gjithashtu gjatë udhëtimit), ashtu dhe për punonjësit turistikë (të cilët mund të promovojnë aktivitetin e tyre në internet dhe të arrijnë një treg global).
8. Përfshirja sociale	●●	US8 synon përmirësimin e shërbimeve të kujdesit social dhe shëndetësor: turistët do të përfitojnë gjithashtu nga shërbimet shëndetësore të përmirësuara; dhe një rajon me kohezion social dhe cilësi jete në rritje do të jetë më tërheqës dhe më i sigurt, edhe për turistët.
9. Plani strategjik për fëmijët dhe adoleshentët	●●	US9 synon përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike dhe të zonave me gjelbërim. Kjo gjë do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme urbane dhe për t'i bërë qytetet dhe fshatrat më tërheqëse për turistët. Për më tepër, turistët që udhëtojnë me fëmijë dhe adoleshentë do të gjejnë në Qarkun e Vlorës një territor që përmbush nevojat e tyre.

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 2

Produktet tipike rurale dhe artizanati

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●●	Një nga objektivat e US1 është zgjerimi i larmisë së mundësisë që ofron turizmi, gjithashtu nëpërmjet promovimit të turizmit rural, krijimit të strukturave të akomodimit në zonat rurale (Veprimi 1.2) dhe të rrugëve turistike, duke u bazuar në produktet agroushqimore (Veprimi 1.3). Përmirësimi i produkteve tipike agroushqimore dhe artizanale është një pjesë thelbësore e vlerësimit të identitetit dhe kulturës lokale, të cilat janë atraksione të fuqishme për turistët, sidomos për ata që janë të gatshëm të zbulojnë të gjitha aspektet e një territori, duke rënë në kontakt me kuzhinën lokale, duke blerë produkte tipike, etj. Zhvillimi i sinergjive ndërmjet turizmit, bujqësisë dhe artizanatit mund të ndihmojë në krijimin e një "sistemi mikpritjeje", sipas parimeve evropiane dhe metodologjisë ILS LEDA. Mbi të gjitha, aktivitetet artizanale dhe turistike (përfshirë menaxhimin e strukturave të akomodimit, sigurimin e shërbimeve...) ofrojnë një mundësi të rëndësishme për të zgjeruar larminë e aktiviteve rurale dhe për të garantuar burime të tjera të ardhurash për fermerët, duke ulur në këtë mënyrë varfërinë dhe marzhinalizimin.
3. Peshkimi dhe akuakultura	●●●	Peshkimi dhe akuakultura kanë shumë të përbashkëta me aktivitetet rurale: Ato janë të lidhura ngushtë me kulturën lokale, traditat, kuzhinën dhe këto të gjitha janë të ndërlidhura me peizazhin natyror (dhe kanë një rol kryesor në mirëmbajtjen e tij, ruajtjen dhe vlerësimin e qëndrueshëm) dhe të gjithë sektorët ndajnë të njëjtat probleme dhe nevoja. Që të gjitha kanë të bëjnë me sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, me dimensionin e biznesit të vogël, me aksesin e vështirë në kredimarrje dhe tregje etj. Kjo është arsyeja pse US2 dhe US3 mund të zhvillojnë sinerji me nivel të lartë, sidomos në zonat e markave territoriale, të shërbimeve të biznesit dhe të shoqatave të prodhuesve.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●●	US2 synon përmirësimin e cilësisë së produkteve rurale – kjo duhet shoqëruar me trajnimin e duhur të fermerëve dhe mbarështuesve, për t'i bërë ata të aftë të modernizojnë dhe të zgjerojnë larminë e prodhimeve, duke futur sisteme cilësore, duke zhvilluar sipërmarrjet e tyre, etj. Sistemi i arsimit do të ketë një rol kryesor në këtë aspekt, gjithashtu duke zhvilluar lidhjet me botën rurale me qëllim që të përmbushë kërkesat e tij për trajnim, sa më shumë që të jetë e mundur.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●●	Aktivitetet tipike rurale, me "njohuritë" përkatëse, zejet dhe produktet tradicionale, janë të ndërlidhura ngushtë me kulturën e komunitetit rajonal, kështu që përmirësimi i tyre, ashtu si ai i trashëgimisë kulturore, rrit pamjen tërheqëse të qarkut dhe ndihmon në rikuperimin dhe përforcimin e ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë të komunitetit rajonal. Kjo është arsyeja pse të dyja US-të përfshijnë mbështetjen e punëve artizanale artistike dhe rikuperimin e njohurive tradicionale dhe përfshijnë ndërhyrjet në zonat rurale (US5, Veprimi 5.1: ruajtja dhe restaurimi i arkitekturës tradicionale dhe e teknikave të ndërtimeve tradicionale; US2, Veprimi 2.1: rikuperimi i elementeve të kulturës tradicionale).
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●	Bujqësia ka një rol të rëndësishëm në mirëmbajtjen e peizazhit tradicional rural. Aktivitetet rurale, nëse nuk janë zhvilluar në një mënyrë të qëndrueshme, mund të kenë një ndikim negativ në mjedis, duke ndotur ujin dhe tokën me mbetje dhe pesticide dhe duke ulur biodiversitetin me përzgjedhje të papërshtatshme kulturore. Është e rëndësishme të zhvillohen sinerji të forta ndërmjet 2 Udhëzuesve Strategjikë dhe për ta bërë mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin rural që të shkojnë krahas për krahas, për të garantuar qëndrueshmërinë e përgjithshme.
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●●	Fuqizimi i rrjeteve është vendimtar për zhvillimin rural pasi: - aksesin i produkteve lokale në tregje varet shumë nga zgjerimi dhe cilësia e rrjetit rrugor; - rrjeti efikas i shërbimeve bazë (furnizimi me ujë dhe energji, trajtimi i ujit të përdorur, administrimi i mbetjeve) ndikon në mënyrë pozitive të jeta rurale dhe të kushtet e punës, si dhe ul ndotjen e shkaktuar nga aktivitetet rurale; - një sistem efikas i TIK-ut mund të ndihmojë në uljen e izolimit të komuniteteve rurale dhe për të hapur tregje të reja për produktet rurale.
8. Përfshirja sociale	●●	Decentralizimi dhe fuqizimi i shërbimeve të kujdesit social dhe shëndetësor mund të përmirësojë cilësinë e jetës në komunitetet rurale dhe mund të mbështesë në mënyrë efikase fermerët dhe familjet e tyre për të luftuar izolimin dhe varfërinë.
9. Plani Strategjik për fëmijët dhe adoleshentët	●	US9 synon përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike dhe të zonave me gjelbërim. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës në fshatrat rurale.

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 3

Peshkimi dhe akuakultura

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●●	Turizmi i bazuar në komunitet mund të përfaqësojë një mundësi për të zgjeruar larinë e aktiviteteve prodhuese që lidhen me detin dhe ligatinat; këto ekosisteme, nëse ruhen mirë dhe vlerësohen në mënyrën e duhur, mund të kthehen në atraksione për ekoturizmin dhe komunitetet lokale mund të ofrojnë ekspertizën (njohuri mbi territorin, aftësi për të peshkuar...), shërbime (shëtitje me varkë...) dhe produkte tipike (peshk të freskët dhe midhje) për turistët për të rritur të ardhurat.
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●●	Peshkimi dhe akuakultura kanë shumë aspekte të përbashkëta me aktivitetet rurale: Ato janë të lidhura ngushtë me kulturën lokale, traditat, kuzhinën dhe këto të gjitha janë të ndërlidhura me peizazhin natyror (dhe kanë një rol kryesor në mirëmbajtjen e tij, ruajtjen dhe vlerësimin e qëndrueshëm) dhe të gjithë sektorët ndajnë të njëjtat probleme dhe nevoja. Ato që të gjitha kanë të bëjnë me sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, me përmasat e biznesit të vogël, me aksesin e vështirë në kredimarrje dhe tregje, etj. Kjo është arsyeja pse US2 dhe US3 mund të krijojnë sinergji me nivel të lartë, sidomos në zonat e markave territoriale, të shërbimeve të biznesit dhe të shoqatave të prodhuesve.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●●	US3 synon përmirësimin e cilësisë së produkteve detare – kjo duhet shoqëruar me trajnimin e duhur të fermerëve dhe peshkatarëve, për t'i bërë ata të aftë të modernizojnë dhe të zgjerojnë larinë e prodhimeve, të mbrojnë mjedisin, të futin sisteme cilësore dhe të zhvillojnë sipërmarrjet e tyre, etj. Sistemi i arsimit do të ketë një rol kryesor në këtë, gjithashtu duke zhvilluar lidhjet me botën prodhuese me qëllim që të përmbushë kërkesat e tij për trajnim, sa më shumë që të jetë e mundur.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●	Peshkimi dhe akuakultura janë aktivitete tipike në Qarkun e Vlorës dhe kanë një histori njohurish, zëjesh dhe produktesh tradicionale, të ndërlidhura ngushtë me kulturën e komunitetit rajonal. Prandaj dhe përmirësimi i këtyre aktiviteteve ndihmon në rikuperimin dhe përforcimin e ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë të komunitetit rajonal, duke rritur pamjen tërheqëse të rajonit. .
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	Peshkimi dhe akuakultura kanë një rol të rëndësishëm në mirëmbajtjen e habitateve të detit dhe të ligatinave dhe këto aktivitete, nëse nuk zhvillohen në një mënyrë të qëndrueshme, mund të kenë një ndikim negativ të mjedisit, për shembull duke ulur biodiversitetin. Është e rëndësishme të krijohet sinergji të forta ndërmjet 2 Udhëzuesve Strategjikë dhe për ta bërë zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit që të shkojnë krah për krah, për të garantuar qëndrueshmërinë e përgjithshme.
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●●	Zhvillimi i rrjeteve materiale dhe jomateriale është vendimtar për zhvillimin e peshkimit dhe të akuakulturës pasi: - aksesin e produkteve lokale në tregje varet shumë nga zgjerimi dhe cilësia e rrjetit të transportit (rrugët, portet); - rrjeti efikas i shërbimeve bazë (furnizimi me ujë dhe energji, trajtimi i ujit të përdorur, administrimi i mbetjeve) ndikon në mënyrë pozitive të cilësia e jetës dhe të kushtet e punës në fshatrat bregdetare dhe mund të ulë ndotjen e shkaktuar nga aktivitetet prodhuese; - një sistem efikas i TIK-ut mund të ndihmojë për të hapur tregje të reja për produktet e peshkut të detit.
8. Përfshirja sociale	●●	Decentralizimi dhe fuqizimi i shërbimeve të përkujdesjes sociale dhe shëndetësore mund të përmirësojë cilësinë e jetës në fshatrat bregdetare dhe mund të mbështesë në mënyrë efektive peshkatarët dhe fermerët për të luftuar varfërinë.
9. Plani strategjik për fëmijët dhe adoleshentët	●	US9 synon përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike dhe të zonave me gjelbërim. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës në fshatrat bregdetare.

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 4

Arsimimi dhe trajnimi

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●●	Zhvillimi i një turizmi të bazuar në komunitet duhet të shoqërohet nga një trajnim i duhur i burimeve njerëzore, për t'i bërë ata të aftë të ofrojnë shërbime sipas standardeve të BE-së si shoqërues turistikë, si operatorë turistikë, si personel në strukturat e akomodimit, në bare dhe restorante, në ambientet zbavitëse, etj. Gjithashtu, ngritja e kapaciteteve në sektorin e biznesit është i rëndësishëm në zhvillimin e sipërmarrjeve në sektorin turistik. Sistemi i arsimit do të ketë një rol kryesor në këtë, gjithashtu duke zhvilluar lidhjet me sipërmarrjet me qëllim përbushjen e kërkesave të tyre për trajnim, sa më shumë që të jetë e mundur.
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●●	US2 synon përmirësimin e cilësisë së produkteve rurale – kjo duhet shoqëruar me trajnimin e duhur të fermerëve dhe mbarështuesve, për t'i bërë ata të aftë të modernizojnë dhe të zgjerojnë larminë e prodhimeve, duke futur sisteme cilësore, duke zhvilluar sipërmarrjet e tyre etj. Sistemi i arsimit do të ketë një rol kryesor në këtë, gjithashtu duke zhvilluar lidhjet me botën rurale me qëllim që të përbushë kërkesat e tij për trajnim, sa më shumë që të jetë e mundur.
3. Peshkimi dhe akuakultura	●●●	US3 synon përmirësimin e cilësisë së produkteve detare – kjo duhet shoqëruar me trajnimin e duhur të fermerëve dhe peshkatarëve, për t'i bërë ata të aftë të modernizojnë dhe të zgjerojnë larminë e prodhimeve, të mbrojnë mjedisin, të futin sisteme cilësore dhe të zhvillojnë sipërmarrjet e tyre, etj. Sistemi i arsimit do të ketë një rol kryesor në këtë, gjithashtu duke zhvilluar lidhjet me botën prodhuese me qëllim që të përbushë kërkesat e tij për trajnim, sa më shumë që të jetë e mundur.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●●	US4 mund të mbështesë përmirësimin e trashëgimisë kulturore rajonale, sidomos nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> - Promovimit të kërkimeve në fushën e trashëgimisë kulturore - Promovimit të zhvillimit të arsimit të lartë për restaurimin e trashëgimisë kulturore, komunikim dhe menaxhim - Përhapjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit rreth trashëgimisë kulturore, duke filluar nga shkollat.
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	Arsimimi dhe trajnimi mund të luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, në fakt ata mund: <ul style="list-style-type: none"> - Të rrisin ndërgjegjësimin e popullsisë mbi mjedisin dhe mund të nxisin sjelljet pro mjedisit, duke filluar nga fëmijët në shkolla - Të kualifikojnë kërkues shkencorë dhe profesionistë në sektorin e teknologjive pro mjedisit për administrimin e mbetjeve, në prodhimin e energjisë, në arkitekturë, inxhinieri etj.; - Të trajnojnë burimet njerëzore në fushën e çertifikimeve mbi mjedisin.
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●	Përmirësimi i arsimit dhe trajnimit është i ndërlidhur me fuqizimin e rrjeteve si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i TIK-ut është thelbësor për të zhvilluar programet e arsimit dhe trajnimit me bazë kompjuterin dhe për t'i bërë ato të disponueshme për popullsinë e gjerë - Arsimimi dhe trajnimi mund të ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dixhitale, të aftësive dhe përfshirjes, sidomos në zonat rurale dhe të thella dhe për të trajnuar ekspertët e TIK-ut (shikoni veprimin 7.2) - Përmirësimi i rrjeteve të transportit mund të jetë i dobishëm për studentët të cilët duhet të zhvendosen në qytete të tjera për të ndjekur shkollën ose universitetin.
8. Përfshirja sociale	●●●	2 Udhëzuesit Strategjikë mund të zhvillojnë sinergjitë në 3 fusha: <ul style="list-style-type: none"> - Arsimimi dhe programet e trajnimit profesional synojnë të rrisin përfshirjen sociale të grupeve të pafavorizuara duke përmirësuar autonominë e tyre dhe aftësinë e tyre për të fituar jetesën - Trajnimi profesional i punonjësve socialë, për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të përkujdesjes sociale në qark - Arsimimi dhe formimi profesional në sektorin e shëndetit, për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të përkujdesjes shëndetësore në qark në një perspektivë decentralizuese.
9. Plani Strategjik për fëmijët dhe adoleshentët	●●●	Arsimimi dhe trajnimi luajnë një rol kryesor në jetën e përditshme të fëmijëve dhe adoleshentëve. Zbatimi i US4 dhe US9 duhet të jetë i koordinuar, me qëllim: <ul style="list-style-type: none"> - Marrjen në konsideratë të nevojës së fëmijëve dhe adoleshentëve për të përmirësuar sistemin e arsimit dhe të formimit profesional dhe infrastrukturën e shkollës; - Zhvillimin e arsimit dhe të programeve të trajnimit profesional që synojnë rritjen e përfshirjes sociale të fëmijëve dhe adoleshentëve me aftësi të kufizuara duke përmirësuar autonominë e tyre.

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 5

Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●●	Trashëgimia kulturore është një nga atraksionet turistike kryesore në Qarkun e Vlorës, kështu që përmirësimi i saj është vendimtar në zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm bazuar në vlerat lokale. Vlerësimi dhe menaxhimi i ri i monumenteve rajonale mund të rrisë zhvillimin e turizmit kulturor, duke ndihmuar kështu në zgjerimin e larmisë së mundësisë që ofron turizmi. Për më tepër, ndërtesat historike të braktisura dhe të shkatërruara mund të rikuperohen për të përfshirë në to strukturat e akomodimit, shërbimet turistike dhe pajisjet.
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●●	Aktivitetet tipike rurale, me "njohuritë" përkatëse, zejet dhe produktet tradicionale, janë të ndërlidhura ngushtë me kulturën e komunitetit rajonal, kështu që përmirësimi i tyre, ashtu si përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale, rrit pamjen tërheqëse të qarkut dhe ndihmon në rikuperimin dhe përfundimin e ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë të komunitetit rajonal. Kjo është arsyeja pse 2 Udhëzuesit Strategjikë mbivendosen pjesërisht, p.sh., US5 përfshin mbështetjen e punëve artizanale artistike dhe rikuperimin e njohurive tradicionale dhe që të dy Udhëzuesit strategjikë përfshijnë ndërhyrjet në zonat rurale (US5, Veprimi 5.1: ruajtja dhe restaurimi i arkitekturës tradicionale dhe e teknikave të ndërtimeve tradicionale; US2, Veprimi 2.1: rikuperimi i elementeve të kulturës tradicionale).
3. Peshkimi dhe akuakultura	●	Peshkimi dhe akuakultura kanë një rol të rëndësishëm në mirëmbajtjen e habitateve të detit dhe të ligatinave dhe këto aktivitete, nëse nuk zhvillohen në një mënyrë të qëndrueshme, mund të kenë një ndikim negativ të mjedisit, për shembull duke ulur biodiversitetin. Është e rëndësishme të zhvillohen sinergji të forta ndërmjet 2 Udhëzuesve Strategjikë dhe për të ekuilibruar zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit për të garantuar qëndrueshmërinë e përgjithshme.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●●	US4 mund të mbështesë përmirësimin e trashëgimisë kulturore rajonale, sidomos nëpërmjet: - Promovimit të kërkimeve në fushën e trashëgimisë kulturore; - Promovimit të zhvillimit të arsimit në nivel universitar në restaurimin e trashëgimisë kulturore, komunikim dhe menaxhim; - Përhapjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit rreth trashëgimisë kulturore, duke filluar nga shkollat.
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	Trashëgimia kulturore dhe mjedisore janë pjesë thelbësore të identitetit territorial dhe që të dyja janë atraksione të fuqishme turistike. Prandaj dhe janë të lidhura ngushtë dhe, për shembull, mbrojtja e natyrës dhe mirëmbajtja e peizazhit që rrethon një vend historik duhet të shkojë përkrah aktiviteteve të restaurimit, gjërmimeve arkeologjike, etj. me qëllim mbajtjen e pamjes tërheqëse të vendeve të paprekura.
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●	Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale, sipas perspektivës së zhvillimit të turizmit, kërkon një punë për përfundimin e rrjeteve të transportit, për të rritur më shumë aksesin në vendet dhe monumentet historike. Për më tepër, trashëgimia kulturore mund të përfitojë nga përmirësimi i TIK-ut, i cili mund të sigurojë mënyra të reja për të përhapur dhe promovuar kulturën rajonale në mbarë botën.
8. Përfshirja sociale	●●●	Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale dhe rritja e qarkullimit të vizitorëve që lidhet me këtë, mund të ofrojë mundësi punësimi për të gjithë popullsinë, e cila mund të përfshihet në administrimin e vendeve historike ose që mund t'i përdorë ato si "vitrina" për produktet rurale dhe artizanale, në koordinim me menaxhimin e vendeve. Kjo gjë mund t'u ofrojë komuniteteve të marzhinalizuara një burim të ardhurash dhe për të ndihmuar në reduktimin e varfërisë.
9. Plani strategjik për fëmijët dhe adoleshentët	●●	Fëmijët dhe adoleshentët përfaqësojnë të ardhmen e Qarkut të Vlorës dhe ndërkohë që rriten, atyre do t'u duhet të merren me ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore me qëllim transmetimin e saj brezave të ardhshëm, prandaj dhe është i rëndësishëm ndërgjegjësimi i tyre pikërisht tani. Në këtë mënyrë, sinergjitë e mundshme ndërmjet US5 dhe US9 mund të zhvillohen nëpërmjet Veprimit 9.3 "Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në aktivitetet sociale dhe kulturore dhe në zbulimin e trashëgimisë kulturore".

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 6

Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●●	Mjedisi dhe peizazhi përfaqësojnë një nga atraksionet kryesore turistike në Qarkun e Vlorës. Prandaj, ruajtja e tyre është thelbësore për të mbajtur dhe për të rritur qarkullimin e turistëve dhe për të garantuar sigurinë nga ndotja, rrëshqitjet e tokës dhe përmytjet. Është gjithashtu e rëndësishme të rehabilitohen zonat e ndotura dhe/ose të degraduara, në mënyrë që të mos vazhdojnë të kërcënojnë shëndetin dhe të ndotin peizazhet natyrore, duke u kthyer kështu në një pengesë për zhvillimin e turizmit.
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●●	Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në mirëmbajtjen e peizazhit tradicional rural dhe të aktiviteve rurale, nëse nuk janë zhvilluar në një mënyrë të qëndrueshme, mund të kenë një ndikim negativ në mjedis, duke ndotur ujin dhe tokën me mbetje dhe pesticide dhe duke ulur biodiversitetin me përzgjedhje të papërshtatshme kulturore. Është e rëndësishme të zhvillohen sinergji të forta ndërmjet 2 Udhëzuesve Strategjikë dhe për të ekuilibruar mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin rural për të garantuar qëndrueshmërinë e përgjithshme.
3. Peshkimi dhe akuakultura	●●●	Peshkimi dhe akuakultura janë aktivitete tipike në Qarkun e Vlorës dhe kanë një histori njohurish, zejesh dhe produktesh tradicionale, të ndërlidhura ngushtë me kulturën e komunitetit rajonal. Prandaj dhe përmirësimi i këtyre aktiviteve, ashtu si përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale, ndihmon në rritjen e pamjes tërheqëse të rajonit dhe për të rikuperuar dhe përforcuar ndjenjën e identitetit dhe të përkatësisë së komunitetit rajonal.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●●	Arsimimi dhe trajnimi mund të luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, në fakt ata mund: <ul style="list-style-type: none"> - Të rrisin ndërgjegjësimin e popullsisë mbi mjedisin dhe mund të nxisin sjelljet pro mjedisit, duke filluar nga fëmijët në shkolla; - Të kualifikojnë kërkues shkencorë dhe profesionistë në sektorin e teknologjive pro mjedisit për administrimin e mbetjeve, në prodhimin e energjisë, në arkitekturë, inxhinieri etj.; - Të trajnojnë burimet njerëzore në fushën e çertifikimeve mbi mjedisin.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●●	Trashëgimia kulturore dhe mjedisore janë pjesë thelbësore të identitetit territorial dhe që të dyja janë atraksione të fuqishme turistike. Prandaj, ato janë të lidhura ngushtë dhe, për shembull, mbrojtja e natyrës dhe mirëmbajtja e peizazhit që rrethon një vend historik duhet të shkojë përkrah aktiviteve të restaurimit, gërmimeve arkeologjike, etj. me qëllim mbajtjen e pamjes tërheqëse të vendeve të paprekura.
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●●	Zhvillimi i rrjeteve duhet të kryhet në koordinim të ngushtë me politikat për mbrojtjen e mjedisit, duke i kushtuar vëmendje veçanërisht ekuilibrit ndërmjet efikasitetit dhe sigurisë së infrastrukturës së transportit dhe mirëmbajtjes së peizazhit të padëmtrar si një atraksion turistik. Sinergjitë e nivelit të lartë mund të zhvillohen ndërmjet 2 US-ve gjithashtu nëpërmjet Veprimit 7.3. "Promovimi i energjisë së rinovueshme dhe kursimi i energjisë" dhe veprimi 7.1, i cili përfshin zhvillimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve për lëvizjen e qëndrueshme. Për më tepër, zhvillimi i TIK-ut mund të ndihmojë në përhapjen e ndërgjegjësimit mbi mjedisin dhe të sjelljeve pro mjedisit si dhe të njohurive lidhur me teknologjitë e qëndrueshme dhe energjitë e rinovueshme.
8. Përfshirja sociale	●●●	Zbatimi i US6 mund të krijojë mundësi të reja punësimi në sektorët që lidhen me mjedisin, siç është administrimi i mbetjeve, prodhimi i energjisë së rinovueshme, mirëmbajtja, mbrojtja dhe administrimi i parqeve natyrore, shërbimet e biznesit për rritjen e qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve etj. Kjo gjë mund të ndihmojë në rritjen e përfshirjes sociale dhe në luftën kundër varfërisë dhe marzhinalizimit.
9. Plani Strategjik për fëmijët dhe adoleshentët	●●●	Sipas perspektivës për zhvillim të qëndrueshëm, fëmijët dhe adoleshentët përfaqësojnë depozituesit e ardhshëm dhe menaxhuesit e mjedisit; me qëllim që t'i bëjmë ata të përshtatshëm për këtë rol, është e rëndësishme që t'i ndërgjegjësojmë ata për çështjet mbi mjedisin. Sinergjitë ndërmjet US6 dhe US9 mund të zhvillohen në këtë mënyrë nëpërmjet Veprimit 9.4. "Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe i cilësisë urbane në qytete dhe fshatra", i cili përfshin, ndërmjet kategorive të ndërhyrjes, promovimin e "aktiviteve për të rritur ndërgjegjësimin mbi mjedisin, për përhapjen e njohurive rreth zhvillimit të qëndrueshmërisë dhe nxitjen e sjelljeve pro mjedisit".

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 7

Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●●	US1 dhe US7 mund të zhvillojnë sinergji shumë të forta, pasi rrjetet janë thelbësore në zhvillimin e turizmit: një territor tërheqës për turistët duhet të ofrojë komoditetet kryesore – furnizimi efikas me ujë dhe energji, trajtimi i ujit të ndotur dhe administrimi i mbetjeve të ngurta janë thelbësore në përbushjen e nevojave bazë për turistët pa ndotur mjedisin dhe pa ndotur atraksionet turistike; turistët duhet të kenë mundësinë për të lëvizur të sigurt – kjo është arsyeja pse infrastruktura e transportit është gjithashtu e rëndësishme; së fundmi, zhvillimi i rrjeteve të TIK-ut është shumë i rëndësishëm, si për turistët (të cilët mund të mbledhin informacione rreth destinacionit të tyre gjithashtu gjatë udhëtimit) dhe për punonjësit turistikë (të cilët mund të promovojnë aktivitetin e tyre në internet dhe të arrijnë një treg global).
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●●	Rrjetet e përmirësuara janë vendimtare për zhvillimin rural pasi: - akses i produkteve lokale në tregje varet shumë nga zgjerimi dhe cilësia e rrjetit rrugor; - një rrjet efikas i shërbimeve kryesore ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës rurale dhe të kushteve të punës si dhe ul nivelin e ndotjes të shkaktuar nga aktivitetet rurale; - një sistem efikas i TIK-ut mund të ndihmojë në uljen e izolimit të komuniteteve rurale dhe për të hapur tregje të reja për produktet rurale.
3. Peshkimi dhe akuakultura	●●●	Zhvillimi i rrjeteve materiale dhe jomateriale është vendimtar për zhvillimin e peshkimit dhe të akuakulturës pasi: - akses i produkteve lokale në tregje varet shumë nga zgjerimi dhe cilësia e rrjetit të transportit (rugët, portet); - rrjetet efikase të shërbimeve kryesore ndikojnë pozitivisht në cilësinë e jetës dhe në kushtet e punës në fshatrat bregdetare dhe mund të ulin nivelin e ndotjes të shkaktuar nga aktivitetet prodhuese; - një sistem efikas i TIK-ut mund të ndihmojë për të hapur tregje të reja për produktet e peshkut të detit.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●	Përmirësimi i arsimit dhe i trajnimit është i ndërlidhur me fuqizimin e rrjeteve si më poshtë: - Përmirësimi i TIK-ut është thelbësor për të zhvilluar programet e arsimit dhe trajnimit me bazë internetin dhe për t'i bërë ato të disponueshme për popullsinë e gjerë; - Arsimimi dhe trajnimi mund të ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dixhitale, të aftësive dhe përfshirjes, sidomos në zonat rurale dhe të thella dhe për të trajnuar ekspertët e TIK-ut (shikoni veprimin 7.2) - Përmirësimi i rrjeteve të transportit mund të jetë i dobishëm për studentët të cilët duhet të zhvendosen në qytete të tjera për të ndjekur shkollën ose universitetin.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●	Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale, sipas perspektivës së zhvillimit të turizmit, kërkon një punë për përforcimin e sistemeve të transportit, për të rritur më shumë aksesin në vendet dhe monumentet historike. Për më tepër, trashëgimia kulturore mund të përfitojë shumë nga përmirësimi i TIK-ut, i cili mund të sigurojë mënyra të reja për të përhapur dhe promovuar kulturën rajonale në mbarë botën.
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	Zhvillimi i rrjeteve duhet të kryhet në koordinim të ngushtë me politikat për mbrojtjen e mjedisit, duke i kushtuar vëmendje veçanërisht ekuilibrit ndërmjet efikasitetit dhe sigurisë së infrastrukturës së transportit dhe mirëmbajtjes së peizazhit të padëmtuar si një atraksion turistik. Sinergjitë e nivelit të lartë mund të zhvillohen ndërmjet 2 Udhëzuesve strategjikë gjithashtu nëpërmjet veprimit 7.3 dhe veprimit 7.1, i cili përfshin zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve për lëvizjen e qëndrueshme. Për më tepër, zhvillimi i TIK-ut mund të ndihmojë në përhapjen e ndërgjegjësimit mbi mjedisin dhe të sjelljeve pro mjedisit si dhe të njohurive lidhur me teknologjitë e qëndrueshme dhe energjitë e rinovueshme.
8. Përfshirja sociale	●●	Zhvillimi i rrjeteve mund të ndihmojë në rritjen e përfshirjes sociale: rrjetet e fuqizuara të rrugëve dhe të TIK-ut mund t'u japin komuniteteve të izoluara mundësinë për të shkuar te vendet e punës, te shërbimet, te mundësitë e punësimit dhe te institucionet e arsimit më shpejt dhe më të sigurt, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës.
9. Plani Strategjik për fëmijët dhe adolehentët	●●●	Sinergjitë e mundshme ndërmjet dy US-ve mund të zhvillohen nëpërmjet: - Veprimit 7.1, duke përfshirë fuqizimin e shërbimeve të transportit publik, promovimin e planit të lëvizjes dhe zhvillimit të lëvizjes së qëndrueshme, i cili duhet zbatuar duke i kushtuar vëmendje dhe nevojave të fëmijëve, në koherencë me objektivat e Veprimit 9.1; - Veprimit 7.2, i cili synon përmirësimin e njohurive dixhitale, të aftësive dhe përfshirjes në komunitetet lokale dhe përfshin, para së gjithash, brezat e rinj.

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 8

Përfshirja sociale

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●	US8 synon përmirësimin e shërbimeve të kujdesit social dhe shëndetësor: turistët do të përfitojnë gjithashtu nga shërbimet shëndetësore të përmirësuara; dhe një rajon me kohezion social dhe cilësi jete në rritje do të jetë më tërheqës dhe më i sigurt, edhe për turistët.
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●●	Decentralizimi dhe fuqizimi i shërbimeve të përkujdesjes sociale dhe shëndetësore mund të përmirësojë cilësinë e jetës në komunitetet rurale dhe mund të mbështesë në mënyrë efikase fermerët dhe familjet e tyre për të luftuar izolimin dhe varfërinë.
3. Peshkimi dhe akuakultura	●●	Decentralizimi dhe fuqizimi i shërbimeve të kujdesit social dhe shëndetësor mund të përmirësojë cilësinë e jetës në fshatrat bregdetare dhe mund të mbështesë në mënyrë efikase peshkatarët dhe fermerët për të luftuar varfërinë.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●●	2 Udhëzuesit Strategjikë mund të zhvillojnë sinergjitë në 3 fusha: - Programet e arsimit dhe të formimit profesional synojnë të rrisin përfshirjen sociale të grupeve të pafavorizuara (p.sh., personat me aftësi të kufizuara, të sëmurët mendorë etj.) duke përmirësuar autonominë e tyre dhe aftësinë e tyre për të fituar jetesën; - Formimi profesional i punonjësve socialë, për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të përkujdesjes sociale në qark; - Arsimimi dhe formimi profesional në sektorin e shëndetit, për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të përkujdesjes shëndetësore në qark në një perspektivë decentralizuese.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●●	Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale dhe rritja e qarkullimit të vizitorëve që lidhet me këtë, mund të sigurojë mundësi punësimi për të gjithë popullsinë. Kjo e fundit mund të përfshihet në administrimin e vendeve historike ose për t'i përdorur ato si "vitrina" për produktet rurale dhe artizanale, në koordinim me menaxhimin e vendeve. Kjo gjë mund t'u ofrojë komuniteteve të marshalizuar një burim të ardhurash dhe mund të ndihmojë në reduktimin e varfërisë.
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	Zbatimi i US6 mund të krijojë mundësi të reja punësimi në sektorët që lidhen me mjedisin, siç është administrimi i mbetjeve, prodhimi i energjisë së rinovueshme, mirëmbajtja, mbrojtja dhe menaxhimi i parqeve natyrore, shërbimet e biznesit për rritjen e qëndrueshmërisë së sipërmarrjeve, etj. Kjo gjë mund të ndihmojë në rritjen e përfshirjes sociale dhe në luftën kundër varfërisë dhe marzhinalizimit.
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●	Zhvillimi i rrjetëve mund të ndihmojë në rritjen e përfshirjes sociale: rrjetet e fuqizuara të rrugëve dhe të TIK-ut mund t'u japin komuniteteve të izoluar mundësinë për të shkuar te vendet e punës, te shërbimet, te mundësitë e punësimit dhe te institucionet e arsimit më shpejt dhe më të sigurt, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës së tyre.
9. Plani Strategjik për fëmijët dhe adoleshentët	●●●	Udhëzuesit Strategjikë mund të zhvillojnë sinergjitë në 3 fusha: - Jeta sociale: Veprimi 9.3. nxit përdorimin e hapësirave publike për socializim dhe ndihmon integrimin social dhe marrëdhëniet ndërmjet brezave; - Pjesëmarrja: Veprimi 9.2. "Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në planifikimin dhe menaxhimin urban" lidhet drejtpërdrejt me (dhe një pjesë e) veprimin 8.4. "Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve lokale në politikën dhe zhvillimit rajonal"; - Mjedis në favor të personave me aftësi të kufizuara: Veprimi 9.1 përfshin heqjen e barrierave arkitekturore, duke theksuar kështu rolin e fëmijëve si parametra dhe garantues të nevojave të të gjithë qytetarëve, përfshirë grupet e pafavorizuara siç janë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

Udhëzuesi Strategjik 9

Plani Strategjik për fëmijët dhe adoleshentët

US-të sinergjike	Niveli i sinergjisë (*)	Arsyetimi dhe komentet
1. Turizmi me bazë komunitetin	●●	US9 synon përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike dhe të zonave me gjelbërim. Kjo gjë do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme urbane dhe për t'i bërë qytetet dhe fshatrat më tërheqëse për turistët. Për më tepër, turistët që udhëtojnë me fëmijë dhe adoleshentë do të gjejnë në Qarkun e Vlorës një territor që përmbush nevojat e tyre.
2. Produktet tipike rurale dhe artizanati	●	US9 synon përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike dhe të zonave me gjelbërim. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës në fshatrat rurale.
3. Peshkimi dhe akuakultura	●	US9 synon përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike dhe të zonave me gjelbërim. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës në fshatrat bregdetare.
4. Arsimimi dhe trajnimi	●●●	Arsimimi dhe trajnimi luajnë një rol kryesor në jetën e përditshme të fëmijëve dhe adoleshentëve. Zbatimi i US4 dhe US9 duhet të jetë i koordinuar, me qëllim: - marrjen në konsideratë të nevojës së fëmijëve dhe adoleshentëve për të përmirësuar sistemin e arsimit dhe të formimit profesional dhe infrastrukturën e shkollës; - zhvillimin e arsimit dhe të programeve të formimit profesional që synojnë rritjen e përfshirjes sociale të fëmijëve dhe adoleshentëve me aftësi të kufizuara duke përmirësuar autonominë e tyre.
5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale	●●	Fëmijët dhe adoleshentët përfaqësojnë të ardhmen e Qarkut të Vlorës dhe ndërkohë që rriten, atyre do t'u duhet të merren me ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore me qëllim transmetimin e saj brezave të ardhshëm, prandaj dhe është i rëndësishëm ndërgjegjësimi i tyre pikërisht tani. Në këtë mënyrë, sinergjitë e mundshme ndërmjet US5 dhe US9 mund të zhvillohen nëpërmjet Veprimit 9.3 "Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në aktivitetet sociale dhe kulturore dhe në zbulimin e trashëgimisë kulturore".
6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit	●●●	Sipas perspektivës për zhvillim të qëndrueshëm, fëmijët dhe adoleshentët përfaqësojnë depozituesit e ardhshëm dhe menaxhuesit e mjedisit; me qëllim që t'i bëjmë ata të përshtatshëm për këtë rol, është e rëndësishme që t'i ndërgjegjësojmë ata për çështjet mbi mjedisin. Sinergjitë ndërmjet US6 dhe US9 mund të zhvillohen në këtë mënyrë nëpërmjet Veprimit 9.4. "Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe i cilësisë urbane në qytete dhe fshatra", i cili përfshin, ndërmjet kategorive të ndërhyrjes, promovimin e "aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin mbi mjedisin, për përhapjen e njohurive rreth zhvillimit të qëndrueshmërisë dhe nxitjen e sjelljeve pro mjedisit".
7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia	●●●	Sinergjitë e mundshme ndërmjet dy US-ve mund të zhvillohen nëpërmjet: - Veprimit 7.1, duke përfshirë fuqizimin e shërbimeve të transportit publik, promovimin e planit të lëvizjes dhe zhvillimit të lëvizjes së qëndrueshme, i cili duhet zbatuar duke i kushtuar vëmendje dhe nevojave të fëmijëve, në koherencë me objektivin e Veprimit 9.1 për nxitjen e autonomisë së fëmijëve; - Veprimi 7.2. "Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit", të cilat synojnë përmirësimin e njohurive dixhitale, të aftësive dhe përfshirjes në komunitetet lokale dhe do të përfshijnë, para se gjithash, brezat e rinj.
8. Përfshirja sociale	●●●	2 Udhëzuesit Strategjikë mund të zhvillojnë sinergjitë në 3 fusha: - Jeta sociale: Veprimi 9.3. nxit përdorimin e hapësirave publike për socializim, duke ndihmuar kështu integrimin social dhe marrëdhëniet ndërmjet brezave; - Pjesëmarrja: Veprimi 9.2. "Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në planifikimin dhe menaxhimin urban" lidhet drejtpërdrejt me (dhe një pjesë e) veprimin 8.4. "Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve lokale në politikën e zhvillimit rajonal"; - Mjedisi në favor të personave me aftësi të kufizuara: Veprimi 9.1 përfshin heqjen e barrierave arkitekturore, duke theksuar kështu rolin e fëmijëve si parametra dhe garantues të nevojave të të gjithë qytetarëve, përfshirë grupet e pafavorizuara siç janë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

(*) Niveli i sinergjisë: ●●●: i lartë; ●●: mesatar; ●: i ulët

2.6. Konsistenca e strategjisë me politikat e zhvillimit rajonal

Me qëllim maksimizimin e rezultateve të PS-së dhe për ta bërë zbatimin e saj një praktikë të mundshme, u verifikua konsistenca e strategjisë së përcaktuar me politikat aktuale të zhvillimit, duke krahasuar objektivat kryesore të planeve dhe programeve rajonale me objektivat dhe përmbajtjet e PS-së.

Tabelat e mëposhtme sintetizojnë rezultatet e këtij aktiviteti, duke identifikuar marrëdhëniet ndërmjet objektiveve kryesore të përbashkëta

për programet në nivel rajonal në sektorët kryesorë të zhvillimit rajonal, në një rën anë dhe në Udhëzuesit Strategjikë dhe veprimet e PS-së rajonale nga ana tjetër.

Tabelat tregojnë qartë se Udhëzuesit Strategjikë dhe Veprimet e Planit Strategjik rajonal u përgjigjen objektiveve kryesore të programeve në nivel rajonal dhe në këtë mënyrë janë konsistente me politikat dhe objektivat rajonale.

SEKTORI 1: MBROJTJA E MJEDISIT DHE RRJETET INFRASTRUKTURORE

Qëllimet kryesore	Programet rajonale si referencë	Udhëzuesit Strategjikë dhe Veprimet konsistente
Administrimi i mbetjeve: Përcaktimi i lanfilleve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane, blerja e makinerive për administrimin e mbetjeve, nxitja e edukimit lidhur me mbetjet urbane, rehabilitimi i vendeve aktuale të grumbullimit që janë të paligjshme, organizimi i veçimit të mbetjeve.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani për administrimin e mbetjeve në Qarkun e Vlorës - Plani strategjik për zhvillimin e turizmit - Komuna Qendër - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum - Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë 	US6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit Veprimi 6.3. Administrimi i mbetjeve të ngurta ekologjikisht të qëndrueshme
Furnizimi me ujë dhe sistemi i ujërave të zeza: Rehabilitimi teknik i furnizimit me ujë, rehabilitimi teknik dhe zgjerimi i sistemit të ujërave të zeza, sistemet e reja për ujërat e zeza dhe për furnizimin me ujë, lidhja e çdo shtëpie me sistemin e ujërave të zeza.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani strukturor - Vlorë - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum 	US6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit Veprimi 6.2. Ruajtja e burimeve të ujit dhe administrimi i ciklit të qarkullimit të ujit
Mbrojtja e mjedisit dhe e burimeve natyrore: Rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë mbi mjedisin, ruajtja dhe menaxhimi i burimeve natyrore, mbrojtja e tokës dhe masat kundër erozionit, ngritja e kapaciteteve lokale për planifikim, administrimi dhe monitorimi i burimeve natyrore dhe biologjike, ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e mjedisit, përgatitja e materialeve promovuese.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur peizazhore Vjosë-Nartë - Plani i menaxhimit për Kompleksin e Llogarasë - Studim për Lumin e Vlorës - Strategjia e Qarkut të Vlorës për arritjen e objektiveve të OZHM-së 	US6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit Veprimi 6.1. Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonave natyrore, i peizazheve dhe ruajtja e biodiversitetit
Infrastruktura: Përkufizimi i strategjive të transportit, përmirësimi i aksesit në fshatra të ndryshme, rregullimi i të gjitha rrjeteve rrugore.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani strukturor - Vlorë - Studimi i parafizibilitetit për zhvillimin e aksit hekurudhor - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Orikum - Plani strategjik për zhvillimin e turizmit - Komuna Qendër - Plani për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë 	US7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia Veprimi 7.1. Përmirësimi i rrjeteve të transportit për të përmirësuar aksesin territorial dhe konkurrencën

SEKTORI 2: TRASHËGIMIA KULTURORE

<i>Qëllimet kryesore</i>	<i>Programet rajonale si referencë</i>	<i>Udhëzuesit Strategjikë dhe Veprimet konsistente</i>
<p>Ruajtja dhe përmirësimi i trashëgimisë kulturore:</p> <p>Restaurimi dhe ruajtja e ndërtesave historike, kulturore dhe e shtëpive karakteristike.</p>	- Plani strukturor - Vlorë	<p>US5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale</p> <p>Veprimi 5.1. Njohja, ruajtja, restaurimi dhe kualifikimi i pasurive historike, nëpërmjet menaxhimit të ri dhe krijimit të rrjeteve të integruara</p>

SEKTORI 3: PRODHIMET BUJQËSORE DHE TURIZMI RURAL

<i>Qëllimet kryesore</i>	<i>Programet rajonale si referencë</i>	<i>Udhëzuesit Strategjikë dhe Veprimet konsistente</i>
<p>Zhvillimi i bujqësisë:</p> <p>Përdorimi efikas i tokës bujqësore duke përmirësuar sistemin e ujitjes dhe të kullimit, kreditimi dhe mbështetja e specialistëve të bujqësisë për zbatimin e shërbimeve në bujqësi, studimi i parafizibilitetit për një treg në Sarandë, krijimi dhe përforcimi i sipërmarrjeve të prodhimeve bujqësore, nxitja e fermerëve për t'u organizuar në shoqata ose grupime, mbrojtja e artizanatit tradicional, e zejeve dhe e traditave lokale.</p> <p>Prodhimi bujqësor:</p> <p>Çertifikimi i produkteve, nxitja e produkteve vendase, organizimi i panairëve me prodhime bujqësore dhe blegtorale, krijimi i një marke për prodhimet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i zhvillimit - Xarrë - Plani i zhvillimit - Oriku - Studim për Lumin e Vlorës 	<p>US2. Produktet tipike rurale dhe artizanati</p> <p>Veprimi 2.2. Nxitja e grupimit të prodhuesve</p> <p>Veprimi 2.3. Nxitja dhe mbështetja e aksesit të sipërmarrjeve në kredimarrje për fermerët, mbarështuesit dhe artizanët</p>
<p>Turizmi rural:</p> <p>Ndërtimi i fshatrave të reja turistike (Psimeno).</p>	- Plani i zhvillimit - Xarrë	<p>US2. Produktet tipike rurale dhe artizanati</p> <p>Veprimi 2.1. Promovimi i produkteve karakteristike dhe fuqizimi i konkurrencës bazuar në cilësinë për eksport</p> <p>US1. Turizmi me bazë komunitetin</p> <p>Veprimi 1.2. Kualifikimi dhe rritja e larmisë së strukturave të akomodimit</p>

SEKTORI 4: ÇËSHTJET SOCIALE

<i>Qëllimet kryesore</i>	<i>Programet rajonale si referencë</i>	<i>Udhëzuesit Strategjikë dhe Veprimet konsistente</i>
<p>Përfshirja sociale:</p> <p>Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmirësimi i nivelit të arsimit, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Strategjia e Qarkut të Vlorës për arritjen e objektivave të OZHM-së - Ngritja e një seksioni të posaçëm pedagogjik në Universitetin e Vlorës 	<p>US8. Përfshirja sociale</p> <p>Veprimi 8.1. Përforcimi i integritit social dhe lufta kundër varfërisë nëpërmjet programeve të punësimit</p> <p>Veprimi 8.2. Përmirësimi dhe rinovimi i shërbimeve të kujdesit social</p> <p>Veprimi 8.3. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore publike</p> <p>US4. Arsimimi dhe trajnimi</p> <p>Veprimi 4.1. Vlerësimi i arsimit ekzistues dhe i aktiviteteve të trajnimit duke përforcuar lidhjet e tyre me sipërmarrjet kombëtare dhe ndërkombëtare</p> <p>Veprimi 4.2. Fuqizimi i aksesit në arsim dhe trajnime nëpërmjet financimit dhe bursave</p> <p>Veprimi 4.3. Fuqizimi dhe nxitja e programeve të trajnimit për shkëmbim ndërkombëtar</p> <p>Veprimi 4.5. Fuqizimi i arsimit dhe i trajnimeve në sektorët kyç të zhvillimit rajonal</p>

2.7. Konsistenca e strategjisë me politikat e zhvillimit kombëtar

PS-ja është një platformë rinovimi që synon rritjen territoriale duke përfshirë të gjithë komponentët kulturorë, mjedisorë, socialë dhe ekonomikë të një rajoni për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm duke përdorur teknikat pjesëmarrëse. Platforma synon gjithashtu të lidhë dhe të harmonizojë politikat në nivel kombëtar me programet në nivel lokal dhe me ndërhyrjet. Kjo mund të arrihet duke zhvilluar dhe transferuar në nivel lokal objektivat dhe strategjitë kombëtare, me qëllim garantimin e koherencës dhe të përputhshmërisë ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes territoriale.

Kjo mënyrë thelbësore në maksimizimin e përfitimeve dhe rezultateve të planifikimit strategjik, u ndërmor me tre hapa:

- **Hapi 1:** Përcaktimi dhe përgatitja e një liste me

Strategjitë Sektoriale Kombëtare kryesore, më e rëndësishmja dhe më e dobishmja për parapërgatitjen e PS-së së Qarkut Vlorë.

- **Hapi 2:** përcaktimi i objektivave kryesore strategjike për secilën strategji kombëtare, për të siguruar një përmbledhje të prioriteteve aktuale të qeverisë shqiptare.
- **Hapi 3:** ballafaqimi i strategjive kombëtare me Udhëzuesit Strategjikë për Qarkun e Vlorës dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre.

Ky studim ndihmon për të treguar se si mund të jetë planifikimi strategjik një instrument i përshtatshëm dhe i vlefshëm për arritjen e objektivave të Qeverisjes Kombëtare. Kjo PS, sapo të aprovohet, mund të shërbejë si praktika më e mirë për zhvillimin e rajoneve të tjera shqiptare dhe të zhvillimit lokal në përgjithësi.

HAPI 1

9 strategjitë kombëtare të analizuar:

- Strategjia Sektoriale për Turizmin 2007-2013
- Strategjia Kombëtare për Mjedisin 2007-2020
- Strategjia për Sektorin e Bujqësisë dhe Ushqimit 2007 - 2013
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural 2007 - 2013
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013
- Strategjia Sektoriale për Transportin 2008-2013
- Strategjia Sektoriale për Kujdesin Social 2007 - 2013
- Strategjia Kombëtare për Fëmijët
- Strategjia për Zhvillimin e Peshkimit dhe Akuakulturës 2007 - 2015



HAPI 2

Përcaktimi i objektivave kryesorë strategjikë:

STRATEGJIA SEKTORIALE PËR TURIZMIN 2007-2013

- Zhvillimi i turizmit dhe i produkteve të tij
- Ngritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i ambienteve institucionale
- Financimi dhe vendosja e mekanizmave afatgjatë për zonat natyrore dhe kulturore që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre
- Krijimi i një baze të dhënash të sistemit turistik për mbledhjet statistikore dhe përpunimin dhe gjithashtu për të bërë kërkime shkencore mbi tregjet turistike
- Përmirësimi i infrastrukturës për nevojat turistike
- Përmirësimi i koordinimit publik-privat-civil

vazhdon në faqen tjetër

HAPI 2

Përcaktimi i objektivave kryesorë strategjikë:

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MJEDISIN 2007-2020

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit nëpër Shqipëri në nivele që përputhen me standardet kombëtare, të KE-së dhe të OBSH-së
- Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë, të substancave të ozonit dhe atyre varfëruese për të kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimatike
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve në atë mënyrë që të reduktohen rreziqet për shëndetin e njerëzve, mjedisin dhe tregtinë ndërkohë që përmbushen kërkesat e KE-së
- Sigurimi i përdorimit të ujit të pijshëm për të gjithë popullsinë
- Mbrojtja e të gjitha burimeve në sipërfaqe dhe nëntokë për përdorim aktual dhe në të ardhmen
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokave për të maksimizuar riprodhimin, për të minimizuar erozionin dhe për të parandaluar kontaminimin
- Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit, i zonave të mbrojtura dhe i specieve për të ruajtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore të mjedisit shqiptar, duke përmbushur detyrimet evropiane dhe ndërkombëtare
- Krijimi i një sistemi planifikimi zhvillimi dhe hapësinar të integruar dhe të efektshëm i cili merr në konsideratë objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore në mënyrë të ekuilibruar
- Përmirësimi dhe rehabilitimi i zonave që janë objekt i dëmtimeve të rënda mjedisore, për të eliminuar kërcënimet që i kanosen shëndetit publik dhe biodiversitetit, të cilat janë pasojë e këtyre dëmtimeve
- Mbajja nën kontroll, në nivele të sigurta për shëndetin, i zhurmës, rrezatimit dhe stresit mjedisor, ndaj të cilave është e ekspozuar popullsia.

STRATEGJIA PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE USHQIMIT 2007 - 2013

- Administrimi i tokës në mënyrë të qëndrueshme, si një komponent bazë ky në bujqësi dhe në përputhje të plotë me zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë
- Rritja e punësimit, e të ardhurave dhe e standardeve të jetesës së fermerëve dhe e familjeve të tyre
- Rritja e efikasitetit ekonomik të sektorit të bujqësisë dhe të përpunimit të produkteve bujqësore, e cila shprehet nëpërmjet rritjes së prodhueshmërisë dhe cilësisë së produkteve
- Garantimi i standardeve më të larta të sigurisë ushqimore për të gjithë popullsinë
- Përmirësimi i tregtisë bujqësore
- Rritja e mbështetjes financiare për fermerët, bujqësinë dhe bizneset e përpunimit të produkteve bujqësore
- Përmirësimi i menaxhimit, ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore
- Përmirësimi i nivelit dhe i cilësisë së teknologjive, të informacionit dhe të njohurive të fermerëve.

STRATEGJIA NDRËSEKTORIALE PËR ZHVILLIMIN RURAL 2007 - 2013

- Rritja e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe të përpunimit të produkteve bujqësore nëpërmjet masave për modernizimin e fermës dhe mbështetjes së ristrukturimit dhe zhvillimit të aktiviteteve me vlerë të shtuar
- Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat rurale
- Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe nxitja e zgjerimit të larmisë së aktiviteteve ekonomike
- Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve lokale për të menaxhuar në mënyrë të efektshme programet e komunitetit për zhvillimin rural nëpërmjet zhvillimit rural pjesëmarrës.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM 2007-2013

- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit, sidomos të transportit rrugor, për krijimin e një hapësire ekonomike të integruar
- Zhvillimi i sistemeve të energjisë bazuar në parimet e tregut dhe i kapacitetit për të prodhuar energji me qëllim mbulimin e kërkesës në total për energji me një kosto sociale dhe mjedisore minimale
- Zhvillimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve sipas standardeve të BE-së, për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe mbrojtjen e mjedisit
- Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe degradimi
- Krijimi i një klime të favorshme për biznesin për një zhvillim dinamik të sipërmarrjeve private dhe për tërheqjen e investimeve të huaja
- Krijimi i një kuadri ligjor të politikës sociale për të garantuar mbrojtjen sociale të qytetarëve
- Përmirësimi i arsimit dhe i sistemit arsimor për t'u përgjigjur kërkesave të ekonomisë së tregut.

vazhdon në faqen tjetër

HAPI 2

Përcaktimi i objektivave kryesorë strategjike:

STRATEGJIA SEKTORIALE PËR TRANSPORTIN 2008-2013

- Bërja e rrugëve turistike dhe e pikave kufitare plotësisht funksionale;
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së Rrjetit rrugor kombëtar nëpërmjet sistemit të menaxhimit të pasurisë rrugore që synon privatizimin e plotë të shërbimeve;
- Krijimi i një rrjeti për qarkullimin e transportit për të garantuar zhvillimin, rritjen e trafikut të mallrave, bërjen e transportit të përdorshëm nga të gjithë dhe për të ndihmuar në bashkëpunimin e brendshëm dhe tregun kombëtar të punës;
- Zhvillimi i logjistikës dhe i teknologjive inteligjente moderne në sektorin e transportit;
- Garantimi i një transporti detar të efektshëm dhe mbrojtja e mjedisit detar dhe e zonave bregdetare;
- Përmirësimi i transportit hekurudhor dhe përmirësimi i standardeve dhe kushteve në transportin publik;
- Rritja e efikasitetit të transportit ajror për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

STRATEGJIA SEKTORIALE PËR KUJDESIN SOCIAL 2007-2013

- Lufta kundër varfërisë;
- Reformimi i shërbimeve të kujdesit social;
- Mbështetja e grupeve të pafavorizuara dhe garantimi i integritetit social.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR FËMIJËT

- Mbijetesa e fëmijëve;
- Mbrojtja e fëmijëve;
- Zhvillimi i fëmijëve;
- Pjesëmarrja e fëmijëve (liria e fjalës, përfshirja e fëmijëve në vendimmarrje, qytetet për fëmijët, trajnimet).

STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS 2007-2013

- Zhvillimi i shpejtë dhe i larmishëm i peshkimit në det;
- Zhvillimi i shpejtë i akuakulturës, sidomos i akuakulturës detare;
- Mbështetja e zhvillimit të industrisë së përpunimit të peshkut;
- Zhvillimi i shpejtë i infrastrukturës së porteve dhe i tregtisë.



HAPI 3

Ballafaqimi i strategjive:

US1. Turizmi me bazë komunitetin

Udhëzuesi Strategjik është qartësisht në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë Sektoriale dhe Turizmit 2007-2013 lidhur me zhvillimin e turizmit si një prioritet kryesor dhe në mënyrë specifike, përmirësimi i infrastrukturës, peizazhit dhe mbrojtjes kulturore të nevojave turistike.

US2. Produktet tipike rurale dhe artizanati

Ky udhëzuesi Strategjik mund t'i referohet Strategjisë së Sektorit të Bujqësisë dhe Ushqimit 2007-2013 dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural 2007-2013 për sa i përket produkteve karakteristike rurale dhe zhvillimit dhe çertifikimit të cilësisë së tyre. Ka gjithashtu një koherencë të mirë ndërmjet ndërhyrjeve të parashikuara për arritjen e objektivave strategjike, siç është modernizimi i teknologjive, trajnimi i fermerëve, kontrolli i cilësisë etj.

US3. Peshkimi dhe akuakultura

Sipas Strategjisë për Zhvillimin e Peshkimit dhe Akuakulturës 2007-2015, Shqipëria ka premisa të mira për zhvillimin e peshkimit dhe të akuakulturës dhe synon të ridimensionojë vlerat dhe t'i kushtojë rëndësi sektorit të peshkimit në ekonominë kombëtare. Strategjia sektoriale ndan të njëjtat objektiva me Udhëzuesin Strategjik 3, që ka të bëjë me vlerësimin dhe përmirësimin e produkteve të peshkut, përmirësimin e infrastrukturës së porteve.

vazhdon në faqen tjetër

HAPI 3

US4. Arsimimi dhe trajnimi

Arsimimi dhe trajnimi përbën një qëllim strategjik për pothuajse të gjitha programet kombëtare të analizuara, edhe pse mund të kenë lidhje me sektorë të ndryshëm. Strategjitë që përfshihen këtu janë si më poshtë:

- Strategjia Sektoriale për Transportin 2007-2013
- Strategjia për Sektorin e Bujqësisë dhe Ushqimit 2007 - 2013
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural 2007- 2013
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013
- Strategjia Kombëtare për Kujdesin Social

Çdo strategji kombëtare radhit ngritjen e kapaciteteve si objektivin kryesor në sektorin e tij specifik, në përputhje të plotë me Udhëzuesin Strategjik 4, i cili përcakton përmirësimin e arsimimit dhe zhvillimin e kapaciteteve, gjithashtu nëpërmjet trajnimeve, si një prioritet kryesor të Planit Strategjik rajonal.

US5. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore rajonale

Një nga objektivat strategjike të Strategjisë Sektoriale për Turizmin është përmirësimi i investimeve në kulturë për të përmirësuar zhvillimin e turizmit, në mënyrë specifike për të ngadalësuar shkatërrimin e ndërtesave historike, për të përmirësuar dhe reklamuar aktivitetet kulturore dhe festivalet folklorike, për të përmirësuar aksesin kulturor në muze. Ky objektivi mbështet plotësisht Udhëzuesin Strategjik 5 të Planit Strategjik rajonal.

US6. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit dhe i peizazhit

Ky Udhëzues Strategjik është në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007–2013 dhe me Strategjinë Kombëtare për Mjedisin 2007–2020, qëllimi i përgjithshëm i së cilës është përmirësimi i kushteve të mjedisit dhe garantimi i përputhshmërisë me detyrimet e Komunitetit Evropian. Mbrojtja dhe zhvillimi i peizazhit dhe i zonave natyrore bazuar në qëndrueshmëri, reduktimi i emetimeve të gazeve, përmirësimi i administrimit të mbetjeve dhe minimizimi i erozionit janë vetëm disa nga objektivat që strategjitë kombëtare kanë të përbashkët me Planin Strategjik rajonal.

US7. Rrjetet materiale dhe jomateriale dhe energjia

Strategjitë kombëtare të cilave i referohet US-ja janë Strategjia Sektoriale për Transportin 2007 – 2013 dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007 – 2013. Ka një koherencë të mirë lidhur me përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore dhe me objektivat për t'i bërë rrugët turistike plotësisht funksionale, zhvillimin e sistemeve të energjisë dhe përmirësimin e kapacitetit për të prodhuar energji.

US8. Përfshirja sociale

Të gjitha çështjet që lidhen me përfshirjet sociale janë pjesë e Strategjisë Sektoriale për Kujdesin Social 2007-2013. Kjo strategji ka të përbashkëta disa objektiva me US8, për shembull përforcimin e integritit social, përmirësimin e përkujdesjes sociale, luftën kundër varfërisë.

US9. Plani strategjik për fëmijët dhe adoleshentët

Pjesëmarrja e fëmijëve në shoqëri është një nga parimet e "Konventës për të drejtat e fëmijëve" të UNICEF-it. Përfshirja e fëmijëve në vendime synon garantimin e pjesëmarrjes së efektshme dhe të përgjegjshme të fëmijëve në vendimmarrje, në përputhje me aftësisë e tyre, të familjeve dhe të të gjitha niveleve arsimore, në nivel lokal dhe qendror. Qeveritë vendore dhe autoritetet e tyre, nëpërmjet përforcimit dhe partneritetit në të gjitha nivelet, duhet të sigurojnë që fëmijët të jenë në plan të parë në programet e tyre për zhvillim. Ky është objektivi kryesor i Strategjisë kombëtare për fëmijët, e cila është plotësisht koherente me Udhëzuesin Strategjik.



REZULTATET

Të gjithë Udhëzuesit Strategjike të Planit Strategjik për Qarkun e Vlorës janë të përputhshme me strategjitë sektoriale përkatëse në nivel kombëtar për periudhën e përafërt 2007-2013.

KAPITULLI 3

PLANI I VEPRIMIT



Pamje nga
bregdeti i Vlorës

3.1. Hyrje metodologjike

Plani i Veprimit është një sistem i integruar i projekteve, i propozuar kryesisht nga aktorët lokalë dhe i vendosur në një kuadër koherent dhe të orientuar nga vizioni, i cili duhet zbatuar me qëllim arritjen e objektivave të PS-së.

Plani i veprimit synon:

- Arritjen e koordinimit dhe të konsistencës ndërmjet zhvillimit të nismave në nivele lokale, rajonale dhe kombëtare
- Përmirësimin e lidhësive të komunitetit rajonal në menaxhimin e politikave të zhvillimit
- Përcaktimin e burimeve dhe procedurave për të zbatuar dhe menaxhuar nismat për zhvillim
- Mbështetjen e përputhjes së nevojave specifike të territorit me burimet e disponueshme financiare, që synojnë optimizmin e tyre dhe punësimin efikas.

Plani i veprimit për zhvillimin e qëndrueshëm të Qarkut të Vlorës u përcaktua nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

1. **Mbledhja e projekt-propozimeve** nga aktorët territorialë në të gjitha nivelet, ose drejtpërdrejt (nëpërmjet formularëve të projektit të plotësuar nga propozuesit ose jo në mënyrë të drejtpërdrejtë (duke përpunuar rezultatet e procesit të pjesëmarrjes dhe interpretimit të dëshirave të

komunitetit rajonal). Më pas, projektet e mbledhura dhe idetë u lidhën në mënyrë të përshtatshme me Strategjinë dhe u grupuan në 10 "Paketa Projektësh". Nga pikëpamja metodologjike, Paketa e projekteve është një *kuti mbajtëse* për projektet që janë të lidhura ngushtë për shkak të çështjeve specifike që ato trajtojnë dhe/ose të zonave të ndërhyrjes.

2. **Vendosja e parafizibilitetit të Paketave të Projekteve**, duke ndjekur procedurat e mundshme për të zbatuar projektet dhe duke propozuar partneritete të mundshme, duke u fokusuar veçanërisht në rolin e aktorëve institucionalë dhe privatë në zbatimin e procesit. Në këtë pikëpamje, u bënë përpjekje për të kuptuar nëse projektet ishin të përshtatshme për t'u zbatuar vetëm nga institucionet publike, nga partneritetet publike-private, ose nga investuesit privatë të cilët mund të mbështeten në njëfarë mënyre gjithashtu nga AULEDA.

Plani i Veprimit u zhvillua nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të aktorëve territorialë gjatë takimeve me Fokus Grupet. Rrjedhimisht, informacioni i mëposhtëm duhet të konsiderohet se është ndarë plotësisht me komunitetin rajonal dhe për të cilin ai ka rënë dakord.

3.2. Hartimi i projekteve pjesëmarrëse

Raundet e takimeve me autoritetet lokale

9-12 Mars 2011

Takimet u mbajtën me përfaqësuesit e 18 bashkive dhe komunave të Qarkut të Vlorës. Këto takime synonin të paraqisnin PS-në dhe draftin e Strategjisë së qëndrueshme të zhvillimit rajonal, si dhe ndërmarrjen e studimeve për projekte të mundshme ose për projektide për t'u përfshirë në PS. Qëllimi ishte rritja e pjesëmarrjes në qeverisje vendore dhe promovimi i rolit drejtues të qeverisjes rajonale në proces. Të gjitha takimet u mbajtën me kërkesë të Kryetarit të Qarkut dhe përfshinin një përfaqësim tërësor të procesit në vazhdimësi të planifikimit strategjik, duke u fokusuar në fazën e tij finale, që është përcaktimi i projekteve të zhvillimit. Gjatë takimeve, një ekspert i PS-së u shoqërua dhe u mbështet vazhdimisht nga koordinatori lokal i ART GOLD 2, nga stafi i AULEDA-s dhe nga dy anëtarët e stafit rajonal. Të gjithë aktorët territorialë të cilët morën pjesë në takime, shprehën aprovimin dhe vlerësimin e tyre për procesin e planifikimit strategjik dhe gatishmërinë për të dorëzuar projekt-propozime për zbatimin e tij.

Fokus Grupet

18 dhe 19 Prill 2011

Pas aktivitetit prezantues, Ditët e Hapura dhe raundi i takimeve me bashkitë dhe komunat, Fokus Grupet (FG) prezantuan një hap të mëtejshëm drejt nxitjes së diskutimeve demokratike mbi projektet për zhvillimin e integruar, për të zbatuar dhe për të arritur veprimet e Planit Strategjik. Fokus Grupet u organizuan në formën e tryezave të vogla e të rumbullakëta dhe synonin:

- Analizimin e thellë të veprimeve dhe të kategorive të projekteve të përfshira në Strategjinë e zhvillimit rajonal, të cilat u ndanë më parë dhe për të cilat u ra dakord
- Mbledhjen dhe koordinimin e projekteve konkrete (përtej projekteve me prioritet të

propozuara dhe të projektuara tashmë nga (GTM) për të zbatuar veprimet duke u fokusuar veçanërisht te projektet që përfshijnë krijimin e rrjeteve (ndërmjet burimeve, vendeve, institucioneve etj.)

- Nxitjen e aktorëve territorialë për të bashkëpunuar dhe për të zbatuar nismat e zhvillimit, pra duke nxitur krijimin e partneriteteve publike-publike dhe publike-private.

Takimet u mbajtën në Vlorë dhe Sarandë, me qëllim vazhdimin dhe përmirësimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve rajonalë në proces. Gjashtë FG-të (tre në Vlorë dhe tre në Sarandë) u organizuan, u fokusuan te Udhëzuesit Strategjikë (të grupuar siç duhet), për të theksuar qasjen efikase të diskutimeve. FG-të u emërtuan si më poshtë:

- *FG1: Veprimet për turizmin, kulturën dhe mjedisin*, që synojnë diskutimin dhe zhvillimin e veprimeve të Udhëzuesve Strategjikë 1,4 (për sa i përket arsimimit dhe trajnimit mbi turizmin, kulturën dhe mjedisin), 5 dhe 6.
- *FG2: Veprimet për produktivitetin*, lidhur me veprimet që kanë të bëjnë me Udhëzuesit Strategjikë 2, 3, 4 (për sa i përket arsimimit dhe trajnimit që lidhen me sektorin e bujqësisë dhe peshkimit) dhe 7.
- *FG3: Veprimet për zhvillimin social*, të fokusuara mbi veprimet që lidhen me Udhëzuesit Strategjikë 4 (për sa i përket arsimimit dhe trajnimit që lidhen me sektorin social), 8 dhe 9.

Për këtë rast u krijua një broshurë që shpjegon imtësisht veprimet e PS-së dhe kategoritë e projekteve (si në anglisht ashtu dhe në shqip) dhe më pas iu shpërnda pjesëmarrësve, së bashku me një formular projekti (në shqip) për t'u plotësuar me projekt-propozime dhe ide që duhen përfshirë në Planin Strategjik. Për shkak të zgjedhjeve vendore administrative që po afronin, pjesëmarrja nuk arritë numrin e pritshëm (32 pjesëmarrës në total), prandaj dhe në çdo qytet të tre grupet e planifikuara u bashkuan në një. Megjithatë, debatet ishin mjaft konstruktive, u propozuan disa projekte konkrete dhe autoritetet rajonale konfirmuan gatishmërinë e tyre për të kontribuar në arritjen e objektivave të PS-së.

Fokus Grupet

Përfundimet dhe rezultatet e arritura

Secili takim i Fokus Grupeve përfshinte një shpjegim të shkurtër të objektivave për t'u arritur, dhe i pikave të diskutimit, me qëllimin mbështetjen dhe stimulimin e diskutimit. Të gjithë pjesëmarrësit dhanë kontributin e tyre duke propozuar nisma konkrete për të zbatuar veprimet e strategjisë së përbashkët për zhvillimin rajonal. Pas çdo debati, u nxorën përfundimet, duke bërë një përmbledhje të pikave të diskutimit dhe të rezultateve.

Në fund të Fokus Grupeve, u mblodhën 15 formularë projektsh të plotësuar.

Vlorë

18 Prill 2011

Takimi u drejtua nga ekspertët e PS-së dhe krijoi një draft me lista të projekteve të përbashkëta për t'u përfshirë në PS-në rajonale.

Propozimet kryesore ishin si më poshtë:

- Ngritja e një qendre rinore shumëfunktionale në Orikum
- Përmirësimi i parkut arkeologjik të Orikumit i cili e ka humbur pamjen e tij tërheqëse për shkak të vendndodhjes së tij brenda zonës ushtarake të Pashalimanit
- Përcaktimi i një politike marketingu për turizmin rajonal
- Krijimi i një shkolle profesionale për turizmin (një projekt i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta)
- Vendosja e një "tryeze koordinimi" së bashku me institucionet kombëtare për administrimin e monumenteve kulturore
- Ngritja e një qendre të kujdesit ditor për personat me aftësi të kufizuara në Vlorë, e integruar me një sistem fermash mësimore me qëllim sjelljen e pacientëve në kontakt me natyrën si një metodë terapeutike
- Krijimi i një baze të dhënash të shoqatave për kulturën dhe muzikën tradicionale, me qëllim koordinimin e aktiviteteve të tyre
- Kalimi i muzikës tradicionale te brezat e rinj, pra nëpërmjet koordinimit me aktivitetet e

qendrave rinore

- Përgatitja e një guide turistike për Komunën e Novoselës
- Aplikimi i Komunës së Novoselës për të marrë statusin e Parkut Rajonal për zonën e mbrojtur të Pishë-Poros
- Krijimi i një qendre sportive në Komunën e Novoselës, për të shërbyer gjithashtu për kampusin e ri universitar
- Kultivimi i ullirit kombëtar
- Shtimi i dokeve për varkat e peshkimit në portin e Vlorës
- Promovimi i prodhimit të peshkut të konservuar (ançovi dhe skumbri).



Sarandë

19 Prill 2011

Në Sarandë, ashtu si në rastin e Vlorës, ekspertët e PS-së shpjeguan statusin aktual të procesit të planifikimit strategjik dhe debatet e moderuara, ndërkohë që pjesëmarrësit kontribuan nëpërmjet ideve të tyre dhe projekteve konkrete.

Përfundimi kryesor i takimit konsistonte në një draft liste të projekteve të përbashkëta për t'u përfshirë në PS-në rajonale.

Propozimet kryesore ishin si më poshtë:

- Përmirësimi i aktiviteteve të peshkimit duke përmirësuar portet ekzistuese për varkat e peshkimit, duke ndërtuar një kantier detar për mirëmbajtjen dhe riparimin e varkave, si dhe rritja e cilësisë dhe e sigurisë së produkteve të akuakulturës në lagunën e Butrintit
- Rregullimi i aktiviteteve të peshkimit
- Administrimi i mbetjeve të ndërtimeve dhe shkatërtimeve
- Rregullimi i zallishteve dhe aktiviteteve të tjera nxjerrëse që kanë një ndikim të lartë të mjedisi
- Krijimi i lidhjeve ndërmjet barinjve, artizanëve

- dhe tregjeve turistike për të përmirësuar aktivitetet artizanale tradicionale të tekstileve duke përdorur leshin e deleve dhe të dhive
- Zhvillimi i arsimit të lartë lidhur me restaurimin e monumenteve
- Restaurimi i monumenteve
- Plotësimi i axhendës së aktiviteteve me organizimin e festivaleve për të promovuar produktet ushqimore karakteristike dhe kuzhinën tradicionale
- Krijimi i markave dhe përmirësimi i standardizimit të produkteve agroushqimore për eksporte.



  	<p>STRATEGIC PLANNING OF VLORA REGION <i>"TOWARDS SUSTAINABLE DEVELOPMENT"</i> www.vloraregionstrategicplanning.eu</p>	 	<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">FOKUS GRUPET PRILL 2011</p>
<h3>PROPOZIM PROJEKTESH</h3>			
<p>Në kuadër të procesit të planifikimit strategjik, Fokus Grupet kanë si qëllim të identifikojnë propozime projektesh për të arritur objektivat e strategjisë për zhvillim rajonal. Jeni i ftuar për të dhënë kontributin tuaj duke propozuar ndërhyrje konkrete që ju konsideroni të dobishme për zbatimin e Veprimeve të planit strategjik.</p> <p>Ju lutemi, plotësoni formularin me shkronja të mëdha duke shkruar emrin dhe kontaktin tuaj, titullin dhe karakteristikat kryesore të propozimit tuaj duke specifikuar Veprimin të cilit i referohet.</p>			
<p>TE DHENAT TUAJA PERSONALE</p>			
<p>Emri:</p> <p>Mbiemri:</p> <p>Kontakti:</p> <p style="margin-left: 20px;">Tel.:</p> <p style="margin-left: 20px;">Fax:</p> <p style="margin-left: 20px;">E-mail:</p>		<p>PROPOZIMI JUAJ</p> <p>Titulli i projektit:</p> <p>Veprimi referues:</p> <p>Përshkrim i shkurtër i Projektit:</p>	
<p>Emri:</p> <p>Mbiemri:</p> <p>Kontakti:</p> <p style="margin-left: 20px;">Tel.:</p> <p style="margin-left: 20px;">Fax:</p> <p style="margin-left: 20px;">E-mail:</p>		<p>Titulli i projektit:</p> <p>Veprimi referues:</p> <p>Përshkrim i shkurtër i Projektit:</p>	
<p>UNDP ARTGOLD 2 Albania AGA2 www.artgold.undp.org.al</p>		<p>AULEDA www.auleda.org</p>	

Lartë: një moment nga Fokus Grupet në Sarandë.

Poshtë: Formulari për mbledhjen e projekteve të propozuara të shpërndarë grupeve të interesit nëpër Fokus Grupe

3.3. 10 Paketat e Projekteve për zhvillimin rajonal

Aktorët territorialë të përfshirë në procesin e pjesëmarrjes propozuan një numër të madh projekt-idesh për zbatimin e strategjisë së përbashkët të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal. U sugjeruan edhe ide të tjera nga ekspertët e PS-së, bazuar në rezultatet e debateve dhe të takimeve të mbajtura me institucionet në nivel kombëtar. Një tjetër grup i projekt-ideve erdhi nga analizat e kryera nga një prej ekspertëve të ILS LEDA-s për zinxhirët e vlerave të rajonit.

Me qëllim dhënien e një perspektive më të gjerë për këto propozime dhe ide, u përcaktuan 10 Paketa Projektësh, të cilat trajtojnë aspektet dhe zonat kryesore të cilat aktorët territorialë i kanë konsideruar vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal. 10 Paketat e Projekteve përmbajnë një total prej 112 projektësh. Ashtu siç është shpjeguar më parë, Paketat e Projekteve janë "kuti mbajtëse" ku projektet që trajtojnë të njëjtat tema dhe/ose të njëjtat pjesë të territoreve rajonale lidhen me të njëjtën ide dhe janë të integruara me njëra-tjetrën duke krijuar kështu sinergji dhe ndërveprime. Kështu, projektet mund të kontribuojnë në mënyrë më të efektshme për arritjen e vizionit "Territor me zero emetime" dhe për ripërcaktimin e rolit të qarkut në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar. Paketat e propozuara të Projekteve janë si më poshtë:

1. "Turizmi tematik në Qarkun e Vlorës" – Trashëgimisë kulturore dhe zonave natyrore në qark u mungojnë politikat e koordinuara për përmirësim, prandaj dhe shpesh janë të neglizhuara, të nënvlerësuara dhe hyrja në to është e vështirë. Paketa e Projekteve propozon krijimin e një sistemi të integruar të qarqeve turistike duke përfshirë një rrjet vendesh arkeologjike, kështjella, manastire, vende natyrore, struktura akomodimi, ambiente turistike dhe shërbime. Ndërhryjet mund të përfshijnë: restaurimin e vendeve historike dhe të rrethinave të tyre, krijimin e infrastrukturës së përshtatshme për aksesin dhe shfrytëzimin turistik (rrugica, vende parkimi, tualete publike, kabina biletash, dyqane me suvenire etj.), dizenjimin dhe prodhimin e materialeve promovuese në shumë gjuhë, vendosja e shërbimeve turistike (guida,

transporti, etj.), trajnimin e burimeve njerëzore, sistemet e integruara të biletave etj. Paketa e Projekteve përmban 53 projekte.

2. "Markat për produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës" – Megjithëse produktet ushqimore rajonale janë përfaqësuese të forta të identitetit shqiptar dhe kanë një potencial të fortë për zhvillim dhe karakteristika të cilësisë së mirë, ato njihen dhe vlerësohen vetëm në tregun lokal dhe kombëtar. Prandaj dhe qëllimi është përmbushja e zinxhirëve të vlerave (duke përfshirë përpunimin dhe tregtimin), nxitja dhe mbështetja e shoqatave të prodhuesve, me qëllim që të nxitet përmirësimi, futja e markave dhe e çertifikimeve dhe hedhja e produkteve të Qarkut të Vlorës në tregjet ndërkombëtare. Paketa e Projekteve përmban 18 projekte.

3. "Mbrotjtja e ujit dhe e tokës" – Territori rajonal është i kërcënuar rëndë nga mungesa e sistemeve të administrimit të mbetjeve dhe të ujit të ndotur si dhe nga ndërtimet e pakontrolluara të cilat kërcënojnë ekuilibrin hidrogeologjik dhe duke shkaktuar rrëshqitje të tokës, erozion dhe përmytje. Këto probleme përbëjnë rrezik për sigurinë e njerëzve dhe gjithashtu kanë një ndikim negativ në pamjen tërheqëse turistike. Prandaj dhe Paketa e Projekteve synon ruajtjen dhe mbrotjtjen e burimeve natyrore siç është uji, uji i detit dhe toka, duke rregulluar dhe ulur ndikimin e aktiviteteve njerëzore në to dhe duke programuar dhe ndërmarrë ndërhyrje parandaluese të efektshme. Paketa e Projekteve përmban 7 projekte.

4. "Rrugët detare në qarkun e Vlorës" – Shtrirja e madhe e vijës bregdetare dhe shfuqizimi i ndalimit të motobarkave në të ardhmen në Shqipëri e bën të arsyeshme planifikimin e zhvillimit të një rrjeti të porteve të shpërndarë në mënyrë më të barabartë në qark, të specializuar dhe të integruar me zonat rrethuese urbane dhe joubane (nëpërmjet krijimit të bregdeteve tërheqëse dhe gjallëruese) dhe të lidhur me anë të shërbimi efikas të transportit detar. Në këtë rrjet, rol kryesor do të kenë portet turistike, të cilat mund ta ndihmojnë Qarkun e Vlorës të hyjë në tregun turistik të zotëruesve të barkave për

shëtitje, të cilët udhëtojnë në Mesdhe, nga Greqia në Kroaci dhe anasjelltas. Paketa e Projekteve përmban 6 projekte.

5. "Artizanati i Qarkut të Vlorës" – Megjithëse produktet artizanale rajonale janë përfaqësuese të forta të identitetit lokal dhe kanë një potencial të fortë për zhvillim, sidomos në lidhje me tregun e turizmit, ato njihen dhe vlerësohen vetëm në tregun lokal dhe kombëtar. Për më tepër, ato janë të kërcënuara nga emigracioni, nga migrimi i brendshëm dhe nga mungesa e promovimit dhe e komunikimit. Paketa e projekteve synon të garantojë qëndrueshmërinë për produktet artizanale karakteristike, duke përhapur "njohuritë" te brezat e rinj, duke rritur ndërgjegjësimin mbi rolin e artizanatit në krijimin e identitetit rajonal dhe duke përcaktuar një markë dhe politika marketingu të koordinuara, për të futur produktet artizanale të Qarkut të Vlorës në tregjet ndërkombëtare. Paketa e Projekteve përmban 3 projekte.

6. "Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës" – Infrastruktura bazë, siç janë rrjetet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe ai i ujërave të zeza, rrjetet e furnizimit me energji dhe rrjetet e besueshme të TIK-ut ose mungojnë ose janë të papërshtatshme në Qarkun e Vlorës. Ky problem prek sidomos zonat rurale dhe të thella, ku realizimi i rrjeteve të shërbimeve bazë është i vështirë. Paketa e Projekteve rrjedh nga ideja se shërbimet bazë janë një kërkesë themelore për zhvillimin e turizmit dhe të biznesit. Për më tepër, zhvillimi i zonave të izoluara kërkon përmirësimin e lidhjeve – jo vetëm "fizike", por gjithashtu "virtuale" - me pjesën tjetër të qarkut dhe të botës. Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) mund të përfaqësojnë mjetin kryesor për komunitetet rurale në zonat e thella që të kenë akses në informacion, shërbime, arsimim dhe mundësi punësimi, për të promovuar territorin, aktivitete dhe produktet e tyre në mbarë botën si dhe për të nxitur të rinjtë që të qëndrojnë dhe të punojnë në fshatrat e tyre. Paketa e projekteve përmban 4 projekte.

7. "Rrjeti për përkujdesjen sociale në Qarkun e Vlorës" – Paketa e projekteve është e fokusuar në idenë (e cila është e përbashkët për disa aktorë territorialë dhe nga FSHZH-ja) e rinovimit të ndërtesave të vjetra e të braktisura (shpesh ish-ndërtesat shtetërore) dhe transformimi i tyre në ambiente për përkujdesje sociale (për fëmijët, të moshuarit, për personat me aftësi të kufizuara, etj.) dhe/ose në vende

për aktivitete sociale dhe kulturore. Qëllimi është rritja e kohezionit social, përfshirjen dhe dialogun ndërmjet brezave me komunitetet lokale. Paketa e Projekteve përmban 9 projekte.

8. "Fëmijët e Qarkut të Vlorës" – Aktivitetet pjesëmarrëse theksuan rëndësinë e edukimit dhe të përkujdesjes së fëmijëve dhe gjithashtu luftën kundër përjashtimit social të minoriteteve etnike. Kjo është arsyeja pse PS-ja rajonale parashikoi një Udhëzues Strategjik dedikuar fëmijëve dhe adoleshentëve. Prandaj dhe Paketa e Projekteve përmban të gjitha propozimet e fokusuar te fëmijët, duke i konsideruar ata të ardhmen e qarkut dhe mirëqenien e tyre si një çështje thelbësore për të ndërtuar një shoqëri më të bashkuar dhe gjithëpërfshirëse. Paketa e Projekteve përmban 7 projekte.

9. "Shëndeti në Qarkun e Vlorës" – Përmirësimi i ambienteve të kujdesit shëndetësor dhe krijimi i një rrjeti qendrash shëndetësore për komunitetin, për të ndihmuar si banorët ashtu dhe turistët që udhëtojnë në zonat jurbane, ishin nevojat kryesore në këtë sektor që u ngritën gjatë takimeve të konsultimeve publike. Përbushja e këtyre nevojave është vendimtare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e jetës, si për popullsinë rajonale, ashtu dhe për vizitorët. Paketa e Projekteve përmban 3 projekte.

10. "Punësimi i grave në Qarkun e Vlorës" – Proçesi i pjesëmarrjes theksoi barazinë gjinore si një çështje të rëndësishme në shoqërinë rajonale. Gratë duket se janë të angazhuara shumë në shoqatat jofitimprurëse, megjithatë në përputhje me tendencat kombëtare, pjesëmarrja e tyre në tregun e punës mbetet e pamjaftueshme. Paketa e projekteve synon të mbështesë punësimin e grave dhe sipërmarrjen nga ana e tyre në sektorët që konsiderohen të rëndësishëm për përmirësimin territorial dhe për zhvillimin ekonomik të qarkut. Kjo Paketë projekti është e lidhur ngushtë me Paketat e Projekteve 8 dhe 9, pasi krijimi i shërbimeve dhe i strukturave për fëmijët, për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara mund të ndihmojë gratë për të rifituar kohën e nevojshme për punësim dhe për aktivitete sipërmarrëse. Paketa e Projekteve përmban 2 projekte.

Diagram i mëposhtëm tregon lidhjen midis 10 Paketave të Projekteve dhe Strategjisë së Zhvillimit Rajonal, ndërsa Tabela 1 tregon Veprimet e PS-së që u referohen Paketave të Projekteve.

STRATEGJIA
9 UDHËZUESIT STRATEGJIKË

33 VEPRIMET

PLANI I VEPRIMIT
10 "PAKETAT E PROJEKTEVE"




Tabela 1. Paketat e Projekteve dhe lidhja e tyre me Veprimet e Planit Strategjik	
<i>Paketa e Projektit</i>	<i>Veprimet e Planit strategjik si referencë</i>
Turizmi tematik në Qarkun e Vlorës (53 projekte)	<p>1.1. Shërbimet e informacionit për turistët, komunikim dhe marketing i efektshëm territorial</p> <p>1.2. Kualifikimi dhe rritja e larmisë së strukturave të akomodimit</p> <p>1.3. Vlerësimi dhe integrimi i identiteteve kulturore, e peizazhit dhe e burimeve mjedisore për zhvillimin dhe diferencimin turistik</p> <p>1.4. Përmirësimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve për turizmin</p> <p>3.2. Ruajtja e ekosistemeve të lagunës</p> <p>4.5. Arsimimi dhe trajnimi lidhur me sektorët kyç për zhvillimin rajonal</p> <p>5.1. Njohja, ruajtja, restaurimi dhe kualifikimi i pasurive historike</p> <p>5.2. Përmirësimi i zinxhirëve të vlerave që lidhen me prodhimin dhe trashëgiminë kulturore</p> <p>6.1. Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonave natyrore, i peizazheve dhe ruajtja e biodiversitetit</p> <p>7.1. Përmirësimi i rrjeteve të transportit për të përmirësuar aksesin territorial dhe konkurrencën</p>
Markat për produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës (18 projekte)	<p>2.1. Promovimi i produkteve tipike dhe rritja e produkteve cilësore për qëllime eksporti</p> <p>2.2. Nxitja e grupimit të prodhuesve</p> <p>2.3. Nxitja dhe mbështetja e aksesit të sipërmarrjeve në kredimarrje për fermerët, mbarështuesit dhe artizanët</p> <p>3.1. Finalizimi dhe vlerësimi i zinxhirëve të vlerave për produktet e peshkut</p> <p>3.3. Rinovimi i pikave kufitare tokësore dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara të ankorimit</p> <p>3.4. Racionalizimi dhe përforsimi i sistemit të infrastrukturës për të mbështetur prodhimin me një vizion të integruar</p> <p>4.5. Arsimimi dhe trajnimi lidhur me sektorët kyç për zhvillimin rajonal</p>
Mbrojtja e ujit dhe e tokës (7 projekte)	<p>2.2. Nxitja e grupimit të prodhuesve</p> <p>6.2. Ruajtja e burimeve të ujit dhe administrimi i ciklit të qarkullimit të ujit</p> <p>6.3. Administrimi i mbetjeve të ngurta ekologjikut të qëndrueshme</p> <p>6.4. Mbrojtja e territorit nga rreziku hidrogeologjik</p>
Rrugët detare në Qarkun e Vlorës (6 projekte)	<p>3.3. Rinovimi i pikave kufitare tokësore dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara të ankorimit</p> <p>7.1. Përmirësimi i rrjeteve të transportit për të përmirësuar aksesin territorial dhe konkurrencën</p> <p>9.4. Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe i cilësisë urbane në qytete dhe fshatra</p>
Artizanati i Qarkut të Vlorës (3 projekte)	<p>4.5. Arsimimi dhe trajnimi lidhur me sektorët kyç për zhvillimin rajonal</p> <p>5.2. Përmirësimi i zinxhirëve të vlerave që lidhen me prodhimin dhe trashëgiminë kulturore</p> <p>8.1. Përforsimi i integritit social dhe lufta kundër varfërisë nëpërmjet programeve të punësimit</p>
Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës (4 projekte)	<p>4.5. Arsimimi dhe trajnimi lidhur me sektorët kyç për zhvillimin rajonal</p> <p>6.2. Ruajtja e burimeve të ujit dhe administrimi i ciklit të qarkullimit të ujit</p> <p>7.2. Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK)</p> <p>7.3. Promovimi i energjisë së rinovueshme dhe i kursimit të energjisë</p>
Rrjeti i përkujdesjes sociale në Qarkun e Vlorës (9 projekte)	<p>8.2. Përmirësimi dhe rinovimi i shërbimeve të kujdesit social</p>
Fëmijët e Qarkut të Vlorës (7 projekte)	<p>8.2. Përmirësimi dhe rinovimi i shërbimeve të kujdesit social</p> <p>9.3. Rritja e përfshirjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në aktivitetet sociale dhe kulturore dhe në zbulimin e trashëgimisë kulturore</p> <p>9.4. Përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe i cilësisë urbane në qytete dhe fshatra</p>
Shëndetësia në Qarkun e Vlorës (3 projekte)	<p>4.5. Arsimimi dhe trajnimi lidhur me sektorët kyç për zhvillimin rajonal</p> <p>8.3. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore publike</p>
Gratë e punësuar në Qarkun e Vlorës (2 projekte)	<p>8.1. Përforsimi i integritit social dhe lufta kundër varfërisë nëpërmjet programeve të punësimit</p>
Numri total i projekteve: 112	

Tabela e të dhënave për Paketat e Projekteve

Tabelat e mëposhtme të të dhënave japin më shumë detaje rreth secilës Paketë Projekti: ato sigurojnë një përshkrim të shkurtër të projekteve që përmbajnë, specifikojnë burimin e projekteve (nëse këto të fundit janë propozuar nga aktorët lokalë, ekspertët, aktorët e bashkëpunimit ndërkombëtar, etj.) dhe përfshijnë shënime paraprake mbi partnerët e mundshëm për t'u përfshirë dhe mbi procedurat e nevojshme për zbatimin e projekteve.

Përveç kësaj, tabelat e të dhënave tregojnë se si PS-ja ishte në gjendje të përfshinte dhe të koordinonte përfundimet e programeve të tjera UNOPS siç është ILS LEDA dhe IDEASS.


Në veçanti:

- Analizimi i burimeve prodhuese nëpërmjet metodologjisë së kërkimit të veprimit, i zbatuar nga ILS LEDA në qark, çoi në

përcaktimin e 4 projekteve pjesëmarrëse "modulare", të bazuara fort në realitetin social-ekonomik, të cilat u përfshinë në Paketat specifike të Projektit lidhur me artizanatin dhe me prodhimet agrourbore; u sugjeruan ide të tjera për projektin, bazuar në veprimet dhe hapat për zhvillimi ekonomik lokal në Qarkun e Vlorës, të propozuara nga eksperti i ILS LEDA-s.

- Katalogu i IDEASS dhe faqja e internetit përmbajnë disa metodologji të reja të cilat mund të aplikohen lehtësisht në territorin rajonal; tabelat me të dhënat e Paketave të Projektit tregojnë në mënyrë të qartë eksperiencën e IDEASS e cila mund të merret si një model reference (sidomos nga pikëpamja e menaxhimit dhe e organizimit) për zbatimin e projekteve specifike të sugjeruara nga aktorët lokalë.

Lidhja ndërmjet Paketave të Projekteve dhe programeve UNOPS, IDEASS dhe ILS LEDA



Paketa 1 e projektit Turizmi tematik në Qarkun e Vlorës

53 Projekte

Projekti/projekt-propozimet/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
<i>Mikpritja, pritja e turistëve dhe marketingu</i>			
Përmirësimi i kapitalit njerëzor në turizëm (Shoqata Shqiptare e Turizmit - ATA)	4.5 1.4	<p>Projekti përfshin 3 aktivitete kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> Krijimi i një softueri për rezervimin e hotelit nëpërmjet internetit për qarkun. Tre kurse trajnimi bazë 3-javore për turizmin, duke synuar punonjës për restorante, hotele dhe agjenci udhëtimi. Promovimin e rezultateve të projektit, përveç të tjerave, nëpërmjet një manuali të praktikave më të mira europiane të shërbimeve turistike. <p>Kostoja e projektit është rreth 36 000 USD.</p>	Për përgatitjen e softuerit do të kontraktohet një shoqëri me eksperiencë. Aktivitetet e trajnimit do të zbatohen nga anëtarët e asociuar dhe partnerët e ATA-s, të specializuar në trajnimin profesional mbi turizmin
Trajnimi i guidave turistike të specializuara në trashëgiminë kulturore dhe turizmin kulturor në qark	4.5	<p>Mungesa e shoqëruesve turistikë konsiderohet një problem serioz nga aktorët territorialë. Projekti do të fokusohet sidomos në identifikimin e subjektit(ëve) i cili do të merret me menaxhimin e burimeve njerëzore, pasi të trajnohet.</p>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, ATA, Ministria e Turizmit
"Turizëm@Arsim"	5.1 4.5	<p>Projekti ndahet në 3 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Krijimi i një harte dixhitale interaktive të trashëgimisë kulturore dhe të turizmit në Shqipëri për të mbështetur itineraret turistike në internet, duke përfshirë informacione të detajuara dygjuhëshe për vendet e trashëgimisë kulturore në Shqipëri (pozita gjeografike, historiku, përshkrimi, statusi aktual dhe ndërhyrjet e kryera për restaurim, bibliografia, pamjet), të nëndara në kategori dhe të klasifikuara sipas periudhës së tyre kohore. Mbështetja e aktivitetëve trajnuesë për zhvillimin e turizmit. Përgatitja e një plani komunikimi për të rritur vizibilitetin e turizmit kulturor. Plani do të përfshijë vendosjen e 4 itinerareve multimediale pilote që do të hidhen në faqen e internetit të MTKR-së dhe organizimi i aktivitetëve promovuesë. 	Partnerë: PNUD-i në Shqipëri, Ministria e Turizmit, e Inovacionit dhe TIK-ut, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Universita del Molise, TIK CNR, Instituti Shqiptar i Monumenteve, Universiteti i Turizmit (Tiranë), Institucionet lokale, Babelia & C. (zbatimi i aktivitetëve trajnuesë) Projekti ka nevojë të lidhet reciprokisht dhe të integrohet me projektet e tjera që synojnë përgatitjen e guidave turistike dhe të hartave ("Guida turistike dhe harta e Qarkut të Vlorës dhe krijimi i faqeve turistike rajonale në internet")
Guida turistike dhe harta e Qarkut të Vlorës dhe krijimi i faqeve turistike rajonale në internet	1.1	<p>Krijimi dhe zbatimi i një faqeje interneti që përmban informacione rreth asaj çfarë mund të bësh në këtë qark, përfshirë itineraret virtuale dhe informacionin dixhital. Faqja e internetit do t'u japë mundësinë turistëve të shkarqojnë materiale informuese - broshura, harta të hollësishme të itinerareve, guida për zona të rëndësishme dhe vende të trashëgimisë kulturore etj. - me një çasje modulare dhe të personalizuar, në përputhje me prijet aktuale të tregut turistik.</p> <p>Përmbajtja e faqes së internetit do të krijojë një guidë turistike virtuale modulare dhe lehtësisht të përditësueshme, përfshirë një hartë të qarkut dhe të itinerareve siç është udhëtimi në Parkun Kombëtar të Llogorasë, ekskursione natyrore nëpër luginën e Shushicës, qarqet kulturore etj.</p>	Partnerë të mundshëm: Qeverisja vendore (menaxhimi i faqes së internetit), Dhoma e Tregtisë dhe universitetet (krijimi i përmbajtjes); një disenjues faqeje interneti do të kontraktohet për të krijuar faqen e internetit. Projektet kanë nevojë të lidhen reciprokisht dhe të integrohen me projektet kombëtare që synojnë përgatitjen e guidave dhe hartave të zonave turistike.
Guida turistike (Dhoma e tregtisë)			
Guidë për ekskursione në natyrë nëpër luginën e Shushicës (Komuna Horë-Vranisht)			

Projektit/projekt-propozimit/projekt-ideitë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Pikat e informacionit turistik në Vlorë dhe Sarandë	1.4	Krijimi i 2 pikave të informacionit turistik në qytetet kryesore të qarkut, të ndëriudhura siç duhet nëpërmjet një intraneti, të cilat do të ofrojnë informacion të përditësuar mbi vendet që mund të vizitohen, si dhe shërbime të rezervimit të hoteleve, të pensioneve që ofrojnë mëngjesin dhe strukturave të agroturizmit. Projekti do të përfillojë nga zhvillimi i një softueri për rezervimin e hotelit në internet (projekti "Përmirësimi i kapitalit njerëzor mbi turizmin") dhe nga rezultatet e projekteve si "Guida turistike dhe harta e Qarkut të Vlorës dhe krijimi i një faqeje turistike rajonale në internet", "Krijimi i një harte dixhitale interaktive të trashëgimisë kulturore dhe të turizmit në Shqipëri", dhe "Krijimi dhe promovimi i një axhende aktiviteteve në Qarkun e Vlorës".	Partnerë të mundshëm: ATA, Ministria e Turizmit, strukturat e akomodimit dhe shërbimet turistike (të lidhura sipas preferencës)
Nismat për Turizmin me bazë komunitetin në Bashkinë e Himarës (CRCD)	1.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Rinovimi i shtëpive tradicionale për turizëm familjar	1.2	Krijimi i rrjetit të shtëpive tradicionale për t'u përdorur për akomodimin e turistëve. Projekti mund të zbatohet metodologjikisht që ofron eksperiencë italiane "Compagnia dei Parchi", të përfshirë në katalogun e IDEASS. CDP-ja është një konsorcium novator, jofitimprurës, me përgjegjësi të kufizuar, me një strukturë organizative të përbërë nga një zyrë qendrore (përgjegjëse për rezervimet dhe promovimin e turizmit) dhe nga një rrjet strukturash ortake akomodimi në zona të mbrojtura, që promovohen nëpërmjet internetit, panairëve tregtare dhe lidhjeve në faqet e internetit për turizmin. CDP-ja nxit gjithashtu zhvillimin e shërbimeve të reja që lidhen me turizmin.	Projekti mund të përfshijë AULEDA-n, pasi do të nevojiten grante për të ndihmuar fermerët që të investojnë në rinovimin e shtëpive. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të materialeve dhe të teknologjive tradicionale, ekologjikisht miqësore dhe zbatimit të masave për kursimin e energjisë.
Hapësira të reja parkimi në destinacionet kryesore turistike	1.4	Krijimi i zonave të reja të parkimit në destinacionet kryesore turistike (Vlorë, Orikum, Llogora, Dhërmi, Himarë, Sarandë, Ksamil, Butrint). Hapësirat e parkimit do të krijohen në raport të ngushtë me atraksionet turistike rajonale kryesore. Vendpikimet do të projektohen e ndërtohen në bazë të kriterëve ekologjike, me materiale dhe teknologji ekologjike, me qëllim që të minimizohet efekti negativ mbi mjedisin dhe peizazhin.	Projekti do të zbatohet nga autoritetet vendore. Mund të parashikohet edhe një pagesë për parkimin, që do të përbënte një të ardhur shtesë për administratën vendore.
Tualetet publike në zonat turistike	1.4	Ndërtimi i tualeteve publike në zonat kryesore turistike. Projekti do të respektojë rregulloret ndërkombëtare për ndërtesat që u lejojnë aksesin invalidëve.	Projekti do të zbatohet nga autoritetet vendore. Menaxhimi i tualeteve publike mund t'u caktohet gjithashtu kontraktuesve privatë.
<i>Aksesi në zonat turistike</i>			
Rehabilitimi i rrugës Vlorë-Kuç-Borsh	7.1	Rehabilitimi në të gjithë gjatësinë e saj i rrugës kombëtare që lidh luginën e Shushicës me qytetin e Vlorës dhe Himarën. Projekti i përgjigjet një nevojë të shprehur nga kryebashkiaku i Shushicës, i cili shpjegoi se ndërtimi i rrugës do të lehtësojë, si transportin për njerëzit, ashtu dhe për produktet bujqësore dhe blegtorale.	Projekti është përfshirë tashmë në Planin për Zhvillimin e Bregdetit Jugor të Shqipërisë. FSHZH-ja mund të jetë një partner i mundshëm për zbatimin e projektit.
Rehabilitimi i rrugëve që lidhin fshatrat e luginës së Shushicës me rrugët kombëtare	7.1	Projekti ndërlidhet ngushtë me projektin e mëparshëm ("Rehabilitimi i rrugës Vlorë-Kuç-Borsh) dhe ka për qëllim të krijojë kushtet për ta kthyer luginën e Shushicës në një destinacion turistik kryesor në qark.	FSHZH-ja mund të jetë një partner i mundshëm.
Rehabilitimi dhe integrimi i rrjetit të rrugëve rurale	7.1	Rehabilitimi i rrugëve rurale synon të përmirësojë aksesin në zonat që janë interesante për turistët: do t'i jepet prioritet rrugëve që të çojnë te kalatë, te fshatrat karakteristike, te rrenojat arkeologjike, etj.	FSHZH-ja mund të jetë një partner i mundshëm.
Rehabilitimi i rrugës Ksamil-Butrint (Komuna Ksamil)	7.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	FSHZH-ja mund të jetë një partner i mundshëm.

Projektet/projekt-propozimet/projekt-ide të (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përkrahimi i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
<i>Rrjetet turistike të trashëgimisë</i>			
Rrjeti turistik arkeologjik	5.1	Krijimi dhe promovimi i koordinuar i një rrjeti vendesh arkeologjike rajonale (Butrinti, Finiqi, Amantia, Orikumi, etj.), duke pasur parqun arkeologjik të Butrintit si atraksionin kryesor. Krijimi i një sistemi të integruar biletarie me veçori të ndryshme për objektiva të ndryshme për të nxitur turistët.	Ministria e Turizmit dhe Instituti shqiptar i Monumenteve duhet të përfshihen në mënyrë aktive.
Përmirësimi i shërbimeve turistike në Parkun Arkeologjik të Finiqit (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare - DRKK, Sarandë)	5.1	Projekti përfshin: rregullimin e rrugës hyrëse në park; shtrirjen dhe planin e ri urbanistik të rrugëve për këmbësorët; ndërtimin e kabinave të biletarëve; rrethimin e monumenteve; krijimin e 2 zonave të pushimit për turistët; mbjelljen e pemëve të ullirit përgjatë rrugës kryesore; vendosjen e koshave të mbeturinave përgjatë rrugicës kryesore dhe pranë monumenteve; aktivitetet promovuese. Kostoja e projektit është rreth 30 000 USD.	Stafi i parkut, i mbështetur nga ekspertët e Institutit të Monumenteve të Kulturës, do të zbatojë projektin. Kompanitë e ndërtimit do të paraqesin ofertat për ndërrhyjet infrastrukturorë. Do të kontraktohen një ekspert i jashtëm për të monitoruar dhe mbikëqyrur projektin.
Muzeu i Finiqit (Komuna Finiq)	5.1 5.2	Ndërtimi dhe vënia në funksionim e Muzeut të Finiqit, që do të përdoret gjithashtu si qendër kulture dhe artizanati, me hapësira që do t'i dedikohen shifjes së produkteve artizanale.	Mund të krijohen lidhje të mundshme me projektin "Pazari i madh i Vlorës" dhe mund të vendosen partneritete me shoqatat e artizanëve.
Restaurimi i qendrës arkeologjike të Amantias	5.1	Aksesi në qendrën arkeologjike të Amantias, në luginën e Shushicës, është i vështirë për turistët, kryesisht për shkak të rrjetit të varfër rrugor. Aksesi i vështirë dhe promovimi i pak të mund ta çojnë qendrën drejt shkatërrimit. Projekti përfshin restaurimin e rrënojave të qytetit dhe përfshirjen e Amantias si "destinacionin përfundimtar" të tinerarit turistik në luginën e Shushicës.	Partnerë të mundshëm: Universiteti, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Restaurimi i qendrës arkeologjike të Orikumit	5.1	Momentalisht, aksesi në parkun arkeologjik të Orikumit është i vështirë, pasi ky i fundit përfshihet brenda zonës ushtarake. Prania e ndërtesave ushtarake të braktisura përbën gjithashtu një pengesë për shfrytëzimin e turizmit dhe kërcënon ekosistemin e lagunës. Nevojiten gërmime të tjera për ta nxjerrë në dritë qytetin antik. Si rezultat, qendra mund të bëhet objekt i një projekti të integruar, që do të përfshijë gërmimet në zonën arkeologjike, rehabilitimin mjedisor të lagunës dhe mbrojtjen e saj, që do të bëhet, ndërmjet të tjerash, duke hequr ndërtesat ushtarake të braktisura.	Partnerë të mundshëm: Universiteti, Ministria e Turizmit, Instituti shqiptar i monumenteve, Ministria e Mbrojtjes. Do të arrihet një marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes për rehabilitimin dhe shfrytëzimin e qendrës.
Rrjeti turistik i kalave	5.1	Krijimi dhe promovimi i koordinuar i një rrjeti kalash (Porto Palermos, Bors, Himarë, Butrint etj.), që kanë si pikë kryesore atraksionin Kalanë e Porto Palermos. Krijimi i një sistemi të integruar biletarie me veçori të ndryshme për objektiva të ndryshme për të nxitur turistët.	Partnerë të mundshëm: Universiteti, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve, ATA
Restaurimi i Kalasë së Porto Palermos dhe rehabilitimi i zonave përreth saj	5.1	Vendi i Kalasë së Porto Palermos ka potencialin për t'u kthyer në një atraksion kryesor turistik, për shkak të vlerave kulturore dhe peizazhore. Zbatimi i projektit "Rehabilitimi i rrugës Vlorë-Kuç-Bors" do të risë aksesin në zonat e thella duke e kthyer atë në kryqëzim për itineraret turistike në qark. Projekti do të merret me restaurimin dhe menaxhimin e saj, si dhe me restaurimin dhe rinovimin e ndërtesave pranë saj, që për momentin janë të shkatërruara.	Partnerë të mundshëm: Universiteti, Ministria e Turizmit, Instituti shqiptar i monumenteve, Ministria e Mbrojtjes. E gjithë zona e Porto Palermos mund të bëhet objekt i një projekti të integruar, që do të trajtojë gjithashtu çështjen e rigjenerimit të ndërtesave ushtarake. Do të arrihet një marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes për rehabilitimin.

Projektit/projekt-propozimit/projekt-ideitë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Pëshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Restaurimi i Kullës së Dervish Aliut (DRKK, Vlorë)	5.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Rrjeti turistik i manastireve dhe i kishave	5.1	Krijimi dhe promovimi i koordinuar i rrjetit të manastireve dhe të kishave bizantine, me pika kryesore atraksioni Zvërnecin dhe Rrethin e Delvinës.	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, ATA
Restaurimi i Manastirit të Zvërnecit (DRKK, Vlorë)	5.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Restaurimi i Kishës së Shën Gjergjit, Sarandë (Drejtoria e Kulturës, Sarandë)	5.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Manastiri i Shën Nikollës, Mesopotam (Drejtoria e Kulturës, Sarandë)	5.1	Manastiri i fortifikuar, i ndërtuar ndoshta në epokën e perandorit Konstandin IX (1042-1054), përfshin kishën me të njëjtin emër të Shën Nikollës. <i>Nevojitet informacion i mëtejshëm rreth projektit.</i>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Restaurimi i Bazilikës së Shën Janit, Delvinë (Drejtoria e Kulturës, Sarandë)	5.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Ndërrhyrje në mozaikët e Bazilikës (Sinagogës), Sarandë (Drejtoria e Kulturës, Sarandë)	5.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Restaurimi i Kishës së Shën Nikollës, Mesopotam (Drejtoria e Kulturës, Sarandë)	5.1	Autoritetet lokale të Komunës Mesopotam kanë përmendur gjithashtu nevojën për të përmirësuar aksesin në manastir nëpërmjet një rruge që e lidh atë me Delvinën dhe me Xhaminë e Xhemilit, duke krijuar kështu një rrugë të vogël turistike që përfshin vende të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në këtë rreth. <i>Nevojitet informacion i mëtejshëm rreth projektit.</i>	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve
Biletë e integruar për vendet e trashëgimisë kulturore	1.4	Krijimi dhe promovimi i një sistemi të integruar dhe modular për biletat, që u jep mundësinë turistëve të blejnë një biletë të vetme, të vlefshme për monumentet më të rëndësishme në zonë dhe për një numër të caktuar ditësh. Mund të prodhohen bileta të çmimeve të ndryshme, duke dhënë mundësi aksesit për një numër të ndryshëm atraksionesh. Biletat mund të funksionojnë gjithashtu si kuponë për të pasur ulje për produktet dhe shërbimet. Përfshirja e pikave të informacionit turistik dhe e agjencive të udhëtimit do të jetë vendimtare për suksesin e projektit.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Turizmit, ATA, agjencitë e udhëtimit
Restaurimi i "ndërtesave të vogla"	5.1	Projekti përfshin restaurimin e ndërtesave tradicionale në Dhërmi, Palas, në fshatin Qeparo, në qytetin e vjetër të Vlorës dhe rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë mbi vlerat kulturore dhe historike të tyre, gjithashtu si atraksione turistike.	Partnerë të mundshëm: Universitetet, ministria e Turizmit, pronarët e ndërtesave historike, shoqatat kulturore
"Tryeza e koordinimit" për menaxhimin e monumenteve kulturore	5.1	Fokus Grupet theksuan nevojën e një bashkëpunimi më të ngushtë dhe të koordinimit ndërmjet institucioneve lokale dhe kombëtare, që synojnë përmirësimin e efektshmërisë së politikave që lidhen me restaurimin, ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore rajonale. Tryeza do të mbledhë të gjitha autoritetet dhe institucionet përkatëse në këto fusha dhe do të ndihmojë në përcaktimin e politikave të koordinuara dhe të projekteve të përbashkëta për të përmirësuar trashëgiminë kulturore, në përcaktimin e përgjegjësisë dhe detyrave, në monitorimin e rezultateve të arritura.	Partnerë të mundshëm: Universitetet, Ministria e Turizmit, Instituti Shqiptar i Monumenteve, autoritetet vendore, vendet e trashëgimisë kulturore dhe organet e menaxhimit.

Projektit/projekt-propozimet/projekt-ideatë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
<i>Rrjetet turistike natyrore dhe sportive</i>			
Krijimi i itinerareve për sportet në luginën e Shushicës	1.3	Rehabilitimi i rrugëve ekzistuese dhe i rrugëve rurale për të formuar qarqe për turizmin sportiv (ecjet në natyrë, ecjet me biçikletë në mal, etj.). Rrugicat do të jenë të sigurta dhe të pajisura me pika vrojtimi, me zona për piknik, me shërbime të vogla si dyqanet për marrjen e biçikletave me qira dhe për riparime. Rrjeti do të përfshihet në një hartë dhe do të promovohet në faqen e internetit për turizmin rajonal (shihni më lart).	Lugina e Shushicës mund të kthehet në objekt të një projekti të integruar, për integrimin e aspekteve natyrore, kulturore dhe prodhuese. Partnerë të mundshëm: Ministria e Turizmit, FSHZH-ja, shoqatat që operojnë në fushën (e turizmit malor, turizmit sportiv, etj.), subjektet private.
Zhvillimi i sportit të fluturimeve (Shoqata e aeronautikës)	1.3	Projekti përfshin: identifikimin e vendeve për fluturime dhe ngritjen e një shkolle dhe të qendrave të trajnimit për sportin e fluturimeve në territorin e qarkut, që të menaxhohet nga shoqata e pilotëve; krijimi i një infrastrukture dhe i shërbimeve për pilotët dhe vizitorët; mbështetja e aktiviteteve që lidhen me sportin e fluturimeve dhe me qendrat e sportit të fluturimeve. Projekti, në bashkëpunim me organet ndërkombëtare, do të punojë gjithashtu për të hartuar rregulloret e sportit të fluturimeve.	Shoqata e aeronautikës do të zbatojë projektin në bashkëpunim me shoqatat e pilotëve.
Ambiente sportive bashkëkohore (Komuna Armen)	1.3	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Qendër sportive për fshatrat (Komuna Livadhja)	1.3	Krijimi i një rrjeti të qendrave sportive në fshatrat kryesore, që funksionojnë si atraksione për grupet e fshatrave fqinje dhe që ofrojnë ambiente sportive dhe gjithashtu shërbime për turistët.	Autoritetet vendore mund të përfshijnë investuesit privatë në zbatimin e projektit dhe në administrimin e qendrave sportive.
Parku botanik i florës mesdhetare (Komuna Ksamil)	1.3	Hyrja në park do të jetë drejtpërdrejt nga Butrinti, për të bashkuar vlerat kulturore dhe mjedisore.	
Turizmi kurativ në Ksamil (Komuna Ksamil)	* 1.3	Ngritja e një qendre të integruar për turizmin kurativ, duke përfshirë këtu një hotel dhe një qendër tregtare si dhe ofrimin e fizioterapisë dhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Projekti mund të kontribuojë në vlerësimin e ujërave kurative në zonën e liqenit të Butrintit, një nevojë kjo e cila u ngrit gjatë Ditëve të Hapurës.	Partnerë të mundshëm: Universitetet shqiptare dhe të huaja (është kontaktuar Universiteti i Vjenës) dhe investuesit privatë. Mund të zhvillohen sinergji të mundshme me novacionin e IDEASS "Zhvillimi i burimeve hidrotermale në Shqipëri me anë të metodologjive të reja" (partnerë: Shoqata B.A.ZH, Universiteti i Padovës).
Fillimi i ndërtimit të parkut rajonal në luginën e Shushicës (Komuna Horë-Vranisht)	6.1	Kjo ide vjen si një vazhdim logjik i projektit të PNUD-it "Lumi Vlorë", i cili hodhi idenë e krijimit të një parku rajonal në luginën e Shushicës për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, sidomos në sektorin e ekoturizmit. Lugina ka potenciale të forta për të realizuar aktivitetet e ecjeve në natyrë.	Në vitin 2006 u krijua një Komitet Promovimi për parkun. Projekti do të ecë në vazhden e kësaj eksperience dhe do të (ri)vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe të Bujqësisë.
Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në zonën e Butrintit	6.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Krijimi i një qendre universitare për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të detit dhe të ligatinave	3.2 6.1	Ideja është që të krijohet një qendër kërkimore që të fokusohet në çështjet e mjedisit, veçanërisht të trajtojë problemet e detit dhe të ligatinave, të cilat janë ekosisteme shumë të rëndësishme dhe pika atraksioni turistike në qark.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Mjedisit, universitetet

Projektit/projekt-propozimet/projekt-ideitë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
<i>Rrjetet turistike natyrore dhe sportive</i>			
Zona e mbrojtur e lagunës së Orikumit	3.2	Laguna e Orikumit është laguna e vetme në qark e cila nuk është deklaruar si një zonë e mbrojtur, pavarësisht rëndësisë së saj si një kuadër mjedisor i Parkut Arkeologjik të Orikumit. Prezenca e bazës ushtarake të Pashalimanit ka ndihmuar në ruajtjen e ligatinave nga ndërtesat e pakontrolluara, por zona është e mbuluar tashmë me ndërtesa ushtarake të braktisura dhe me pajisje, me shumë gjasa të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin. Përcaktimi i një zone të mbrojtur mund të nxisë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm kulturor dhe natyror dhe mund të ndihmojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe të peizazhit.	Zona e përcaktuar rishtazi nën mbrojtje mund të menaxhohet nëpërmjet përfshirjes së komunitetit lokal, duke marrë si model metodologjinë e IDEASS "Menaxhimi i qëndrueshëm i parkut kombëtar detar La Caleta nga komuniteti" (Republika Dominikane)
Parku rajonal Pishë-Poro	3.2	Qëllimi i propozimit është ruajtja e një zone të gjerë në Komunën e Novoselës, në veri të lagunës së Nartës, me vlerë të madhe natyrore dhe peizazhore, duke e transformuar atë një park rajonal dhe duke nxitur frytëzimin e qëndrueshëm turistik të saj, të lidhur gjithashtu me turizmin bregdetar.	Komuna e Novoselës do të aplikojë për të marrë statusin e parkut rajonal për zonën Pishë-Poro.
Vrojimi i zogjve në lagunën e Nartës	3.2 6.1	Laguna e Nartës strehon 195 specie zogjsh dhe përfaqëson vendin e dytë më të madh në Shqipëri për zogjtë e detit. Gjatë dimrit ajo tërheq rreth 23% të zogjve që migrojnë në Shqipëri. Me qëllim përcaktimit e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme në zonë, synimi i projektit është të organizojë itinerare për vrojimin e zogjeve në lagunë, duke përfshirë dhe së fundmi duke trajnuar anëtarët e komunitetit lokal (peshkatarë, zotërues barkash, etj) që të shërbejnë si shoqërues.	Aktivitetet turistike në zonën e mbrojtur mund të menaxhohen nëpërmjet përfshirjes aktive të komunitetit lokal, duke iu referuar metodologjisë së zbatuar në eksperiencën e IDEASS "Menaxhimi i qëndrueshëm i parkut kombëtar detar La Caleta nga komuniteti" (Republika Dominikane)
<i>Prodhimi kulturor</i>			
"Sistemi kulturor i Vlorës"	5.2	Hapi 1 (Trashëgimia kulturore dhe kapitali relaciona) <ul style="list-style-type: none"> Kryerja e studimit për trashëgiminë kulturore rajonale dhe shoqatat kulturore Krijimi i <i>Sistemit kulturor të Vlorës</i> si një rrjet ndërmjet aktorëve lokalë të kulturës Përfshirja e aktorëve lokalë të kulturës në subjektin qeverisës të Auleda-s Ndërtimi i një harte të trashëgimisë kulturore të Vlorës Hapi 2 (Prodhimi kulturor) Rikuperimi i "njohurive" lidhur me prodhimin e instrumenteve muzikore tradicionale Mbledhja e njohurive lidhur me zhanret e vjetra tradicionale muzikore (iso-polifonia) dhe nxitja e përhapjes së tyre Racionalizimi dhe përmirësimi i cilësisë së ofertës aktuale kulturore të qarkut Nxitja e sinergjive ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe krijimtarisë bashkëkohore nëpërmjet krijimit të rrjeteve të reja Hapi 3 ("Sistemi i vendeve") Krijimi i një sistemi të integruar të vendeve të <i>Kulturës materiale</i> të vendeve" Organizimi dhe mbështetja e menaxhimit të "Sistemeve të vendeve" Hapi 4 (Prodhimi multimedial) Projektimi dhe realizimi i një "Laboratori multimedia" <i>Shënim nga iNExT studio:</i> Projekti mund të nxisë gjithashtu zhvillimin e galerive të artit në qytetet kryesore, për të mbështetur artistët lokalë – një nevojë kjo që u ngrit gjatë Ditëve të Hapurave. Mund të merret parasysh gjithashtu krijimi i një baze të dhënash të shoqatave kulturore që merren me muzikën tradicionale, për të koordinuar aktivitetet e tyre (një nevojë kjo që u ngrit gjatë Fokus Grupeve).	Partnerë të mundshëm: <ul style="list-style-type: none"> AULEDA (zbatim) Qeverisja vendore Bashkitë dhe komunat që kanë trashëgimi kulturore materiale/jomateriale Artizanë që prodhojnë instrumente muzikore tradicionale Bizneset që tregtojnë produkte kulturore (përfshirë tregtinë nëpërmjet internetit) Shkollat dhe universitetet Institutet e trajnimit profesional Prodhuesit e punëve artistike tradicionale dhe multimediale dixhitale Shoqatat kulturore Institucionet në sektorin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore Hapi 2 mund të zbatohet gjithashtu në koordinim me aktivitetet e qendrave rinore.

Projektet/projekt-propozimet/projekt-ide të (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Trashëgimia kulturore nëpërmjet iso-polifonisë (Qendra kulturore "Aulona")	5.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Guida e eksperiencave të muzikës isopolifonike në luginën e Shushicës (Komuna Horë-Vranisht)	5.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Kinema në Komunën e Novoselës (Komuna Novoselë)	5.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Iso-Polifonia dhe trashëgimia shpirtërore (Qendra kulturore "Aulona")	5.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
"Vlerat etnografike që nuk zhduken" (Bashkia Vlorë)	5.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
"Promovimi i vlerave kulturore" (Komuna Novoselë)		<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Krijimi dhe promovimi i një axhende të aktiviteteve në Qarkun e Vlorës	5.2	Krijimi i një axhende të koordinuar dhe të përditësuar vazhdimisht të aktiviteteve që ekzistojnë në qark dhe projektimi i aktiviteteve të reja periodike për të përmirësuar identitetin kulturor rajonal dhe për të tërhequr turistët nga e gjithë Shqipëria dhe nga jashtë vendit. Axhenda do të publikohet në faqet e internetit të institucioneve kombëtare, rajonale e lokale dhe në faqe të tjera interneti, që u dedikohen çështjeve të lidhura me turizmin.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Turizmit, qeverisja vendore, shoqatat kulturore. Projekti është i lidhur ngushtë me projektet "Sistemi kulturor në Vlorë", "Guida turistike dhe harta e Qarkut të Vlorës, si dhe krijimi i një faqeje interneti për turizmin në qark" dhe "Turizëm@Arisim".

Legjenda

- Projekt-ide të sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-ide të u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteteve pjesëmarrëse
- Projekt-ide të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunat gjatë takimeve për konsultim
- Projektfishat e dorëzuar nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
- * Projekt-ide të që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 2 e Projektit Markat për produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës

18 Projekte

Projekti/projekt-propozime/projekt-ide të (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përkrahjet i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Mbështetje për sipërmarrjet e reja në sektorin e përpunimit të ushqimit	2.3	Nxitija e ngritjes së sipërmarrjeve të reja rurale, sidomos strukturat e agroturizmit dhe të turizmit rural; dhe sipërmarrjet e përpunimit të ushqimit për të përpunuar produktet vendase tipike, të përcaktuara nga një ekspert i ILS LEDA-s: frutat, mjalti, midhjet, peshku dhe qumështi. Mbështetja mund të ofrohet nëpërmjet granteve, trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve, analizimit të tregut, sigurimit të informacionit lidhur me fondet e disponueshme kombëtare dhe ndërkombëtare.	Partnerë të mundshëm: AULEDA dhe shoqatat e prodhuesve
Ndërtimi i strukturave të magazinimit të produkteve bujqësore në luginën e Shushicës	2.2	Pjesëmarrja theksorë nevojën e magazinave për ruajtjen e produkteve bujqësore. Këto struktura mund të ngrihen në godina të papërdorura (të restauruara sipas kriterëve pro mjedisit) dhe të menaxhohen nga shoqatat e fermerëve.	Partnerë të mundshëm: AULEDA dhe shoqatat e fermerëve
Tregu bujqësor, Ksamil (Komuna Ksamil)	2.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Partnerë të mundshëm: AULEDA dhe shoqatat e fermerëve
Përmirësimi i zinxhirit të vlerave të Ullirit (hartuar në bazë të veprimeve të propozuara nga ILS LEDA për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës)	2.1 2.2 2.3 4.5	<p>Projekti synon krijimin e kushteve bazë për të rritur produktivitetin e zinxhirit të vlerave, përmes përmirësimit të sigurisë, cilësisë dhe promovimit të produkteve të tij dhe zhvillimit të shoqatave përfaqësuese të prodhuesve. Aktivitetet dhe hapat kryesorë janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e kohezionit dhe e krijimit të rrejtit në zinxhirin e vlerave të Ullirit <ul style="list-style-type: none"> Nxitija e kohezionit të prodhuesve individualë duke mbështetur përfshirjen e tyre në shoqata të cilat ose ekzistojnë ose janë krijuar rishtazi. Nxitija e krijimit të një Forumi në Vlorë për Ullirin, me pjesëmarrjen e shoqatave të prodhuesve. Forumi do të ketë misionin për të planifikuar dhe për të zbatuar strategji të koordinuara për prodhimin, novacionet dhe tregimin. Përfshirja e shoqatave në Partneritetin Lokal të AULEDA-s. Promovimi i sinergjive me aktorët lokalë të zinxhirëve të vlerave të Peshkut dhe të Frutave dhe të Bimëve. Përmirësimi i produktivitetit të zinxhirit të vlerave të Ullirit <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e Forumit në organizimin e kurseve të trajnimit për nivelet bazë dhe të avancuar në aktivitetet bujqësore dhe të përpunimit. Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve të reja dhe të laboratorëve të përpunimit. Çertififikimi i sipërmarrjeve të zinxhirit të vlerave të Ullirit <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e sipërmarrjeve në arrijeten e cilësisë ISO, HACCP dhe çertififikimit organik. <p><i>Përmirësimi i tregimit dhe i promovimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Analizimi i tregjeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përpunimi i strategjive të tregut sipas tij. Nxitija e kërkimeve shkencore të aplikuara rreth karakteristikave bio-kimike dhe të ushqyerjes për produktet e zinxhirit të vlerave të Ullirit të Vlorës dhe nxitija e aktiviteteve edukuese rreth ushqimeve për konsumatorët rajonalë. Krijimi dhe promovimi i një marke cilësore të Vlorës për produktet e Ullirit. Përcaktimi i distributorëve kombëtarë dhe të huaj dhe menaxhimi i aktivitetit përfaqësues në lidhje me ta. 	Partnerë të mundshëm: AULEDA, fermerët dhe prodhuesit (individualisht dhe në partneritet), këshilluesit e jashtëm (për të ofruar konsulentë në lidhje me çështjet specifike), aktorët e sektorit të mikpritjes (për të mbështetur tregimin dhe promovimin e produkteve). Projekti është i lidhur ngushtësisht me projektin "Promovimi i Ullinjve Kallinjot" (shiko më poshtë).
Promovimi i Ullinjve Kallinjot (Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore – QTTB, Vlorë)	2.1	Projekti përfshin dy aktivitete kryesore: blerja e një centrifuge dyfazore për të futur teknologjinë e avancuar në prodhimin e vajit; aktivitetet promovuese: udhëtimet demonstruese, strategjia përmes medias, fletëpalosjet promovuese, tryezat e rumbullakëta me specialistë nga ky sektor dhe fermerët që prodhojnë dhe nxjerrin vajin e ullirit.	Subjektet zbatuese: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në bashkëpunim me "Shoqatën e ullinjve Kallinjot"

Projektit/projekt-propozimit/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Brief description	Shënime mbi zbatimin
<p>"Bimët mjekësore të Vlorës"</p>	<p>2.1 2.2 2.3 4.5</p>	<p>Hapi 1 (Puna me zinxhirët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kryerja e studimit mbi bimët aromatike dhe mjekësore të qarkut Nxjtja e kultivimit të bimëve dhe aktivitetet e qëndrueshme për mbledhjen e burimeve gjenetike të pakultivueshme Promovimi i shoqatave lokale të prodhuesve dhe mbledhësve të bimëve, përfshirja e tyre në partneritetin lokal të AULEDA-s Organizimi i sistemeve të Kontrollit të Cilësisë dhe të Sigurisë Ushqimore Mbështetja e emërimit (krijimit të një marke) dhe paketimit të produkteve të freskëta e të thara Gjetja e tregjeve të përshatshme, kombëtare, ballkanike dhe ndërkombëtare, gjetja e distributorit përfundimtar në tregjet e përcaktuar dhe garantimi i një negocimi dhe ndërmjetësimi Organizimi i "Rrjetit të bimëve të Vlorës" <p>Hapi 2 (Përpunimi)</p> <ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i mundësive për përpunimin e bimëve dhe i konkurrencës Përcaktimi i proceseve organike të prodhimit <p>Hapi 3 (Krijimi i sipërmarrjeve)</p> <ul style="list-style-type: none"> Projektimi i trajnimit të avancuar (trajnimi profesional dhe të mësuarit nëpërmjet aktiviteteve) Zhvillimi i aktiviteteve të trajnimit për përpunimin e bimëve, krijimin e sipërmarrjeve dhe menaxhimin e tyre Përcaktimi i proceseve organike të prodhimit Promovimi dhe mbështetja globalisht e sipërmarrjeve për përpunimin e bimëve 	<p>Partnerë të mundshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> AULEDA (zbatimi) Qeverisja vendore Bashkitë dhe komunat Prodhuesit e bimëve mjekësore Mbledhësit e bimëve mjekësore Sipërmarrjet që punojnë në sektorët e përpunimit kimik dhe të paketimit Sipërmarrjet që merren me aktivitetet e eksportit Institutet e trajnimit profesional Kompanitë që krijojnë faqe interneti
<p>Ndërtimi i një strukture magazinimi për bimët mjekësore në luginën e Shushicës</p>	<p>2.2</p>	<p>Anketimet dhe takimet theksuan nevojën për magazinën për ruajtjen e bimëve. Këto struktura mund të ngrihen në mënyrë të papërdorura (të restauruara sipas kriterëve pro mjedisit) dhe të menaxhohen nga mbledhësit e bimëve dhe fermerët në bashkëpunim.</p>	<p>Partnerë të mundshëm: AULEDA dhe shoqatat e mbledhësve të bimëve dhe fermerëve</p>
<p>Përmirësimi i zinxhirit të vlerave të Verës (hartuar në bazë të veprimeve të propozuara nga ILS LEDA për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës)</p>	<p>2.1 2.2 2.3 4.5</p>	<p>Projekti synon krijimin e kushteve bazë për të rritur produktivitetin e zinxhirit të vlerave, përmes përmirësimit të sigurisë, cilësisë dhe promovimit të produkteve të tij dhe zhvillimit të shoqatave përfaqësuese të prodhuesve. Aktivitetet dhe hapat kryesorë janë si vijon:</p> <p><i>Mbështetja e kohëzimit dhe e krijimit të rrjetit në zinxhirin e vlerave të Verës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxjtja e kohëzimit të fermerëve individualë dhe të punishteve të verës duke mbështetur përfshirjen e tyre në shoqata të cilat ose ekzistojnë ose janë krijuar rishtazi. Nxjtja e krijimit të një Forumi të Verës në Vlorë, ku do të marrin pjesë shoqatat e prodhuesve, me misionin e planifikimit dhe të zbatimit të strategjive të koordinuara për prodhimin, novacionin dhe tregtimin. Përfshirja e shoqatave në Partneritetin Lokal të AULEDA-s. <p><i>Përmirësimi i produktivitetit rajonal të zinxhirit të vlerave të Verës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e Forumit në organizimin e kurseve të trajnimit për nivelet bazë dhe të avancuar. Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve të reja të vogla dhe individuale dhe e laboratorëve e fidanishteve të varieteteve endogjene të rrushit (gjithashtu nëpërmjet Fondit të Garancisë). <p><i>Çertifkimi i sipërmarrjeve të zinxhirit të vlerave të Verës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e sipërmarrjeve në arritjen e cilësisë ISO, HACCP dhe çertifkimit organik. <p><i>Përmirësimi i tregimit dhe i promovimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Analizimi i tregjeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përpunimi i strategjive të tregut sipas tij. Nxjtja e kërkimeve shkencore rreth karakteristikave të cilësisë së produkteve të Verës së Vlorës dhe nxjtja e aktiviteteve të edukimit rreth ushqimeve për konsumatorët në qark. Krijimi dhe promovimi i një marke cilësore të Vlorës për produktet e Verës, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Përcaktimi i distributorëve kombëtarë dhe të huaj dhe menaxhimi i aktivitetit përfaqësues në lidhje me ta. 	<p>Partnerë të mundshëm: AULEDA, fermerët dhe prodhuesit e verës (individualisht dhe në partneritet), këshilluesit e jashtëm (për të ofruar konsulencë në lidhje me çështjet specifike), aktorët e sektorit të mikpritjes (për të mbështetur tregtimin dhe promovimin e produkteve). Projekti është i lidhur ngushtë me projektin "Prodhimi i verërave me cilësi të lartë me varietete vendase" (shihni më poshtë).</p>










Projekt/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Prodhimi i verërave të cilësisë së lartë me varietete vendase (Shoqata e Agrobiznesit)	2.1	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Partnerë të mundshëm: AULEDA dhe Shoqata e Agrobiznesit
Tregu i mjaltit (Komuna Horë-Vranisht)	2.2	Tregu, i cili mund të ndërtohet në Komunën Horë-Vranisht, do t'u sigurojë blëtarëve të luginës së Shushicës një vend për tregimin e mjaltit, duke përmirësuar kështu zinxhirin ekzistues të vlerave të Blëfës. Tregu mund të pajiset gjithashtu me shërbime veterinarie, shërbime të kontrollit të cilësisë, shërbime biznesi, etj. dhe të menaxhohet me anë të përfshirjes së shoqatave të prodhuesve të mjaltit.	Partnerë të mundshëm: AULEDA dhe shoqatat e prodhuesve të mjaltit
"Peshkimi në Vlorë"	3.1 3.4 4.5 2.1 2.2	Hapi 1 (Puna me kapitalin relaciona) <ul style="list-style-type: none"> Kryerja e studimit të aktiviteteve të peshkimit në Rrethin e Vlorës Përfshirja e peshkatarëve në shoqatën ekzistuese të Peshkatarëve të Vlorës Mbledhja e informacionit rreth aktiviteteve të peshkimit në Sarandë Promovimi i Shoqatës së Peshkatarëve të Sarandës dhe përfshirja e peshkatarëve në të Përfshirja e Shoqatave të Peshkatarëve në Partneritetin Lokal të AULEDA-s Kryerja e studimit të prodhuesve të ullinjve Kallinjot dhe të përpunuesve të ullinjve Promovimi i "Shoqatës Vlorjate të Kallinjotit" dhe përfshirja në të e prodhuesve të Kallinjotit dhe e përpunuesve të ullinjve Hapi 2 (Tregjet e peshkut) <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e trajnimit për negociatorët tregtarë, që do të punësohen në tregjet ushqimore. Zhvillimi i aktiviteteve të trajnimit Identifikimi, rikthimi në gjendje normale apo restaurimi dhe pajisja e plotë e 2 ndërtesave ekzistuese (një në Vlorë dhe një në Sarandë) si tregje peshku Hapi 3 (Restorantet) <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e kurseve të trajnimit për punonjësit e kateringut. Zhvillimi i aktiviteteve të trajnimit Identifikimi, rikthimi në gjendje normale apo restaurimi dhe pajisja e 2 ndërtesave ekzistuese (një në Vlorë – zona e Triportit – dhe një në Sarandë) dhe pajisja e certifikimi i tyre si restorante Hapi 4 (Prodhimi pilot i konservave të peshkut) <ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i konservimit tradicional dhe inovativ të peshkut (Vlorë, Sarandë) Mbështetja teknike dhe e specializuar, me qëllim zhvillimin e proceseve të sigurta, cilësore dhe organike të frutave të detit të konservuara (si në vaj edhe natyrale) Hapi 5 (Ngritja e sipërmarrjes) <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i aktiviteteve të trajnimit Pjesëmarrja në panairët ndërkombëtare të ushqimeve Hapi 5 (Ngritja e sipërmarrjes) <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja globale për krijimin e 2 sipërmarrjeve të reja (Vlorë, Sarandë) për prodhimin e konservave të peshkut 	<ul style="list-style-type: none"> Partnerë të mundshëm: <ul style="list-style-type: none"> AULEDA (zbatim) Qeverisja vendore Bashkitë dhe komunat bregdetare Bashkitë e komunat e qarkut, ku prodhohen ullinjët Kallinjot dhe vaji ekstra i virgjër Kallinjot Shoqatat e peshkatarëve Shoqatat e prodhuesve të ullirit Aktivitetet e përpunimit të ushqimit (konservat e peshkut) Aktivitetet për prodhimin e vajit të ullirit Aktivitetet e prodhimit të materialeve për paketim Aktivitetet e ndërtimit Tregtarët e peshkut Aktivitetet e eksportit të ushqimit Hotelet, restorantet, aktivitetet e kateringut Institutet e trajnimit profesional Kompanitë që krijojnë faqe interneti Mund të krijohen sinerji me projektin prioritar "Promovimi i Ullinjve Kallinjot". Gjatë Fokus Grupeve, shoqatat e peshkatarëve dhe Drejtoria e Vlorës shprehën interesin e tyre për projektin e ndërtimit të një fabrike për përpunimin e peshkut të konservuar (ançovi dhe skumbri).
Zgjerim i dokut në Manastirin e Demës (Drejtoria Kombëtare e Peshkimit)	3.3	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Rikonstruktimi i pikës së komandimit në kanalën Butrint-Bistricë (OMP, Butrint)	3.4	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	

Projektet/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
<p>Përmirësimi i standardeve të cilësisë së molusqeve në përputhje me rregulloret e Komunitetit Europian (Organizata e Menaxhimit të Peshkimit – OMP, Butrint)</p>	<p>2.1</p>	<p>Projekti përfshin 5 aktivitete të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Heqja e guaskave të molusqeve nga laguna e Butrintit dhe eliminimi i mbeturinave të guaskave; 2. Matja e parametereve mikrobiologjike të produktit përpara dhe pas ndërrhyrjes dhe krahasimi i rezultateve me rregulloret e BE-së; 3. Organizimi i një Konference Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e kërkuesve shkencorë vendas dhe të huaj; 4. Disenimi dhe botimi i një fletëpalosjeje ku përfshihet informacion rreth molusqeve, kuadrit ligjor për prodhimin e tyre dhe hapat që duhen ndjekur për arrijten e standardeve të BE-së për sigurinë e ushqimit; 5. Përgatitja e një faqeje interneti për të promovuar shoqatën, projektin dhe aktivitetet që lidhen me të. 	<p>Aktiviteti 1: Mund të kontraktohet një kompani për të marrë përsipër punën;</p> <p>Aktiviteti 2: të zbatohet nga OMP-ja në bashkëpunim me universitetet dhe me institucionet kombëtare; Aktiviteti 3: të zbatohet nga OMP-ja, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Vlorës;</p> <p>Aktiviteti 4: Fletëpalosja do të përgatitet nga stafi i OMP-së për projektin; Aktiviteti 5: Do të kontraktohet një kompani me eksperiencë për të përgatitur faqen e internetit.</p>
<p>Përmirësimi i zinxhirit të vlerave të Bletës (hartuar në bazë të veprimeve të propozuara nga ILS LEDA për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës)</p>	<p>2.1 2.2 2.3 4.5</p>	<p>Projekti synon krijimin e kushteve bazë për të rritur produktivitetin e zinxhirit të vlerave, përmes përmirësimit të sigurisë, cilësisë dhe promovimit të produkteve të tij dhe zhvillimit të shoqatave përfaqësuese të prodhuesve. Aktivitetet dhe hapat kryesorë janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Mbështetja e kohëzimit dhe e krijimit të rrjetit në zinxhirin e vlerave të Bletës</i> • Nxjtja e kohëzimit të bletarëve individualë dhe përpunuesve të produkteve të bletëve duke mbështetur përfshirjen e tyre në shoqata të cilat ose ekzistojnë ose janë krijuar rishtazi. • Nxjtja e krijimit të një Forumi në Vlorë për bletët, me pjesëmarrjen e shoqatës së bletarëve dhe përpunuesve të produkteve të bletëve. Forumi do të ketë misionin për të planifikuar dhe për të zbatuar strategji të koordinuara për prodhimin, novacionet dhe tregtimin. • Përfshirja e shoqatave në Partneritetin Lokal të AULEDA-s. • Nxjtja e sinergjive ndërmjet aktorëve lokalë të zinxhirit të vlerave të Bletës, Frutave, Perimeve dhe të Bimëve. <p><i>Përmirësimi i produktivitetit të zinxhirit të vlerave të Bletës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e Forumit në organizimin e kurseve të trajnimit për nivelet bazë dhe të avancuar në aktivitetet e rritjes së bletëve. • Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve të reja individuale dhe të vogla të rritjes së bletëve dhe e laboratorëve për përpunimin e produkteve të zinxhirit të vlerave të Bletës (gjithashtu nëpërmjet Fondit të Garancisë). <p><i>Çertifkimi i sipërmarrjeve ushqimore të zinxhirit të vlerave të Bletës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e sipërmarrjeve në arrijten e cilësisë ISO, HACCP dhe të certifikimit organik. <p><i>Përmirësimi i tregimit dhe i promovimit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizimi i tregjeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përpunimi i strategjive të tregut sipas tij. • Nxjtja e kërkimeve shkencore të aplikuara rreth karakteristikeve bio-kimike dhe të ushqyeshjes për produktet e zinxhirit të vlerave të Bletës në Vlorë dhe nxjtja e aktivitetëve edukuese rreth ushqimeve për konsumatorët në qark. • Krijimi dhe promovimi, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, i një marke cilësie të Vlorës të produkteve të bletës. • Përcaktimi i distributorëve kombëtarë dhe të huaj dhe menaxhimi i aktivitetit përfaqësues në lidhje me ta. 	<p>Partnerë të mundshëm: AULEDA, bletarët dhe përpunuesit e produkteve të bletëve (Individualisht dhe në partneritet), këshilluesit e jashtëm (për të ofruar konsulencë në lidhje me çështjet specifike), aktorët e sektorit të mikpritjes (për të mbështetur tregtimin dhe promovimin e produkteve).</p>

Projektet/projekt-propozimet/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
<p>Përmirësimi i zinxhirit të vlerave të Pijeve Alkoolike (hartuar në bazë të veprimeve të propozuara nga ILS LEDA për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës)</p>	<p>2.1 2.2 2.3 4.5</p>	<p>Projekti synon krijimin e kushteve bazë për të rritur produktivitetin e zinxhirit të vlerave, përmes përmirësimit të sigurisë, cilësisë dhe promovimit të produkteve të tij dhe zhvillimit të shoqatave përfaqësuese të prodhuesve. Aktivitetet dhe hapat kryesorë janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e kohezionit të prodhuesve individualë duke mbështetur përfshirjen e tyre në shoqata të cilat ose ekzistojnë ose janë krijuar rishtazi; përfshirja e shoqatave në Partneritetin Lokal të AULEDA-s. Nxjtja e kohezionit të prodhuesve individualë duke mbështetur përfshirjen e tyre në shoqata të cilat ose ekzistojnë ose janë krijuar rishtazi; përfshirja e shoqatave në Partneritetin Lokal të AULEDA-s. Nxjtja e krijimit të një Forumi në Vlorë për pijet alkoolike, me pjesëmarrjen e shoqatave të prodhuesve. Misioni i Forumit është të planifikojë dhe të zbatojë strategji të koordinuara për prodhimin, novacionet dhe tregtimin. Nxjtja e sinergjive me aktorët lokalë të zinxhirëve të vlerave të Frutave dhe Bimëve. <p>Përmirësimi i produktivitetit rajonal të zinxhirit të vlerave të Pijeve Alkoolike</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e Forumit në organizimin e kurseve të trajnimit për nivelet bazë dhe të avancuar në aktivitetet e përpunimit. Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve të reja individuale dhe të vogla dhe të laboratorëve të përpunimit (gjithashtu nëpërmjet Fondit të Garancisë). <p>Çertifikimi i sipërmarrjeve të zinxhirit të vlerave të Pijeve Alkoolike</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e sipërmarrjeve në arritjen e cilësisë ISO, HACCP dhe çertifikimit organik. <p>Përmirësimi i tregimit dhe i promovimit</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizimi i tregjeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përpunimi i strategjive të tregut sipas tij. Nxjtja e kërkimeve shkencore të aplikuar rreth karakteristikave bio-kimike dhe të ushqyerjes të produkteve të zinxhirit të vlerave të Pijeve Alkoolike të Vlorës dhe nxjtja e aktiviteve edukuese rreth ushqimeve për konsumatorët në qark. Krijimi dhe nxjtja e një marke cilësore të Vlorës për produktet e pijeve alkoolike, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Përcaktimi i distributorëve kombëtarë dhe të huaj dhe menaxhimi i aktivitetit përfaqësues në lidhje me ta. 	<p>Partnerë të mundshëm: AULEDA, prodhuesit e pijeve alkoolike (individualisht dhe në partneritet), këshilluesit e jashtëm (për të ofruar konsulencë në lidhje me çështjet specifike), aktorët e sektorit të mikpritjes (për të mbështetur tregtimin dhe promovimin e produkteve).</p>
<p>Përmirësimi i zinxhirit të vlerave të Mishit (hartuar në bazë të veprimeve të propozuara nga ILS LEDA për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës)</p>	<p>2.1 2.2 2.3 4.5</p>	<p>Projekti synon krijimin e kushteve bazë për të rritur produktivitetin e zinxhirit të vlerave, përmes përmirësimit të sigurisë, cilësisë dhe promovimit të produkteve të tij dhe zhvillimit të shoqatave përfaqësuese të prodhuesve. Aktivitetet dhe hapat kryesorë janë si vijon:</p> <p>Mbështetja e kohezionit dhe e krijimit të rrjetit në zinxhirin e vlerave të Mishit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxjtja e kohezionit të prodhuesve individualë duke mbështetur përfshirjen e tyre në shoqata të cilat ose ekzistojnë ose janë krijuar rishtazi; përfshirja e shoqatave në Partneritetin Lokal të AULEDA-s. Nxjtja e krijimit të një forumi në Vlorë për mishin, me pjesëmarrjen e shoqatave të prodhuesve. Forumi do të ketë misionin për të planifikuar dhe për të zbatuar strategji të koordinuara për prodhimin, novacionet dhe tregtimin. Nxjtja e sinergjive me aktorët lokalë të zinxhirit të vlerave të Frutave dhe të Peirimeve (për zonat me kullota). <p>Përmirësimi i produktivitetit rajonal të zinxhirit të vlerave të Mishit</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e Forumit në organizimin e kurseve të trajnimit për nivelet bazë dhe të avancuar në mbarrësitim dhe përpunim. Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve të reja individuale dhe të vogla, e thetoreve dhe të laboratorëve të përpunimit (gjithashtu nëpërmjet Fondit të Garancisë). <p>Çertifikimi i sipërmarrjeve të zinxhirit të vlerave të Mishit</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetja e sipërmarrjeve në arritjen e cilësisë ISO, HACCP dhe çertifikimit organik. <p>Përmirësimi i tregimit dhe i promovimit</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizimi i tregjeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përpunimi i strategjive të tregut sipas tij. Nxjtja e kërkimeve shkencore të aplikuar rreth karakteristikave bio-kimike dhe të ushqyerjes për produktet e zinxhirit të vlerave të Mishit në Vlorë dhe nxjtja e aktiviteve edukuese rreth ushqimeve për konsumatorët rajonalë. Krijimi dhe promovimi, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, i një marke cilësore të produkteve të Mishit. Përcaktimi i distributorëve kombëtarë dhe të huaj dhe menaxhimi i aktivitetit përfaqësues në lidhje me ta. 	<p>Partnerë të mundshëm: AULEDA, mbarështuesit dhe prodhuesit (individualisht dhe në partneritet), këshilluesit e jashtëm (për të ofruar konsulencë në lidhje me çështjet specifike), aktorët e sektorit të mikpritjes (për të mbështetur tregtimin dhe promovimin e produkteve).</p>

Projektit/projekt-propozimet/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
<p>Përmirësimi i zinxhirit të vlerave të Qumështit (hartuar në bazë të veprimeve të propozuara nga ILS LEDA për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës)</p>	<p>2.1 2.2 2.3 4.5</p>	<p>Projekti synon krijimin e kushteve bazë për të rritur produktivitetin e zinxhirit të vlerave, përmes përmirësimit të sigurisë, cilësisë dhe promovimit të produkteve të tij dhe zhvillimit të shoqatave përfaqësuese të prodhuesve. Aktivitetet dhe hapat kryesorë janë si vijon:</p> <p><i>Mbështetja e kohezionit dhe e krijimit të rrjetit në zinxhirin e vlerave të Qumështit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxjtja e kohezionit të prodhuesve individualë duke mbështetur përfshirjen e tyre në shoqata të cilat ose ekzistojnë ose janë krijuar rishtazi; përfshirja e shoqatave në Partneritetin Lokal të AULEDA-s. Nxjtja e krijimit të një forumi në Vlorë për qumështin, me pjesëmarrjen e shoqatave të prodhuesve. Forumi do të ketë misionin për të planifikuar dhe për të zbatuar strategji të koordinuara për prodhimin, novacionet dhe tregtimin. Nxjtja e sinergjive me aktorët lokalë të zinxhirit të vlerave të Frutave dhe të Perimeve (për zonat me kullota). <i>Përmirësimi i produktivitetit të zinxhirit të vlerave të Qumështit</i> Mbështetja e forumit në organizimin e kurseve të trajnimit për nivelet bazë dhe të avancuar në mbështetjen dhe përpunimin. Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve të reja individuale dhe të vogla artizanale cilësore dhe të laboratorëve të përpunimit (gjithashtu nëpërmjet Fondit të garancisë). Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve në arritjen e cilësisë ISO, HACCP dhe të certifikimit organik. <i>Përmirësimi i tregimit dhe i promovimit</i> Analizimi i tregjeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përpunimi i strategjive të tregut sipas tij. Nxjtja e kërkimeve shkencore të aplikuar rreth karakteristikave bio-kimike dhe të ushqyerjes për produktet e zinxhirit të vlerave të Qumështit në Vlorë dhe nxjtja e aktiviteteve edukuese rreth ushqimeve për konsumatorët në qark. Krijimi dhe promovimi, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, i një marke cilësie të Vlorës të produkteve të Qumështit. Përcaktimi i distributorëve kombëtarë dhe të huaj dhe menaxhimi i aktivitetit përfaqësues në lidhje me ta. 	<p>PPartnerë të mundshëm: AULEDA, mbarështruesit dhe prodhuesit (individualisht dhe të bashkuar), këshilluesit e jashtëm (për të ofruar konsulentë në lidhje me çështjet specifike), aktorët e sektorit të mikpritjes (për të mbështetur tregtimin dhe promovimin e produkteve).</p>

Legjenda

-  Projekt-identë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
-  Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
-  Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
-  Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
-  Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
-  Projekt-identë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteve pjesëmarrëse
-  Projekt-identë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunat gjatë takimeve për konsultim
-  Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
-  * Projekt-identë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 3 e Projektit Mbrojtja e ujit dhe e tokës

7 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Implantet për trajtimin e ujit në zonat bregdetare	6.2	Projekti synon kryesisht të ruajë detin dhe ekosistemet bregdetare, duke marrë në konsideratë gjithashtu potencialin e lartë të tyre si atraksione turistike.	Partner i mundshëm: FSHZH
Trajtimi i qëndrueshëm mjedisor i ujit në zonat rurale	* 6.2	Ideja është të promovohet përhapja e sistemeve të vogla të pastrimit, të bazuara në teknologjitë pro mjedisit, në zonat rurale dhe të thella, ku ndërtimi i impianteve më të mëdha mund të jetë financiarisht i pamundur. Projektideja frymëzohet nga metodologjia e përdorur nga IDEASS në projektin "Ligatinat e ndërtuara, sistemet e purifikimit të ujërave natyrale" (Itali).	Partnerë të mundshëm: AULEDA, institucionet dhe shoqatat për mjedisin, universitetet. Mbështetje e mundshme nga bashkëpunimi i decentralizuar.
Rehabilitimi i rrjetit të kullimit dhe ujitjes	6.2 2.2	Rehabilitimi dhe integrimi i sistemeve të kanalimit për të ujitur fushat, gjithashtu nëpërmjet rikuperimit të kanaleve të kullimit të braktisura, shpesh të mbushura me mbeturina. Projekti do të përfshijë një sistem të menaxhimit të rrjetit, i cili përfshin autoritetet vendore dhe fermerët.	Partnerë të mundshëm: Komunitat Brataj, Horë-Vranisht, Koië, Livadhja, Markat, Shushicë, Selenicë (të cilat kanë shprehur interes për këtë projekt), shoqatat e fermerëve).
Sistemi "Zero mbetje" për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve	* 6.3	Krijimi i sistemeve për menaxhimin e mbetjeve, sipas qasjes "Zero mbetje": mbetjet do të konsiderohen si burim dhe do të riciklohen sa më shumë që të jetë e mundur dhe do të konsiderohen gjithashtu si lëndë e parë për aktivitetet e tjera prodhuese, duke minimizuar kështu sasinë e materialeve që dergohen në landfillet. Studimet e fizibilitetit për zbatimin e kësaj ideje marrin si model reference praktikat më të mira që janë zhvilluar në vende të tjera, siç është programi i Aleancës për Zero Mbetje (www.zerowaste.org) dhe eksperiencat e ndryshme ekzistuese të riciklitimit dhe ripërdorimit të mbetjeve nga ndërtimet dhe shkatërrimet.	Aspektet e menaxhimit të projektidesë mund të frymëzohen nga eksperiencat e IDEASS "Pjesëmarrja e komunitetit në menaxhimin e shërbimeve lokale" (Itali).
Plani rregullator (Bashkia Sarandë)	6.4	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Përdorimi i teknologjive bioinxhinierike për tokën	* 6.4	Projektideja konsiston në aplikimin e teknologjive bioinxhinierike për tokën për të zgjidhur paqëndrueshmërinë hidrogeologjike lidhur me shpatet, rrugët malore, etj. Ajo i referohet drejtpërdrejt metodologjisë së eksperiencës së IDEASS "Bioinxhinieria për tokën" (Itali).	Partner i mundshëm: FSHZH Projekti mund të zbatohet nëpërmjet Bashkëpunimit të Decentralizuar.
Harta e rreziqeve hidrogeologjike	6.4	Krijimi i hartës dhe monitorimi i zonave me rrezik të lartë hidrogeologjik, nëpërmjet studimeve, rindërtimit historik të fenomeneve të paqëndrueshmërisë, analizave dhe kontrollit të reshjeve dhe të sistemit hidrografik sipërfaqësor, me synimin për të parandaluar rëshqitjet e tokës, përmbyrjet dhe erozionin dhe për të programuar në mënyrë të efektshme mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërrhyrjet inxhinierike.	Partner i mundshëm: Ministria e Mjedisit, universitetet.

Legjenda

- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-identë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
- Projekt-identë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 4 e Projektit Rrugët detare në Qarkun e Vlorës

7 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Studimi i fizibilitetit për zhvillimin e rrjetit të porteve	7.1 3.3	Studimi synon të përcaktojë ndërrhyjet dhe procedurat për zhvillimin dhe specializimin e porteve rajonale, duke u fokusuar në rrjetin e porteve dhe limaneve turistike për varkat e peshkimit.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Transportit, Ministria e Turizmit, FSHZH-ja, autoritetet vendore, drejtoritë e peshkimit, shoqatat e peshkatarëve.
Ndërtimi i porteve turistike	7.1	Gjatësia e brigjeve detare rajonale dhe mungesa e porteve të vogla të pajisura siç duhet justifikon ngritjen e limaneve turistike si ndalesa të ndërmjetme për udhëtarët në det, ndërmjet Greqisë dhe Kroacisë. Për këtë nevojitet një studim i detajuar i fizibilitetit.	Komuna Ksamili shprehu gatishmërinë për të ndërtuar një port të vogël në territorin e saj.
Shtimi i doko në Vlorë dhe Sarandë (Shoqatat e peshkatarëve dhe drejtoritë e peshkimit)	3.3	Kjo projektide ka si qëllim të: <ul style="list-style-type: none"> Rrisë numrin e varkave të peshkimit që mund të gjejnë strehë në porte; Rrisë numrin e punonjësve në sektorin e peshkimit; Përmirësojë infrastrukturën e portit. 	Partnerë të mundshëm: Ministria e Transportit, FSHZH-ja, autoritetet vendore, drejtoritë e peshkimit, shoqatat e peshkatarëve.
Shërbimet e transportit detar që lidhin Vlorën, Himarën, Sarandën dhe Ksamilin	7.1	Krijimi i shërbimeve të transportit që lidhin portet më të mëdha dhe destinacionet turistike të qarkut (ato ekzistueset dhe ato që do të ndërtohen) për t'u ofruar turistëve një mënyrë alternative transporti.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Transportit, investitorët privatë.
Integrimi i portit të Vlorës në strukturën urbane	7.1	Projekti për rinovimin e portit (financuar tashmë nga Kooperacioni Italian dhe i programuar për të filluar vitin që vjen) përfshin 2 zona të dallueshme: një zonë tregtare dhe një zonë detare, me 2 hyrje të mëvetëshme, të cilat duhet të lidhen siç duhet me rrugët urbane dhe me rrjetet e shërbimeve. Ky projekt synon të përcaktojë dhe të krijojë lidhjet ndërmjet portit dhe strukturës urbane të qytetit.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Transportit, Bashkia Vlorë, Shoqata e Peshkatarëve të Vlorës.
Rehabilitimi i bregdetit në qytetet dhe fshatrat bregdetare	9.4	Projektimi i ri urban për zonat bregdetare në Vlorë, Himarë e Sarandë (të paktën), për të përmirësuar pamjen tërheqëse turistike dhe cilësinë urbanistike, si dhe për të rritur numrin e hapësirave për këmbësorët si një mjedis i favorshëm për bizneset që lidhen me turizmin.	Projektet do të zbatohen nga autoritetet vendore, gjithashtu duke promovuar konkurrencën arkitekturore.

Legjenda

- Projekt-idetë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-ri
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-idetë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteve pjesëmarrëse
- Projekt-idetë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunitat gjatë takimeve për konsultim
- Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
- * Projekt-idetë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 5 e Projektit Artizanati i Qarkut të Vlorës

3 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
"Pazari i madh i Vlorës"	5.2 4.5	<p>Hapi 1 (Puna me zinxhirët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Përfundimi i studimit për burimet rajonale artistike dhe artizanale Nxirja e shoqatave dhe përfshirja e tyre në Partneritetin Lokal të AULEDA-s Gjetja e mënyrave të reja të furnizimit me materiale të lëndës së parë (sidomos në tekstilë) Gjetja e tregjeve të reja dhe të përshtatshme kombëtare, rajonale (Balkani) dhe ndërkombëtare Gjetja e distributorit final në tregjet e përcaktuara, duke siguruar negocimin dhe ndërmjetësimin Organizimi i "Rrjetit për Artin dhe Artizanatin e Vlorës" Hapi 2 (Garantimi i një të ardhmeje për artizanatin) Organizimi i një përzgjedhjeje rajonale/kombëtare për praktikuesit e rinj të artizanatit Përgatitja e trajnimit (trajnim profesional dhe të mësuarit nga zhvillimi i aktiviteteve). Zhvillimi i aktiviteteve të trajnimit për çështjet që lidhen me artizanatin dhe me krijimin e sipërmarrjeve Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve të reja në artizanat Hapi 3 (Pazari virtual) Promovimi i "Pazarit të Vlorës" si një shoqatë të shoqatave dhe si një evolucion i "Rrjetit të Artit dhe Artizanatit të Vlorës" Harta (GIS) e burimeve të artizanatit në Qark Projektimi, krijimi dhe menaxhimi i faqes së internetit të "Pazarit të Vlorës" Organizimi i i aktiviteteve të promovimit dhe komunikimit (tregtimi me jashtë) <p><i>Shënim nga iNExT studio:</i> Projekti mund të përfshijë gjithashtu krijimin e një marke për produktet artizanale të Qarkut të Vlorës, si një evolucion i "Pazarit të Vlorës". Rrjeti i shoqatave mund të funksionojë gjithashtu si një regjistër për artizanet, për të rritur cilësinë e artizanatit (një nevojë që lind gjatë Ditëve të Hapurës). Krijimi i sipërmarrjeve të reja të artizanatit (Hapi 2) mund të përfshijë punishte për përpunimin e lëkurës (një nevojë e shprehur nga kryetari i Bashkisë Horë-Vranisht).</p>	<p>Partnerë të mundshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> AULEDA (zbatimi) Qeverisja vendore Bashkitë dhe komunat Prodhuesit dhe mbledhësit e drurit Mbarëshuesit e deleve dhe të dhive Artizanët e drurit, tekstileve, hekurit dhe çelikut dhe artizanë të tjerë Artistët e artit pamor Impiantet, kompanitë e rikuperimit dhe të restaurimit Aktivitetet e importit (lënda e parë) Dyqanet e artit dhe të artizanatit dhe tregtarët Aktivitetet e eksportit (produktet artizanale dhe veprat e artit) Institutet e trajnimit profesional Spektori i prodhimit dhe i menaxhimit të produkteve artistike Shoqatat kulturore Kompanitë që krijojnë faqe interneti <p><i>Shënim nga iNExT studio:</i> Pazari virtual (Hapi 3) duhet të krijojë lidhje me organet menaxhuese të atraksioneve turistike, për hapjen e dyqaneve të vogla artizanale në vendet e trashëgimisë kulturore, si në Butrint e Finiq.</p>
Shkolla e arteve dhe e zejeve	* 4.5 5.2	<p>Debatet i Ditëve të Hapurës i përfshirë në seminarin e Çështjeve Sociale në Sarandë, ngriti një propozim për krijimin e "shkollave tradicionale" ose "shkollat e zejeve" për të vlerësuar "njohuritë" dhe aftësitë e më të vjetërve, për t'ua transmetuar ato brezave të rinj dhe për të nxitur krijimin e sipërmarrjeve artizanale, që do të mbështeten nga AULEDA.</p>	<p>Projekti mund të zbatohet me përfshirjen e AULEDA-s, me institutet e trajnimit profesional, me universitetet (Fakultetet e Shkencave Sociale) dhe me shoqatat joformale, duke marrë si model metodologjinë e IDEASS "Universiteti i Zejeve dhe i Tregtisë" (Ekuador).</p>

Projektit/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Përfshirja e grupeve vulnerabël në tregun e punës dhe të biznesit (Rajoni i Markesë)	4.5 5.2 8.1	Projekti synon të përfshijë grupet vulnerabël në tregun e punës (duke i kushtuar vëmendje të veçantë sektorëve të lidhur me artet dhe zejët rajonale) duke nxitur dhe duke dhënë mbështetje teknike për sipërmarrjet sociale. Aktivitetet e propozuara janë: krijimi i hartës së arteve dhe zejëve rajonale; transformimi i bizneseve rajonale në sipërmarrje korporatash me përgjegjësi sociale; ngritja e të paktën 5 sipërmarrjeve sociale; ngritja e qendrave për sipërmarrjet sociale dhe e Departamentit të Sipërmarrjeve Sociale të AULEDA-s; binjakëzimi me ekspertiencat italiane në Rajonin e Markesë; organizimi i një laboratorit të sipërmarrjeve sociale.	Partnerë: AULEDA dhe Rajoni i Marche-s (Itali), të mbështetura nga PNUD-i dhe Komiteti Shkencor i KIP

Legjenda

- Projekt-idetë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-idetë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteteve pjesëmarrëse
- Projekt-idetë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunat gjatë takimeve për konsultim
- Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
- * Projekt-idetë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 6 e Projektit

Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës

4 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Rritja e mundësisë për komunikim dhe marrje informacioni në zonën e Lumit të Vlorës (Komuna Armen)	7.2 4.5	<p>Projekti përfshin 6 aktivitete të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Instalimi i një rrjeti komunikimi, duke ofruar telefon, internet, TV; 2) Pajisja e shkollave me kompjuterë të lidhur me internetin; 3) Kurse trajnimi me 4 leksione për TIK-un, për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme; 4) Mbeshtetje teknike për krijimin e planit të biznesit dhe fillimi i atyre bizneseve që janë të lidhura drejtpërdrejt me sektorin e TIK-ut; 5) Fushatata promovuese të vlerave sociale, ekonomike dhe natyrore të zonës, nëpërmjet kronikave televizive, fletpalosjeve, reportazheve për zonën, CD-ve promovuese; 6) Krijimi i faqes së internetit për Lumin e Vlorës. <p>Kostoja e projektit është rreth 34 000 USD.</p>	<p>Aktiviteti 1 do të zbatohet nga partnerët italianë (përcaktimi i projektit teknik dhe trajnimi i grupeve të punës) në bashkëpunim me një grup pune të formuar nga inxhinierë ekspertë në TIK. Aktiviteti 2 do të zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Informimit Publik. Aktivitetet 4 dhe 5 do të zhvillohen nga stafi i AULEDA-s. Aktiviteti 6 do të zbatohet nga disenjuesi i faqes së internetit, i cili është kontraktuar për të krijuar këtë faqe.</p>
Përmirësimi i rrjeteve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në zonat turistike	6.2	<p>Sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve përfaqësojnë kushtet paraprake thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe duhet të përmirësohen dhe të zhvillohen në të gjithë qarkun, duke u dhënë prioritet destinacioneve kryesore turistike: Vlorë, Sarandë, Orikum, Ksamili etj. Pjesa më e madhe e projekteve janë në proces nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, financuar nga MPPT-ja dhe nga donatorë të ndryshëm (Banka Islamike, IPA, IDA, Banka Botërore, GEF, EIB, Qeveria Holandeze, Qeveria Italiane):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implantet për trajtimin e ujërave të zeza në Vlorë, Orikum, Dukat, Tragjas, Radhimë) • Furnizimi me ujë dhe sistemi i ujërave të zeza në Orikum • Sistemi i ujërave të zeza dhe ai i furnizimit me ujë në Ksamil • Furnizimi me ujë në Sarandë, Vlorë, Delvinë, Aliko-Sarandë. 	<p>Partnerë të mundshëm: MPPT, FSHZH, donatorët ndërkombëtarë.</p>
Rrjeti i furnizimit me ujë në zonat rurale	6.2	<p>Projekti u kërkua veçanërisht nga autoritetet vendore në Selenicë, Kotë, Horë-Vranisht, Mesopotam, Dhiver, Markat, Livadhja</p>	<p>Partner i mundshëm: FSHZH</p>
Rrjetet e furnizimit me energji elektrike në zonat rurale	7.3	<p>Furnizimi i vazhdueshëm me energji është një prioritet kryesor për zhvillimin rural dhe turizmin: ideja është të promovohet krijimi i rrjeteve të vogla të furnizimit me energji në zonat rurale, bazuar në burimet e energjisë së rinovueshme (hidroenergji, energjia diellore, biomasa), për të garantuar energji për fshatrat ose për grupet e fshatrave.</p>	<p>Projekti mund të zbatohet nëpërmjet Bashkëpunimit të Decentralizuar.</p>

Legjenda

- Projekt-idetë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-idetë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteteve pjesëmarrëse
- Projekt-idetë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunat gjatë takimeve për konsultim
- Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
- * Projekt-idetë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 7 e Projektit










Rrjeti i përkujdesjes sociale në Qarkun e Vlorës

9 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Restaurimi i shkollës së Dukatit (Bashkia Orikum)	8.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Qendra komunitare shumëfunktionale në Ksamil (Komuna Ksamil)	8.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Qendra e kujdesit të përditshëm për personat me aftësi të kufizuara (Shoqata e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë PLM, Vlorë)	8.2	Qendra e kujdesit të përditshëm do t'u ofrojë personave me aftësi të kufizuara shërbime të tilla si përkujdesje të përditshme për fëmijët e moshës 12-25 vjeç, shërbime psikosociale, asistencë për familjet dhe edukim parashkollor.	Partnerë të mundshëm: shoqatat jofitimprurëse që kanë në objektivat tyre personat me aftësi të kufizuara, institucionet e shëndetit publik.
Fermat mësimore	13	Qëllimi është të krijohet një rjet fermash mësimore për t'i sjellë njerëzit në kontakt me natyrën dhe me aktivitetet tradicionale dhe gjithashtu për të shërbyer si një eksperiencë terapeutike dhe socializmi. Fermat do të fokusohen te grupet e synuara, siç janë studentët e shkollave, personat me aftësi të kufizuara, të paafët mendërisht dhe kategoritë e tjera në rrezik. Aktivitetet e fermave do të koordinohen me qendrën e përditshme (shikoni më lartë).	Partnerë të mundshëm: shoqatat jofitimprurëse që kanë në objektivat të tyre personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, të burgosurit, personat që janë duke u trajtuar kundër drogës, etj.; fermerët – individualisht ose në partneritet; institucionet e shëndetit publik.
Tryeza e përhershme e negocimeve për koordinimin ndërmjet shoqatave, zyrave bashkiake dhe zyrave rajonale të punës	8.2	Projekti/idea është të ngrihet një lloj komiteti i përhershëm, i krijuar nga shoqatat jofitimprurëse dhe zyrat bashkiake dhe rajonale që merren me çështjet sociale dhe të punës, që synojnë të koordinojnë aktivitetet dhe projektet, të optimizojnë burimet, të ideojnë programet e përbashkëta. Qëllimi është të përcaktohen politika sociale të efektshme dhe të mprehta për të luftuar papunësinë dhe përjashtimin social në një mënyrë të integruar, duke vlerësuar punën e të gjithë aktorëve territorialë që operojnë në këto fusha. Në një fazë të dytë, mund të realizohet krijimi i një qendre shoqatash jofitimprurëse, ku mund të mbahen takimet e komitetit dhe ku të gjitha shoqata mund të kenë hapësirë për të punuar së bashku.	Shoqatat jofitimprurëse, zyrat bashkiake dhe zyrat rajonale të punës do të angazhohen zyrtarisht (p.sh., nëpërmjet një Memorandumi Mirëkuptimi) për t'u takuar në mënyrë periodike për vazhdimin e projektit.
Qendra e rehabilitimit në Sarandë për personat me probleme shëndetësore mendore	8.2	Qendra do të marrë si model referimi eksperiencën që është ndërmarrë tashmë në Vlorë në kuadrin e ART GOLD 1.	Partnerë të mundshëm: shoqatat jofitimprurëse që kanë në objektivat tyre personat me aftësi të kufizuara; institucionet e shëndetit publik; universitetet.
Kujdesi në shtëpi për të moshuarit	8.2	Përmirësimi i kujdesit në shtëpi për të moshuarit, sidomos duke përmirësuar trajnimet profesionale	Partnerë të mundshëm: shoqatat jofitimprurëse që kanë në objektivat të tyre të moshuarit; zyrat bashkiake dhe rajonale që trajtojnë çështjet sociale; institucionet e shëndetit publik; insitucionet e trajnimit; universitetet.

Projekti/projekt-propozimet/projekt-identë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Qendra e ndihmës për gratë	8.2	Ngritja e një qendre mbështetëse për gratë (viktima të dhunës, të pafavorizuara, gratë e kthyer nga vendet e tjera, etj.) në Sarandë.	Partnerë të mundshëm: shoqatat e grave; zyrat rajonale dhe bashkiat që merren me çështjet sociale; institucionet e shëndetit publik.
Hapësirat e restauruara për qëllime sociale	8.2	Restaurimi dhe rinovimi i ndërtesave publike të braktisura dhe të shkatëruara për t'i përdorur ato si qendra komunitare, qendra të kujdesit të përditshëm, shtëpi përkujdesjeje për të moshuarit, etj.	Partnerë të mundshëm: Komunitat Lukova dhe Dhiver, Bashkia Selenicë, Fondi Shqiptar për Zhvillim. Shoqatat jofitimprurëse që trajtojnë çështjet sociale dhe institucionet e shëndetit publik do të përfshihen në administrimin e strukturave të reja.

Legjenda

-  Projekt-identë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
-  Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
-  Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
-  Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
-  Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
-  Projekt-identë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteve pjesëmarrëse
-  Projekt-identë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunitat gjatë takimeve për konsultim
-  Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
-  * Projekt-identë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 8 e projektit Fëmijët e Qarkut të Vlorës

7 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Ristrukturimi i Teatrit të Kukullave (Qendra Komunitare për Fëmijët, Vlorë)	9.3	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Integrimi i fëmijëve egjiptianë (Shoqata "Edukuesit për të drejtat e njeriut", Vlorë)	8.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
"Për fëmijët tanë, për të ardhmen tonë" (Bashkia Vlorë)	9.3	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Integrimi në shkollë i fëmijëve romë dhe ndërgjegjësimi i familjeve të tyre	8.2	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	Shoqatat joftimprurëse dhe institucionet arsimore duhet të bashkëpunojnë për të zbatuar projektin.
Qendra e kujdesit të përditshëm për fëmijët e Sarandës	8.2	Transformimi i qendrës rezidenciale për fëmijët në Sarandë në një shtëpi pritjeje të përkohshme, për të siguruar përkujdesje për fëmijët, nënat e të cilëve janë të punësuar në sektorin e turizmit ose në atë bujqësor.	Shoqatat joftimprurëse dhe institucionet arsimore duhet të bashkëpunojnë për të zbatuar projektin.
Festivali i Teatrit të Fëmijëve	9.3	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Rrjeti i këndeve të lojërave	9.4	Krijimi i një sistemi të këndeve publike të lojërave për fëmijët në qytetet dhe fshatrat kryesore të qarkut.	Do të ideohen projekte specifike të cilat do të zbatohen nga bashkitë dhe komunat, duke aplikuar gjithashtu metodologjitë e planifikimit pjesëmarrës.

Legjenda

- Projekt-idetë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë

- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-idetë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteve pjesëmarrëse
- Projekt-idetë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunat gjatë takimeve për konsultim
- Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
- * Projekt-idetë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 9 e projektit Shëndetësia në Qarkun e Vlorës

3 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Rehabilitimi i 2 qendrave shëndetësore në Komunën Horë-Vranisht	8.3	<i>Nevojitet informacion i mëtejshëm</i>	
Rrjeti komunitar i qendrave shëndetësore	8.3 4.5	Ngritja e qendrave komunitare shëndetësore në komunat e vogla, të përzgjedhura nëpërmjet kriterëve që variojnë nga popullsia të aksesit në potencialet e atraksioneve turistike. Komunat e përzgjedhura do të shërbejnë kështu si një pikë referimi për shërbimet shëndetësore për një grup fshatrash fqinje dhe për turistët që vizitojnë qarkun. Projektit duhet të përfshijë gjithashtu trajnimin e personelit sanitar në gjuhë të huaja, sidomos në anglisht.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Shëndetësisë, autoritetet vendore, institucionet e trajnimit, universitetet.
Përmirësimi i spitalit të Sarandës	8.3	Blerja e pajisjeve të reja; ndërtimi i maternitetit; trajnimi i specialisëve të rinj; adaptimi i standardeve të BE-së për shërbimet shëndetësore.	Partnerë të mundshëm: Ministria e Shëndetësisë, universitetet.

Legjenda

- Projekt-idetë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-idetë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteve pjesëmarrëse
- Projekt-idetë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunat gjatë takimeve për konsultim
- Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
- * Projekt-idetë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

Paketa 10 e Projektit Punësimi i grave në Qarkun e Vlorës

2 Projekte

Projektet/projekt-propozimet/projekt-idetë (dhe aplikuesit/propozuesit)	Veprimet e PS-së	Përshkrim i shkurtër	Shënime mbi zbatimin
Gratë në sipërmarrje	8.1	Mbështetja e krijimit të sipërmarrjeve që drejtohen nga gratë e punësuar, për të rritur punësimin dhe autonominë e tyre, në sektorët e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> • Artizanati – prodhimi i suvenirave artistike për turistët; • Përpunimi i ushqimeve (frutat, buka, etj.) në zonat rurale; • Turizmi familjar. 	Partnerë të mundshëm: AULEDA dhe shoqatat e grave në Vlorë dhe Sarandë
Programet e punësimit të grave për mirëmbajtjen e hapësirave publike	8.1	Ngritja e sipërmarrjeve sociale për gratë, që të kontraktohen nga autoritetet vendore për të ndërmarrë aktivitetet e mirëmbajtjes dhe të pastrimit të hapësirave publike, zonave me gjelbërim etj.	Partnerë të mundshëm: Autoritetet vendore dhe shoqatat e grave në Vlorë dhe Sarandë

Legjenda

- Projekt-idetë e sugjeruara nga ekspertët e Planifikimit Strategjik, të bazuara në rezultatet e pjesëmarrjes
- Projekt-propozimet nga një ekspert i ILS LEDA-s, të bazuara në një studim të zinxhirëve të vlerave
- Projektet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së dhe të vendosura në një projektfishë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 1-rë
- Projekt-propozimet prioritare që aktorët territorialë i kanë paraqitur KPQ-së – faza e 2-të
- Projekt-idetë u ngritën gjatë takimeve dhe aktiviteve pjesëmarrëse
- Projekt-idetë të propozuara drejtpërdrejt nga bashkitë/komunat gjatë takimeve për konsultim
- Projektfishat e dorëzuara nga grupet e interesit dhe iniciativat e bashkëpunimit të decentralizuar
- * Projekt-idetë që mund të zbatohen duke marrë si model referimi novacionet e IDEASS

3.4. Sinergjitë ndërmjet Paketave të Projekteve

Në përputhje me qasjen e integruar, të miratuar nga PS-ja, 10 Paketat e Projektit (PP-të) janë në sinergji të fortë ndërmjet tyre. Për shembull:

PP1 "Turizmi tematik në Qarkun e Vlorës" është në sinergji të fortë me:

- PP2 "Markat për produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës" dhe PP5 "Artizanati në Qarkun e Vlorës" – niveli i lartë i sinergjisë rezulton nga potenciali i ushqimit tradicional i produkteve joushqimore për të shërbyer si atraksione turistike: Përmirësimi i cilësisë së tyre mund të ndihmojë në diversifikimin e ofertave turistike dhe për ta bërë qarkullimin e turistëve më pak sezonal, duke i joshur turistët që të zbulojnë zonat rurale ku traditat janë më të forta. Për më tepër, politikat dhe procedurat për vendosjen e markave mund të aplikohen për strukturat dhe shërbimet turistike.
- PP3 "Mbrojtja e ujit dhe e tokës", PP4 "Rrugët detare në Qarkun e Vlorës", PP6 "Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës" dhe PP9 "Shëndetësia në Qarkun e Vlorës" - Zhvillimi i turizmit është i lidhur ngushtë me përmirësimin e infrastrukturës bazë për ruajtjen e burimeve natyrore, përmirësimin e rrjeteve të transportit (si në tokë dhe në det) dhe shërbimet shëndetësore, për t'i lejuar turistët që të lëvizin më lirshëm dhe më të sigurt brenda territorit rajonal dhe përhapja e TIK-ut për të promovuar burimet dhe produktet territoriale në tregjet e jashtme.

PP2 "Markat për produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës" krijon sinergji të forta me PP1 (siç është shpjeguar më parë) dhe me PP3 "Mbrojtja e ujit dhe e tokës". Për sa i përket lidhjes së fundit, nga njëra anë mbrojtja e ujit dhe e tokës nga ndotja dhe nga rreziqet e tjera është thelbësore për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve agroushqimore (të çertifikuara me marka) dhe shëndetin e kafshëve të fermës; nga ana tjetër, çdo markë do të përcaktohet duke lidhur arritjen e saj me përputhshmërinë ndaj kërkesave të qëndrueshmërisë mjedisore, duke përçuar idenë se cilësia e produkteve dhe ruajtja territoriale janë të ndërvarura.

Ekzistojnë gjithashtu sinergji të forta ndërmjet PP2 dhe:

- PP5 "Artizanati i Qarkut të Vlorës" – PS-ja parashikon politikat e vendosjes së markave

si për produktet ushqimore ashtu dhe për produktet karakteristike joushqimore; procedurat janë të ngjashme dhe mund të ideohet dhe të aplikohet gjithashtu një *markë gjithëpërfshirëse* për të gjitha produktet rajonale.

- PP6 "Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës" – TIK-u do të jetë një instrument kryesor për të promovuar markën(at) e Qarkut të Vlorës në mbarë botën duke i integruar kështu në tregjet ndërkombëtare.
- PP10 "Punësimi i grave në Qarkun e Vlorës" – Gratë që merren me aktivitete bujqësore dhe të përpunimit do të përfitojnë asistencë dhe mbështetje teknike për të arritur çertifikimet dhe markat për produktet e tyre.

4 PP-të e fundit (PP7 "Rrjeti i përkujdesjes sociale në Qarkun e Vlorës", PP8 "Fëmijët e Qarkut të Vlorës", PP9 "Shëndetësia në Qarkun e Vlorës" dhe PP10 "Punësimi i grave në Qarkun e Vlorës"), të cilat që të gjitha trajtojnë çështjet sociale, zhvillojnë sinergji të forta dhe reciproke, duke krijuar kushtet për mundësi të barabarta dhe për akses të barabartë në shërbimet e përkujdesjes sociale. Mund të zhvillohen gjithashtu sinergji të forta ndërmjet PP7 dhe PP10, nga njëra anë dhe ndërmjet PP1, PP2 dhe PP5 nga ana tjetër: kjo është për shkak të prezencës së projekteve që synojnë përfshirjen e grave dhe të grupeve të pafavorizuara në tregun e punës dhe sidomos në sektorët që janë vlerësuar strategjikë për ekonominë rajonale: turizmi, prodhimet agroushqimore dhe artizanati:

Tabela 2 që paraqitet në faqen e mëposhtme, përmban një vlerësim cilësor të nivelit të sinergjisë i cili mund të zhvillohet ndërmjet Paketave të Projektit; ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë tre shkallët e lidhjes reciproke në rritje:

- **sinergji e ulët:** PP-të kanë të përbashkëta vetëm të njëjtin objektiva të përgjithshëm
- **sinergji mesatare:** PP-të kanë të përbashkëta të njëjtat objektiva të përgjithshme dhe grupe përfituese/aktorë territorialë të përfshirë
- **sinergji e lartë:** PP-të janë të ndërvarura ngushtë dhe materialisht të lidhura, për shkak se kanë të përbashkët të njëjtat objektiva, grup(e) përfitues, zonë(a) të ndërhyrjes dhe aktivitete.

Tabela 2.

Sintetizimi i sinergjive ndërmjet 10 Paketave të projektit për zhvillimin e qëndrueshëm të Qarkut të Vlorës

	Turizmi tematik në Qarkun e Vlorës	Markat për Produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës	Mbrojtja e ujit dhe e tokës	Rrugët detare në Qarkun e Vlorës	Artizanati i Qarkut të Vlorës	Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës	Rrjeti i përkujdesjes sociale në Qarkun e Vlorës	Fëmijët e Qarkut të Vlorës	Shëndetësia në Qarkun e Vlorës	Punësimi i grave në Qarkun e Vlorës
1	Turizmi tematik në Qarkun e Vlorës	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●	●	●●●●	●●
2	Markat për produktet ushqimore të Qarkut të Vlorës		●●●●	●	●●	●●	●	●	●	●●
3	Mbrojtja e ujit dhe e tokës	●●●●		●●●●	●●●●	●●●●	●	●	●	●
4	Rrugët detare në Qarkun e Vlorës	●	●●●●		●	●●	●	●	●●	●
5	Artizanati i Qarkut të Vlorës	●●●●	●●●●	●		●●	●●	●●	●	●●
6	Infrastruktura bazë dhe TIK-u për Qarkun e Vlorës	●●●●	●●●●	●●	●●		●●	●	●●	●
7	Rrjeti i përkujdesjes sociale në Qarkun e Vlorës	●	●	●	●●	●●		●●●●	●●●●	●●●●
8	Fëmijët e Qarku i Vlorës	●	●	●	●●	●	●●●●		●●●●	●●●●
9	Shëndetësia në Qarkun e Vlorës	●●●●	●	●	●	●●	●●●●	●●●●		●●●●
10	Punësimi i grave në Qarkun e Vlorës	●●	●	●	●●	●	●●●●	●●●●	●●●●	

Niveli i sinergjise: ●●●: i larte; ●●: mesatar; ●: i ulet

3.5. Një e ardhme për Planin Strategjik: Projektet e koordinuara të zhvillimit

10 Paketat e Projektit për zhvillimin rajonal përfaqësojnë rezultatet kryesore të procesit të planifikimit strategjik të Qarkut të Vlorës.

Për shkak të natyrës së tyre tematike, projektet që ato përmbajnë janë të shpërndara në të gjithë territorin e rajonit. Rrjedhimisht, për ta zbatuar PS-në në mënyrë sa më të efektshme, do të jetë e nevojshme të identifikohen zonat fizike të ndërhyrjes në nivel nënrajonat, gjithashtu për të lehtësuar krijimin e një partneriteti të projekteve dhe për t'i bërë veprimet e tyre më të mprehta. Prandaj dhe sfida është që të fillojnë dhe të zhvillohen një grup projektesh të integruara, duke përfshirë zonat e ngjashme të ndërhyrjes, bazuar në veçoritë e tyre strukturore, social-ekonomike dhe/ose kulturore. Këto projekte të integruara do të rrjedhin drejtpërdrejt nga rezultatet e procesit të kryer të planifikimit strategjik dhe do të shërbejnë si "shprehja e prekshme" e strategjisë së përbashkët të zhvillimit për territorin rajonal. Përmes tyre, veprimet e PS-së rajonale do të zbatohen gradualisht, hap pas hapi, gjithnjë duke marrë parasysh "tablonë e madhe" të përfaqësuar nga Vizioni dhe Strategjia e përgjithshme.

Projektet e integruara të propozuara ose Projektet e Koordinuara të Zhvillimit (PKZH) janë katër:

1. Qarku i turizmit kulturor

Krijimi i qarqeve të turizmit tematik që përfshijnë vendet e trashëgimisë kulturore të përhapura në të gjithë qarkun, për t'u menaxhuar dhe promovuar në mënyrë të koordinuar nëpërmjet pjesëmarrjes aktive dhe bashkëpunimit të të gjitha niveleve të qeverisjes, shoqatave kulturore, sipërmarrjeve dhe bizneseve të lidhura me turizmin.

2. Rrethi rural i luginës së Shushicës

Krijimi i një partneriteti për menaxhimin dhe zhvillimin e koordinuar të zonës së nënrajonit që karakterizohet për traditën bujqësore organike, potencialin e lartë turistik, peizazhin e pasur dhe për trashëgiminë kulturore. Partneriteti do të përfshijë qeverisjet vendore dhe një grup biznesesh (individualë dhe në partneritet), që

punojnë në sektorin agroushqimor dhe atë të turizmit, të cilët do të bashkëpunojnë për të:

- zhvilluar projektet e përbashkëta për zhvillimin rural, duke filluar nga projektet e PS-së në sektorin agroushqimor
- zhvilluar rrugët turistike për ecjet në natyrë, ngjitjet dhe për aktivitete të tjera turistike jashtë në natyrë
- zhvilluar prodhueshmërinë dhe zgjerimin e larmisë së aktiviteteve rurale; për të mbështetur finalizimin dhe integrimin e zinxhirëve të vlerave; për të mbështetur arritjen e çertifikimeve të cilësisë dhe krijimin e një marke territoriale për produktet e Qarkut të Vlorës ("markë gjithëpërfshirëse").


3. Qarku i turizmit peizazhor të bregdetit jugor të Shqipërisë

Zbatimi dhe integrimi i Planit për zhvillimin e bregdetit jugor të Shqipërisë, duke e shtrirë në të gjithë Qarkun dhe zbatimi i projekteve të PS-së lidhur me bregdetin, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare të Qarkut.

4. Rrethi agroushqimor i Delvinës

Krijimi i një partneriteti për menaxhimin dhe zhvillimin rural të koordinuar të një zone nënrajonale, që karakterizohet nga tradita e fortë agrikulturore dhe trashëgimia e pasur e produkteve tipike agroushqimore me një treg të konsoliduar (Saranda). Partneriteti do të përfshijë qeverisjet vendore dhe një grup biznesesh (të pavarura dhe në partneritet), që punojnë në sektorin agroushqimor, të cilët do të bashkëpunojnë për të:

- zhvilluar projektet e përbashkëta për zhvillimin rural, duke filluar nga projektet e PS-së në sektorin agroushqimor; për të përmirësuar produktivitetin dhe zgjerimin e larmisë së aktiviteteve rurale dhe për të mbështetur finalizimin dhe integrimin e zinxhirëve të vlerave
- mbështetur arritjen e çertifikimeve të cilësisë
- mbështetur krijimin e një marke territoriale për produktet e Qarkut të Vlorës ("markë gjithëpërfshirëse").



PKZH1
Qarku i turizmit kulturor

PKZH2
Rrethi rural i luginës së Shushicës

PKZH3
Qarku i turizmit peizazor të bregdetit jugor të Shqipërisë

PKZH4
Rrethi agroushqimor i Delvinës



